

**ASPEKTE TEORIKO-PRAKTIKE TE EKZEKUTIMIT TË  
SANKSIONEVE PENALE NË KOSOVË (1945–2014)  
(Vështrim krahasues)**

Resmi HOXHA

\_\_\_/10/2015

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANES  
DEPARTAMENTI JURIDIK

NE PERMBUSHJE TE DETYRIMEVE PER DOKTORATURE NE  
PROGRAMIN E STUDIMIT TË \_\_\_\_\_

Ass. Prof. Drejtës Mirgen Prenca

*59 965 fjalë*

**Tiranë,  
Maj 2015**

## DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim me titull: ASPEKTE TEORIKO-PRAKTIKE TE EKZEKUTIMIT TË SANKSIONEVE PENALE NË KOSOVË (1945–2014) (Vështrim krahasues), është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Tiranë,

\_\_\_\_. 10. 2015

Emri mbiemri dhe nënshkrimi

Resmi HOXHA

-----  
Tiranë, 2015

## PERMBAJTJA

<b>Deklarata e autorësisë .....</b>	<b>2</b>
<b>Permbajtja.....</b>	<b>3</b>
<b>Abstrakt.....</b>	<b>7</b>
<b>Abstract .....</b>	<b>8</b>
<b>Falenderime.....</b>	<b>9</b>
<b>Lista e shkurtimeve dhe e fjalorit .....</b>	<b>10</b>
<b>KAPITULLI I: HYRJE .....</b>	<b>11</b>
1. 1. Shtrimi i problemit.....	12
1. 2. Qëllimi i studimit .....	14
1. 3. Burimet e referimit.....	16
1. 4. Hipoteza / hipotezat e punimit .....	18
1.5. Pyetjet kërkimore te punimit.....	19
1.6. Metodadat dhe metodologjia e kërkimit .....	20
1.7. Mundësitë dhe kufizimet.....	21
<b>KAPITULLI II.....</b>	<b>23</b>
<b>KUPTIMI, ROLI DHE QELLIMET E SANKSIONIT PENAL .....</b>	<b>23</b>
2.1. Standardet ndërkombëtare për zbatimin e dënimeve penale.....	27
2.2. Baza juridike e zbatimit të sanksioneve penale në Kosovë .....	30
2.2.1. Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ekzekutimi i sanksioneve penale .....	32
2.2.2. Privimi i lirisë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës miratuar më 2008 .....	36
2.2.3. Parimet e dënimit penal sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës ..	42
2.2.4. Kodi i Procedurës Penale te Kosovës.....	45
2.2.5. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale te Kosovës .....	49
2.3. Veprimi i legjislacionit penal të Kosovës, për veprat penale që kryhen jashtë territorit të Kosovës .....	54
2.3.1. Sanksionet penale sipas Kodit Penal të Kosovës .....	57
2.3.2. Llojet e sanksioneve penale në përgjithësi .....	59
2.3.3. Sistemi i sanksioneve penale në të drejtën penale të Kosovës .....	60
2.3.4. Llojet e masave dhe sanksioneve ndaj të miturve .....	61
2.3.5. Sistemi i dënimeve në të drejtën penale të Kosovës (Petroviq, f. 111).62	
2.3.6. Dënimi me vdekje (Petroviq, 2006: 111) .....	64
2.3.7. Elementet e përgjithshme të dënimit (Petroviq, 2006: 111).....	65
2.3.8. Elementët relativ të dënimit .....	66
2.4. Dënimet penale sipas kodit penal të Kosovës.....	68
2.4.1 Dënimi me burg të përjetshëm .....	71

2.4.2. Dënimi me burg.....	71
2.4.3. Dënimi me gjobë .....	72
2.4.4. Masat e trajtimit të detyrueshëm .....	73
2.4.4.1. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në institucion adekuat .....	74
2.4.4.2. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri.....	76
2.4.5. Trajtimi dhe rehabilitimi i personave të varur nga droga dhe alkooli ...	77
2.4.6. Dënimet alternative – një risi e kodit penal të Kosovës .....	78
2.4.6.1 Dënimi me kusht .....	79
2.4.6.2. Gjysëmliria .....	80
2.4.6.3. Urdhri për punë me dobi shoqërore.....	82
2.4.6.4. Urdhri për trajtim të detyrueshëm rehabilitues .....	83
2.4.6.5. Urdhri për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues .....	84
2.4.7. Dënimet plotësuese sipas Kodit penal të Kosovës .....	85
2.4.7.1 Heqja e të drejtës për të u zgjedhur .....	86
2.4.7.2. Urdhri për kompensimin e dëmit .....	86
2.4.7.3. Ndalim i ushtrimit të funksionit .....	87
2.4.7.4. Ndalim i ushtrimit të profesionit .....	87
2.4.7.5. Konfiskimi – marrja e sendit .....	88
2.4.7.6. Urdhri për publikimin e aktgjykimit .....	89
2.4.7.7. Dëbimi .....	89
<b>KAPITULLI III .....</b>	<b>90</b>
<b>POLITIKA PENALE NË VËSHTRIMIT HISTORIK NË KOSOVË.....</b>	<b>90</b>
3.1. Kriminaliteti dhe politika penale në Kosovë .....	90
3.1.1. E drejta penale e Kosovës gjatë periudhës së feudalizmit; .....	90
3.1.2 E drejta penale e Kosovës midis dy luftërave botërore (1918-1941) .....	98
3.1.3. E drejta penale e Kosovës pas luftës së dytë botërore.....	99
3.1.4. Ligji penal i RSFJ të Jugosllavisë dhe Ligji penal i KSAK .....	100
3.2. Politika e dënimit në Kosovë gjatë periudhës 1945 – 1968.....	104
3.3. Politika e dënimit në Kosovë gjatë periudhës 1968 – 1989.....	105
3.4. Politika e dënimit në Kosovë gjatë periudhës 1989 – 1999.....	112
3.5. Politika e dënimit në Kosovë gjatë periudhës 1999-2008 .....	114
<b>KAPITULLI IV .....</b>	<b>117</b>
<b>PROCEDURA E EKZEKUTIMIT TE SANKSIONEVE PENALE SIPAS</b>	
<b>LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS.....</b>	<b>117</b>
4.1. Veprimet procedurale për ekzekutimin e sanksioneve penale .....	119
4.1.1. Ardhja e vendimeve të formës se prere nga Gjykata .....	119
4.1.2. Aktgjykimi dhe aktvendimi qe nuk e ka formën e prere.....	120
4.1.3. Nxjerrja e urdhrit për ekzekutim të vendimit .....	121
4.2. Fillimi i ekzekutimit të vendimeve .....	121
4.2.1. Fillimi Ekzekutimit me Burgim apo Burgim Afatgjatë .....	122
4.2.2. Fillimi dhe shtyrja e ekzekutimit me burg dhe burgu afatgjatë.....	123
4.3. Shtyrja e ekzekutimit të vendimit .....	125
4.4. Përfundimi i ekzekutimit të vendimit si formë e fundit e procesit .....	127
4.5. Ekzekutimi i dënimit me gjobë .....	130
4.6. Ekzekutimi i Dënimit me Burgim dhe Burgim të përjetshëm .....	131
4.7. Ekzekutimi i Dënimit me burgim te pezulluar.....	134

4.8. Ekzekutimi i Dënimeve plotësuese .....	136
4.8.1. Heqja e të drejtës për tu zgjedhur .....	137
4.8.2. Urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit .....	138
4.8.3. Ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës .....	139
4.8.4. Ndalimi i drejtimit të automjetit .....	140
4.8.5. Marrja e sendeve – konfiskimi .....	141
4.8.6. Dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës .....	141
4.9. Ekzekutimi i urdhërimeve të tjera të Gjykatës .....	142
4.9.1. Parimi i identitetit të normave lidhur me ekstradimin .....	145
4.9.2. Parimi i specialitetit lidhur me ekstradimin .....	146
4.9.3. Parimi i disponibilitetit .....	146
4.9.4. Pengesat për ekstradimin lidhur me kryerësin e veprës penale .....	149
4.10. Transferi i procedurës penale shtetit të huaj .....	154
4.11. Njohja e aktgjyqimeve penale të gjykatave të huaja të shteteve të huaja .....	156
4.12. Ekzekutimi i urdhërimeve të tjera të gjykatës .....	159
4.13. Ekzekutimi i vendimeve që nuk kanë marrë formë të prerë .....	160
4.14. Ekzekutimi i masave mjekësore .....	164
4.15. Roli i Gjykatave dhe Prokurorisë në ekzekutimin e sanksioneve penale .....	168
4.16. Roli i gjykatës në ekzekutimin e vendimeve penale .....	175
4.17. Roli i policisë në ekzekutimin e sanksioneve penale .....	186
4.18. Roli i institucioneve të vuajtjes së dënimit me burgim .....	189
<b>KAPITULLI V .....</b>	<b>195</b>
<b>VËSHTRIM KRAHASUESË E LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME</b>	
<b>VENDE TË TJERA .....</b>	<b>195</b>
5.1. Vështrim krahasuesë e legjislacionit të Kosovës me vende të tjera lidhur me sanksionet penale dhe sistemin e institucioneve të ekzekutimit të tyre në rajon .....	195
5.1.1. Sanksionet penale dhe institucionet e ekzekutimit të tyre sipas legjislacionit penal shqiptar .....	200
5.1.2. Sanksionet penale dhe institucionet e ekzekutimit të tyre sipas legjislacionit penal të Kroacisë .....	205
5.1.3. Sanksionet penale dhe institucionet e ekzekutimit të tyre sipas legjislacionit penal të Sllovenisë .....	207
5.1.4. Sanksionet penale dhe institucionet e ekzekutimit të tyre sipas legjislacionit penal Serbisë .....	209
<b>KAPITULLI VI .....</b>	<b>212</b>
<b>ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONEVE TË</b>	
<b>EKZEKUTIMIT E SANKSIONEVE PENALE .....</b>	<b>212</b>
6.1. Shërbimit Korrektues të Kosovës – organizmi dhe funksioni .....	212
6.1.1. Profesionalizmi, synimi dhe objektivat e këtij shërbimi .....	214
6.2. Si funksionon shërbimi korrektues i Kosovës, dhe baza ligjore e tij .....	215
6.3. Struktura organizative e Shërbimit Korrektues .....	221
6.3.1. Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues .....	221
6.3.2. Llojet e institucioneve korrektuese .....	222
6.3.3. Organizimi i institucioneve të ekzekutimit të sanksioneve penale për të rriturit .....	225

6.6. Qendrat e paraburgimit, për ekzekutimin e paraburgimit dhe dënimeve me burgim deri në tre (3) muaj.....	226
6.7. Burgjet, për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe burgim të përjetshëm	229
6.8. Burgu i sigurisë së lartë.....	230
6.9. Qendra Korrektuese për dënime të gjata.....	232
6.10. Qendra korrektuese për dënime të shkurta.....	233
6.11. Burgjet për femra, për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe masës së paraburgimit .....	235
6.12. Organizimi i institucioneve të ekzekutimin e sanksioneve penale për të mitur .....	236
6.12.1. Qendra Korrektuese për të mitur në Lipjan.....	236
6.12.2. Institucionet edukativo-korrektuese për ekzekutimin e masave edukative të dërgimit të kryesit të mitur në institucionin edukative-korrektues,...	239
6.12.3. Burgjet për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm - Burgu i sigurisë së lartë.....	240
6.12.4. Burgu për të dënuar dëshmitar të mbrojtur .....	241
6.13. Organizimi i shërbimit të provës.....	244
<b>KAPITULLI VII.....</b>	<b>248</b>
<b>BASHKËPUNIMI PENALE NDËRKOMBËATR NË FUSHË NË FUSHËN E EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT .....</b>	<b>248</b>
7.1. Nevoja për bashkëpunim rajonal si nevojë e parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit .....	250
7.2. Arritje dhe Sfida në fushën e bashkëpunimit penal ndërkombëtar dhe rajonal lidhur me ekzekutimin e dënimeve penale .....	253
<b>SHTOJCA A .....</b>	<b>263</b>
<b>Ligje dhe rregullore.....</b>	<b>263</b>
Akte nënligjore për ekzekutimin e sanksioneve penale në Kosovë .....	269
Udhëzime administrative .....	271
Rregulloret .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Rendi Shtëpiak i Qendrave të Paraburgimit dhe Qendrave Korrektuese.....	220
<b>PËRFUNDIMEVE DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>273</b>
Rekomandimet: .....	276
<b>LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA .....</b>	<b>279</b>

## ABSTRAKT

Drejtësia është drejtësi vetëm atëherë kur ajo realizohet deri në fund, që do të thotë atëherë kur shkelësi i ligjit, ta vuaj dënimin, e tij!

Në Kosovë, në periudhën 1945-2014 kemi kaluar nëpër disa sisteme të ndryshme, me ngjyrimet politike krejt kontradiktore dhe qëllime të ndryshme; nga ato shkatërruese deri tek ato ndërtuese dhe mirë-funksionalizuese, çka e bënë edhe penologjinë në periudhë krahasimore atraktive dhe me interes analitik sikurse edhe ekzekutimin e sanksioneve penale dhe bartësve ekzekutiv të tyre të nduardurshëm, duke lejuar një hapësirë të lartë analizimi dhe kërkime shkencore.

E drejta për ekzekutim të aktgjykimit (në rastin tonë të sanksioneve penale) është një pjesë integruese e së drejtës për gjykim të drejtë brenda kohës së arsyeshme. Ky punim, shqyrton kornizën ligjore si në vend ashtu edhe atë ndërkombëtare të zbatueshme për ekzekutimin e sanksioneve penale; punimi po ashtu shqyrton edhe zbatimin e tyre të deritashëm nga ana e institucioneve si dhe ingranazhin e përgjithshëm të procesit të ekzekutimit të sanksioneve penale.

Punimi më tej vazhdon të shqyrtojë praktikën për ekzekutimin e sanksioneve penale në Kosovë, dhe analizohen kodet penale të Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë, Kroacisë, Gjermanisë, Francës dhe Anglisë, duke sjellë kështu një analizë, duke nënvizuar më tej mangësitë në procesin e ekzekutimit të sanksioneve penale në Kosovë.

Përgjithësisht jepet një trajtim analitik dhe vështrime krahasimore të ekzekutimit të sanksioneve penale në Kosovë duke e pasuruar këtë vështrim edhe me statistika dhe raporte të punës së bartësve të ekzekutimit të sanksioneve penale si dhe duke shtjelluar penologjinë përgjithësisht, politikën penalogjike në Kosovë në periudhën kohore, sistemin e ekzekutimit të sanksioneve penale, burgjet, ndarjen organizimin, funksionimin e tyre, rolin e institucioneve si prokurorisë, gjykatës, policisë në këtë ekzekutim, të drejtat e të provuarve apo të sanksionuarve me sanksione penale.

## **Abstract**

*Justice is justice only when it is carried to the end, which means when the offender, to serve the sentence, his!*

*In Kosovo, in the period 1945-2014 have gone through several different systems, with political overtones quite contradictory and different purposes; of those devastating to those building and well-function, what makes the comparative period penology attractive and analytically interest as well as the execution of criminal sanctions and their holders type multivariate executive, allowing a space of critical thinking and scientific curiosity.*

*The right of execution of the judgment (in our case, criminal sanctions) is an integral part of the right to a fair trial within a reasonable time. This paper examines the legal framework in the country and the international applicable to the enforcement of criminal sanctions; the paper also examines their implementation so far by the institutions and the general pinion in the execution of criminal sanctions.*

*The paper goes on to examine the practice of executing criminal sanctions in Kosovo, and analyzed criminal codes of Albania, Macedonia, Serbia, Croatia, Germany, France and England, bringing with it an analysis, further highlighting the shortcomings in the execution process criminal sanctions in Kosovo.*

*Generally given a treatment analytically and comparative reviews of the execution of criminal sanctions in Kosovo, enriching this look with statistics and reports of the work of holders of execution of criminal sanctions and arguing penology generally penology policy in Kosovo in the period, the system the execution of criminal sanctions, prisons, sharing organization, their functioning, role of institutions like the prosecution, court, police in the execution, the rights of the deprived or criminal sanctions sanctioned.*



## **FALENDERIME**

*Nuk mund të përshkruhen të gjitha ndodhitë mbresëlënëse të cilat kanë ndodhur që kur fillova studimet në UET. Për rrjedhojë, do ta kufizoj vetëm me falënderimin e disa prej shumë personave, të cilët ndihmuan në përmbushjen e studimeve të mia, të cilëve do të doja t'u shprehja mirënjohjen time.*

*Një falënderim special për profesorin tim, mentorin Dr.Mirgen PRENCE, për ndihmën dhe mbështetjen e çmuar që më ofroi për gjatë gjithë punës sime dhe për kontributin e tij në finalizimin e disertacionit, produkti i shumë orëve konsultimi dhe mbështetjeje nga ana e tij.*

*Faleminderit Profesor.*

*Falënderoj familjen time për mbështetjen që më ka dhënë si dhe kolegët dhe bashkëpunëtorët profesional për mbështetjen e pakufizuar deri më tani.*

*Me respekt, i juaji !*

**Resmi Hoxha**

*Prishtinë, 2015*

## **LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT**

KP – Kodi penal,

QPB – Qendra e para burgimit

KKVK – Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e përkohshme të Kosovës

UNMIK – Misioni administrues i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

OSBE – Organizata për siguri dhe bashkëpunim evropian,

SHKI – Shërbimi Korrektues Institucioneve

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

## KAPITULLI I: HYRJE

Në Republikën e Kosovës, të gjithë personat e dënuar për vepra të ndryshme penale dhe ata të cilët supozohet se kanë kryer vepër penale privohen nga liria dhe vendosen në Institucionet e Shërbimit Korrektues të Kosovës, si: në Qendra të paraburgimit, Qendra korrektuese apo në Burgun e sigurisë së lartë.

Në Qendrat e paraburgimit vendosën të gjithë personat të cilët supozohet se kanë kryer vepër penale dhe gjenden nën hetime si dhe personat ndaj të cilëve është vërtetuar akuza për vepër penale të kryer. Në Qendra korrektuese vendosen personat e dënuar kur vendimi i gjykatës është i fermës së prerë. Të gjithë të dënuarit për vepra penale të ndryshme e që dënimi i tyre është gjerë në 3 vite, vendosen në Qendrën korrektuese për dënime të shkurta në Smrekonicë, kurse të dënuarit me vendim të formës së prerë, e që janë të dënuar mbi tri vite burgim vendosen në Qendrën korrektuese për dënime të gjata në Dubravë. Të miturit të cilët janë të dënuar me burg për të mitur dhe atyre të cilëve iu është dhënë masa edukuese korrektuese 1 gjerë në 5 vite, vendosën në Qendrën Korrektuese për të mitur në Lipjan. Femrat e privuara nga liria për shkak të dyshimit se kanë kryer vepër penale apo ato të cilat janë dënuar dhe kanë vendim të formës së prerë për veprën e kryer vendosen në Qendrën korrektuese për femra në Lipjan. Personat e dënuar mbi 15 vite burg dhe me dënim të përjetshëm, si dhe ata të cilët nga organet kompetente që janë të klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë vendosën në Burgun e sigurisë së lartë në Grdovc. Në Qendrat e paraburgimit, në Qendrat korrektuese dhe në Burgun e sigurisë së lartë bëhet klasifikimi i të burgosurve në bazë të moshës së tyre, veprës penale që kanë kryer, e kaluara kriminale, gjendja shëndetësore si dhe në bazë të nevojave të tyre individuale për arsimim, aftësim profesional, punësim etj.

## **1. 1. Shtrimi i problemit**

Ky punim ka për qëllim pasqyrimin i zhvillimit dhe ngritjes së Shërbimit Korrektues të Kosovës në periudha të ndryshme kohore e në veçanti në periudhën kohore të pasluftës që nga viti 1999 e gjerë më sot. Ngritja dhe zhvillimi i Institucioneve të Shërbimit Korrektues të Kosovës në periudhën e pasluftës nga viti 1999, ka qenë pjesë e një tranzicion legal nëpër të cilën ka kaluar Republika e Kosovës gjatë administrimit ndërkombëtar në bazë të Rezolutës 1244. Procesi i reformimit të Institucioneve të Shërbimit Korrektues të Kosovës në periudhën e pasluftës ka qenë një nga fushat, ku krahas përpjekjeve për të ndërtuar një koncept të ri të funksionimit të Institucioneve të Shërbimit Korrektues të Kosovës është punuar dhe vepruar edhe në unifikimin e rregullave proceduarave të punës me normat dhe standardet ndërkombëtare. Rezoluta 1244 dhe Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e përkohshme të Kosovës e kanë përcaktuar autoritetin e UNMIK-ut për të shtrirë kompetencat dhe fushën e veprimtarisë së vetë në të gjithë territorin e Kosovës ku kanë qenë Institucionet e Shërbimit korrektues të Kosovës. Vlen të theksohet se në këtë drejtim nuk ka pasur vështirësi që UNMIK të administrojë të gjitha Qendrat e Paraburgimit dhe Qendrat korrektuese të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Shikuar në aspektin kronologjik, përpjekjet për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës mund të ndahen në tri periudha:

Periudha e parë përfshinë kohën e administrimit të përkohshëm të Institucioneve të Shërbimit Korrektues të Kosovës nga ana e KFOR-it, Qershor 1999. Periudha e dytë fillon me UNMIK-un, i cili merr kompetencat nga KFOR-i për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës nga Janari i vitit 2000. Periudha e tretë fillon me kalimin e kompetencave nga UNMIK-u në Qeverinë e Kosovës, më saktë kalimi i

kompetencave nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut në Ministrin e Drejtësisë së Qeverisë së Kosovës që ka ndodhur në Qershor të vitit 2006. Duke analizuar në mënyrë profesionale tërë procesin dhe fazat nëpër të cilat ka kaluar Organizimi dhe funksionimi i Institucioneve të Shërbimit korrektues të Kosovës, kam vënë në dukje edhe të metat dhe rreziqet që sjell çdo improvizim apo kopjim i ndonjë Shërbimi Korrektues të ndonjë Shteti nga Bashkësia Ndërkombëtare. Kjo ndodh për shkak se modelet e ndryshme të shteteve të ndryshme do të kishin efekt jo të mirë dhe jo në përputhje me nevojat, strukturën dhe funksionin e institucioneve të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Në vendimin tim për ta hulumtuar çështjen e Organizimit dhe funksionimit të Institucioneve të Shërbimit korrektues të Kosovës kanë ndikuar shumë faktor. I pari konsiston në aktualitetin e procesit dhe forcimin e sundimit të ligjit në Kosovës. Momenti i dytë ka të bëjë me përkushtimin tim profesional e praktik në reformimin dhe Krijimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës si një shërbim modern dhe në përputhje me nevojat dhe kushtet e Kosovës.

Puna ime është orientuar në drejtim të vënies në dukje të njohurive dhe përvojave të mia praktike dhe profesionale të fituara në vite në Institucionet për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, për ti kurorëzuar në punim profesional, i cili mund të ketë rëndësi në zhvillimin dhe ngritjen e Shërbimit Korrektues të Kosovës edhe në të ardhmen.

Gjatë hartimit të këtij punimi kamë aplikuar metodat e hulumtimeve në fushën Juridike-Penologjike, duke zbatuar metodat normative, analitike dhe sinteza, induksioni dhe deduksioni, metoda kooperative statistikore etj. Në veçanti jam munduar që hulumtimin ta ilustroj me paraqitje empirike duke pasqyruar periudha të ndryshme të funksionimit të Shërbimit korrektues të Kosovës. Gjatë hartimit të punimit kam shfrytëzuar literaturën kombëtare e ndërkombëtare e që i referohet zhvillimit të

institucioneve për ekzekutimin e sanksioneve penale si dhe kam shfrytëzuar akte ligjore e kushtetuese që i referohen kësaj fushe.

## **1. 2. Qëllimi i studimit**

Në vështrimin historik, legjislacioni mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ka njohur rrugën e vet të zhvillimit dhe të transformimit që nga krijimi i shtetit të pavarur shqiptare deri në ditët e sotme. Ai ka pësuar ndryshime në varësi të zhvillimeve ekonomike, shoqërore, politike ideologjike etj.

Duke bërë një ndarje të legjislacionit mbi ekzekutimin e vendimeve në: Legjislacioni mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale dhe Legjislacioni mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile.

Në Kosovë, aktgjykimet si në rastet civile ashtu edhe në ato penale, pasi të marrin formën e prerë, përbarohen/ekzekutohen nga zyrtarë për përbarime në gjykata, që përfshijnë gjyqtarë dhe referentë për përbarime. Në rastet civile, procedura përbarimore iniciohet nga kreditori në mënyrë që të fitojë gëzimin e së drejtës e cila veç se i është njohur në aktgjykim të formës së prerë apo në ndonjë tjetër dokument origjinal. Në rastet penale, ekzekutimi i sanksioneve penale fillon me automatizëm sapo aktgjykimi me të cilin është caktuar sanksioni penal merr formën e prerë dhe nuk ka pengesa ligjore për përbarim të tij. Sipas statistikave të publikuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), ka pasur një numër të përgjithshëm prej 89,201 të aktgjykimeve civile në pritje të përbarimit në gjykatat komunale në Kosovë deri në dhjetor të vitit 2009. Gjatë rrjedhës së periudhës dymbëdhjetë-mujore në vijim, 26,568 lëndë përbarimore civile u futën në sistem përderisa gjykatat kompletuan përgjithësisht 10,992 lëndë, duke rezultuar

më një numër të përgjithshëm prej 104,777 lëndë civile të pa përmbuaruara deri nga fundi i dhjetorit të vitit 2010. Kjo përfaqëson një rritje neto prej 15,576 të lëndëve gjatë kalimit të vitit, ose përafërsisht 17.46%. Andaj, në vitin 2010 gjykatat civile në përgjithësi kanë përfunduar përafërsisht 9.49% të numrit total prej 115,769 rasteve që ndodheshin pranë tyre gjatë vitit. Numrat në anën penale të përlllogaritjes, edhe pse shumë më të vegjël ende janë mjaft domethënës. Sipas statistikave të KGJK-së, ka pasur një numër të përgjithshëm prej 12,858 aktgjykimesh penale në gjykatat komunale në Kosovë nga fundi i dhjetorit të vitit 2009. Gjatë rrjedhës së periudhës pasuese dymbëdhjetë-mujore, 6,222 lëndë ekzekutive penale u futën në sistem përderisa gjykatat kompletuan përgjithësisht 5,651 lëndë, duke rezultuar në një numër të përgjithshëm prej 13,429 lëndë penale të pa-ekzekutuara deri nga fundi i dhjetorit të vitit 2010. Intervistat e kryera nga OSBE me referentët për ekzekutime zbulojnë së shumica dërmuese e këtyre aktgjykimeve parashohin gjoha monetare. Kjo ka qenë një rritje neto prej 571 të lëndëve gjatë kalimit të vitit, ose përafërsisht 4.44%. Andaj, në vitin 2010 gjykatat penale në përgjithësi kanë përfunduar përafërsisht 29.62% të numrit total prej 19,080 rasteve që ndodheshin pranë tyre gjatë vitit (KGJK, Departamenti i Statistikës; Raporti-2010: Statistika e gjykatave të rregullta, 2014: 18). E drejta për përmbarrim të aktgjykimit është një pjesë integruese e së drejtës për gjykim të drejtë brenda kohës së arsyeshme. Ky raport, shqyrton kornizën ligjore si në vend ashtu edhe atë ndërkombëtare të zbatueshme për përmbarrimin e aktgjykimeve civile dhe penale; raporti po ashtu shqyrton dispozitat e Strategjisë për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra të paraqitura nga KGJK-ja në nëntor të vitit 2010 dhe zbatimin e saj të deritashëm nga ana e gjykatave. Raporti më tej vazhdon të shqyrtojë praktikën përmbarrimore civile nga gjykatat në Kosovë; nënvizon gjetjet për dy lloje të rasteve përmbarrimore civile: ato që përfshijnë mbledhjen e faturave të papaguara për

shërbime komunale dhe ato që përfshijnë subjekte publike si debitorë të aktgjyqimeve. Raporti po ashtu nënvizon mangësitë në procesin e ekzekutimit të sanksioneve penale ndaj personave të dënuar për krime në Kosovë. Synimi i punimit ishte të kontribuonte në analizimin dhe matjen e përgjegjësive institucionale në “transparencën dhe përgjegjshmërinë” e organeve kompetente në zbatimin e vendimeve gjyqësore. Këtë punim planifikoj t’i arrij përmasat përfundimtare përmes realizimit të objektivave specifike: Matjen e shkallës së zbatueshmërisë së vendimeve gjyqësore, dhe sanksioneve ndaj veprave penale; Analizimin e kontekstit ligjor, metodologjik dhe konceptual krahasimor të zbatueshmërisë së vendimeve gjyqësore dhe sanksioneve ndaj veprave penale; Studimin e procesit administrativ që garanton zbatimin e vendimeve gjyqësore përmes ofrimit të rekomandimeve dhe sugjerimeve konkrete; Rritjen e ndërgjegjësimit të qeverisë, por edhe të aktorëve të tjerë me interes, lidhur me problematikat e evidentuara dhe mundësitë për zgjidhje.

### **1. 3. Burimet e referimit**

Është brengosës numri i madh i lëndëve përmbartimore/ekzekutive që është në rritje në Kosovë, po komprometon të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme, duke shkelur në këtë mënyrë si kornizën ligjore vendore ashtu edhe ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Thomas Hammarberg, Komisionari për të Drejta të Njeriut pranë Këshillit të Evropës, në vitin 2009 kishte thënë se “ekzekutimi i mangët i vendimeve përfundimtare gjyqësore duhet të shihet si refuzim për të pranuar sundimin e ligjit dhe është një problem serioz për të drejtat e njeriut.” (Thomas Hammarberg, 2009) Ai ka arritur në gjetjet se “niveli i ulët i zbatimit të vendimeve gjyqësore është një pengesë e



madhe për krijimin e besimit në gjyqësor.” Ai gjithashtu nënvizon se “aktgjykimet e pa-  
ekzekutuara kanë shkelur besimin e publikut në aftësinë, profesionalizmin dhe  
korrektësinë e gjyqësorit, duke kufizuar në këtë mënyrë qasjen efektive në drejtësi”  
(Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2010: 11).

Përmbartimi/ekzekutimi i aktgjykimeve është po ashtu indikator i pavarësisë  
gjyqësore: “Garancitë kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe pavarësia e gjyqësorit u  
lejojnë gjyqtarëve t’i mbrojnë të drejtat dhe liritë e individëve të përcaktuara me ligj.  
Megjithatë, këto garanci kushtetuese dhe mbrojtje ligjore humbin rëndësinë e vet atëherë  
kur vendimet gjyqësore nuk zbatohen. Veç kësaj, kur individëve u mungon besimi në  
zbatueshmërinë e vendimeve, ka gjasa që ata më pak të mbështeten në gjykata për  
zgjidhjen e kontesteve dhe si rezultat mund t’u kthehen mënyrave tjera jozyrtare dhe  
private për të kërkuar drejtësi. Me kalimin e kohës, dështimi për t’i zbatuar në mënyrë  
efektive vendimet do të zbeh besimin në sistemin e drejtësisë dhe sundimin e ligjit (ABA-  
CEELI, 2003: 1)” Në anën tjetër Vaselika Hysi konstaton se: ekzekutimi i vendimeve  
penale synon riedukimin e të dënuarve rivendosjen e të drejtave të personave të proceduar  
padrejtësisht dhe të të drejtave të subjekteve juridike të cenuara nga vepra penale (Hysi,  
2012: 120). Dënimet për veprat penale konsistojnë në dënimin me burg, dhe lidhur me  
Dënimin me burg Ragip Halili e konsideron paraqitjen burgimit si një hap të madh drejt  
humanizmit të reagimit të shoqërisë ndaj kriminalitetit e sidomos të tretmanit ndaj  
personave të dëmtuar (Halili, 2014: 103). Derisa kemi arritur një qëllim parësorë të  
preventivit të krimit përmes dënimit të shkelësve të ligjeve dhe rregullore si ndaj  
personave fizik ashtu edhe nga institucioneve në përgjithësi, duke lindur kështu Teoria e  
frikësimit me ekzekutimin e dënimit konsideron se parandalimi i kriminalitetit më së miri  
arrihet me ekzekutimin e dënimit ndaj të gjykuarave. Ky ekzekutim duhet të jetë ashtu që

të shkaktoj frikë në masë. Në mënyrë që kjo të arrihet dënimet duhet të ekzekutohen hapur dhe të jenë të ashpra apo në mënyrë të tillë që për to të flitet në masë nga njëri në tjetrin. Këtë përfundim ka arritur ta nxjerrë Borisllav Petroviq (Petroviq, 2006). Duke nisur nga kjo teori, çështja bëhet pak më shqetësuese kur kemi të bëjmë me të miturit dhe mbi këtë unë beshtes hulumtimin në literaturën e Këshillit të Evropës; European Rules for Juvenile Offenders Subject to Sanctions Or Measures, i cili merret me rregullat që janë në fuqi në Evropë për të miturit. Qëllimi i rregullave është të përkrah të drejtat dhe sigurinë e shkelësve të mitur gjatë nënshtrimit të sanksioneve ose masave dhe të privimit fizike, dhe promovimit në aspekt të avancimit fizik-mendor dhe sociale të tyre kur subjekt i sanksioneve ose masave të komunitetit, ose çdo formë e heqjes së lirisë. Kjo e gjitha bazuar në Rekomandimin Rec (2008) 11 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Rregullat Evropiane për të mitur nënshtrohen sanksioneve ose masave, e cila u miratua më 5 nëntor 2008 (Council of Europe, 2009).

#### **1. 4. Hipoteza / hipotezat e punimit**

Procesi i ekzekutimit të vendimit të formës së prerë mbetet një proces kompleks, i ndikuar nga situata sociale, ekonomike dhe politike e shteteve kontraktuese dhe, në këtë kuptim (Scozzari dhe Giunta kundër Italisë [DHM], nr. 39221/98 dhe 41963/98, GJEDNJ 2000-VIII, para. 249; Assanidze kundër Gjeorgjisë [DHM], nr. 71503/01, GJEDNJ 2004-II, para. 198). Pas analizimeve të para initiale të ndërmarrura në hulumtimin sekondarë; rrjedhimisht të materialeve editoriale, literaturës akademike dhe profesionale, dhe në nën tjetër duke u mbështet në analizimin e rezultateve primare; hulumtimeve në teren, mund të arrihet deri në valorizimin e hipotezës :

*H1. Ekzekutimi i sanksioneve penale është proces kompleks, i përcaktuar me normativa ligjore.*

*H2. Ekzekutimi i sanksioneve penale në Kosovë në periudhën kohore 1945 -2014, përkundër vështirësive është realizuar në masë të kënaqshme!*

Ndërsa hipoteza ndihmëse e punimit janë:

- Ekzekutimi i sanksioneve penale është përcjellë me veçori të veçanta nëpër sisteme të ndryshme socio-politike që ka kaluar Kosova në periudha të ndryshme kronologjike.

- Në kontrast me vështirësitë e shumta të hasura me aktgjykime civile, gjatë ekzekutimit të aktgjykimeve penale haset në vështirësi dukshëm më të pakta.

### **1.5. Pyetjet kërkimore te punimit**

- Organet që ekzekutojnë vendimet penale të formës së prerë.

- Cilat janë parimet dhe legjislacioni vendorë ndër kohë mbi ekzekutimin e vendimeve të huaja?

- Cili është roli i gjyqësorit në ekzekutimin e sanksioneve penale?

- Cili është roli i policisë në ekzekutimin e sanksioneve penale?

- Cili është roli i institucioneve të tjera në ekzekutimin e sanksioneve penale?

- Cili është evoluimi ligjorë mbi ekzekutimin e sanksioneve ligjore në periudhën 1945-2014 në Republikën e Kosovës?

- Cilat janë karakteristikat që kanë përcjellë ekzekutimin e sanksioneve penale nëpër sisteme të ndryshme socio-politike që ka kaluar Kosova në periudha të ndryshme kohore 1945-2014?

## **1.6. Metodatat dhe metodologjia e kërkimit**

Gjatë këtij hulumtimi dhe kërkimi shkencor kam përcaktuar ato metode pune të cilat më mundësojnë dhe sigurojnë më shumë mundësi për të ardhur gjerë tek të dhënat e nevojshme dhe njëherësh më sigurojnë një shkallë të duhur të racionalitet, ekonomizimit dhe vetëmohimit.

Metodë të cilat kam përdorur janë: Shfrytëzimi i dokumentacioneve zyrtare; Metoda e intervistimit; Metoda e bashkëbisedimit; Metoda statistikore-përpunimit të rezultateve.

Me metodën e parë janë shfrytëzuar dokumentet zyrtare nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Shërbimit Korrektues të Kosovës, Institucionet korrektuese, Qendrat e Paraburgimit, Qendrat Korrektuese. Po ashtu gjatë punës hulumtuese kam shfrytëzuar ligjet të periudhave të ndryshme kohore, aktet nënligjore, udhëzimet administrative, vendimet e ndryshme, udhëzimet dhe urdhëresat, programet e trajtimit të burgosurve, rregullat e brendshme të institucioneve, rendin shtëpiak, dosjet e personave të dënuar dhe literaturën profesionale nga kjo fushë shkencore.

Gjatë hulumtimit tim më ka ndihmuar edhe stafi i Institucioneve korrektuese, të cilët i kam angazhuar për mbledhjen e të dhënave të nevojshme, e posaçërisht në : Kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave në lidhje me organizimin e punës së institucioneve korrektuese të Kosovës, strukturën e të dënuarve, kategorizimin e të dënuarve; Këtë çështje e ka vështirësuar mosfunksionimi i duhur i sistemit digjital i të dhënave, çka ka dashur mund dhe kohë që këto të dhëna të nxirren nga Arkivat e institucioneve dhe të përpunohen ashtu si duhet; Secili institucion ka format e veçanta statistikore të të dhënave për të burgosurit por edhe për stafin. Pas kësaj metode në mbledhjen e të dhënave kam shfrytëzuar metodën e intervistimit, me qëllim të mbledhjes së të dhënave kërkimore sa

më të sakta dhe konkrete.

### **1.7. Mundësitë dhe kufizimet**

Duke ditur se aspektet krahsimore ne temën time konsistojnë ndërmjet viteve 1945-2014 dhe dihet se Republika e Kosovës ka kaluar nëpër sisteme politiko-sociale të ndryshme, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1945 instalohet Jugosllavia e Re, me sistem të brishtë, shtypës ndaj Shqiptarëve, duke vazhduar shtypja dhe represioni deri në vitin 1968 ku filluan protestat dhe aktivitetet rezistive dhe protestuese nda Jugosllavisë së tretë, duke u kurorëzuar kjo lëvizje në vitin 1974 me reformën kushtetuese në Jugosllavi, në Kosovë u krijuan kushte për instalim të nj sistemi paksa më i favorshëm i sistemit të drejtësisë, e me këtë edhe të ekzekutimit të sanksioneve penale mbi bazë ligjore jo të atyre politike dhe represioniste. Gjendja politike në Kosovë ka qenë dinamike vazhdimisht duke u përkeqësuar dhe u përmirësuar paksa ndër vite, përkeqësimi i parë maksimal u arrit në vitin 1981 me suprimimet kushtetuese të Kosovës, pastaj në vitin 1997 me fillimin e Luftës së Armatosur ndërmjet Jugosllavisë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

E fillova këtë shtjellim për të ilustruar se mundësi në qasje të të dhënave të sakta në periudhën e para-çlirimit nga okupimi paraqet një kufizim pothuajse substancial, mirëpo ju edhe të pa kapërcyeshëm, ngase të dhënat e mija i kam mbështetur në raporte periodike të sistemit të drejtësisë të kohës, dhe në hulumtim në teren më qytetarë të moshës që kanë përjetuar këtë periudhë kohore!

Mundësitë e shumta shtrihen në teorinë e të drejtës, si E drejta materiale penale përcakton qëllimin, llojin dhe zgjatjen e sanksioneve penale, veçanërisht dënimin dhe

kushtet për shqiptimin e tij, deri sa e drejta ekzekutive penale i përcakton metodat, mënyrat dhe procedurën e ekzekutimit të tyre. Sipas kësaj na del qëllimi i çdo sanksioni penal, veçanërisht qëllimi i dënimit që është i përcaktuar në bazë të së drejtës penale materiale mund të realizohet vetëm përmes së drejtës ekzekutive penale. Kjo lidhje e pandashme del nga fakti se këto dy degë të së drejtës penale nuk mund të ekzistojnë pa njëra tjetrën. Me fjalë të tjera e drejta ekzekutive penale është në funksion të së drejtës penale materiale. Për tu ekzekutuar sanksioni duhet të jetë e përcaktuar dhe e shqiptuar, kurse sanksioni i shqiptuar nëse nuk është i ekzekutuar ose nëse nuk mund të jetë i ekzekutuar nuk mund ta arrijë qëllimin e për të cilin është paraparë me të drejtën penale materiale (Petroviq, 2006). Në teorinë juridike dallohen edhe ndarje të tjera si pasojë e veprës penale, si p.sh. në pasoja kryesore dhe sekondare, të afërme dhe të largëta. Pasojë kryesore është se kush ka qenë shkaktar i veprimit të kryer, kurse sekondarja vazhdon kalimthi nëpër pasojën kryesore, për shkak të lidhshmërisë së lëndës së sulmuesit apo raportit të tyre të afërt. Pasojë e afërt apo e mëparshme është ajo e cila i paraprinë shkakut kryesor, si parakusht i domosdoshëm për ekzekutimin e saj. Pasoja e mëtejme apo e mëvonshme, lajmërohet si rezultat i domosdoshëm i shkakut kryesor. Dhe në aspektin praktik mundësitë në periudhën e pasluftës konsistojnë në mundësin e qasjes në informacione dhe raporte konkrete gjyqësore, studimore mbi lëmin. Ajo çka mund të konkludohet në hulumtimet e dritanishme rezulton në faktin se përkundër përpjekjeve nuk ka pasur një hulumtim cilësorë deri në këtë kohë mbi materien në fjalë, po ashtu edhe një metodë hulumtimi të trasuar, për çka me ndihmën e këshillit mentorial dhe konsultimeve të vazhdueshme kemi arritur ta trasojmë metodën koherente të studimit të materies dhe të ndërtoj këtë punim!

## KAPITULLI II

### KUPTIMI, ROLI DHE QELLIMET E SANKSIONIT PENAL

Shoqëria njerëzore ka qenë dhe është e interesuar të qeveriset me ligje që sigurojnë rendin e qetësinë, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe të mbrohet nga fenomeni negativ i kriminalitetit si dhe ka kërkuar e kërkon të jepet drejtësi. Në të drejtën penale, masat të cilat zbatohen ndaj kryerësve të veprave penale quhen sanksione penale. Sanksionet penale janë ndër mjetet që i ndërmerr shoqëria me qëllim të mbrojtjes nga kriminaliteti. Sanksionet penale kanë për qëllim që të sigurojnë kushtet elementare të jetës së përbashkët. Në të kundërtën, nëse zbatimi i sanksioneve penale nuk është në funksion të luftimit të kriminalitetit, por i shërben interesave të ngushta burokratike apo partive politike, gjykatat bëhen vegël e tyre. Atëherë në fushën e së drejtës penale, veçmas në fushën e sanksioneve penale shprehet arbitrariteti, deformimet dhe cenimi i sigurisë dhe i barazisë si dhe shkelja e lirive dhe të drejtave të qytetarëve. Sanksionet që parashihen në të drejtën penale janë masa shtrënguese që zbatohen me dhunë dhe paraqesin represion ndaj kryesit të veprës penale. Me anë të sanksioneve penale, kryesit të veprës penale i kufizohen apo i merren të drejtat, liritë dhe vlerat tjera shumë të rëndësishme, siç është liria e lëvizjes, pasuria, etj., ndërsa në disa vende ku ende njihet dënimi me vdekje, kryesit i merret edhe jeta. Në fushën e së drejtës penale në përgjithësi dhe të sanksioneve penale në veçanti, si imperativ imponohen këto parime: respektimi i drejtësisë, të postulateve sociale etike, ligjshmërisë, legjitimitetit, humanizmit, dinjiteti dhe integritetit të njeriut (Elezi, 2013). Në shtetet demokratike është vendosur sundimi i ligjit, ndërsa në shtetin tonë në fazën e tranzicionit, kur synohet të ndërtohet shteti i së drejtës, nuk mund të thuhet se është vendosur ende plotësisht sundimi i ligjit. Nocioni i shtetit të së drejtës në Shqipëri

është bërë i njohur pas kalimit nga shteti totalitar në pluralizmin politik, pas viteve 90-të. Formulimi teorik i konceptit të shtetit të së drejtës – siç thekson prof. Luan Omari - ndeshet që nga gjysma e dytë e shek. XIX, por mori zhvillim të dukshëm gjatë shek. XX (Omari, 2002: 3). Ky term përdoret tani në shkallë të gjerë dhe përbën shtyllën e demokracisë dhe shtetit. Sir Ninian Stephen në referatin e tij të vitit 1999 ka thënë se: “Ruajtja e shtetit të së drejtës është baza e vërtetë e një shoqërie demokratike. Pa të, demokracia është një frazë boshe”. Më tej ai vazhdon: “Kryesore është njohja e përgjithshme dhe respekti për parimin e shtetit të së drejtës nga legjislatori. Së dyti, interpretimi gjyqësor. Së treti, nevojitet doktrina kushtetuese e ndarjes së pushteteve dhe dallimi midis pushtetit legjislativ dhe gjyqësor” (Stephen, 1999).

Në mënyrë që shteti i së drejtës të funksionojë në një shtet duhet të plotësohen disa kushte (Cowdery, 2008): 1. Duhet të ekzistojnë ligjet që ndalojnë dhe mbrojnë qytetarët nga dhuna dhe anarkia; 2. Qeveria duhet të jetë e kufizuar nga të njëjtët ligje si dhe qytetarët; 3. Ligji duhet të jetë i qartë, i përgjithshëm dhe i barabartë. Qartësia nënkupton që ligji duhet të parashikojë të ardhmen, të jetë i hapur dhe relativisht i qëndrueshëm; Ligjet duhet të kenë zbatim për të gjithë në mënyrë të barabartë; Ligji duhet të jetë dhe të mbetet i arsyeshëm në përputhje me opinionin publik dhe vlerat e përgjithshme sociale dhe duhet të ekzistojnë disa mekanizma (formalë ose joformalë) për ta siguruar diçka të tillë.

Sanksionet penale janë masa të dhunshme penalo-juridike të cilat i shqipton gjykata në procedurën e përcaktuar në ligj ndaj kryesit të veprës penale, me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë dhe individit nga kriminaliteti, ndërsa konsistojnë në marrjen apo kufizimin e lirive dhe të drejtave të caktuara apo në tërheqjen e vërejtjes kryesit se do ti merren apo kufizohen liritë apo të drejtat nëse sërish kryen veprë penale (Elezi, 2013). Prandaj për



këtë arsye mendojmë se për një luftë të suksesshme kundër kriminalitetit është e domosdoshme që krahas masave represive duhet të ndërmerren edhe masa preventive ngase shteti që pretendon të jetë demokratik dhe human ndaj qytetarëve të vet, për parandalimin dhe çrrënjosjen e kriminalitetit, krahas sanksioneve penale, duhet të disponojë dhe të ndërmarrë masa të ndryshme siç janë ngritja e nivelit të arsimit, kulturës dhe vetëdijes për respektimin e ligjit, të lirive, të drejtave, sigurisë dhe barazisë së qytetarëve në të gjitha fushat e jetës dhe një varg masash të tjera për mirëqenien ekonomike dhe sociale të qytetarëve dhe shoqërisë së atij vendi në tërësi. Këto janë masa të përgjithshme të cilat në një distance të caktuar janë mjete më efikas i parandalimit të kriminalitetit.

Shoqëria njerëzore ka kaluar nëpër etapa të ndryshme të zhvillimit historiko-kulturor dhe lufta kundër krimit është zhvilluar me mjete dhe metoda të ndryshme e që kanë kontribuar në mbrojtjen e të mirave individual dhe të atyre shoqërore nga sulmet dhe atakimet e ndryshme (Halili, 2009: 66). Në një periudhë të gjatë kohore të zhvillimit shoqëror si mjete dhe metoda të vetme të luftës kundër kriminalitetit kanë ekzistuar dënime fizike dhe trupore (Halili, 2009: 66). Krahas dënimeve fizike kanë ekzistuar tortura fizike si dhe dënimi me vdekje, i cili dënim ekziston në shumë shtete edhe tani (Halili, 2009: 66).

Me zhvillimin shoqëror, më vonë kanë filluar të aplikohen edhe dënime tjera, si:

- Dënimi me privim nga liria apo dënimi me burg,
- Dënimi me konfiskim të pasurisë,
- Dënime me të holla

Pas Revolucionit borgjez francez si dhe nën ndikimin e ideve të lëvizjeve dhe shkollave të ndryshme, për parandalimin dhe pengimin e kriminalitetit janë përdorur edhe

sanksione tjera, si dënimet plotësuese, ato alternative si dhe masat dhe mjete tjera për parandalimin e kriminalitetit. Sanksionet penale janë masa të shtrëngimit të parapara me dispozita pozitive ligjore të cilat aplikohen ndaj kryerësve të veprave penale (Zoran, 2000: 36). Sanksionet penale paraqesin njërën nga masat me të cilat shoqëria mbrohet nga kriminaliteti. Ato janë forma të reagimit të shtetit ndaj veprave penale të cilat i kryejnë qytetarët. Zakonisht aplikohen ndaj kryerësve të veprave penale me qëllim të mbrojtjes së të mirave të rëndësishme të shtetit dhe të individit (Salihu 2012: 28).

Parashikimi dhe aplikimi i të gjitha sanksioneve penale në një shtet sipas dispozitave pozitive penale quhet sistem i sanksioneve penale (Halili, 2009: 66). Sanksionet penale si masa mbrojtëse cilësohen mjetet për pengimin e kriminalitetit, sigurimin e rendit shoqëror nga atakimet e rrezikshme dhe kundërligjore të individëve dhe grupeve të caktuara (Halili, 2009: 68). Sanksionet penale shqiptohen dhe aplikohen kundër vullnetit të kryesit të veprës penale dhe konsistojnë në marrjen apo kufizimin e disa të drejtave të cilat përndryshe i kanë gëzuar gjerë në momentin e kryerjes së veprës penale (Halili, 2009: 69). Sanksionet penale që i shqiptohen kryesve të veprave penale më pak kanë karakter hakmarrës e më tepër shqiptohen më qëllim të përmirësimit (Halili, 2009: 165).

Për procedurën penale është i lidhur studimi mbi të ekzistuarit e dy tendencave të njohura në suazat e saj siç janë: tendencat e sigurimit të efikasitetit të procedurës penale në luftë kundër kriminalitetit apo që çdo kryes i njohur i veprës penale të kapet dhe dënohet në pajtim me ligjet e së drejtës materiale penale dhe tendencat e mbrojtjes së qytetarëve nga ndjekja dhe dënimi i paarsyeshëm penale, gjegjësisht që çdo person kundër të cilit ngrihet procedurë penale të ketë mundësinë e mbrojtjes (Bayer, 1995: 12–13). Duke pasur në konsideratë ekzistimin e tendencave për procedurë efikase penale dhe

mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në procedurën penale, gjegjësisht pranimin e ndikimit të tyre në rregullimin e procedurës penale dhe lidhur me këtë afirmimin gjegjësisht kufizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në këtë kuptim vend i posaçëm u takon deklaratave dhe konventave ndërkombëtare të cilat mund të karakterizohen si dokumente universale dhe regjionale.

Nga shumë konventa, deklarata dhe rekomandime ndërkombëtare duhet veçuar posaçërisht dokumentet universale:

- Deklarata Universale Mbi të Drejtat e Njeriut (1948);
- Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës (1989);
- Rregullat Minimale Standarde të KB për Sjelljen Ndaj të Burgosurve (1955);
- Rregullat Minimale Standarde të KB për Aplikimin e Procedurave Gjyqësore Ndaj të Miturve (1985);
- Deklarata Mbi Pavarësinë e Gjyqësisë (1989).

Instrumentet me të cilat gjithashtu mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të përmbajtura edhe në dokumentet regjionale (Sijerçiq– Çoliq, Haliloviq, 2007).

## **2.1. Standardet ndërkombëtare për zbatimin e dënimeve penale**

Standardet ndërkombëtare për zbatimin e dënimeve penale janë paraparë në aktet ndërkombëtare që janë të nxjerrura nga organet ndërkombëtare, si që janë:- konventat, protokollet, marrëveshjet ndërkombëtare, deklaratat, parimet, udhëzimet, rregullat standarde dhe rekomandimet (Sijerçiq – Çoliq, Haliloviq, 2007).

Autoritetet shtetërore kanë obligime ligjore ndaj për respektimin e të drejtave të njeriut, kanë obligim që të garantojnë mbrojtje efektive të të drejtave të njeriut gjatë ekzekutimit të sanksioneve penale. Autoritetet shtetërore gjatë ekzekutimit të sanksioneve penale janë të obliguar të konsistojnë në mbrojtjen, parandalimin, hetimin dhe dënimin e shkelësve të të drejtave të njeriut, për ti kthyer ato të drejtat, apo për të bërë kompensimin e tyre çdo herë kur është e duhur dhe e mundur. Në kuadër të drejtësisë së një shteti, sistemi i ekzekutimit të sanksioneve penale paraqet një sistem të ndërlikuar dhe të shumëllojshëm, që kërkon mbikëqyrje strikte ligjore dhe përfillje të standardeve ndërkombëtare.

Të gjitha aktet ndërkombëtare që trajtojnë çështjet e trajtimit të personave të privuar nga liria dhe të dënuar, kërkojnë një kontroll të jashtëm mbi verifikimin e funksionimit të sistemeve penitensiare lidhur me respektimin e të drejtave të gjithë të privuarve nga liria në bazë të çfarëdo forme ligjore.

Në institucionet e ekzekutimit të sanksioneve penale nuk përjashtohet mundësia e keqtrajtimit, e ofendimit, dhe mospërfilljes së të drejtave të personave të dënuar. Për këtë arsye shtrohet nevoja e domosdoshme e një kontrolli rigoroz në të gjitha institucionet korrektuese ku janë të vendosur personat e privuar nga liria dhe personat e dënuar (Halili, 2002 / Hysi, 2010 / Latifi, Elezi, Hysi, 2012).

Mu për këtë arsye janë nxjerrur standardet ndërkombëtare dedikuar respektimit të të drejtave të njeriut, e që drejtpërsëdrejti prekin të drejtat e personave të privuar nga liria. Këto akte juridike ndërkombëtare janë nxjerrur dhe proklamuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, dhe nga Këshilli i Evropës.

Për shkak të rëndësisë së tyre në përcaktimin e normave dhe standardeve ndërkombëtare për trajtimin e të personave të dënuar këto akte juridike ndërkombëtare do

shqyrtohen dhe trajtohen (Sijerçiq – Çoliq, Haliloviq, 2007).

Për secilin të burgosur që ka një dënim për një periudhë të përshtatshme, menjëherë pas pranimit dhe pasi të studiohet personaliteti i tij, do të përgatitet një program trajtimi në një institucion të përshtatshëm, në dritën e njohurive të fituara për nevojat, aftësitë e prirjet individuale, veçanërisht afërsisë me të afërmit. Të burgosurve do t'u jepet mundësi, brenda regjimit, të marrin pjesë në aktivitetet e institucionit që i ndihmojnë ata të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë, vetëbesimit dhe të nxisin interesin në trajtimin e tyre (Sijerçiq – Çoliq, Haliloviq, 2007). Duhet bërë përpjekje për të zhvilluar metodat e bashkëpunimit inkurajues dhe pjesëmarrjes së të burgosurve në regjimin e tyre. Për këtë qëllim, të burgosurit do të inkurajohen që të marrin përsipër, brenda kufijve të përcaktuar, përgjegjësi në një sërë sektorësh të aktivitetit të institucionit. Përgatitja e të burgosurve për lirim duhet të fillojë menjëherë pas pranimit në një institucion penal. Në këtë mënyrë, trajtimi i të burgosurve duhet të verë theksin jo në përjashtimin e tyre nga komuniteti, por pjesëmarrjen e tyre të vazhdueshme në të. Për këtë qëllim, kurdoherë që është e mundshme duhen angazhuar agjencitë e komunitetit dhe punonjësit shoqërorë për të ndihmuar personelin e institucionit në detyrën e rehabilitimit shoqëror të të burgosurve, veçanërisht duke ruajtur dhe përmirësuar marrëdhëniet me familjet e tyre, me personat e tjerë dhe me agjencitë shoqërore. Duhet ndërmarrë hapa për të mbrojtur, në masën më të madhe të mundshme në përputhje me legjislacionin dhe dënimin, të drejtat e interesat e tyre civile, të drejtat e sigurimit shoqëror dhe përfitimet e tjera shoqërore të të burgosurve. Programet e trajtimit duhet të përfshijnë dispozita mbi leje burgu, e cila duhet të jepet sa më shumë që të jetë e mundur për arsye mjekësore, edukative, profesionale, familjare dhe arsye të tjera shoqërore. Shtetasit e huaj nuk duhet të përjashtohen nga rregullat për leje

burgu vetëm për shkak të shtetësisë së tyre. Veç kësaj, duhet bërë çdo përpjekje për t'iu dhënë atyre mundësi për të marrë pjesë në aktivitetet e regjimit në mënyrë të përbashkët, me qëllim që të lehtësojnë ndjenjat e tyre të izolimit (Avokati i Popullit, 2009: 8).

## **2.2. Baza juridike e zbatimit të sanksioneve penale në Kosovë**

Në kuadër të sistemit të normave juridike me të cilat rregullohet realizimi i kërkesave penale-juridike të lindura me kryerjen e veprës penale, vërehen tri degë të së drejtës: -e drejta penale (e drejta materiale penale apo e drejta penale në kuptimin e ngushtë të fjalës);- e drejta e procedurës penale (e drejta e procedurës penale apo formale penale); dhe- e drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale (e drejta e ekzekutive penale). E drejta penale, e drejta e procedurës penale dhe e drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale-juridike janë pjesë e së drejtës penale në kuptimin e gjerë të fjalës. Studimi i konceptit të procedurës penale mbështetet në definimin e procedurës penale si në aspektin e veprimeve procedurale penale të cilat ndërmerren me qëllim të ndriçimit të veprës penale dhe zbulimit të kryesit të saj, ashtu edhe duke u nisur nga marrëdhëniet procedurale penale të cilat zhvillohen ndërmjet subjekteve të procedurës penale (Bayer, 1995: 4 – 8).

Duke pasur parasysh se veprat e ndëshkueshme ndahen në vepra penale, delikte ekonomike, kundërvajtje dhe masa disiplinore, është pranuar klasifikimi i procedurave ndëshkimore në:

- procedurë penale;
- procedurë ndaj delikteve ekonomike;
- procedura e kundërvajtës
- procedura disiplinore.

Çështjet materiale juridike të cilave u përshkruhen vepra të tjera ndëshkuese (të cilat nuk janë vepra penale) dhe masat apo sanksionet tjera gjegjëse të cilat mund të shqiptohen si dhe çështjet procedurale juridike mbi mënyrën e veprimit në rast të dyshimit se është kryer ndonjë vepër e dënueshme (e cila nuk është vepër penale) – janë të rregulluara me ligje të posaçme (p.sh. në ligjet mbi kundërvajtjet apo përgjegjësitë disiplinore të personave) (UNMIK-ut 1999/24). Aspekti ligjor dhe praktikë i ekzekutimit të sanksioneve penale në Kosovë nga viti 1945 e gjerë më sot ka kaluar nëpër disa etapa të zhvillimit dhe ndryshimeve shoqëroro-politike. Nga vitit 1945, kur Kosova ishte pjesë e Republikës së Serbisë në ish shtetin Jugosllav janë zbatuar ligjet e shtetit Jugosllav. Kjo periudhë ka zgjatur gjerë në vitin 1974, kur Kosova fiton pavarësinë politike dhe bëhet pjesë e sistemi Federativ të Jugosllavisë. Në këtë periudhë Kosova nxjerr ligjet e veta dhe në përputhje me ligjet ngre Institucionet e veta Korrektuese. Kjo periudhë ishte shumë e frytshme dhe e suksesshme për Kosovën në çdo fushë, andaj edhe në atë të ekzekutimit të sanksioneve penale. Mirëpo në vitin 1989, kjo autonomi u suprimua dhunshëm nga Serbia dhe Kosova bëhet prapë pjesë e Serbisë dhe zbatohen ligjet serbe. Mirëpo Kosova filloi të refuzoj të gjitha urdhrat dhe detyrat nga Serbia, çka edhe shumë njerëz u detyrohen të ikin kurse një pjesë u dënua me dënime të gjatë dhe u torturuan dhe matretuan skajshmërisht. Në vitin 1999, pas luftës në Kosovë, me ndihmën e faktorit ndërkombëtar Kosova fiton pavarësinë dhe fillon ngritja e Kosovës në çdo aspekt. Në vitin 2008, Kosova shpall pavarësinë dhe nxjerr Kushtetutën e vet. Në përputhje me kushtetutën nxirren shumë ligje të reja dhe disa ligje ekzistuese plotësohen dhe ndryshohen (Sijerçiq – Çoliq, Halilović, 2007).

Zbatimi i sanksionet penale bëhet në bazë të hierkisë së akteve me të larte kushtetuese e ligjore të shtetit si dhe në bazë të akteve dhe normave ndërkombëtare.

Sanksionet penale burimin e vet e kanë në Kushtetutën e Kosovës (Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008), Kodin Penal të republikës së Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale (Kodi Penal I Republikës së Kosovës, nr.04/L-082) Ligji i Ekzekutimit të sanksioneve Penale (Ligji i ekzekutimit të sanksioneve penale nr.04/L-149) Kodi i Drejtësisë për të mitur (Kodi i drejtësisë për të mitur i Republikës së Kosovës nr.03&L-193), Rregullat e Brendshme të Shërbimit korrektues të Kosovës, udhëzimet administrative të Ministrisë së Drejtësisë, Rregullat ndërkombëtare të burgjeve, Rregullat Evropiane të Burgjeve si dhe aktet tjera ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

### *2.2.1. Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ekzekutimi i sanksioneve penale*

Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) përmban një listë të gjatë të drejtave procedurale që u njihen të gjithë personave që janë palë në një proces në kuptim të gjerë: e drejta për proces publik, që procesi të përfundojë në një afat të arsyeshëm dhe të drejtohet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e drejta e prezumimit të pafajësisë. Që në fillim neni 6 afirmon se “çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet rregullisht”. Kjo shprehje e përgjithshme mbulon të gjitha të drejtat e veçanta që paraqiten në këtë nen, por edhe këtu nuk ka asnjë përkufizim. Duke lexuar nenin 6 të KEDNJ ligjshmëria mund të përkufizohet në dy mënyra: në kuptimin e ngushtë ligjshmëri do të thotë se secila prej palëve në proces mund të mbrojë çështjen e vet në kushte përgjithësisht të barabarta në raport me palën kundërshtare (M. De Salvia, 1995: 265). Në kuptim të gjerë ligjshmëri është sinonim i drejtësisë dhe përfshin disa të drejta



të veçanta si e drejta për t'u gjykuar nga gjykata në afat të arsyeshëm etj. Këtu duhet të shtojmë prezumimin e pafajësisë pa të cilin nuk ka proces të vërtetë, pra proces të rregullt ligjor. Madje nëpërmjet disa vendimeve Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) e miraton këtë konceptim të gjerë, sidomos kur thotë se paragrafi i parë i nenit 6 është norma bazë, paragrafët 2 dhe 3 janë zbatime të veçanta të tij (Çështja Lutz kundër Spanjës 25 Gusht 1987, Seria A nr. 123 – B), ose kur thekson se kërkesat e paragrafit të 3 analizohen si aspekte të veçanta të së drejtës për një proces të rregullt ligjor që garantohet nga paragrafi 1 (Çështja Lutz kundër Spanjës 25 Gusht 1987, Seria A nr. 123 – B). Procesi i rregullt ligjor siç është përmendur dhe më sipër nga neni 6 i KEDNJ, mbulon një fushë të përgjithshme, sepse zbatohet njëherësh në çështjet civile dhe në çdo akuzë me karakter penal. Lind pyetja nëse kjo shprehje i korrespondon vetëm procedurës penale stricto sensu, domethënë procesit juridik që dënon autorin e një veprë penale apo përfshin edhe autorët e veprimeve apo mosveprimeve, të cilat edhe pse nuk janë vepra penale në kuptim struktural të fjalës, kanë karakter represiv, ç'ka nënkupton sjelljet që ndëshkohen me sanksione disiplinore, ose ekonomike që shpesh quhen parapenale (M. Delmas, 1987: 819)?

Aplikimi i nenit 6 i KEDNJ fillon me akuzën, duke bërë që ai jo vetëm të mos kufizohet në fazën e gjykimit por përfshin edhe një pjesë të mirë të fazës përgatitore si dhe ekzekutimin e vendimeve të drejtësisë, i tillë është rasti i vendimit Hornsby kundër Greqisë (Çështja Hornsby kundër Greqisë, 19 Mars 1997, Seria A nr. 229 – B), në të cilin gjykata afirmon se “duke mos marrë përgjatë pesë viteve masat e nevojshme në përputhje me vendimin gjyqësor përfundimtar dhe të ekzekutueshëm, autoritetet kombëtare i kanë privuar dispozitat e nenit 6.1 të KEDNJ nga çdo efekt i dobishëm”. Ky rast nuk kishte të bënte me çështje penale, por vendimi përcakton se ekzekutimi i gjykimit ose vendimit, të

cilitdo juridiksioni, duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e procesit në kuptimin e nenit 6 të KEDNJ-së. Gjithçka që vjen pas akuzës, qoftë ky procedim penal apo ekzekutim i vendimit penal, varet nga neni 6 i KEDNJ-së. Rëndësia e së drejtës për një proces të rregullt ligjor shfaqet në dy këndvështrime: së pari, neni 6 i konventës u lë shteteve një liri shumë të reduktuar, pavarësisht se ajo ka një karakter të kushtëzuar në një farë mënyre relative, meqenëse konventa parashikon shmangien që konsiston në një moszbatim total, por të përkohshëm sipas nenit 15 paragrafi parë i KEDNJ – së që bazohet në ekzistencën e rasteve të gjendjes së jashtëzakonshme (në rast lufte, ose në rast të një rreziku tjetër publik që kërcënon jetën e kombit) duke shmangur parimin për proces të rregullt ligjor me përjashtim të aspektit që lidhet me publikimin e debateve (Çështja Law less kundër Irlandës, 14 Nëntor 1960, Seria A, nr. 1). Megjithatë ndryshe nga dispozita të tjera si për shembull neni 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) neni 12 (e drejta për martesën) etj, neni 6 nuk lejon që të mbahen shumë parasysh të dhënat kombëtare. Së dyti duket se koncepti i ligjshmërisë lidhet me të gjithë procedurën penale në kuptimin e gjerë, jo vetëm me bërthamën e saj që përbëhet nga rregullat e funksionimit të drejtësisë nga fillimi e deri në fund të procedurës, por edhe me strukturën e administratës gjyqësore. Pra studimi i nenit 6 duhet të parashikojë ligjshmëri në organizimin gjyqësor dhe në rregullat procedurale.

Garancitë e parashikuara në Nenin 6 zbatohen jo vetëm në proceset gjyqësore, por edhe gjithashtu edhe në fazat që paraprijnë dhe pasojnë ato. Në çështjet penale garancitë përfshijnë hetimet paragjyqësore të kryera nga policia. Gjykata deklaroi se koha e duhur që garantohet fillon që nga momenti kur ngrihet një akuze, dhe se kushtet e tjera të Nenit 6 - veçanërisht të paragrafit 3 – mund të jenë gjithashtu të përshtatshme përpara se një çështje të parashikohet në gjyq, nëse, dhe për sa kohe që drejtësia e gjyqit të paragjykohet

seriozisht nga një dështim fillestar për të qene në pajtim me to. Gjykata gjithashtu u shpreh se në çështjet që kishin lidhje me Nenin 8 të Konventës – të drejtën për jetën e familjes – Neni 6 gjithashtu zbatohet për fazat administrative të procesit gjyqësor. Neni 6 nuk parashikon të drejtën për apelim. Megjithatë, kjo e drejtë parashikohet në çështjet penale në Nenin 2 të Protokollit Nr. 7 të Konventës Evropiane. Gjykata ka deklaruar në precedentin e saj se, kur një shtet nuk parashikon në të drejtën vendase një të drejtë të tillë për apelim, këto procedime mbulohen nga garancitë që parashikohen në Nenin 6, edhe nëse Neni 6 nuk parashikon një të drejtë për apel. Megjithatë, mënyra sesi këto garanci vihen në zbatim duhet të jenë në varësi të tipareve të veçanta të procedimeve të tilla. Në bazë të precedentit të Gjykatës, duhet marrë parasysh tërësia e procedimeve të kryera në rendin ligjor vendas, funksionet në ligj dhe praktike të organit të apelit dhe pushteti e mënyra në të cilën paraqiten dhe mbrohen interesat e palëve. Kështu, nuk ekziston asnjë e drejtë e tillë për ndonjë lloj të caktuar apeli ose mënyrë për t'u marrë me apelimet. Gjykata ka deklaruar gjithashtu se Neni 6 zbatohet për procedimet përpara një gjykate kushtetuese nëse rezultatet e këtyre procedimeve janë drejtpërdrejt vendimmarrëse për një të drejtë civile apo detyrim të tillë. Neni 16 mbulon gjithashtu procedurat pas seancës gjyqësore, të tilla si ekzekutimi i një vendimi. Gjykata u shpreh në *Hornsby kundër Greqisë* se e drejta për një proces gjyqësor që mbulohet nga Neni 6 do të ishte i rreme nëse një sistem ligjor vendas i një Shteti Kontraktues do të lejonte që të mbetej mos veprues në dem të një pale një vendim përfundimtar e i detyrueshëm gjyqësor. Është i qartë fakti se Neni 6 mbulon procedimet të marra si një e tere. Gjykata ka deklaruar se ndërhyrja e një legjislature për të përcaktuar rezultatet e procedimeve duke aprovuar një ligj mund të shkelin parimin e barazisë në mjete.

### *2.2.2. Privimi i lirisë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës miratuar më 2008*

Kushtetuta është akti me i lart i lart juridik i Republikës së Kosovës, andaj ligjet dhe aktet tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë (Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008) Një përgjigje të tillë e gjejmë kur lexojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës - neni 16 pika 1. Kushtetuta është dokumenti në të cilën e ka bazën i gjithë legjislacioni i vendit, i cili rregullon marrëdhëniet mes shtetit dhe personave, organeve shtetërore mes tyre dhe madje edhe përcakton bazat për rregullimin e marrëdhënieve të personave mes tyre. Legjislacion jo vetëm që duhet të mbështetet tek kushtetuta, por duhet të jetë në përputhje me të. Kushtetuta është një burim ose pikënisje dhe kornizë për ligjet e tjera të vendit.. Kushtetuta përcakton parimet dhe mekanizmat e përgjithshëm e të posaçëm të organizimit të shtetit. Ajo krijon institucionet e qeverisë duke ndarë pushtetet mes tyre në mënyrë që vënia e rregullit të fillojë që nga mekanizmat shtetërore. Zakonisht pushtetet që u jepen institucioneve shtetërore kufizohen dhe vendoset një mekanizëm ndërkontrolli mes tyre duke ruajtur kështu balancimin e funksionimit normal të tyre (Sijerçiq – Çoliq, Halilović, 2007).

Në kontrast me vështirësitë e shumta të hasura me aktgjykime civile, gjatë ekzekutimit të aktgjykimeve penale haset në vështirësi dukshëm më të pakta. Siç ceket në fillim të këtij raporti në vitin 2010 është shënuar një rritje përfundimtare e përafërsisht 17.46% të rasteve të pa përmbaruara civile krahas një rritjeje përfundimtare prej vetëm 4.44% të rasteve të pa përmbaruara penale. Kjo pjesë e raportit kufizon shtrirjen e shqyrtimit në tri shqetësime kryesore lidhur me ekzekutimin e aktgjykimeve penale dhe vendosjen e sanksioneve. Së pari, shpesh ka vonesë dhe jo-transparencë ndërmjet kohës së aktgjykimit verbal dhe atij me shkrim. Së dyti, adresat e pasakta të të pandehurve

shpesh rezultojnë në vështirësi për të gjetur vendndodhjen të pandehurve kur aktgjykimi me të cilin është shpallur dënimi me burg apo gjobë merr formën e prerë. Dhe së treti, ka mungesë të trajnimit për referentët që janë përgjegjës për ekzekutimin e këtyre aktgjykimeve. Aktgjykimi me shkrim duhet të përmbajë datën kur është shpallur vendimi i gjykatës (KGJK, Raporti nr. 3/8, 2011) Megjithatë, nuk ka kusht për ta përfshirë në aktgjykimin me shkrim datën kur vendimi i gjykatës është vendosur në formë të shkruar. OSBE më parë ka raportuar lidhur me vonesat e mëdha ndërmjet aktgjykimeve verbale dhe atyre me shkrim OSBE vazhdon të vërejë vonesa. Në disa raste kalojnë muaj para se aktgjykimi verbal të konvertohet në aktgjykim me shkrim. Por kur vendimi i gjykatës vendoset në formë të aktgjykimit me shkrim, gjyqtari e nënshkruan pa datë nënshkrimi. Mungesa e datës së nënshkrimit jep përshtypjen se është nënshkruar në datën e shpalljes verbale të tij. Kjo e bën të vështirë të monitorohet nëse gjykata qëndron në përputhshmëri me kërkesat kohore të parapara me kod në lidhje me aktgjykimin “që duhet të përpilohet me shkrim brenda pesëmbëdhjetë ditë nga shpallja e tij kur i akuzuari gjendet në paraburgim, ndërsa brenda tridhjetë ditë në raste të tjera” (Neni 395 (1), KPPK) Vetëm kur monitoruesit shikojnë shkresat e lëndëve në kohë të ndryshme, ose pyesin gjyqtarët drejtpërdrejtë, OSBE mund të vlerësojë periudhën kohore në të cilën këto vendime vendosen në aktgjykime me shkrim. Shembujt në vijim ilustronë shkeljet e vërejtura të ligjit, shkelje të cilat nuk do të mund të vëreheshin pa monitorim aktiv. Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Pejë/Peć që përfshinte një të pandehur të akuzuar sipas Kodit Penal të Kosovës (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës) për kryerjen e veprës penale trafikim me njerëz (Neni 139 KPK) dhe dhunim (Neni 193 KPK) shpallja vendimit të gjykatës ishte bërë me 25 tetor 2010. Deri nga 24 shkurti 2011, ende nuk është lëshuar aktgjykimi me shkrim. Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë/Priština, një i pandehur ishte

gjykuar për kryerjen e veprës penale të rrezikimit të trafikut publik (Neni 297, paragrafi 5 lidhur me paragrafët 3 dhe 1 të KPK-së) Shpallja verbale u bë me 26 nëntor 2010, po u deshën pothuajse tre muaj që të lëshohet aktgjykimi me shkrim. Ishte lëshuar me 18 shkurt 2011. Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Pejë/Peć që përfshinte tre të pandehur të akuzuar për trafikim me njerëz (Neni 139 KPK) vendimi i gjykatës ishte shpallur me gojë me 23 dhjetor 2010. Deri nga 24 shkurti 2011, ende nuk është lëshuar aktgjykimi me shkrim. Për më tepër, kur aktgjykimi që cakton dënim me burg apo gjobë monetare merr formim e prerë, marrja e pasaktë e adresave të të pandehurve shpesh rezulton në vështirës në gjetjen e vendndodhjes së të pandehurve. OSBE ka vërejtur se adresat e pasakta krijojnë pengesë për ekzekutimin e sanksioneve. Nëse ka vonesë në dërgesën e dokumenteve tek i pandehuri kjo do të vonojë ekzekutimin e aktgjykimit përfundimtar apo vendosjen e sanksionit ([http://intranet/documents/410\\_2.pdf](http://intranet/documents/410_2.pdf) (i qasur më 25 korrik 2014)). Sipas shumicës së referentëve për ekzekutime në gjykatat komunale, sigurimi i adresave të sakta të palëve është pengesa kryesore në ekzekutimin e aktgjykimeve. Nga fundi i vitit 2010 dhe fillimi i vitit 2011, OSBE ka kontaktuar referentët komunal që implementojnë ekzekutimin e aktgjykimeve. Referentët për ekzekutime kanë deklaruar se kanë mungesë personeli dhe se nuk kanë trajnim të mjaftueshëm. Shumë referentë për ekzekutime pranë gjykatave komunale po ashtu nuk kishin dijeni lidhur me ligjin e ri që rregullon ekzekutimin e aktgjykimeve penale. As njoftimi e as kopje të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (Ligji Nr. 03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, 2010) nuk kishin arritur tek këta referentë. Edhe pse komponentë kritike për implementimin efektiv të ligjit, shumë referentë ende i referoheshin dhe punonin sipas Rregullores së UNMIK-ut 2004/46 mbi Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/46)

Për të mos u larguar nga pushteti gjyqësor, duhet thënë që një gjyqësor i pavarur, gjë e cila edhe kjo sigurohet nga Kushtetuta, është themelor për funksionin e shtetit ligjor.

Për funksionim të shtetit ligjor kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve Ndërkombëtare (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008) Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare garantohen edhe me këtë Kushtetutë. Konventat ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 25, 2008) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve tjera Mizore, Jonjerëzore e poshtëruese, ka gjetë vendin e vet në kushtetutën e Kosovës. Po ashtu si gjëja më esenciale për njeriun, E drejta për jetë, është pjesë e trajtimit kushtetues (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008) ku potencohet se secili individ gëzon të drejtën për jetë. Me rëndësi të veçantë është edhe ndalimi i dënimit me Vedeje. (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008) Kushtetuta garanton të drejtat e lirisë dhe sigurisë, prandaj askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente kur shpall personin fajtor dhe shqipton dënimin me burg, për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale. Vetëm në rastet kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore caktohet para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008).

Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit, në gjuhën që ajo ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të

bëhet sa më shpejt që të jetë e mundshme. Personi që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirim e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. që Çdo i dyshuar që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit. Ai i cili privohet nga liria, duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj dhe ka të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet. Personave që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit. Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj. Personi që vuan dënimin, ka të drejtë të ankohet për kushtet e privimit nga liria, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Kushtetuta e Kosovës parasheh të drejtën për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, çdo kujt i garanton mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008) Kushtetuta kur flet për Parimin e Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale, thekson se askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë veprë e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si veprë penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit



(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008)

Dënimi i shqiptuar për një veprë penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës, kurse ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale.

Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës. Në kapitullin e drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën veprë, Kushtetuta e Kosovës siguron personi që ka kryer veprë penale se nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008)

Të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve të Kosovës janë të garantuara me Kushtetutë, por mund të kufizohen vetëm me ligj (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008)

Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.

Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

Një nder kompetencat e Presidentit sipas kushtetutës është edhe shpallja e faljes

individuale, në pajtim me ligjin për falje. (Ligji për falje Nr.03/L-101) Presidenti jep falje për sanksionet penale të shqiptuar ndaj individëve në pajtim me ligjin e veçantë për falje. Kushtetuta është bazë dhe kornizë për hierarkinë e të vendit

### *2.2.3. Parimet e dënimit penal sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës*

Pas Kushtetutës së republikës së Kosovës, Kodi Penal është i rëndësishëm së veçantë në fushën e drejtësisë, pasi përcakton veprat penale dënimet dhe masat që merren ndaj kryerësve të veprave të ndryshme penale. Ky kod veprat penale dhe sanksionet penale i parashihet vetëm për ato sjellje me të cilat cenohen liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe të drejtat tjera të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me të Drejtën ndërkombëtare. (Kodi Penal I Republikës së Kosovës, nr.04&L-082)

Parimet procedurale penale kanë rëndësi të madhe për ta kuptuar të drejtën e procedurës penale dhe zbatimin e saj të drejtë në praktikë.

Procedura penale në Kosovë mbështetet në parimet procedurale penale në vijim:

- Përcaktimin e së vërtetës materiale;
- Prezumimi i pafajësisë;
- Parimi in dubio pro reo;
- Parimi akuzator;
- Parimi i legalitetit me parimin oficiel;
- Parimi i oportunitetit;
- Parimi i procedurës së drejtë;
- Parimi i pavarësisë gjyqësore;
- Parimi i vlerësimit të lirë të provave;

- Parimi i përdorimit të gjuhës amtare;
- Parimi i “barazisë së armëve”;
- Parimi i transparencës;
- Parimi i kompensimit të dëmit dhe rehabilitimit etj (Sahiti, Murati, Kunshtek, 2004: 134)

Sipas Parimit oficial dhe ndjekja penale, funksionin e ndjekjes penale e kryen organi kompetent sipas detyrës zyrtare (lat. ex officio) në interesin publik pavarësisht nga dëshira e personit i cili është i dëmtuar me veprën penale apo të ndonjë personi tjetër i cili do të kishte interes që në lëndën e caktuar të (mos) realizohet funksioni i ndjekjes penale (Sijerçiq-Çoliq, 2005: 69).

Parimi oficial ka të bëjë me njërin nga tri funksionet themelore të procedurës penale – funksionin e ndjekjes penale. Ky parim nuk është i lidhur vetëm për procedurën e ndjekjes penale sepse shtrihet në tërë procesin e procedurës penale. Duke pasur parasysh se sipas parimit oficial funksioni i ndjekjes penale realizohet për interesin publik ky funksion në pjesën më të madhe të sistemeve juridike i është besuar prokurorisë publike.

Për dallim nga parimi oficial i ndjekjes penale, parimi i dispozicionit të drejtën e ndjekjes penale ia lë vullnetit të personit të dëmtuar i cili këtë ndjekje e realizon përmes padisë private. Në procedurën bashkëkohore penale parimi oficial është në plan të parë me çka në masën më të madhe të mundshme kufizohet ndjekja me nismën e të dëmtuarit. Interesi i luftimit të kriminalitetit dhe mbrojtjes së shoqërisë nga veprat penale e tejkalon shumëfish interesin e të dëmtuarit dhe dëshirën e tij të cilën do të dëshironte ta shprehë ai në pikëpamje të inicimit të ndjekjes penale (Sijerçiq – Çoliq, Haliloviq, 2007).

Sipas KPPPK, në esencë është miratuar parimi oficial meqenëse për numrin më të

madh të veprave penale procedurën e inicion sipas detyrës zyrtare prokurori publik. Këtë të drejtë dhe detyrë prokurori publik e ka edhe për veprat penale të cilat ndiqen sipas kërkesës së të dëmtuarit.

Krahas veprave penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare (pjesa dërrmuese e veprave penale) dhe veprave penale të cilat ndiqen sipas kërkesës së palës së dëmtuar (pjesa më e vogël e veprave penale), në pjesën e posaçme të KPPK është paraparë që për disa vepra penale ndjekja inicohet sipas padisë private (gjithashtu numër më i vogël i veprave penale) . Për këtë arsye KPPK ka paraparë se paditësi i autorizuar për vepra penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare është prokurori publik, kurse për veprat të cilat ndiqen sipas padisë private është paditësi privat (Neni 6 par. 2). Duke pasur parasysh se për numrin më të madh të veprave penale ndjekja inicohet ex officio detyra dhe e drejta themelore e prokurorit publik është hetimi i veprave penale dhe ndjekja penale e kryesve të tyre (Neni 47 par. 1).

Në përcaktimin e dënimit penal për veprat penale, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm, Kodi Penal i Kosovës përfillë parimet, si :

- Parimi i ligjshmërisë,
- Parimi i humanizmit,
- Parimi i drejtësisë,
- Parimi i ligjshmërisë

Në përputhje me parimin e ligjshmërisë asnjë person nuk mund të dënohet për vepra penale nëse para kryerjes së saj nuk është përcaktuar me ligj si vepër penale dhe nuk është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për atë vepër. Në caktimin e fajësisë dhe të dënimit të gjithë kryesit e veprave penale para ligjit janë të barabartë dhe

përgjegjës. Caktimi i dënimit do të jetë i drejtë dhe në përputhje me peshën e fajësisë. Nga kjo shihet se Kodi Penal i Kosovës në caktimin e fajësisë dhe dënimit përfillë parimin e drejtësisë dhe atë të humanizmit.

- Parimi i proporcionalitetit

Në parashikimin e veprave penale, masave si dhe në caktimin e dënimit penal, Kodi parasheh shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe në përputhje me të duke respektuar edhe të drejtat e njeriut përfillë parimin e proporcionalitetit, që do të thotë dënimi penal do ti caktohet personit në përputhje dhe në proporcionalitet të rrezikshmërisë që paraqet për mesin shoqërorë vepra e kryer penale.

- Parimi drejtësisë

Përkufizimi i veprave penale me këtë Kod përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejon interpretim sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale dhe dënimi penal përcaktohet në favor të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura penale. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 4 parasheh sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm, të cilat i shqiptohen kryerësve të veprave penale. (Kodi Penal I Republikës së Kosovës, nr.04/L-082)

#### *2.2.4. Kodi i Procedurës Penale te Kosovës*

Objekt themelor i procedurës penale është çështja penale (Sahiti, 2005: 54). Çështja penale është ngjarje reale, e cila me përmbajtjen e vet tregon një vepër penale konkrete dhe kryesin e saj, për të cilin zhvillohet procedura penale (Sahiti, 2005: 54).

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, sistemi i drejtësisë është ballafaquar me probleme dhe vështirësi të ndryshme. Pra vitit 1999, sipas kodit të procedurës penale të

Jugosllavisë kishte një sistem inkuizitor të drejtësisë penale, ku hetimet zbatoheshin në bazë të kallëzimeve dhe dominoheshin nga Gjyqtari hetues. Mundësia dhe mjetet ishin të pakët për të hetuar krime të natyrës së rëndë penale, si që është krimi i organizuar. (Kodi i Procedurës penale të Kosovës, nr. 04&L – 123) Puna në përgatitjen e kodit pena të Kosovës ka filluar me 1. shtator 1999. Versioni i parë është përgatitur vetëm në gjuhën shqipe nga ekspertët kosovar dhe në fund të dhjetorit të këtij viti është dërguar në New York. Në shkurt të vitit 2000 ky kod është kthyer në Prishtinë dhe ka vazhduar puna në përgatitjen e tij paralelisht në dy gjuhë-në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze, prej shkurtit të vitit 2000 krahas ekspertëve kosovar, kanë marrë pjesë edhe rreth 30 ekspert ndërkombëtar nga Këshilli i Evropës, UNMIK-u, ABACE, UNICEF-it OSBE dhe ekspert individ të Anglisë dhe të SHBA. Në fillim të marsit 2003 është përgatitur versioni përfundimtar i KPK dhe i është dërguar Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës. Pas shqyrtimit të Kodit nga këto organe i është kthyer Zyrës ligjore të UNMIK-ut dhe kodi u më 6 korrik 2003, ndërsa ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004, u shpall në rregulloren e UNMIK-ut nr.2003/25. Model nismëtar i përpilimit të këtij kodi ka shërbyer Kodi Penal i BeH. e më pas u përpilua sipas koncepteve modeleve konkrete të shteteve bashkëhore të Evropës perëndimore, posaçërisht të Kodit penal të Gjermanisë, Zvicrës, Francës, dhe Italisë, janë akceptuar edhe zgjidhje parimore dhe konkrete nga legjislacioni penal i Anglisë dhe SHBA, pastaj janë marr disa konceptione nga Kodi penal i Shqipërisë, Sllovenisë, Kroacisë, pastaj një numër i madh i dispozitave të konventave ndërkombëtare që i dedikohen të drejtave dhe lirive të njeriut dhe luftën efikase kundër kriminalitetit. Edhe Kodi Penal i Kosovës është i ndarë në dy pjesë, në pjesën e përgjithshme dhe në pjesën e posaçme, ai është sistemuar në XXX kapituj me 357 nene. Misioni i Kombeve të bashkuara në Kosovë (UNMIK ), në bashkëpunim me ekspert ndërkombëtar dhe vendor,

në vitin 2003, hartuan dhe miratuan Kodin e përkohshëm të procedurës penale të Kosovës, me të cilin gjykata mbante disa nga kompetencat e saj hetuese, por që prokurori dhe mbrojtësi kishin role dukshëm më të gjëra. Kodi i vitit 2003, u ndryshua dhe plotësua në vitin 2008, kishin disa mangësi, pasi parashihte më shumë burime gjyqësore se që ishte e nevojshme për garantimin e të drejtave të njeriut. Së dyti, kishte disa pjesë që pengonin hetimin e suksesshëm të krimeve të rënda. Së treti, të drejtat e njeriut për anëtarësim në BE parashihnin disa kushte bashkëhore të cilat Kosova duhet të i zbatojë, por të cilat mungonin ose ishin të paqarta. Së katërti, kishte shumë raste kur Kodi duhej të qartësohej për të sqaruar procedurat. Kodi i Procedurës Penale i vitit 2013, përfshinë garanci të fuqishme të të drejtave të njeriut dhe njeh nevojat dhe kufizimet e Kosovës si dhe traditën juridiko-ligjore të saj. Ky kod i ri i Procedurës Penale parasheh ndryshime në strukturë si ndryshimin e Ligjit për Gjykata, heqjen e seancës për konfirmim, etj (Sijerçiq – Çolliq, Haliloviq, 2007). Kodi parasheh rolin e palëve, rolin e provave, veprimet fillestare hetuese, shqyrtimin fillestar dhe për herë të dytë të Akuzës, marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe alternativat tjera ndaj gjykimit. Procedurën në shqyrtimin gjyqësor, si dhe mjetet juridike. Rëndësi të veçantë ky kod ka në ata pjesë të dispozitave të tije të cilat rregullojnë zbatimin e paraburgimit, marrja dhe shpallja e aktgjykimit etj. Legjislacioni penal i Kosovës zbatohet edhe ndaj secilit që kryen vepër penale në aeroplanin e regjistruar në Kosovë, pa marr parasysh ku gjendet fluturakja në kohën e kryerjes së veprës penale (neni 99.par.2.). Legjislacioni penal do të aplikohet edhe ndaj personave që kryejnë vepra penale në Kosovë edhe atëherë kur për ato vepra penale janë ndëshkuar në shtetin tjetër, apo kur procedura është duke u zhvilluar, madje edhe në rastet kur kryesi e ka vuajtur dënimin që i është shqiptuar për të njëjtën vepër. Ky parim përjashton rregullën “ne bis in idem” (nuk guzon të ndëshkohet dy herë për të njëjtën vepër penale). Ligji lejon

një zbutje të këtij parimi mjaft të ashpër. Sipas nenit 104 të Kodit penal, nëse personi i ndëshkuar e ka vuajtur dënimin jashtë vendit, dënimin e vuajtur do t'ia llogarisë në dënimin e shqiptuar për të njëjtën veprë penale, gjithashtu, sipas kësaj dispozite, në masën e dënimit të shqiptuar do t'i llogaritet edhe paraburgu apo privimi i lirisë gjatë procedurës së ekstradimit. Vendin tonë pas lufte e frekuentojnë një numër i madh i shtetasve të huaj, qoftë si punëtor UNMIKU, punëtor të organizatave të ndryshme joqeveritare, afaristë, turistë etj, të cilët mund të kryejnë vepra penale në Kosovë. Në raste të këtilla kur kryesi dhe i dëmtuari janë shtetas të huaj, sipas legjislacionit tonë penal, është paraparë mundësia që ndjekja penale e të huajit t'i besohet shtetit të huaj, me kusht që edhe ai shtet të veprojë kësaj me shtetasit tonë (parimi i reciprocitetit). Mundësia dhe procedura për transferim (ekstradim) e personave të këtillë që kanë kryer vepra penale në territorin e Kosovës, është e rregulluar me Kodin e Procedurës penale të Kosovës (kapit. XL VII, neni 516-533) (Sijerçiq – Çolliq, Halilović, 2007).

Përjashtim i posaçëm nga parimi territorial legjislacionit tonë penal parashihet për personat që ushtrojnë funksione me rëndësi të posaçme (i ashtuquajtur i imuniteti juridiko-material) për shembull, deputetët, gjyqtarët sipas dispozitave kushtetuese parashihet se “askush i cili merr pjesë në gjykim nuk mund të thirret në përgjegjësi penale për mendimin e dhënë me rastin e marrjes së vendimit gjyqësor”. Përjashtimi nga veprimi territorial të legjislacionit tonë penal, njihet edhe në bazë të së drejtës ndërkombëtare. Sipas Konventës së Vjenë mbi marrëdhëniet diplomatike të vitit 1961; Të Konventës së Vjenës për marrëdhëniet konsultore të viti 1963 si dhe Marrëveshja lidhur me funksionarët e organizatave të caktuara ndërkombëtare 1947 dhe 1954, personat e huaj që ushtrojnë detyra të caktuara në këtë lëmenj përjashtohen nga juridiksioni i shtetit tonë. Këta janë shefat e shteteve dhe përcjellësit e tyre, shefat e misionëve diplomatike dhe



anëtarët e familjeve të tyre. Në Kosovë imunitet diplomatik gëzojnë edhe punëtorët e UNMIK-ut, OSBE-s, pjesëtarët e policisë së UNMIK-ut dhe KFOR-it (Sijerçiq – Çoliq, Halilović, 2007).

#### *2.2.5. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale të Kosovës*

Përmes formës së prerë vendimi gjyqësor merr përmbajtjen përfundimtare, kurse procedura penale përfundimin final.

Plotfuqishmëria formale do të thotë se vendimi i gjykatës nuk mund të atakohet me mjete të rregullta juridike. Plotfuqishmëria materiale do të thotë pamundësi e zhvillimit të procedurës së re penale për të njëjtën vepër penale. Në procedurën penale të dy llojet e cekura të plotfuqishmërisë vijnë në të njëjtin moment. Forma e prerë apo plotfuqishmëria arrijnë vetëm në aspektin e shprehjes apo diapozitivit të aktgjykimit, respektivisht aktvendimit, derisa arsyetimi nuk hynë në fuqinë ligjore. Me dispozitat juridike duhet të rregullohet dhe sigurohet që vendimi gjyqësor i nxjerrë në procedurën penale të ekzekutohet kur për këtë të plotësohen kushtet ligjore. Me fjalë tjera procedura penale është e drejtuar në nxjerrjen e llojeve të ndryshme të vendimeve, sidomos të aktgjykimit me hyrjen në fuqi e të cilit kuptohet se ngjarja konkrete penale është zgjedhur në mënyrë përfundimtare. Në aspektin e ekzekutimit ai paraqet realizimin e kërkesës penale juridike të përcaktuar gjatë gjykimit dhe përmbajtur në vendimin e plotfuqishëm gjyqësor, gjegjësisht realizimin e vendimit i cili është nxjerrë gjatë procedurës penal. Forma e prerë dhe ekzekutueshmëria sipas rregullit vijnë në të njëjtën kohë. Aktvendimi gjyqësor nuk mund të ekzekutohet para se të hyjë në fuqi. Ligji procedural parasheh kushtet e caktuara për ekzekutueshmërinë e vendimeve ashtu që aktgjykimi ekzekutohet: kur ai është i

formës së prerë; i dërguar si i tillë; kur për ekzekutimin e tij nuk ekzistojnë pengesa ligjore (Neni 135, par. 2). Aktvendimi, sipas rregullit ekzekutohet kur të ketë hyrë në fuqi. Ndërkaq, aktvendimi mund të ekzekutohet edhe para marrjes së klauzolës së formës së prerë nëse është rregulluar kështu, në mënyrë eksplicite me ligj, (caktimi i paraburgimit). Ekzekutimi i urdhëresës fillon menjëherë pas nxjerrjes së saj, nëse organi që e lëshon atë nuk e cakton ndryshe (neni 138. par. 1). Qëllimi i këtij ligji është ekzekutimi i sanksioneve penale, sanksioneve kundërvajtësve dhe masave të trajtimit të detyrueshëm, si dhe aplikimi i masës së paraburgimit (Ligji Nr. 04&L-149, 2013) Fushëveprimi i këtij ligji ekzekutimi i sanksioneve penale. Sipas këtij ligji sanksione penale janë (Ligji Nr. 04&L-149, 2013) :

- dënimet kryesore,
- dënimet alternative,
- dënimet plotësuese dhe
- vërejtja gjyqësore

Vlen të ceket se ekzekutimi i masave të trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm kryhet në institucion të veçantë në pajtim me këtë ligj. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për ekzekutimin e sanksioneve penale të shqyrtuara nga gjykatat vendore dhe të huaja, në pajtim me Kodin e procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë për të mitur, Ligjin për kundërvajtje dhe me marrëveshjet ndërkombëtare (Ligji Nr. 04&L-149, 2013) Qëllimi i ekzekutimit të sanksioneve penale sipas këtij ligji është risocializimi dhe riintegrimi i të dënuarve në shoqëri si dhe përgatitjen e tije për jetë. Ekzekutimi i sanksioneve penale siguron trajtim human, ekzekutohen në mënyrë të paanshme, duke respektuar plotësisht të drejtat e personit të dënuar, si dhe nxitjen e personit të dënuar në risocializim dhe re-integrim në shoqëri. Me këtë ligj parashihet dërgimi i personave të dënuar në institucion

korrektues si dhe pranimi i tyre, vendosja, ndarja, kontrollimet, ushqimi, aktivitetet, përkujdesja shëndetësore, vizitat, si dhe programi individual për risocializim dhe korrektim. Programi resocializues përfshinë, vendosjen në sektorin adekuat, pjesëmarrjen në aktivitetet arsimore, në aftësim profesional, në aktivitete kulturore, sportive, në punë, lidhjet familjare dhe kontakti me botën e jashtme, pushimi në shtëpi, lirimi me kusht, lirimi i parakohshëm si dhe masat për lirim përfundimtar. (Ligji Nr. 04&L-149, 2013) Sipas këtij Ligji Ministri i Drejtësisë nxjerr aktin nënligjor– Rendi shtëpiak, me të cilin rregullohet organizimi dhe mënyra e jetës së personave të dënuar. Krahasuar me ligjin e mëparmë të ekzekutimit të sanksioneve penale, shihet se mungojnë rregullat e Brendshme Institucionale, të cilat, janë nxjerrur nga Drejtoria e Shërbimit korrektues të Kosovës, e jo nga Ministri i Drejtësisë. Mendojmë se ministri duhet të nxjerrë Udhëzime Administrative për të plotësuar dhe për ta për më të zbatueshëm këtë ligj, e asi të nxjerr Rend shtëpiak. Pas ligjit, duhet të vijnë udhëzimet administrative nga Ministri, Rregullat e Brendshme institucionale nga Drejtoria e Shërbimit korrektues të Kosovës dhe rendet shtëpiake institucionale, të cilat duhet të i nxjerrin Institucionet korrektuese në përputhje me Ligjin, Udhëzimet administrative dhe Rregullat e Brendshme. Ky ligj parasheh edhe beneficonet e personave të dënuar, si vizitat në institucion dhe jashtë institucionit, kalimin e kohës në lokalet e veçanta me bashkëshorten, bashkëshortin, pushimet jashtë institucionit korrektues (Ligji Nr. 04&L-149, 2013) Mendojmë se pushimi në shtëpi, pushimi vjetor, nuk janë beneficion por e drejtë ligjore si që është lirimi me kusht, lirimi i parakohshëm, falja dhe amnistia.

Në nëntor të vitit 2010, KGJK publikoi *Strategjinë Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra* (Strategjia). Strategjia është hartuar me qëllim të trajtimit të lëndëve të pakryera civile, penale dhe përmbarimore, dhe përmban një numër pikash veprimi që

trajtojnë në mënyrë specifike përbarimin e aktgjyqimeve civile dhe penale. Përkitazi me lëndët përbarimore civile këto përfshijnë nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit (MiM) ndërmjet KGJK-së dhe Policisë së Kosovës (Strategjia, fq. 9), bankës qendrore dhe zyrës për regjistrimin e bizneseve (Strategjia, fq. 9, pika 7). Strategjia parasheh se KGJK brenda dy viteve nga publikimi i Strategjisë do të lëshojë një vendim lidhur me “organizimin e sistemit për përbarim në të ardhmen (gjyqësor, publik, privat, etj)” (Strategjia, fq. 10, pika 10). Nga kryetarët e gjykatave është kërkuar që brenda dy jave pas lëshimit të Strategjisë, të caktojnë nga një grup punues në kuadër të secilës gjykatë për të trajtuar “zvogëlimin e lëndëve të vjetra të ekzekutimeve (penale/civile) në çdo gjykatë komunale dhe në gjykatën ekonomike” (Strategjia, fq. 20, pika 1.a). Strategjia parasheh që grupi punues do të nis menjëherë “inventarizimin elektronik” dhe “kategorizimin” e të gjitha lëndëve përbarimore civile dhe penale<sup>48</sup> dhe “caktimin e afateve kohore për procedimin e lëndëve (sipas kategorive)” (Strategjia, fq. 21, pika 5.a.). Strategjia gjithashtu e parasheh një ndryshim në Ligjin e Procedurës Përbarimore për të kaluar obligimin e sigurimit të adresës së debitorit nga gjykata tek kreditori (Strategjia, fq. 29, pika 1). Në lidhje me rastet e përbarimeve penale Strategjia parasheh krijimin e një inventari të rasteve përbarimore penale, ku qartazi do të paraqiten afatet e zbatueshme kufizuese për secilin rast (Strategjia, pika 1 (b) dhe 2).. Në fund, Strategjia parasheh përdorim më të gjerë të marrëveshjeve rreth fajësisë dhe procedurave të ndërmjetësimit, të cilat, në rast se zbatohen në mënyrë sistematike do të ndihmojnë në uljen e rasteve përbarimore penale që do të i shtohen sistemit në të ardhmen (Strategjia, fq. 16, pikat 1 (a), (b) dhe (c)). Dispozitat e Strategjisë lidhur me rastet civile përbarimore, po që se zbatohen plotësisht do duhej të ishin të mjaftueshme për të pasur efekt në zvogëlimin e numrit të madh të atyre rasteve. Megjithatë, në një

intervistë me një përfaqësues të KGjK-së mësohet se zbatimi i atyre dispozitave të Strategjisë, thënë më së miri, ka qenë i pabarabart<sup>1</sup>. Deri në fund të tetorit të vitit 2011 nuk është nënshkruar asnjëri nga MiM-et e parapara, dhe më pak se gjysma e gjykatave kanë caktuar grupet punuese të e obliguara<sup>2</sup>. Në mesin e gjykatave ku grupet janë caktuar, pak punë është kryer drejt inventarizimit elektronik të lëndëve, siç parashihet në Strategji<sup>3</sup>. Deri më sot nuk është bërë asnjë ndryshim në Ligjin e Procedurës Përmbare; mirëpo një draft ligj i ri i është dorëzuar Kuvendit të Kosovës.

Në fund, në lidhje me thirrjen që gjykatat duhet të i vënë në përdorim më të gjerë procedurat e ndërmjetësimit në rastet përmbare penale, OSBE-ja është njoftuar që deri në tetor të vitit 2011 ndërmjetësuesit nuk e kanë filluar punën në këtë fushë<sup>4</sup>. Çështje të një shqetësimi të vazhdueshëm rreth zbatimit të Strategjisë i përfshijnë mundësitë në kuadër të obligimit të gjykatës në rastet përmbare kur adresa ose vendndodhja e debitorit është e panjohur (Strategjia, fq. 25, pika 2.) dhe autoritetin e gjykatës *vis-à-vis* sekuestrimit të aseteve (Strategjia, fq. 25, pika 3.). Përveç kësaj, gjykatat do të përfitonin nga një udhëzim në lidhje me rrethanat në të cilat ato do të lejoheshin të gjykonin raste përmbare jashtë radhe (Strategjia, fq. 25, pika 5). Strategjia parasheh që gjykata supreme të sigurojë sqarime në lidhje me këto çështje në formë të një qëndrimi ligjor. Kur qëndrimi i tillë ligjor të sigurohet do të i ndihmojë gjykatave në realizimin e zvogëlimit edhe më të madh të lëndëve të vjetra civile përmbare. KGjK-ja në raportin e kohëve të fundit mbi “Progresin e punës së arritur nga Gjyqësori i Kosovës në zbatimin e

---

<sup>1</sup> Përfaqësues pranë Njesisë së Auditorit Gjyqësor të KGjK-së, Prishtinë/Priština, Kosovë, intervistë personale më 11 tetor të vitit 2011.

<sup>2</sup> Përfaqësues pranë Njesisë së Auditorit Gjyqësor të KGjK-së, Prishtinë/Priština, Kosovë, intervistë personale më 11 tetor të vitit 2011.

<sup>3</sup> Përfaqësues pranë Njesisë së Auditorit Gjyqësor të KGjK-së, Prishtinë/Priština, Kosovë, intervistë personale më 11 tetor të vitit 2011.

<sup>4</sup> Përfaqësues pranë Sekretariatit të Komisionit për Ndërmjetësim të Kosovës, Prishtinë/Priština, Kosovë, intervistë personale më 10 tetor të vitit 2011.

Strategjisë Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra” (KGJK, Raporti nr. 3/8, 2011) i publikuar më 28 tetor të vitit 2011 i shtjellon hollësisht hapat e ndërmarra nga KGJK-ja, gjykatat dhe partnerët tjerë me rëndësi për adresimin e çështjes së lëndëve të pakryera. Sipas raportit, “Gjyqësori i Kosovës prej 1 janarit deri më 30 shtator të vitit 2011 i ka përfunduar gjithsej 33.82% të lëndëve nga numri i përgjithshëm i lëndëve të pakryera” (KGJK, Raporti nr. 3/8, 2011) Nga kjo del që ndonëse është bërë një progres i lavdërueshëm në trajtimin e lëndëve të pakryera civile, penale dhe përmbaremore në përgjithësi, zbatimi i Strategjisë në disa aspekte ka qenë i ngadalshëm dhe ngelet një proces në vijim e sipër.

### **2.3. Veprimi i legjislacionit penal të Kosovës, për veprat penale që kryhen jashtë territorit të Kosovës**

Meqenëse të mirat juridike të Kosovës apo të qytetarëve të saj mund të cenohen edhe me veprat penale që kryhen në shtet tjera, dispozitat e legjislacionit tonë penal parashohin mundësinë e aplikimit të tyre edhe ndaj personave që kryejnë vepra penale jashtë territorit të Kosovës. Për të mundur të aplikohet ligji i jonë penal dhe në situatat kur vepra penale është kryer jashtë Kosovës, ed rehat jonë penale i ka aplikuar disa parime të natyrës së përgjithshme siç janë:

Parimi real, parimi i personalitetit aktiv, personalitetit pasiv, dhe parimi universal.

Kur vepra penale kryhet jashtë territorit të Kosovës, por me të cilat dëmtohen apo rrezikohen të mirat juridike të vendit tonë apo të qytetarëve tanë, aplikohet ligji jonë penal.

Parimi real apo mbrojtës është paraparë në nenin 100 par.1. të kodit penal, ku është

paraparë zbatimi i parimit real të legjislacionit të Kosovës është paraparë me shumicën e veprave penale kundër të drejtës ndërkombëtare të parapara në nenet 116-121, 125-128, 132, 133 (1) 134-137, 139 (1) (2) dhe (3) 141 dhe 244) vepra nga neni 244. Gjithashtu aplikimi i parimit real apo mbrojtës të legjislacionit penal të Kosovës është paraparë edhe për disa vepra penale shumë të rënda me të cilat rrezikohet siguria e Kosovës ose e popullit të saj lidhur me këtë në nenin 100 paragrafi 2 të KPPPK, është paraparë “Ligjet penale të Kosovës zbatohen ndaj cilido person që kryen vepër penale nga nenet 110-113 të këtij kodi jashtë territorit të Kosovës, kur vepra e tillë paraqet rrezik ndaj sigurisë së Kosovës, ose popullsisë së saj, në përgjithësi ose pjesërisht”.Këto inkriminime janë: kryerja e veprave terroriste (neni 100), ndihma në kryerjen e veprave terroriste (neni 111), lehtësimi i kryerjes së terrorizmit, organizimi përkrahja dhe, pjesëmarrja në grupe terroriste (neni 113). Sipas natyrës së tij, parimi real apo mbrojtës, është parim ngase përjashton aplikimin e rregullës ne bis in idem. Madje ndryshe nga parimi territorial, ky është në mënyrë obliguese primar, sepse patjetër duhet të fillohet procedura penale kur kryhen vepra penale të parapara në nenet e theksuara më lart, madje edhe kur neshterin tjetër ka filluar apo ka përfunduar procedura, si dhe në rastet kur e ka vuajtur dënimin. Sipas parimit të personalitetit aktiv apo parimi nacional, legjislacioni ynë penal aplikohet në rastet kur qytetarët e Kosovës kryejnë vepra penale jashtë territorit të Kosovës. Kështu në nenin 101 par.1. të KPPPK thuhet : “Ligjet penale të Kosovës zbatohen ndaj secilit person i cili është banor i Kosovës, nëse personi i tillë kryen vepër penale jashtë territorit të Kosovës dhe nëse kjo vepër po ashtu është e dënueshme në vendin ku është kryer ajo vepër”.

Parimi i personalitetit aktiv zbatohet edhe në rastet e kryerësve të veprave penale të cilët nuk janë shtetas të asnjë shteti (apatrid). Kjo është paraparë në nenin 101.par.2.të

KPPPK, i cili shprehet:” Ligji penal i Kosovës zbatohet po ashtu ndaj secilit person i cili nuk është i një shtetësie të huaj nëse personi kryen veprë penale jashtë territorit të Kosovës dhe kjo veprë po ashtu është e dënueshme në vendin ku është kryer kjo veprë”. Ky parim aplikohet edhe në situatën kur personi pas kryerjes së veprës penale, bëhet banor i Kosovës (101.par.3.) Arsyeshmëria e aplikimit të këtij parimi qëndron në faktin se qytetari i Kosovës, sipas kushtetutës sonë, nuk mund t’i ekstradohet shtetit ku edhe e ka kryer veprën penale, ndërsa në anën tjetër nuk duhet lejuar që personat e këtillë të ngelin të pandëshkuar. Po mos të ekzistonte ky parim shtetasit tonë që kryejnë vepra penale jashtë Kosovës nuk do të mund të ndëshkoheshin. Parimi i personalitetit aktiv është subsidiar, ngase legjislacioni ynë penal do të aplikohet ndaj kosovarëve vetëm po nëse në vendin ku e kanë kryer veprën penale nuk është ushtruar mbrojtja e duhur juridiko penale. Sipas nenit 1003 par.1 pika 1-3 të KPPK thuhet: ndaj shtetasve tanë që kanë kryer vepra penale jashtë vendit, ndjekja penale nuk do të ndërmerret:

1. nëse kryesi në tërësi e ka vuajtur dënimin që i është shqiptuar jashtë vendit;
2. nëse kryesi jashtë vendit me aktgjykimin e formës së prerë është liruar ose dënimi i është parashkrime ose i është falur;
3. nëse për veprë penale, sipas ligjit të huaj, ndiqet në bazë të kërkesës së të dëmtuarit, ndërsa kërkesa e tillë nuk është parashtruar.

Nga kjo rezulton se parimi i personalitetit aktiv e respekton parimin “ne bis in idem”. Edhe për aplikimi e këtij parimi kërkohet identiteti i normave, d.m.th. vepra që konsiderohet si veprë penale sipas ligjeve tona, e tillë duhet konsideruar edhe sipas ligjeve të vendit të kryerjes së kësaj vepre, mirëpo kjo zgjidhje nuk është absolute, në rast kur sipas ligjit të vendit ku është kryer vepra për atë veprë nuk ndëshkohet, mirëpo ajo veprë konsiderohet si veprë penale sipas parimeve të pranuar të bashkësisë ndërkombëtare,



ndjekja mund të ndërmerret sipas lejes së prokurorit shtesorë (Hajrija Sijerçiq – Çoliq, Haris Halilović, 2007) Sipas Parimit personalitetit pasiv, legjislacioni penal i Kosovës aplikohet ndaj të huajve, të cilët jashtë territorit të Kosovës, kryejnë vepra penale kundër qytetarit tonë ose kundër vendit tonë. Kështu sipas nenit 102 të KPPK, thuhet: “Ligji penal i Kosovës zbatohet ndaj cilitdo person i një shtetësie të huaj nëse:

Personi i tillë kryen vepër penale jashtë territorit të Kosovës kundër banorit të Kosovës, edhe atëherë kur vepra e tillë penale nuk është cekur në nenin 100 të këtij kodi; Kjo vepër është e dënueshme në vendin ku është kryer, dhe Kryesi është ndodhur në territorin e Kosovës ose ka qenë transferuar në Kosovë”. Edhe ky parim është supsidiar.

### *2.3.1. Sanksionet penale sipas Kodit Penal të Kosovës*

Pasi që dënimi është masa e reagimit të shoqërisë kundër kryerësit të veprës penale e cila është e përcaktuar si e tillë me rregullativën juridike, ajo duhet të kundrohet si dukuri unike materialoformale. Me fjalë tjera nocioni i dënimit duhet të shpreh në të njëjtën kohë esencën e vet, detyrën shoqërore si dhe veçorit e veta juridike, kjo do të thotë në formën në të cilën paraqitet. Duke u nisur nga uniteti I elementëve formal e material, dënimi përcaktohet si masë e detyruar e paraparë në ligj të cilën e shqipton gjykata ndaj personit penalisht të përgjegjshëm si kryes i veprës penale në funksion të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut si dhe vlerave tjera shoqërore të garantuara me kushtetutë dhe të drejtën ndërkombëtare, gjegjësisht privimin dhe kufizimin e të drejtave të tyre (të kryeseve të veprave penale) (Hajrija Sijerçiq – Çoliq, Haris Halilović, 2007) Çështje kryesore të së drejtës penale të çdo vendi janë sanksionet penale .Këto janë epiqendër të vëmendjes të së drejtës penale dhe të politikës kriminale. Në të gjitha rastet

kur personi i caktuar kryen veprë të rrezikshme, e cila me ligj është e përcaktuar si veprë penale, është e domosdoshme që shoqëria ndaj kryesit të veprës së tillë të ndërmarrë ndonjë masë, e cila ka për qëllim pengimin e kryerjes së veprës penale në të ardhmen. Në të drejtën penale, masat të cilat zbatohen ndaj kryesit të veprave të këtilla quhen sanksione penale. Krahas sanksioneve penale shteti duhet të disponoj dhe të ndërmarrë masa të ndryshme, siç janë ngritja e nivelit arsimor, kulturës dhe vetëdijes për respektimin e ligjit, të lirive, të drejtave, sigurisë dhe barazisë së qytetarëve dhe një varg masash tjera për mirëqenien ekonomike dhe sociale të qytetarëve dhe shoqërisë së atij vendi në tërësi. Sanksionet penale janë masa shtrënguese që zbatohen me dhunë dhe paraqesin represion ndaj kruesit të veprës penale. Me anë të sanksionit penal kryesit të veprës penale i kufizohen apo i merren të drejtat, liritë dhe të drejtat tjera shumë të rëndësishme, siç është liria e lëvizjes, pasuria etj. Ndërsa në vendet ku akoma është në fuqi dënimi me vdekje, kryesit të veprës penale i merret edhe jeta. Meqë e drejta penale funksionin e saj të luftës kundër kriminalitetit e ushtron nëpërmjet të sanksioneve penale, sanksionet penale janë në epiqendër të saj. Edhe sanksionet penale kanë pasur një evulim gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë dhe tendencat e reja të zhvillimit të sanksioneve penale konsistojnë: Në një qasje të re të shoqërisë ndaj delinkuentit që ai të mos trajtohet si armik i shoqërisë, por që me trajtimin adekuat të kthehet si anëtarë i dobishëm dhe i barabartë i shoqërisë, të parashihen dënime alternative, sidomos të disa dënimeve me kusht, me punë për dobi të përgjithshme, gjysmë liria, si substitute të dënimeve me burgim; në përforcimin e mëtejshëm të preventivës speciale, veçmas në formë të resoclaizimit; në dobësimin e elementeve klasike retributive të dënimit; që dënimi të ketë elemente të mjaftueshme satisfaksionit edhe ndaj palës së dëmtuar nga vepra penale; që sanksioni të shqiptohet në raste të pashmangshme dhe të domosdoshme. Nëse përmbushen këto

synime –kushte do të forcohet parimi i ligjshmërisë dhe do të evitohet arbitrariteti (Hajrija Sijerçiq – Çoliq, Haris Halilović, 2007) Sanksionet penale janë masa të dhunshme penalo-juridike të cilat i shqipton gjykata në procedurën e përcaktuar me ligj ndaj kryesit të veprës penale, me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë dhe individit nga kriminaliteti, ndërsa konsistojnë në marrjen apo kufizimin e lirive dhe të drejtave të caktuara apo tërheqjen e vërejtjes kryesit se do t’i merren apo kufizohen liritë apo të drejtat nëse sërish kryen veprë penale.

Sanksionet penale, kanë këto karakteristika themelore:

-me anë të sanksioneve penale shoqëria mbron nga kriminaliteti vlerat më të rëndësishme të individit dhe të bashkësisë shoqërore,

-sanksionet penale mund t’iu shqiptohen vetëm kryesve të veprave penale,

-ndaj kryesve të veprave penale mund të shqiptohet vetëm ai sanksion penale i cili është paraparë me ligj në momentin e kryerjes së veprës penale,

-sanksionin penal mund ta shqiptoj vetëm gjykata në bazë të procedurës të përcaktuar me ligj dhe,

-me anë të sanksioneve penale, kryesve të veprave penale u merren apo u kufizohen liritë dhe të drejtat e tyre.

### *2.3.2. Llojet e sanksioneve penale në përgjithësi*

Që nga fillimi i shekullit XX, në vend të monizmit, në të drejtën penale inaugurohen pluralizmi i sanksioneve penale. Pa marr parasysh dallimet terminologjike, në të cilat e drejta penale bashkehore kryesisht njihen këto lloje të sanksioneve penale: dënimet

kryesore, dënimet alternative, dënimet plotësuese, masat siguruese, masat edukative, dënimi me kusht dhe vërejtja gjyqësore. Në fillim të shekullit XX, krahas dënimit paraqitet edhe një lloj tjetër i sanksionit penal, që u dedikohet kryesve të mitur të veprave penale, këto janë masat edukuese apo masat edukuese përmirësuese. Diç më vonë, por gjithashtu në fillim të shekullit XX, nën ndikimin e shkollës italiane janë krijuar edhe një lloj i sanksioneve penale që aplikohen ndaj kryesve të veprave penale që lëngojnë nga sëmundjet e ndryshme psikike që quhen masa siguruese, në KPPK këto masa quhen masa të trajtimit të detyrueshëm. Pa marr parasysh se ekzistojnë dallime terminologjike në emërtimin e masave siguruese, tani pothuajse se të gjitha legjislacionet penale bashkëkohore njohin këto lloje sanksioneve penale. Mirëpo meqë disa masa siguruese në esencë janë sanksione penale me të cilat kryesve të veprave penale u merren apo u kufizohen disa të drejta, në shumë legjislacione penale të shteteve të Evropës Perëndimorë, këto lloj të sanksioneve konsiderohen si dënime plotësuese, kështu, ka vepruar edhe KPPK në nenin 54.

Në fund të shekullit XIX, evolucioni i së drejtës penale shpjen në humanizimin, zbutjen dhe reagimin e shtetit ndaj kryesve të veprave penale që kanë shpie gjer ke inaugurimi i disa llojeve të reja të sanksioneve penale dënimit me kusht dhe vërejtja gjyqësore.

### *2.3.3. Sistemi i sanksioneve penale në të drejtën penale të Kosovës*

Ngjashëm me të drejtën penale të shteteve të Evropës Perëndimorë dhe të SHBA, e drejta jonë penale përvetëson sistemin pluralist të sanksioneve penale në nenin 3. të KPPK janë paraparë katër lloje të sanksioneve penale këto janë:

1. dënimet kryesore;
2. dënimet alternative;
3. dënimet plotësuese dhe
4. vërejtja gjyqësore.

1. Dënime kryesore shqiptohen ndaj personave madhorë, të cilët janë penalisht të përgjegjshëm për veprën penale të kryer.

2. Dënimet alternative në brendinë e tyre janë substitute, zëvendësim i dënimit me burgim, spektri i tyre është mjaft i gjerë dhe i llojllojshëm. Këto lloje të sanksioneve penale në fakt janë një lloj i posaçëm i masave parapenale, ku kryesi i veprës penale në vend që të dënohet i tërhiqe vërejtja dhe njëherit i caktohen obligime të cilat duhet t'i përmbush brenda afatit të caktuar, e nëse nuk i përmbush obligimet e caktuara, dënimet alternative mund të revokohet dhe të shëndrrohet në dënim me burg.

3. Dënimet plotësuese, janë të karakterit sekondar dhe i plotësojnë dënimet kryesore, këto dënime mund të shqiptohen vetëm së bashku me dënimet kryesore.

4. Vërejtja e gjykatës, ky lloj i sanksionit është i karakterit parapenal, është e paraparë për vepra të lehta penale.

#### *2.3.4. Llojet e masave dhe sanksioneve ndaj të miturve*

Ndaj kryesve të veprave penale të mitur mund të shqiptohen masat e divestitetit, masat edukuese dhe burgimi për të mitur. Në strukturën e të gjitha llojeve të sanksioneve penale që njihen tani në të drejtën penale bashkehoje, dënimi është lloji më i vjetër i sanksionit penal. Ka lindur nga gjakmarrja dhe kompozicioni, si forma të parë të reagimit

të shoqërisë ndaj veprave të ndaluara të individëve. Gjer në fund të shekullit XIX dënimi ka qenë i vetmi lloj i sanksionit penal. Përkundër faktit se tani të drejtat penale bashkëhore njohin edhe lloje tjera të sanksioneve penale, dënimi edhe sot është sanksion themelor, ngase më së shpeshti shqiptohet ndaj kryesve të veprave penale.

#### *2.3.5. Sistemi i dënimeve në të drejtën penale të Kosovës (Petroviq, f. 111)*

KPPK i njeh pesë (5) lloje të dënimeve (neni 36.41 dhe 54).

-dënimin me burgim afatgjatë,

-dënimin me burgim,

-dënimin me gjobë,

-dënimet alternative dhe

-dënimet plotësuese.

E drejta jonë penale nuk e njeh dënimin me vdekje, ky dënim është abroguar më 12. dhjetor 1999 me rregulloren e UNMIKUT 1999/24

Karakteristikë e sistemit të dënimeve të paraparë në KPPK është se parasheh një numër të madh të llojeve të dënimeve. Ky sistem i dënimeve është kopatibil me sistemin e dënimeve të parapara në kodet penale të shteteve të Evropës Perëndimorë dhe SHBA, sidomos me parashikimin e dënimeve plotësuese dhe alternative. (Petroviq, 2006: 111)

Në radhë të parë dënimet ndahen në ato kryesore dhe plotësuese (sekondare).

Dënimet kryesore (primare)

Janë ato të cilat ligji i parasheh se mund të shqiptohen si masë kryesore e dënimit.

Sipas nenit 38. të KPPK dënimet kryesore janë:

1. dënimi me burgim afatgjatë,

2. dënimi me burgim dhe

3. dënimi me gjobë.

Dënimi me gjobë mund të jetë kryesor kur shqiptohet vet dhe plotësues kur shqiptohet së bashku me dënimin me burg.

Dënimet plotësuese

Dënimet plotësuese janë ato lloje të dënimeve të cilat mund të shqiptohen vetëm krahas dënimit kryesor apo alternativ. Sipas nenit 54 të KPPK, parashihen këto dënime plotësuese:

1. gjoba,

2. heqja e së drejtës për tu zgjedhur,

3. Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik,

4. ndalimi i ushtrimit të profesionit, aktiviteteve ose detyrës,

6. marrja e patentë shoferit,

7. marrja e sendit,

8. urdhri për publikimin e aktgjykimit dhe,

9. dëbim i të huajit nga territori i Kosovës.

Dënime alternative

Dënimet alternative janë rezultat i trendëve bashkohore në të drejtën penale dhe kanë për qëllim që në të gjitha rastet e mundshme të parapara me ligj, në vend të dënimit me burgim, të shqiptohet dënimi alternativ, që janë joizoluese, jo me burgim.

Sipas dispozitave të nenit 41, 43, 49, 50,, 52 dhe 53 rezulton se KPPK njih pesë (5) lloje të dënimeve alternative dhe atë:

1. dënimi me kusht neni 43,
2. dënimi me gusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues neni 49,
3. dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues neni 50,
4. dënimi me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme neni 52, dhe
5. gjysmë liria neni 53.

Dënimet më tej ndahen në dënime permanente (përgjithshme) dhe kohore (për një kohë të kufizuar)

Pastaj ekziston minimumi i përgjithshëm dhe minimumi i posaçëm, maksimumi i përgjithshëm dhe maksimumi i posaçëm

Minimumi i përgjithshëm është 15 ditë, ndërsa maksimumi i përgjithshëm është 20 vjet për dënimin me burgim ndërsa 40 vjet për burgimin afatgjatë

Dënimet kumulative dhe dënimet alternative. Kur dënimet parashihen në mënyrë kumulative gjykata duhet ti shqiptoj të gjitha dënimet e parapara me ligj.

#### *2.3.6. Dënimi me vdekje (Petroviq, 2006: 111)*

KPPK dhe i tërë sistemi juridik i Kosovës nuk e njih dënimin me vdekje. Mirëpo në disa shtete të Evropës dhe të botës, ky lloj dënimi njihet edhe tani dhe si i tillë shqiptohet për rastet shumë të rënda të veprës penale .Dënimi me vdekje është i drejtuar kundër vlerës më të rëndësishme të njeriut, kundër jetës së tij, dhe si i tillë është lloji më i rëndë i dënimit në të gjitha legjislacionet që e njohin.



Dënimi me vdekje është lloji më i vjetër i dënimit në historinë e së drejtës penale. Gjer në fund të shekullit XVIII, në Evropë dhe kontinente tjera të botës, dënimi me vdekje ka qenë i paraparë për një numër të madh të veprave penale. P.sh. në legjislacionin penal të Francës në shekullin XVIII dënimi me vdekje parashihej për 115. vepra penale, gjatë kësaj kohe dënimi me vdekje është ekzekutuar në mënyra shumë të vrazhda dhe me mundime të tmerrshme. Në gjysmën e dytë të shek. XVIII dhe në fillim të shekullit XIX nga ana e filozofëve dhe iluministëve si dhe nga disa përfaqësues të shkollës klasike, veçmas të Cezario Bekarios, iu drejtuan kritika të ashpra sistemit ndëshkimor të së drejtës penale mesjetare. Duke u ndikuar nga këto kritika në gjysmën e parë të shekullit XIX numri i veprave penale për të cilat mund të shqiptohet dënimi me vdekje është kufizuar në 12. vepra penale. Në fund të shekullit XIX u themelua edhe lëvizja abolicionistë e cila edhe sot e kësaj dite angazhohet për heqjen e dënimit me vdekje. Kjo lëvizje ka arritur rezultate të konsiderueshme, ngase përpos që u zvogëlua numri i veprave penale për të cilat mund të shqiptohet dënimi me vdekje gjer në fund të vitit 1970 arriti që në 40 shtete të botës të abrogohet dënimi me vdekje, nëse në dekadat e fundit numri i shteteve që kanë abroguar dënimin me vdekje është shumë më i madh. Tani ekzistojnë ithtarët pro dënimit me vdekje dhe ato kundër dënimit me vdekje (abolicionistët) (Hajrija Sijerçiq – Çoliq, Haris Halilović, 2007)

### *2.3.7. Elementet e përgjithshme të dënimit (Petroviq, 2006: 111)*

Nga ky definimi i nocionit të dënimit ,rezultojnë elementet themelore, apo të përgjithshëm të tij; 1) Dënimi si masë e dhunshme paraqet një të keqe e cila e godet personin që ka kryer veprë penale e cila konsiston në marrjen apo kufizimin e lirive dhe

të drejtave të tij; 2) Dënimi duhet të ketë qëllimin e caktuar që dëshirohet të arrihet me ekzekutimin e tij: a) që të shprehet gjykimi shoqëror ndaj kryesit të veprës penale; b) që të ndikohet në kryesin që në të ardhmen të mos kryej vepra penale; c) të ndikoj tek të tjerët që të mos kryejnë vepra penale; d) të ndikoi në vetëdijen e qytetarëve mbi efektin e dëmshëm të veprave penale, si dhe në dënimin e arsyeshëm të kryeseve të atyre veprave ; 3) Dënimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj .Ky është parimi ligjshmërisë së dënimit Me të cilin u ofrohet garancion qytetarëve nga keqpërdorimet dhe arbitrariteti. Kjo do të thotë se dënimi nuk mundë të përcaktohet me asnjë akt nënligjor përveçse me ligj; 4) Ekzekutimi i dënimit është në varshmëri nga ekzistimi i veprës penale dhe përgjegjësisë penale të kryesit të saj. Dënimi nuk mundë ti shqiptohet personit I cili nuk e ka kryer veprën penale, apo nuk është penalisht i përgjegjshëm, apo që nuk është konfirmuar se ai është kryes i sajë; 5) Dënimin mundë ta shqiptoj vetëm gjyqi sipas procedurës së përcaktuar me ligj. (Petroviq, 2006: 111)

### *2.3.8. Elementët relativ të dënimit*

Përveç elementëve themelore tek disa dënime paraqiten edhe elementët relativ të cilët kanë karakter jo të përhershëm, të elementëve variabël (Petroviq, 2006: 111): 1) Dënimi duhet të jetë personal ashtu që duhet të godas vetëm kryesin e veprës penale e jo edhe personat tjerë në afërsi .Megjithatë përkundër përpjekjeve të vazhdueshme në përmbushjen e kësaj kërkese, gati çdo dënim drejtpërdrejt godet edhe personat tjerë (anëtarët e familjes dhe të afërt tjerë); 2) Dënimi duhet të jetë human që do të thotë njerëzor, apo thënë ndryshe nuk guxon të jetë I përbërë (dënimi) nga tortura mundësimi apo të sjellurit tjetër jo njerëzor ndaj kryesit të veprës penale; 3) Dënimi duhet të jetë i

moralshëm çka donë të thotë të mos e demoralizoi kryesin e veprës penale; 4) Dënimi duhet të jetë proporcional me peshën e veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të kryesit të sajë; 5) Dënimi duhet të jetë i ndarë ashtu që mundë të shqiptohet në masë më të vogël apo masë më të madhe ,varësisht nga pasha e veprës penale, rrethanat në të cilat ajo është kryer dhe rrezikshmërisë së kryesit të veprës; 6) Dënimi duhet të jetë i revokueshëm që do të thotë në rastet kur dënimi është shqiptuar në kundërshtim me ligjin mundë të ndërpritet .Mundësia e tillë ekziston te dënimet e privimit nga liria gjersa zgjat ekzekutimi si dhe te dënimet me të holla .Kjo karakteristikë e dënimit ka rëndësi të madhe për shkak të mundësisë së lajthimit të gjyqit gjatë shqiptimit të dënimit; 7) Dënimi duhet të jetë i përmirësueshëm që të mundë të mënjanohej pasojat të cilat rezultojnë nga natyra e vet .Kjo karakteristikë gjithashtu është e rëndësishme për shkak të mundësisë së shqiptimit të kundërligjshëm të dënimit gjatë lajthimit gjyqësor apo në bazë të provave të rrejshme .Dënimi me të holla është i përmirësueshëm, gjersa dënimi me burgim nuk është, ngase koha e kaluar në burg nuk mundë të kthehet ,veçse me shumë të caktuar të parave kompensohet privimi i pa bazë nga liria; 8) Dënimi duhet të jetë i ndërrueshëm, kështu që varësisht nga nevoja ai mundë të zëvendësohet me llojin më të lehtë të dënimit me atë që i është shqiptuar në aktgjykim (Petroviq, f. 111)

Në përkufizimin terminologjik të sanksioneve penale, ekzistojnë dallime në kodet e shteteve të ndryshme dhe tek ne, por pa marrur parasysh ndryshimet në emërtim, ato mund të ndahen në: - Dënime, - Dënime alternative, - Dënime plotësuese, dhe - Masa edukuese korrektuese, si sanksione të veçanta për të mitur.

## 2.4. Dënimet penale sipas kodit penal të Kosovës

Në **Kodin Penal të Kosovës**, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm që mund të u shqiptohen kryerësve të veprave penale janë paraparë në nenin 4 (Kodi Penal I Republikës së Kosovës, nr.04/L-082)

Sipas këtij kodi sanksionet penale janë :

- Dënimet kryesore,
- Dënimet alternative,
- Dënimet plotësuese dhe
- Vërejtja gjyqësore

Ndërsa masat e trajtimit të detyrueshëm, të cilat mund ti shqiptohen kryesit që nuk është penalisht i përgjegjshëm ose i varur nga droga, alkooli, janë:

- Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor,
- Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri, dhe
- Trajtimi me rehabilitim të detyrueshëm të personave të varur nga droga apo alkooli.

Ky kod ne nenin 41, përcakton edhe qëllimin e dënimit. Sipas kësaj dispozite ligjore qëllimet e dënimit janë:

- Të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij,
- Të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale,
- Të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe
- Të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e

detyrimin për respektimin e ligjit.

Mirëpo duhet theksuar se Kodi i Ri Penal i Kosovës, i cili është në zbatim që nga fillimi i vitit 2013, nuk i përfshinë sanksionet penale për të mitur. Sanksionet penale për të mitur janë të përcaktuara dhe rregulluara me Kodin e Drejtësisë për të mitur (Kodi i Drejtësisë për të mitur të Kosovës, nr. 03&L-193). Ky Kod i cili ka hyrë në fuqi në fillim të vitit 2013, në dispozitat e veta për saksonet penale dhe qëllimin e dënimit ka pësuar ndryshime dhe janë paraparë plotësime dhe risi krahasuar me kodin e mëparshëm. Në nenin 42 të këtij kodi ku parashihen llojet e dënimeve, në dënimet kryesore kemi dënimin me burgim të përjetshëm si dënim i ri i cili në Kodet e mëparshme nuk ka ekzistuar. Në kuadër të llojeve të dënimeve të reja Kodi Penal i Kosovës në nenin 49 të tij parashih dënimet alternative. Tashmë objekt i trajtimit të këtij Kodi janë edhe dënimet alternative si dhe organet të cilat merren me mbikëqyrjen e tyre. Sipas Legjislacionit Penal të Kosovës, sanksionet penale kanë ndryshuar në masë të konsideruar në krahasim me Legjislacionin e mëparshëm që aplikohet në Kosovë. Kodi i ri Penal ka paraparë risi dënimet e reja që nuk ekzistonin më parë. Po ashtu në këtë Kod risi është edhe fakti që sanksionet penale ndaj të miturve rregullohen me Kodin e Drejtësisë për të Mitur e jo me Kodin Penal të Kosovës. (Petroviq, 2006: 111)

Sipas legjislacionit të ri penal në Kosovë, sanksionet penale në tërësi e në veçanti dënimet kanë pësuar ndryshime të mëdha, krahasuar me legjislacionin penal të mëparshëm i cili aplikohet në Kosovë. Në legjislacionin e ri penal të Kosovës janë paraparë disa risi. Me këtë legjislacion parashihen dënime të reja, të cilat nuk kanë ekzistuar më parë, por ka edhe të tilla të cilat janë ndryshuar sa i përket emërimit. Më parë, në Legjislacionin penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, kur kjo ishte pjesë konstituive e federatës Jugosllave ka ekzistuar dënimi maksimal gjerë në 25 vite dhe

dënime me vdekje, për vepra të rënda penale (Ligji penal i KSAK, 1974) Me supremimin e autonomisë së Kosovës nga ana e Serbisë në vitin 1989, tani zbatoheshin ligjet e Serbisë e jo të Kosovës. Pas luftës së vitit 1999, në Kosovë kemi administrimin ndërkombëtar UNMIK, sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244, dhe zbatoheshin ligjet e aplikueshme në Kosovë, të periudhës së autonomisë së Kosovës si dhe disa ligje Jugosllave. Stafi ndërkombëtar nxjerrur rregullorë të reja për rregullimin e infrastrukturës ligjore në Kosovë. Pas aprovimit të Kushtetutës së Kosovës në vitin 2008, në përputhje me këtë u paraqit edhe nevoja për ndryshimin, plotësimin e legjislacionit ekzistues si dhe nxjerrjen e ligjeve të reja. Kodi i ri penal i Kosovës si risi parasheh dënimin me burgim të përjetshëm (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82) si dhe dënimin me burgim jo ma pak se 30 ditë dhe jo më shumë se 25 vjet. Po ashtu risi në Kodin penal të Republikës së Kosovës janë paraparë dënimet alternative (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 49) si dhe dënimet plotësuese (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 52) Kodi i ri penal i Kosovës tani nuk i rregullon sanksionet penale për të mitur, çka kjo është një risi, pasi këtë fushë penale ndaj të miturve e rregullon Kodi i drejtësisë për të mitur të Kosovës (Kodi I Drejtësisë për të mitur të Kosovës, Prishtinë, nr. 03/L-193) me të cilin përcaktohen rregullat mbi ekzekutimin e sanksioneve penale për të mitur.

Dënimet kryesore janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe konkrete në nenin 43 të kodit penal të Kosovës, e këto janë:

- Dënimi me burgim të përjetshëm,
- Dënimi me burgim, dhe
- Dënimi me gjobë

#### *2.4.1 Dënimi me burg të përjetshëm*

Nga ndryshimet dhe plotësimi e bëra në fushën e dënimeve, Kodi i Penal i Republikës së Kosovës, parasheh dënimin me burgim të përjetshëm në vend të dënimit burgim gjerë në dyzetë 40 vjet, që ishte i paraparë në Kodin e mëparshëm (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, neni 37 paragrafi 2)

Dënimi me burgim të përjetshëm është dënimi më i rëndë që mund të shqiptohet kryesisht i cili ka kryer veprë ma të rëndë penale, të kryer në mënyrë rënduese dhe që ka shkaktuar pasoja shumë të rënda. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04&L-82) Ky ligj nuk mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm si të vetmin dënim kryesor për një veprë të veçantë penale. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund të shqiptohet personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur njëzetën 21 vjet. Po ashtu dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund të shqiptohet edhe personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi esencialisht të zvogëluar mendore. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04&L-82 paragrafi 3) Personi i dënuar me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur dyzetë 40 vjet nga dënimi me burgim të shqiptuar (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04&L-82)

#### *2.4.2. Dënimi me burg*

Dënimi me burgim është dënim kryesor dhe minimumi i shqiptimit të këtij dënimi është 30 ditë, kurse maksimumi është 25 vjet. Ky dënim mund të shqiptohet me vite dhe muaj të plotë, e në rastet kur dënimi shqiptohet gjerë në 6 muaj, dënimi mundet të shqiptohet edhe në ditë të plota (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04&L-82) Kur

kryesit të veprës gjykata i shqipton dënimin me burgim gjerë në 6 muaj, gjykata mund të vendosë që ky dënim të zëvendësohet me dënimin me të holla ose me dënimin me dobi të dobi të përgjithshme. Për këtë zëvendësim të dënimit paraprakisht duhet të merret pëlqimi i të dënuarit (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04&L-82)

Personi i cili për shkak të kryerjes së veprës penale është dënuar me më së paku 5 vjet burgim, mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur  $\frac{2}{3}$  e dënimit të shqiptuar, kurse për veprat tjera ku dënimi është mbi 5 vite burg, personi mund të lirohet me kusht mbasi të ketë mbajtur  $\frac{1}{2}$  e dënimit të shqiptuar nga gjykata (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 94 paragrafi 2)

#### *2.4.3. Dënimi me gjobë*

Dënimi me gjobë si dënim kryesor nuk mund të shqiptohet më pak se njëqind 100 Euro dhe nuk mundet ta kalojë shumën më tepër se njëzetepesëmijë 25,000 Euro. Kurse sa i përket veprave penale të lidhure me terrorizmin, trafikimin me qenie njerëzore, krim të organizuar ose veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, nuk mundë të tejkalojë shumën prej pesë qind mijë 500,000 Euro (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 46 paragrafi 1) Gjykata kur shqipton dënimin me gjobë cakton afatin e pagesës së dënimit. Afati i pagesës së gjobës nuk mundet me qenë ma i shkurtë se pesëmbëdhjetë 15 ditë dhe jo më i gjatë se tre 3 muaj. Në rrethana të arsyeshme gjykata mund të lejojë që dënimi me gjobë të paguhet me këste për një periudhë kohore që nuk kalon më shumë se dy 2 vjet (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 46 paragrafi 2) Nëse personi i dënuar me gjobë nuk dëshiron të paguaj gjobën apo nuk mund ta paguan gjobën, gjykata ka mundësi të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur



dënimi me gjobë zëvendësohet me dënimin me burgim, atëherë një ditë burgim llogaritet njëzetë 20 Euro. Dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë tre 3 vjet (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04&L-82) Personi i dënuar nëse nuk dëshiron të paguajë gjobën apo nuk ka mundësi të paguajë gjobën, gjykata me pëlqimin e tij mundet në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, të shqiptojë dënimin me urdhër për punë në dobi të dobishme .Urdhri për punë me dobi të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë 8 orë të punës me dobi të përgjithshme llogariten me njëzetë 20 Euro gjobë. Kohëzgjatja e punës nuk mund të tejkalojë dyqindëekatërdhjetë 240 orë. Dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet pas vdekjes së personit të dënuar (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 46, paragrafi 5 dhe 6)

#### *2.4.4. Masat e trajtimit të detyrueshëm*

Masat e trajtimit të detyrueshëm janë sanksione penale që u shqiptohen kryerësve të veprave penale të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë penalisht të papërgjegjshëm për shkak të : paaftësisë mendore, aftësisë së zvogëluar mendore, ose për shkak të varësisë nga droga ose alkooli (Halili, Ragip, 2014)

Kryesi i veprës penale me çrregullime mendore ose personi i cili është duke iu trajtuar si i tillë, duhet trajtuar me humanizëm dhe duke respektuar dinjitetin e tij njerëzor (Halili, Ragip, 2014) Në Kosovë për këtë kategori zbatohen standardet ndërkombëtare të zbatueshme për personat me çrregullim mendor për aq sa është e mundur, me ndryshime dhe përjashtime të kufizuara vetëm për aq sa është e nevojshme sipas rrethanave të caktuara.

Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nuk urdhërohet kur nuk është në procesin

me peshën e veprave të kryera, veprave që priten të kryhen nga kryesi dhe shkallën e rrezikut që paraqet kryesi me kryerjen e veprës penale.

Në kapitullin e pastë të Kodit Penal të Kosovës, janë paraparë Masat e trajtimit të detyrueshëm, e sipas këtij Kodi Masat e trajtimit të detyrueshëm të cilat mund ti shqiptohen kryesit i cili nuk është penalisht përgjegjës, ka aftësi esencialisht të zvogëluar mendore apo është i varur nga droga ose alkooli i shqiptohen këto masa:

- Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor,
- Trajtim i detyrueshëm psikiatrik në liri, dhe
- Trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm të personave të varur nga droga ose alkooli.

Këto sanksione penale në pajtim me këtë Kod, mund ti shqiptohen edhe kryesit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, nëse ekzistojnë shkaqe për shqiptimin e sanksionit të tillë (Halili, Ragip, 2014:79)

#### *2.4.4.1. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në institucion adekuat*

Në përputhje me infrastrukturën ligjore. Gjykata mund të ia shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm në institucionin e kujdesit shëndetësor ndaj kryesit të veprës penale, i cili gjatë kryerjes së veprës penale ka qenë në gjendjet të paftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore. (Halili, Ragip, 2014:79) Gjykata në përputhje me Kodin Penal të Kosovës, mund ta shqiptojë këtë masë, nëse ekzistojnë apo janë përmbushur këto kushte ligjore (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04&L-82)

- Nëse kryesi ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënimi më së paku

(3)

tre vjet burgim ,

- Nëse ekziston rrezik serioz se kryesi do të kryejë veprën tjetër penale,
- Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është i nevojshëm për të shmangur

kryerjen

e veprës tjetër penale,

- Kryesi është i pa aftë për tu përballur me gjykimin dhe,
- Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është i nevojshëm për të shmangur

rrezikun serioz.

Gjykata mund t'ia shqiptojë këtë masë kryesit të veprës penale vetëm nëse janë përmbushur kushtet ligjore të lartpërmendura, nëse ndonjëra nga këto kushte nuk konstatohet nga Gjykata, atëherë[ gjykata nuk mundet të shqiptojë këtë masë kryesit të veprës penale. Personi i cili ka kryer veprë penale në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore dhe i cili është dënuar me burgim, koha e kaluar në institucionin e kujdesit shëndetësor do ti llogaritet në kohën e dënimit të shqiptuar për trajtim të detyrueshëm psikiatrik. Nëse koha e mbajtur në ndalim për trajtim të detyrueshëm psikiatrik është më e shkurtër se dënimi me burgim, gjykata mund të urdhërojë që kryesi të dërgohet në burgim për të mbajtur pjesën e mbetur të dënimit ose gjykata mundet të urdhërojë lirimin me kusht. Me rastin e vendosjes për lirimin me kusht të kryesit të veprës penale, gjykata përveç kushteve ligjore të përcaktuara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, do të marrë parasysh edhe faktin se sa ka qenë i suksesshëm trajtimi psikiatrik i detyrueshëm te kryesi i veprës penale, gjendjen e tij shëndetësore si dhe kohëzgjatjen e dënimit që nuk është mbajtur (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04&L-82)

Masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucion shëndetësor

mundet ta pushojë gjykata, atëherë kur të ketë vërtetuar se ka pushuar nevoja për trajtimin e mëtutjeshëm të kryesit të veprës penale në institucionin e kujdesit shëndetësor (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04&L-82)

#### *2.4.4.2. Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri*

Masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri si masë e detyrueshme i shqipton gjykata kryesit të veprës penale i cili gjatë kryerjes së veprës ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore. Kryesit të veprës penale gjykata mund të ia shqiptojë këtë masë nëse konstaton se: - Konstaton se ekziston rreziku serioz se kryesi do të kryej vepër penale,

- Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penale, dhe

-Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i mjaftueshëm për të shmangur rrezikun serioz (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 90 paragrafi 1)

Në përputhje me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Gjkata mund të shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikik në liri kryesit të veprës penale ndaj të cilit është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm me ndalim në institucion shëndetësor, nëse konstaton se masa e ndalimit në institucion shëndetësor është e panevojshme dhe masa e trajtimit psikiatrik në liri është e mjaftueshme për të parandaluar pasojat e tjera. Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri nuk mund të tejkalojë (3) tre vjet nëse është shqiptuar kryesisht me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore.

Gjkata mund të shqiptojë trajtimin e detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, nëse konstaton se:

- Kryesi nuk i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri ,
- Kur kryesi braktis trajtimin e detyrueshëm në liri, dhe
- Kur përkundër trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, ka rrezik serioz se kryesi prapë do të kryejë veprë penale. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04&L-82, 2012: 24, paragrafi 3). Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri mund të i shqiptohet kryesit të veprës penale me aftësi esencialisht të zvogëluar mendore dhe i cili gjendet në liri me kusht.

#### *2.4.5. Trajtimi dhe rehabilitimi i personave të varur nga droga dhe alkooli*

Masën e trajtimit me anë të rehabilitimit të detyrueshëm i personave të varur nga droga ose alkooli e shqipton gjykata për personin i cili është kryes të veprës penale i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë penalisht i papërgjegjshëm si rezultat i varësisë nga droga apo alkooli, e që konsiston në urdhrin e trajtimit me anë të rehabilitimit të detyrueshëm në një ent shëndetësor. Këtë masë gjykata e shqipton kryesisht krahas dënimit, vërejtjes së gjykatës, ose lirimit nga dënimi dhe njëherit kur ajo bindet se i dënuari ka gjasa për mjekim të suksesshëm. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04&L-82, 2012: 24, paragrafi 1). Masa e trajtimit me anë të rehabilitimit të detyrueshëm të kryesit të veprës penale të varur nga droga ose alkooli i shqiptohet krahas dënimit me gjobë,, vërejtjes së gjykatës ose lirimit nga dënimi, gjykata mund të vendos, me pëlqimin e të dënuarit, që masa e tillë e trajtimit të ekzekutohet në liri. Nëse kryesi pa shkak të arsyeshëm nuk i nënshtrohet trajtimit në liri ose arbitrarisht e braktisë trajtimin, gjykata mund të urdhërojë që trajtimi të ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni91, paragrafi 2).

Nëse kjo masë është shqiptuar krahas dënimit me gjobë, vërejtjes gjyqësore apo lirimit nga dënimi, trajtimi nuk mundet të zgjasë më ta për se (2) dy vjet. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04&L-82, 2012: 24, paragrafi 2). Mirëpo nëse masa është shqiptuar krahas dënimit me burgim, ajo atëherë mund të zgjasë gjerë të kryhet dënimi. Koha e kaluar në institucionin e kujdesit shëndetësor do të llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Gjykata duhet të shqyrtojë ekzekutimin e kësaj mase çdo (2) dy muaj për të vendosur nëse është e nevojshme të vazhdohet masa.

#### *2.4.6. Dënimet alternative – një risi e kodit penal të Kosovës*

Kodi i ri penal i Kosovës në kuadër të risive që ka paraparë janë edhe dënimet alternative. Ky kod në nenin 49, paragrafi 1, përshkruan dënimet alternative dhe llojet e dënimeve alternative. Sipas këtij neni dënimet alternative janë;

- dënimi me kusht,
- gjysmë liria, dhe
- urdhri për punë në dobi të përgjithshme.

Kurse në të njëjtin nen në paragrafin 2, parashihet se gjykata kur shqipton dënimin me kusht, ajo mund të shqyrtojë edhe : urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues, dhe urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04&L-82, 2012, neni ,Nr. 49 paragrafi 1 dhe 2)

#### *2.4.6.1 Dënimi me kusht*

Qëllimi i këtij dënimi është që mos të zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë veprë penale në të ardhmen. Dënimin me kusht është dënim alternativ të cilin e shqipton gjykata në procedurë të rregullt gjyqësore kryesit të veprës penale dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk kryen veprë tjetër penale për kohën e verifikimit të cilën e cakton gjykata. Koha e verifikimit nuk mundet të jetë më e shkurtër se një 1 vit dhe as më e gjatë se pesë 5 vite. Në dënimin me kusht gjykata mund të caktojë që dënimi të ekzekutohet, nëse në afatin e caktuar personi i dënuar nuk e kthen dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale, nuk e kompenson dënimin që e ka shkaktuar me veprë penale ose nuk i përmbushë detyrimet e tjera të parapara me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04&L-82, 2012, neni 50 dhe 51, paragrafi 1,2, 3 dhe 4) Gjkata gjatë procedurës gjyqësore në të njëjtën kohë cakton afatin për përmbushjen e këtyre kushteve në kuadër të kohës së verifikimit. Gjatë shqiptimit të dënimit me kusht gjykata merr parasysh qëllimin e këtij dënimi, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tije pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat tjera në të cilat është kryer vepra penale. Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka paraparë mundësinë e revokimit të dënimit me kusht nëse; - personi i dënuar me kusht gjatë kohës së verifikimit kryen ndonjë veprë tjetër penale për të cilat është dhënë dënim me burgim prej së paku dy 2 apo më tepër vite, (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2 prill 2012, neni 53, paragrafi 1) këtu kemi revokim të detyrueshëm apo obligator. (Halili, Ragip, 2014: 70)- kur personi i dënuar me kusht gjatë kohës së

verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është dhënë dënimi me burgim me më pak se dy vite ose dënimi me gjobë, këtu kemi revokim fakultativ i dënimit me kusht. – personi i dënuar me kusht nëse gjatë kohës së verifikimit nuk i përmbushë detyrat dhe obligimet caktuara nga gjykata, në këta rast gjykata mund të vazhdojë afatin e përmbushjes së kushtit brenda fatit të revokimit apo mundet të revokojë dënimin me kusht. Nëse gjykata konstaton se personi i dënuar me kusht nuk ka mundur të përmbush kushtin e caktuar nga gjykata, për shkaqe dhe rrethana të arsyeshme, atëherë gjykata mundet ta heqë atë detyrim, ose të njëjtin e zëvendëson me detyrim tjetër të paraparë me kodin penal. (Halili, Ragip, 2014: 71) Gjykata e revokon dënimin me kusht, atëherë kur pas shqiptimit të dënimit me kusht, me aktgjykimin e plotfuqishëm konstaton se personi i dënuar ka kryer ndonjë vepër tjetër penale, para se të jetë dënuar me kusht dhe nëse gjykata vlerëson se nuk do të kishte bazë për shqiptimin e dënimit me kusht po të dihej për atë vepër penale (Halili, Ragip, 2014: 71)

#### *2.4.6.2. Gjysëmliria*

Dënimi alternativ gjysëmliria i shqiptohet nga ana e gjykatës kryesit të veprës penale, atëherë kur shqiptohet dënimi me burg deri në një 1 vit. Gjykata në këtë rast mundet të urdhërojë ekzekutimin e dënimit në gjysëmliri për shkak të detyrimeve që ka personi i dënuar lidhur me punën, arsimimin profesional, përgjegjësit esenciale familjare apo nevojën për trajtim mjekësor ose trajtim rehabilitues (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2012, neni 61, paragrafi 1) Atëherë kur personi i dënuar kryen punët e caktuara<sup>5</sup> nga gjykata brenda kohës së lejuar gjatë ditëve të caktuara jashtë burgut,

---

<sup>5</sup> Të dënuarit në gjysëmliri, gjykata ia mundëson ekzekutimin e këtijë dënimi alternative në atë mënyrë që



gjatë kohës sa gjendet në liri, ai është i detyruar që të kthehet në institucion korrektues. I dënuari në gjysëmliri është i detyruar që të kthehet në kohë të caktuar në Institucion korrektuese, pasi kohën tjetër duhet ta kalojë në institucion korrektues. Kur gjykata urdhëron ekzekutimin e dënimit në gjysëmliri, ajo mundet të caktojë disa kushte të parapara me ligj, veçanërisht sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2012, neni 59) Llojet e detyrimeve të caktuara që duhet përmbushur në dënimin me kusht :

- Mjekimi ose rehabilitimi në entin e kujdesit shëndetësor, nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësor ose të rehabilitimit, vizita te psikologu;

- Aftësimi profesional, kryerja e aktiviteteve punuese, mos ndërrimi i vendbanimit, shfrytëzimi i pagës për përmbushjen e detyrimeve familjare, heqja dorë nga alkooli, droga, heqja dorë nga kontakti me persona të caktuar dhe mosvizitimi i lokaleve frekuentuese, heqja dorë nga vajtja e armës,

- Ta kompensojë viktimën, të kthejë dobinë pasurore të fituar me vepër penale, të mos qaset në internet, dhe të ofrojë raporte financiare si që kërkohet nga gjykata.

Kur i dënuari në gjysëmliri nuk i përmbushë detyrimet e caktuara nga gjykata, në lidhje me punën, shkollimin, aftësimin profesion, përkuqdesjen për familje ose detyrimet tjera, gjykata mundet ta revokojë urdhrin për ekzekutimin e dënimit në gjysëmliri dhe të urdhërojë mbajtjen e dënimit të mbetur në burg. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2012, neni 61, paragrafi 3)

---

për çdo ditë mbrenda orëve të lejuara (4, 6, 8, apo 10 ) orë në ditë të qëndrojë në liri për të vazhduar kryerjen e punëve të caktuara, të cilat i ka kryar edhe para kryerjes së veprës penale, apo shkollimin e lënë, studimet apo aftësimin profesional, apo udhoheqjen dhe kryerjen e përgjegjësive familjare (edukim i fëmive, përkuqdesje ndaj familjes dhe kryerjen e punëve të tjera rreth ekonomisë familjare dhe qështjeve të tjera me randësi për familje).

#### *2.4.6.3. Urdhri për punë me dobi shoqërore*

Këtë dënim alternativ mund ta shqipton gjykata me pëlqimin e personit të dënuar. Personi i dënuar me të shqiptuar ky lloj i dënimit alternativ është i obliguar që të kryejë punë në dobi të përgjithshme pa pagesë në periudhën kohore prej 30 deri në 240 orë pune..

Shqiptimi i një dënimi të tillë alternativ paraprakisht kërkon që të plotësohen këto kushte; - kryesit të veprës penale të i jetë dhënë dënimi në të holla prej 2500 Euro, apo dënimi me burgim gjerë në një 1 vit, por njëherit duhet të jep pëlqimin për një dënim të tillë vet personi i dënuar. Në momentin e shqiptimit të këtij dënimi, gjykata përcakton orarin e orëve të punës të cilat duhet ti kryej personi i dënuar. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2012, neni 60, paragrafi 1) Orët e punës të caktuara me vendimin e gjykatës duhet të kryhen brenda një 1 viti. Shërbimi sprovues i Kosovës vendos për llojin e punës që do të kryen personi i dënuar, cakton organizatën se ku do ti kryej personi i dënuar punën në dobi të përgjithshme dhe njëherit mbikëqyrin këtë dënim alternativ se si po e kryen personi i dënuar. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2012, neni 60, paragrafi 2)

Gjykata e cila shqipton dënimin me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, ajo mundet të urdhërojë personin e dënuar për kryerjen e një apo më shumë detyrimeve si në vijim: - të mbajë kontakte me Shërbimin sprovues, të kthen përfitimin pasuror të fituar me kryerjen e veprës penale, të kompensojë dëmin e shkaktuar me vepër penale, dhe të përbush detyrimet e parapara me ligj. Kohëzgjatja e detyrimeve të parapara me ligj nuk mundet me qenë më e shkurt se gjashtë 6 muaj dhe as më e gjatë se tre 3 vjet. Kur personi i dënuar me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme nuk e kryen

këtë punë në dobi të përgjithshme të caktuar nga gjykata ose pjesërisht e kryen, atëherë gjykata mundet të shtyjnë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes dhe të urdhërojë dënimin me burg. Në këtë rast një ditë burgim do të urdhërohet për çdo tetë 8 orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2012, neni 60, paragrafi 5 dhe 6)

#### *2.4.6.4. Urdhri për trajtim të detyrueshëm rehabilitues*

Gjykata mundet të shqiptojë dënimin me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues në raste se: Personi i dënuar që e ka shkelur ligjin për herë të parë, nëse veprën e ka kryer në ndikim të drogës apo alkoolit, nëse gjykata pas shqyrtimit të raportit të shërbimit sprovues, konstaton se faktor kryesor që ka motivuar kryerjen e veprës penale është i lidhur me varësinë e tije nga droga apo alkooli dhe se trajtimi i suksesshëm rehabilitues ndaj kryesit të veprës penale do të zvogëlonte rrezikun për kryerjen e veprës së re penale. Gjykata kryesit të veprës penale ia cakton periudhën gjatë së cilës programi për trajtim të detyrueshëm duhet të fillojë dhe njëherit të përfundojë. Urdhri për trajtim të detyrueshëm rehabilitues nënkupton realizimin e një programi të posaçëm të trajtimit mjekësor me të cilin personi i dënuar do të shërohet nga varësia e alkoolit, drogës, apo mjeteve tjera narkotike (Halili, Ragip, 2014: 72)

Programi trajtues caktohet nga ekspertet e lëmive të caktuara dhe adekuate, kurse realizimi i tije mbikëqyret nga shërbimi sprovues. Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues konsiderohet se është realizuar apo mbajtur, po nëse është realizuar me sukses programi i trajtimit rehabilitues. Lidhur me suksesin apo mosesuksesin e programit rehabilitues, shërbimi sprovues është i obliguar ta njoftojë gjykatën e cila ka

shqiptuar këtë dënim alternativ. Në rast se personi i dënuar nuk e përfillë programin e trajtimit rehabilitues, nuk mban kontakte me shërbimin sprovues, nuk i kryen obligimet lidhur me trajtimin rehabilitues, gjykata mundet ta shtyjë afatin e programit rehabilitues, ta zëvendësojë këtë dënim me një tjetër ose të urdhërojë ekzekutimin e dënimit të caktuar në dënimin me kusht. Periudha e trajtimit të detyrueshëm me qëllim rehabilitimi të personit të dënuar nuk mundet të zgjasë më pak se tre 3 muaj apo më tepër se dymbëdhjetë 12 muaj.

#### *2.4.6.5. Urdhri për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues*

Për veprë të kryer penale gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, po që se ajo konsideron se integrimi i të dënuarit në shoqëri ose përmbushja e kushteve të caktuara nga gjykata arrihet më mirë dhe më suksesshëm përmes mbikëqyrjes nga shërbimi sprovues. Analizuar aspektin përmbajtësor të këtij dënimi shihet se gjykata kryesit të veprës penale i shqipton dënimin me burgim dhe në të njëjtën kohë e pezullon ekzekutimin e këtij dënimi dhe e urdhëron personin të mbajë kontakte me shërbimin sprovues. Në të njëjtën kohë gjykata kërkon nga shërbimi sprovues që të informojë lidhur me mundësit për ekzekutimin e këtij dënimi. Me rastin e caktimit të kësaj mase gjykata merr parasysh edhe detyrimet të cilat dalin nga dënimi me kusht dhe krahas kësaj vendos në përputhje me ligjin dhe gjithnjë duke pasur parasysh moshën e kryesit të veprës penale, gjendjen e tij shëndetësore dhe psikike, mënyrën e jetës dhe nevojat e kryesit të veprës penale. Në veçanti gjykata merr parasysh nevojat në lidhje me familjen, shkollimin, punën e tij. Gjkata po ashtu në hollësi analizon dhe shqyrton të kaluarën e kryesit të veprës penale, motivet për kryerjen e veprës

penale, rrethanat e tijve personale dhe familjare, pasi të gjitha këto janë me rëndësi me rastin e caktimit të këtij dënimi alternativ. Ky dënim i shqiptuar nga gjykata nuk mundet të zgjatë më pak se gjashtë 6 muaj dhe më shumë se tre 3 vjet. Po që se i dënuari nuk i përmbahet kushteve të caktuara nga gjykata, atëherë gjykata mundet ta revokojë këtë dënim, ta zëvendësojë me një tjetër ose ta shtyjë kohëzgjatjen e dënimit. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2012, neni 59, paragrafi 1)

Ekziston një numër i konsiderueshëm i detyrimeve të përfshira me kusht në urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovuës dhe gjykata mund të caktojë një apo më shumë detyrime si p.sh;- mjekimi ose rehabilitimi në institucionin shëndetësor, vizita te psikologu ose te këshilluesit tjerë, aftësimi profesional në një profesion të caktuar, kryerja e aktiviteteve punuese, shfrytëzimi i pagës për përmbushjen e detyrimeve familjare, heqja dorë nga përdorimi i drogës dhe alkoolit, heqja dorë nga shoqërimi me persona të caktuar, heqja dorë nga frekuentimi në vende apo lokale ku konsumohet alkooli, heqja dorë nga bartja e çfarëdo arme, të kompensojë palën e dëmtuar me anë të veprës penale, të kthejë dobinë pasurore të fituar nga kryerja e veprës penale, të mos qaset në internet dhe të ofrojë raporte financiare të kërkuara nga gjykata. (Halili, 2014: 73)

#### *2.4.7. Dënimet plotësuese sipas Kodit penal të Kosovës*

Në kuadër të sanksioneve penale edhe dënimet plotësuese gjykata mundet tua shqipton kryesve të veprave penale krahas dënimit kryesor ose dënimit alternativ me qëllim të mënjanimin të kushteve dhe rrethanave të cilat mund të ndikojnë që kryerësi i veprës penale në të ardhmen të kryejë vepër penale. Këto dënime kanë për efekt kufizimin e disa të drejtave të kryesit të veprës penale, me qëllim parandalimi te kriminalitetit,

arsimimin, edukimin, risocializimin dhe ri-integrimin e personave të dënuar (Halili, 2014: 73) Infrastruktura ligjore e republikës së Kosovës në tërësi e në veçanti Kodi Penal i Republikës së Kosovës në nenin 54 paragrafi 2, parasheh këto dënime plotësuese: Heqja e të drejtës për të u zgjedhur, Urdhri për kompensimin e dëmit, Ndalim i ushtrimit të funksionit. Ndalim i ushtrimit të profesionit, Ndalim i drejtimit të automjetit, Marrja e lejes së vozitje, Konfiskimi, Urdhri për publikimin e aktgjykimit dhe Dëbimi

#### *2.4.7.1 Heqja e të drejtës për të u zgjedhur*

Dënimin plotësues si që është heqja e të drejtës për të u zgjedhur mund të shqipton gjykata kryesit të veprës penale në një afat kohor prej një 1 gjerë në katër 4 vjet, nëse ai person me qëllim të zgjidhet në organet lokale apo qendrore (deputet, këshilltar, kryetar komune, etj) kryen ndonjë nga veprat penale kundër të drejtave të votimit, si falsifikim i listave, kërcënim i votuese, shantazhin ose vepër tjetër penale për të cilën është paraparë dënimi me më së paku dy 2 vjet burgim.

Heqja e të drejtës për tu zgjedhur shqiptohet nga gjykata krahas dënimit me burgim dhe kohëzgjatja e tije është prej një 1 gjerë në tre 3 vjet.

Ekzekutimi i këtij dënimi plotësues fillon pasi i dënuari të ketë mbajtur dënimin me burgim. (Halili, 2014: 73)

#### *2.4.7.2. Urdhri për kompensimin e dëmit*

Urdhrin për kompensimin e humbjes apo dëmit si dënim plotësues gjykata mundet të ia shqiptojë kryesit të veprës penale i cili është shpallur fajtor për çfarëdo vepre penale

që përfshinë vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë. Me këtë rast gjykata do të urdhërojë kryesin e veprës penale që të bëjë kompensimin e dëmit viktimës, i cili është dëmtuar nga kryesi i veprës penale. Dëmshpërblimi përfshinë vlerën e shpenzimeve që është e barabartë me vlerën e pasurisë së vjedhur, humbur, dëmtuar apo të shkatërruar. Vlen të ceket se dëmshpërblimi do të urdhërohet gjithashtu edhe për çfarëdo humbje të të ardhurave të cilat viktimia i përjeton si rezultat i veprës penale si dhe humbjet gjatë procedurave hetimore dhe gjyqësore që ai i ka gjatë këtij procesi lidhur me veprën e kryer ndaj tij (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04&L-82, 2012)

#### *2.4.7.3. Ndalim i ushtrimit të funksionit*

Ndalimin i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik mund ta shqipton gjykata si dënim plotësues kryesit të veprës penale, i cili ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me burg. Kohëzgjatja e ndalimit të ushtrimit të funksionit mundet të zgjasë prej një 1 gjerë në pesë 5 vjet, pas mbajte së dënimit me burgim. Gjykata ia shqipton dënimin plotësues ndalim i ushtrimit të funksionit në administratën publike ose në shërbimin publik në kohëzgjatje prej një 1 gjerë në gjerë në pesë 5 vjet, edhe nëse personi i tillë ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me gjobë ose me dënim me kusht (Halili, 2014: 79)

#### *2.4.7.4. Ndalim i ushtrimit të profesionit*

Ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë, detyrës menaxhues, detyrave që janë të lidhura me sistemin, menaxhimin apo shfrytëzimin e pasurisë në pronën publike,

gjkata mund ti shqipton si dënim plotësues kryesit të veprës penale i cili ka keqpërdorur pozitën e tije, veprimtarinë apo detyrën me qëllim të kryerjes së veprës penale apo nëse ka arsye të pritët që ushtrimi i profesionit, veprimtarisë apo detyrës së tillë nga ai mund të keqpërdoret për kryerjen e veprës penale. Ky dënim plotësues i shqiptuar nga gjykata nuk mundet të jetë më i shkurtër se një 1 vit dhe as më i gjatë se pesë 5 vite, duke llogaritur nga dita kur vendimi merr formën e plotfuqishmërisë, apo formën e prerë. Koha e mbajtur në burg apo në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatje të këtij dënimi (Halili, 2014: 79)

#### *2.4.7.5. Konfiskimi – marrja e sendit*

Konfiskimi apo marrja e sendit është dënim plotësues i karakterit pasuror të cilin e shqipton gjykata për kryesin e veprës penale, e me ç'rast kryesit të veprës bashkë me dënimin kryesor, ose me dënimin alternativ apo me rastin e lirimit nga dënimi, i konfiskohen apo i merren sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale, ose i konfiskohen - merren sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale (Gjykata Supreme e Kosovës, 2011) Sendet e përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale mund të konfiskohen edhe në rastet kur nuk janë pronë e kryesit të veprës, nëse kjo është në dobi të sigurisë së përgjithshme, ose për arsye të moralit, po që se kjo nuk ndikon dëmshëm mbi të drejtat e palës së tretë për të marrë kompensimin e çfarëdo dëmi nga kryesi i veprës penale (Halili, 2014: 87). Konfiskimi apo marrja e detyrueshme e sendit mund të përcaktohet me ligj.



#### *2.4.7.6. Urdhri për publikimin e aktgjykimit*

Urdhri për publikimin e aktgjykimit si dënim plotësues gjykata mundet të ia shqiptojë kryesit të veprës penale kur e çmon se publikimi është në interes të përgjithshëm të të dënuarit apo të personave të tjerë. Urdhri për publikimin e aktgjykimit kërkon që aktgjykimi të publikohet, tërësisht ose pjesërisht në gazetë apo të transmetohet në radio ose televizion.. Ky publikim bëhet me shpenzimet e të dënuarit. Kohëzgjatja e publikimit dhe data caktohet nga vetë gjykata. Mjetet e informimit si; gazeta, radio apo stacioni televiziv janë të obliguara ta publikojnë aktgjykimin të cilin ua dërgon gjykata. Nuk urdhërohet publikimi i gjykimit nëse konstatohet se publikimi i tillë e rrezikon fshehtësinë zyrtare, privatësinë e personave apo moralin e shoqërisë. (Halili, 2014: 87)

#### *2.4.7.7. Dëbimi*

Dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës, si dënim plotësues e shqipton gjykata për kryes të veprave penale që nuk janë qytetar të Republikës së Kosovës. Gjkata këtë dënim plotësues mundet ta shqiptojë në kohëzgjatje prej një 1 viti e gjerë në dhjetë 10 vjet. Me rastin e shqiptimit të këtij dënimi plotësues, gjykata merr parasysh llojin e veprës penale, peshën e veprës penale, motivet e kryerjes së veprës penale dhe lidhjen e kryesit me Republikën e Kosovës. Ekzekutimi i këtij dënimi plotësues llogaritet nga dita kur vendimi gjyqësor e merr formën e prerë. Nëse kryesi i veprës për një kohë të caktuar ka qenë në burg apo në institucionin e kujdesit shëndetësor, atëherë kjo kohë nuk i llogaritet në kohëzgjatjen e dënimit plotësues- dëbim i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës (Halili, 2014: 65)

# KAPITULLI III

## POLITIKA PENALE NË VËSHTRIMIT HISTORIK NË

### KOSOVE

Shprehja "politikë kriminale" po gjen një përdorim gjithnjë e më të shpeshtë në fjalorin e përditshëm, jo vetëm të specialistëve të drejtësisë, të kriminologëve dhe hartuesve të politikave, por edhe në radhët e medias e të publikut të gjerë. Kjo shprehje njihet përcaktime të ndryshme, të cilat në më të shumtën e rasteve, janë të lidhura me konceptet e ndryshme që ekzistojnë, lidhur me këtë disiplinë dhe përmbajtjen e saj (Azra Adžajlić-Dedović, 2007). Duke dashur të analizojmë këto përcaktime, u përpoqëm të gjejmë në fjalorin e gjuhës shqipe kuptimin e fjalës "politikë".

#### **3.1. Kriminaliteti dhe politika penale në Kosovë**

Sanksionet penale në Kosovë kanë ndryshuar varësisht nga ndryshmi i Legjislacionit penal në Shtetin e ish Jugosllavisë si dhe me ndryshimin e legjislacionit të Republikës së Serbisë ("Službeni list" DFJ, nr. 48/1945).

##### *3.1.1. E drejta penale e Kosovës gjatë periudhës së feudalizmit;*

Populli shqiptar në Kosovë, gjatë kohës së sundimit turk, gjendjen, mjerimin dhe pasigurinë personale-qytetare në rrethin e Gjakovës, e ilustronte me këngë popullore, që këndohej gjatë lëvizjes shqiptare në vitin 1908 me përmbajtje si në vijim: "Keni mëshirë, mjerimi është i madh dhe zbuteni fatkeqësinë shqiptare! Më i pasuri ka vetëm

një copë të vogël toke, nëpër shtrëngata dhe dëborë e bartë pa pushim njeriu i ndeshur dhe i zbathur barrën e vet; Pushkën me vete, vetëm bukë me kripë, gjithmonë i kanoset rreziku për jetë“(Tuçović, 1945: 32).

Pushtetit turk, i duhej që pushtetin e tij në territorin e Kosovës, ta ushtronte në mënyrë sa më të lehtë, për këtë arsye si dhe për shkaqe tjera praktike e administrative, territorin e ndante në rrethe dhe në rrethe vendoste njësi territoriale gjyqësore të quajtura sanxhaqe ose kaze, kurse në krye të çdo sanxhaku emërohej një person zyrtar i quajtur kadi<sup>6</sup>.

Kaditë apo gjykatësit në ushtrimin e pushtetit turk kishin autorizime të gjera, të njëjtit merreshin me organizimin e gjykimeve civile dhe penale, por për shkak të autorizimeve që i kishin ata merreshin edhe me mbledhjen e tatimeve shtetërore, e po ashtu i caktonin çmimet e disa nga prodhimet elementare për jetesë. Gjithashtu kaditë shikonin edhe arsyshmerinë e padive të personave, të drejtuara ndaj sjelljeve të organeve shtetërore dhe lidhur me këtë e informonin pushtetin qendror (Rizaj, 1965: 91). Kaditë detyrën e tyre e ushtronin mbi bazën e normave juridike që i përcaktonte Sheriati<sup>7</sup>, kryesisht duke u bazuar në Kuran dhe komentimet e tij. Kaditë në gjysmën e dytë të shekullit XV dhe më vonë, detyrën e tyre e ushtronin mbi bazën e kanuneve, që në fakt ishin kode të nxjerrura nga pushteti turk, por kaditë gjatë punës së tyre i mbronin interesat e pushtetit dhe në përgjithësi të feudalëve. Kështu në Kosovë në shekullin e XVII, ishin emëruar kaditë si organ shtetëror, apo për ta ushtruar pushtetin gjyqësor, dhe kaditë e parë ishin emëruar në Dukagjin, si në Gjakovë, Deçan e Junik, si dhe në vendet e tjera (Rizaj, 1971: 235-236).

---

<sup>6</sup> Kadi është fjalë arabe që do të thotë gjykatës.

<sup>7</sup> Burimi kryesor i të drejtës myslimane është Kurani, libër i shenjtë i myslimanëve, që përbëhet nga fjalët e urta dhe rregullat (urdhërat) e Muhamedit, përndryshe themeluesit të fesë islame, që e kanë quajtur Sherije-ligjdhënës, kështu i tërë sistemi i të drejtës myslimane e ka marr emrin shariat.

Gjatë kohës së sundimit turk, populli i Kosovës kishte një jetë të rëndë ekonomike dhe nivel të ulët të jetës kulturore, kështu kjo gjendje e pa perspektiv dhe duke mos i besuar sundimit turk, ka ndikuar që populli edhe ma tutje ta ruan dhe ta respekton rregullimin fisnor, si e vetmja formë e qeverisjes të cilës i besonin. Kështu në këtë formë të qeverisjes, njerëzit e kanë ndier vetin më të sigurt, kjo për faktin sepse i tërë fisi e ka mbrojtur njëri tjetrin, pra fisi e ka mbrojtur jetën dhe pasurinë e anëtarit të vet (Rizaj, 1971: 30).

Gjer në fund të shekullit XIX gjatë kohës së sundimit turk, populli shqiptarë e ka ruajtur të drejtën zakonore, duke e zgjeruar në rregullimin e marrëdhënieve shoqërore, si brenda familjes edhe më gjerë në shoqëri (Pupovci, 1972 : 19). Por në zbatimin e normave juridike në Shqipëri dhe në Kosovë ka ekzistuar një dualizëm juridik, ashtu që krahas zbatimit të sheriatit si dhe të së drejtës penale turke, Kodit Penal turk të vitit 1858, është zbatuar edhe e drejta zakonore (Elezi, 1959 :180).

Në një memorandum dërguar Sulltanit, populli deklaronte se vendi nuk ka rrugë, gjykata objektive-të paanshme, e as siguri prej grabitjeve të shumta nga kugarët. Kështu në Kosovë në shekullin e XVII nuk ka qen e siguruar-garantuar jeta dhe integriteti trupor i njeriut, pasi që për çdo ditë ka pasur vrasje dhe grabitje, mu për këtë njerëzit qarkullonin në grupe dhe të armatosur. Kështu në pjesën malore të Janjevës Komuna e Lypjanit, kishte grupe të organizuara njerëzish, të cilët i sulmonin udhëtarët dhe pasi i vritnin tërhiqeshin në male, po ashtu edhe në Dukagjin në shekullin e XIX ndodhnin shumë vrasje, dhe të vrrarët i varrosnin pa ceremoni fetare (Historia II, fq.83).

Sa i përket sigurisë dhe jetës së njerëzve, gjendja nuk ishte ma e mirë as në Shqipëri, dhe kjo në veçanti reflektohej në Shqipërinë Veriore, ku ishte kryer një numër i madh i

vrasjeve, e kjo si pasojë e mungesës së funksionimit të pushtetit publik, si dhe për shkak të nivelit shumë të ulët të zhvillimit shoqëroro-ekonomik dhe kultural. Në këto vise në fund të shekullit XVII filluan që të vijnë priftërinjtë dhe kur feja katolike filloj që të përhapej me të madhe, filloj edhe përmirësimi i sigurisë publike të popullit, sepse filloj rënia e kriminalitetit, siç ishin vrasjet, lëndimet trupore, vjedhjet dhe veprat e tjera penale (Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII, (1965) II: 121).

Arsyet apo motivet kryesore të konflikteve të ndryshme, lëndimeve trupore si dhe vrasjeve që kanë ndodhur në Kosovë gjatë kohës së sundimit turk, me theks të veçantë ato që ndodhën në shekullin XIX, ishin marrëdhëniet e pazgjidhura të natyrës pronëso0juridike, mosmarrëveshjet rreth ujitjeve të tokave, prerjet e pyllit të huaj, si dhe kullësia e kafshëve në pronën e huaj etj. Të gjitha këto ndodhin si pasojë e mungesës së një pushteti të mirëfilltë të organizuar, për zgjidhjen e problemeve që ndodhin në mesë njerëzve, dhe si pasojë e nivelit jashtëzakonisht të ulët të zhvillimit shoqëroro-ekonomik dhe kultural. Gjerë në përfundim të sundimit turk në Kosovë, nuk ka pasur një rend, dhe siguri publike, që do të mundet popullit t'i siguronte një qetësi dhe siguri publike, dhe që do t'i ndihmonte në zgjidhjen e çështjeve pronëso0juridike dhe çështjeve të tjera me rëndësi jetike për popullin. Me shtimin e popullsisë natyrshëm se janë shtuar edhe konfliktet, në këtë drejtim teoricieni Vukosavljeviq thekson “Nga viti në vit gjer vonë në Vërmosh, kullosa dhe kositja janë ulur me gjak. Kositja bëhej sipas të gjitha rregullave dhe shkathtësive të luftës popullore, ashtu që derisa disa kositnin të tjerët bënin roje dhe vriteshin. Për ti ikur situatave konfliktuoze kositej edhe natën, ku më tepër shkelej bari se sa kositej, por kjo ka pas të bënë për të treguar të drejtën mbi pronën se sa prona të shfrytëzohej” (Vukosavljević, 1953 :45), këto konflikte bëheshin më tepër për pyje se sa

për tokën sepse toke duhej të punohej. Vukosavleviq konstaton se një gjendje e tillë ekzistonte edhe në Serbi, Maqedoni dhe Bosnjë Hercegovinë, pasi që komisione të posaçme i caktonin mezhdat e pyjeve. Pushteti turk, pronat nuk i ndante sipas nevojave që kishte popullsia, por e merrte një sipërfaqe aq sa i duhet, kurse pjesën tjetër e lente të pa definuar, kështu bënte edhe me pyjet, kurse sipërfaqen që e lente të lirë, tani për atë sipërfaqe fshatarët grindeshin, dhe kështu vinte deri te konfliktet.

Motivet e drejtpërdrejta që kanë shkaktuar lëndime trupore dhe vrasje, në Kosovë janë të natyrës së konflikteve rreth pyjeve dhe ujitjes dhe lidhur me këtë më së miri flet një dokument arkivor i vitit 1890. Në atë dokument konstatohet se fshatarët e Deçanit dhe të Isniqit që nga viti 1716 kanë pasur konflikte të pa zgjidhura rreth çështjes se a është pylli i quajtur Jajla në pronën e Deçanit apo të Isniqit dhe rreth shfrytëzimit të ujit nga lumi Bistrica. Në këtë drejtim siç thuhet në atë dokument arkivor i cili është përpiluar me rastin e pajtimit të këtyre fshatrave, është përshkallëzuar në konflikte me përmasa kolektive, ku për pasoj ka pasur përveç lëndimeve trupore edhe vrasje, kështu vazhdon dokumenti me konstatimin “Vetëm në gjakderdhjen e fundit, sipas hetimeve që janë bërë, duke i llogaritur të plagosurit dhe të vrarët për një vit nga të dy palët, nga Isniqi ka pasur 38 persona të plagosur dhe 24 të vrarë, ndërsa nga Deçani ka pasur 40 persona të plagosur dhe 23 të vrarë, apo gjithsejtë 128 gjakderdhje” (Rexha, 1971 : 247-249).

Konsideroj se sa ju përket motiveve lidhur me këto lëndime trupore dhe vrasje, në mesë të fshatrave Deçan-Isniq, kajrtë vërtetohet fakti se konfliktet kanë lindur si pasoj e mos definimit të pronësisë së pyjeve dhe të drejtës për shfrytëzimin e ujit të lumenjve. Kështu këtu vërtetohet edhe fakti tjetër i mos funksionimit preventiv të pushtetit turk në interes të popullit për rend dhe siguri, ndërsa vetëm pas këti rasti tragjik në vitin 1890 pushteti turk në bashkëpunim me përfaqësuesit e fshatrave Deçan dhe Isniq, i kanë pajtuar

palët në konflikt, e në anën tjetër kanë konstatuar se pylli kontestues është i shtetit, mirëpo fshatarët në pajtim me kushtet e caktuara në këtë dokument kanë të drejtë ta shfrytëzojnë (Rexha, 1971 : 247-249).

Gjatë kohës së pushtetit turk mezhdat ishin burim i konflikteve, dhe kjo çështje nuk u rregullua, atëherë në të drejtën zakonore të popullit shqiptar u krijuan rregulla juridike vendore, lidhur me statusin juridik të mezhdave të pronave, flet KLD-ja prej nenit 238-266 dhe në të gjitha këto dispozita mezhdat janë konsideruar të palëvizshme dhe të shenjta. Kështu neni 242 i KLD parashikon “Kufini i ngulun një herë, nuk luhet ma” ndërsa neni 243 parashikon “Eshtent e vorrit e guri i kufinit faqe Kanunit janë baraz, me e luajt kufinin asht një si me luejt me eshtent e të dekunve”. Këto norma të KLD-së, janë respektuar me besnikëri nga populli, por natyrshëm se ka pasur raste kur nuk janë respektuar, kurse mos respektimi i mezhdave në pajtim me normat e cekura, ka shkaktuar reagime të ashpra, deri edhe në vrasje. Neni 251 i KLD-së parashikonte, nëse ndokush e ka luajtur mezhdën dhe si pasojë e këtij veprimi ka ardhur deri te vrasja, fajtori ka pasur për detyrim pagimin 100 deshve, një ka, dhe pas kësaj do të mbytet nga i tërë fshati. Prej nenit 255-266 KLD parashikon edhe norma të tjera sanksionuese lidhur me mezhdat, kështu parashikon se nëse vie deri te vrasja për shkak të mezhdës, atëherë pikërisht në vendin ku ka ndodhur vrasja është vendosur mezhdë. Neni 260-261 parashikonte se nëse konflikti lidhur me pronën ka ndodhur ndërmjet bajraqeve ose fshatrave, atëherë prona i ka takuar ati bajraki ose fshati anëtari i të cilit është vararë.

Përveç rasteve të cekura, gjatë kohës së sundimit turk në Kosovë, si burim i konflikteve me pasojë të vrasjeve ka qenë faktori grua, nënë, motër e kështu me radhë. Çdo fyerje, lëndim trupor dhe të ngjashme që i janë shkaktuar gruas, motrës përkatësisht nënës, është konsideruar si e keqe e madhe, dhe jo rastësisht si pasojë e kësaj të keqe, ka

ardhur deri edhe te vrasja, ndërsa e keqja që i është shkaktuar gruas, është konsideruar si më e rëndë me atë të keqe që i është shkaktuar mashkullit. Në bazë të botëkuptimeve të atëhershme, burri ka qenë i detyruar që të hakmerret, sepse jeta dhe nderi i femrës janë konsideruar si të pandashme nga jeta dhe nderi i mashkullit, në çdo fis kanë ndodhur vrasje të shumta si pasojë e fyerjes së nënës, motrës e gruas (Palaj, 1944: 130 / Salihu, 1985: 48).

Edhe faktori politik, ishte një ndër arsytet e vrasjeve, sepse ata që e kundërshtonin pushtetin turk, të njëjtit ai pushtet edhe i vriste. Në këtë drejtim autori serb Jovan Cvejić kështu i përshkruante përshtypjet e tija gjatë qëndrimit në Prizren: “Gjatë kohës së qëndrimit tim në Prizren në vitin 1910 për çdo mëngjes mund të shihej ndonjë shqiptar i varur gjatë natës së kaluar (Cvijić, 1922: 395 / Salihu, 1985:50).

Veprat penale të vrasjes, natyrisht se kanë sjellë pasojë të mëdha dhe të shumëfishta, përveç pasojës së humbjes së anëtarit të familjes, si rezultat i hakmarrjes ka ardhur deri te vrasja tjetër, janë shkaktuar pasojë të rënda sociale, për faktin se familja e dorasit për shkak të frikës nga gjakmarrja, me vendimin e pleqërisë (Ismaili, 1979: 16), janë detyruar që të shpërngulen nga vendbanimi, ndërsa tokën dhe pasurinë e tyre e kanë blerë të pasurit.

E drejta penale e Kosovës gjatë kësaj periudhe i ka të gjitha tiparet e të drejtës penale të shteteve tjera të Evropës. Nga periudha e feudalizmit të hershëm, gjer në shek. XII, nuk janë ruajtur dokumente juridike të shkruara (ligje, kode apo përmbledhje të së drejtës zakonore), në bazë të së cilave do të mund të nxirreshin konkluzione lidhur me të drejtën penale të asaj kohe. Në territorin e Kosovës, në Republikën e Shqipërisë dhe në viset tjera etnike shqiptare, gjatë kohës së mesjetës nuk janë ruajtur monumente juridike në bazë të



të cilave do të mund të nxirrnim ndonjë parafytyrim juridik për karakterin e së drejtës penale të asaj kohe. Në shek. XV, Kosova, Shqipëria Viset tjera shqiptare dhe pothuajse të gjitha viset tjera ballkanike u pushtuan nga perandoria turke e cila sundoi në këto vise gati 5. shekuj dhe në këto vise aplikoheshin drejta zakonore por edhe e drejta zakonore penale, krahas kësaj vepronin edhe sheriatit, kanunaret turke dhe Kodi Penal i Turqisë i vitit 1868. Në Kosovë ekzistonte një dualizëm juridik. Krahas zbatimit të sheriatit dhe të drejtës penale turke, është aplikuar edhe e drejta zakonore shqiptare dhe në kuadrin e saj edhe e drejta zakonore penale edhe pse ishin tendencat turke që edhe veprat penale të rregullohen me ligjet dhe kanunaret turke në viset malore së pushoi kurrë së vepruari e drejta zakonore shqiptare. Pjesa më e madhe e së drejtës zakonore shqiptare quhej Kanuni i Lekë Dukagjinit, që i mbledhi populli dhe i sistemoi frati Shtjefën Gjecovi. Në Shqipëri dhe trojet tjera shqiptare, si e drejta zakonore njihen edhe Kanuni i Skënderbeut (arbërit) Kanuni i Maleve, Kanuni i Labërisë si dhe kanunet tjera lokale si ai i Bendës, Mirditës, Pukës, Hasit etj.. Këto kanune së bashku me Kanunin e Lekë Dukagjinit përbëjnë burimet e së drejtës zakonore penale shqiptare. Sipas kanuneve të përmendura veprat penale ishin të sistemuara si vijon: Veprat penale kundër personit, kundër familjes dhe martesës, kundër pronës private, kundër kishës dhe veprat tjera penale.

Kanuni i Lekë Dukagjinit ka 12 libra, 24 kapituj, 259 nyje dhe 1263 paragrafe. Në tërë vëllimin e Kanunit të Lekë Dukagjinit. normat penalo juridike janë të pakta, nuk janë të sistemuara si duhet dhe ka përsëritje. Në kuadrin e normave penalo juridike janë të rregulluara ca institucione të përgjithshme të së drejtës penale, si fjala vjen fajësia, bashkëpunimi, tentativa, dënimet si dhe figurat e veprave penale të posaçme.

Llojet e dënimit sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit. ishin:

1. Gjakmarrja,

2. dënimi me vdekje
3. Dëbimi
4. Djegia e shtëpisë
5. Rrënimi i pasurisë
6. Të prerit e pemëve dhe të lënit e tokës djerrin
7. gjoba dhe
8. lëçitja (bojkotimi).

### *3.1.2 E drejta penale e Kosovës midis dy luftërave botërore (1918-1941)*

Pas përmbytnjes së perandorisë osmane Shqipëria shpalli pavarësinë në vitin 1912, e cila ndërkohë u pranua ndërkombëtarisht. Kosova dhe viset tjera shqiptare u okupuan dhe u vunë nën sovranitetin MSKS, shtet që u themelua në vitin 1918, Kosova dhe Maqedonia u emërtuan Serbi e Jugut. Në tërë territorin e këtij shteti pra edhe të Kosovës, në fillim u aplikuan kapitulli IX dhe XI i Kodit penal të Serbisë mbi krimet dhe kundërvajtjet kundër shtetit, mbretit dhe kushtetutës. Në vitin 1921 u aprovua Ligji i posaçëm mbi mbrojtjen e sigurisë dhe rendit shtetëror, i cili karakterizohej me dënime drakonike. Kodi Pena.i MJ u aprovua në vitin 1929 dhe hyri në fuqi me 1 janar të vitit 1930. Për atë kohë ky kod u vlerësua si kod modern mirëpo për shqiptarët kodi penal u abuzua shumë., ngase u vranë rreth 10.000 shqiptar në periudhën 1918-1941, rreth 200.000 shqiptar të shpërngulur në Turqi. Me reformën agrare rreth 380.000 ha ju morën shqiptarëve dhe ju dhanë kolonistëve serb e malazez.

### *3.1.3. E drejta penale e Kosovës pas luftës së dytë botërore.*

Luftë iu bashkuan edhe shqiptarët me shpresë se pas luftës do t'i bashkëngjiten Shqipërisë, Në Konferencën e Bunjës me 31 dhjetor dhe 1 dhe 2. janar të vitit 1944, ku përpos shqiptarëve morën pjesë edhe disa serb të Kosovës dhe përfaqësues anglez, u vendos që Kosova pas luftës t'i bashkohet Shqipërisë, mirëpo siç është e njohur pas luftës shqiptarët u tradhtuan dhe ngelën nën sovranitetin e Serbisë dhe të Jugosllavisë.

Në shtetin e Jugosllavisë, nën juridiksionin e së cilës ishte edhe Kosova, në vitin 1945 u nxorën këto ligje:

- Ligji mbi luftimin e spekulimeve dhe sabotimeve ekonomike;
- Ligji mbi mbrojtjen e pasurisë popullore dhe qeverisjen e saj;
- Ligji mbi ndalimin e nxitjes së urrejtjes dhe përçarjes kombëtare, racore dhe fetare;
- Ligji mbi veprat penale kundër popullit dhe shtetit dhe
- Ligji mbi llojet e dënimeve.

Me 4 dhjetor 1947 u nxorr Kodi penal –pjesa e përgjithshme dhe hyri në fuqi me 12.2.1948. dhe u përgatit sipas modelit sovjetik dhe i kishte të gjitha mangësitë që i kishte edhe Kodi Sovjetik. Ky Kod ka lejuar analogjinë dhe ka lejuar arbitraritetin dhe paligjshmërinë, sidomos në proceset penale kundër shqiptarëve, por edhe kroatëve dhe sllovenëve. Në vitin 1948 nga lëmia penale u nxorën edhe 3 ligje të rëndësishme: Ligji mbi veprat penal kundër detyrës zyrtare; Ligji mbi veprat penale ushtarake dhe Ligji mbi veprat penale kundër pasurisë së përgjithshme popullore dhe pasurisë së operativave dhe organizatave tjera shoqërore. Më 27.2.1951, Kuvendi i Jugosllavisë aprovoi Kodin e tërësishëm edhe pjesën e përgjithshme, edhe pjesën e veçantë i cili hyri në fuqi me 1. korrik të vitit 1951. ku pushuan së vepruar Kodi penal i vitit 1948 si dhe ligjet penale të

posaçme që kanë qenë në fuqi.

#### *3.1.4. Ligji penal i RSFJ të Jugosllavisë dhe Ligji penal i KSAK*

Kosova me Kushtetutën jugosllave të vitit 1974 në aspektin juridik u barazua në masë të konsiderueshme me republikat e këtij shteti, mirëpo në praktikë nga regjimi i Serbisë, në mënyrë arbitrare dhe kundërkushtetuese iu reduktoheshin autorizimet dhe kompetencat e saja, sidomos në lëminë e policisë, gjyqësisë, legjislacionit etj. Kushtetuta e Jugosllavisë në vitin 1974 për herë të parë aprovoi konceptimin e decentralizimit të kompetencave ligjdhënëse edhe në lëmin e legjislacionit penal të republikave dhe krahinave (neni 281.par.1.pika 12.). Të gjitha republikat dhe krahinat nxorën edhe ligjet e tyre penale të cilat hynë në fuqi më 1.korrik 1977. Në nivelin jugosllav u nxorr Ligji penal federativ i cili po ashtu hyri në fuqi me 1.korrik 1977. Në jugosllav, vepronin 9 ligje penale. Gjatë periudhës (1981-1990), në proceset penale politike u dënuan 3.348 shqiptarë, me dënime mesatare 7 vjet e dy muaj, me gjithsejtë 23.760 vjet burgim. Gjatë kësaj periudhe u gjykuan edhe 10.000 shqiptarë për kundervajtje politike me gjithsejtë 1232 vjet burgim, për vepra penale politike dhe kundervajtje politike u ndëshkuan 13.348 shqiptarë me gjithsejtë rreth 25.000 vjet burgim apo 250 shekuj. Ligji penal i Kosovës ishte në fuqi deri më 23 mars 1989 kur regjimi i atëhershëm serb në mënyrë kundërkushtetuese suprimoi autonominë e Kosovës dhe njiherit abrogoi LPK. Prej marsit 1999 në Kosovë u zbatua ligji Penal I Jugosllavisë dhe ai Serb, ndërsa pas çlirimit u rikthye në fuqi LPK dhe LPJ.

Ligjet penale janë ndryshuar shumë herë për shkak të eksperimentimeve në

ndryshimet politike të sistemit socialist Jugosllav. Zgjidhjet politike kanë qenë të përkohshme, andaj fati i njëjtë ka përcjellë edhe legjislacionin penal si dhe legjislacioni në lëmin e ekzekutimeve të sanksioneve penale. Ligji për llojet e dënimeve është aprovuar me 5 korrik të vitit 1945, i cili ka parapa dymbëdhjetë 12 dënime (“Službeni list“ DFJ, nr. 48/1945), prej tyre vetëm 2 dënime me punë të obligueshme, e ky ligj në vitin 1946, është ndryshuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e llojeve të dënimeve (“Službëni list FNRJ”, br. 66/1946) te cilit ligj iu ka shtuar edhe tri mase edukuese përmirësuese. Në këtë periudhë në Kosovë nuk ka pasur institucione për ekzekutimin e sanksioneve penale, por janë zbatuar dhe shfrytëzuar institucionet dhe struktura ligjore e Jugosllavisë, ku Kosova ka qenë pjesë e Serbisë. Në këtë periudhë dënimet ishin politike ndaj shqiptarëve të Kosovës. Trajtimi i të burgosurve politik ishte jo në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare. Kjo kategori e të burgosurve dënoheshin për shkak të kërkesave të tyre për të qenë të barabartë me Republikat tjera Jugosllave, si dhe për faktin se kishin mendim ndryshe mbi zhvillimet shoqërore në Kosovë. Në shënjestër për tu dënuar ishin anëtarët e grupeve dhe organizatave ilegale në Kosovë, si ajo e Nacional Demokratike Shqiptare, besës Kombëtare dhe organizatat tjera (Keçmezi-Basha, 2009:8) Këtë periudhë e karakterizojnë dënimet e ashpra politike, si pasoj e një regjimi socialist, i cili propagandonte barazi, e në realitet bënte dallime drastike në trajtimin e të dënuarve varësisht nga nacionaliteti që ati i përkiteshin (Keçmezi-Basha, 2009:9)

Do theksuar se vetëm gjatë periudhës 45-vjeçare, 1945 – 1990, ndaj shqiptarëve në ish Jugosllavi u shqiptuan gjithsejtë 66672 vjet e 7 muaj burgim, ose 666 shekuj, 72 vjet e 7 muaj për 7684 veta. Shqiptimi i të gjitha këtyre viteve burgimi ishte bërë me një strategji të paramenduar mirë për përdorimin e dhunës ndaj shqiptarëve, me qëllim që nga trojet e veta të ndiqeshin dhe të shkombëtarizoheshin sa më shumë. (Keçmezi-Basha,

2009:9)

Gjerë në vitin 1968, Institucionet për ekzekutimin e sanksioneve penale ishin nën menaxhimin e Ministrisë së punëve të brendshme (SIKS Beograd :19)

Në këtë periudhë të dënuarit shqiptar dërgoheshin në Institucionin ku ishte siguria maksimale dhe regjimi i ashpër i trajtimit të burgosurve, si:- Burgu qendror në Beograd, Burgu në Goli Otok dhe në burgjet e ish Republikave Jugosllave (Keçmezi-Basha, 2009:9)

Pos dënimeve të ashpra dhe të rënda ndaj personave, dënoheshin edhe anëtarët e familjes në forma dhe metoda të ndryshme. Te burgosurit shqiptare gjër në vitet 60 të shekullit XX, vendoseshin në institucionet serbe dhe ato të Republikave tjera Jugosllave.

Vendosja dhe trajtimi i të burgosurve sipas Ligjit Penal të Republikës Federale Popullore Jugosllave, i nxjerrë në vitin 1951, si dhe Ligjit mbi ekzekutimin e dënimit, masave të sigurisë dhe masave edukuese përmirësuese (“Službëni list FNRJ”, br. 47&1951)

Në vitin 1974, Kosova ndryshon statusin politik në kuadër të federatës Jugosllave, pasi tani Kosova me ndryshimet politike të bëra dhe me Kushtetutën e vitit 1974, bëhet pjesë konstituive e federatës jugosllave. Në përputhje me Kushtetutën nxjerr edhe Ligjet e veta penale, si:

- Ligji Penal i Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës
- Ligji i procedurës penale të Kosovës
- Ligji i Ekzekutimit të Sanksioneve penale, si dhe ligjet tjera në përputhje me Kushtetutën.

Kosova tani krahas infrastrukturës ligjore ngrit edhe institucionet e veta, që ishin nevojë e kohës dhe që duhej të formoheshin në përputhje me ligjet e nxjerrë ura.

Pos dy qendrave të Paraburgimit që kanë ekzistuar më herët, që nga vitit 1953, tani formohen Qendrat e Paraburgimit në Prizren, Qendra e Paraburgimit në Gjilan, Qendra e Paraburgimit në Pejë (Keçmezi-Basha, 2009:9)

Në vazhden e ndryshimeve u paraqit nevoja e ngritjes së institucioneve të reja për ekzekutimin e sanksioneve penale. Kështu në vitin 1976, ndërtohet Qendra Edukuese Korrektuese për të mitur në Lipjan dhe po të njëjtin vit të miturit e kombësisë shqiptare sillen nga Institucioni i të miturve i Pozharevcit që gjendej në Republikën e Serbisë në Qendrën Edukuese Korrektuese në Lipjan. Kjo ishte një ndryshim që kishte rëndësi të veçantë për të miturit por edhe për familjarët e tyre. Pas Lipjanit hapet Shtëpisë Ndëshkimore Korrektuese për dënime të shkurta në Smrekonicë.

Në përputhje me Infrastrukturën ligjore po ashtu në vitin 1984, lëshohet në funksion Shtëpia Ndëshkimore Korrektuese për dënime të gjatat në Dubravë - Istog.

Ngritja e institucioneve të reja dhe funksionalizim i tyre në përputhje me infrastrukturën ligjore e karakterizonte ekzekutimin e sanksioneve penale në Kosovë gjerë në vitin 1989, kur Serbia dhunshëm suprimon autonomin e Kosovës (Keçmezi-Basha, 2009:9) dhe me këtë rast edhe institucionet për ekzekutimin e sanksioneve penale merren në menaxhim nga stafi serb i sjellë nga Beogradi, me ndihmën e stafit serb që ishte në Kosovë.

Viti kalendarik 1998, karakterizohet me luftën e shqiptarëve kundër forcave Serbe në Kosovë.

Kosova në mbështetje të bashkësisë ndërkombëtare fiton pavarësinë dhe vihet nën monitorimin ndërkombëtar në bazë të rezolutës 1244, nxjerrë nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara.<sup>8</sup> Në këtë periudhë kohore aplikohen aktet ligjore, me kusht që të

---

<sup>8</sup> Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit u miratua më 10 qershor 1999, pas marrëveshjes për tërheqjen e

mos kenë pas dispozita dekrimatore (The UNMIK nr 21 - 1999 ) të cilat kanë qenë ne fuqi në Kosovë deri ne vitin 1989.

### **3.2. Politika e dënimit në Kosovë gjatë periudhës 1945 – 1968**

Në periudhën kohore 1945 gjerë më 1968, Kosova, si krahinë autonome ishte në strukturat shtetërore të Republikës së Serbisë në ish shtetin socialist Jugosllav, me një shkallë të kufizuar të pavarësisë në sferat e arsimit fillor e të mesëm, të shëndetësisë, të kulturës dhe të mbrojtjes e sigurimit social e shëndetësor. Ligjet e Republikës së Serbisë zbatoheshin edhe në Kosovë. Legjislacioni penal federal shpesh ka pësuar modifikime për shkak të ndryshimeve politike në shtetin Jugosllav. Ndryshimet e tilla e kanë përcjellur edhe lëmin e ligjeve në fushën e ekzekutimit të sanksioneve penale. Në Kosovë janë aplikuar ligjet e Serbisë dhe Jugosllavisë, por vlen të ceket se fillimisht kanë ekzistuar vetëm ligjet e Jugosllavisë federale që janë zbatuar në të gjitha republikat Jugosllave. Ligji i parë jugosllavë për llojet e dënimeve është nxjerrur me 5 qershor të vitit 1945 (Sluzhbeni list DFJ, br.48/1945), i cili ka përcaktuar 12 dënime; a ligj në vitin 1946 është plotësuar dhe ndryshuar dhe është quajtur Ligji mbi llojet e dënimeve (Sluzhbeni list FNRJ, br.66/1946). Në bazë të ndryshimeve të tij është kaluar nga sistemi i izolimit- qelisë në sistemin kolektiv i mbajtjes së dënimit, burgut. Ligji për ekzekutimin e dënimeve (Sluzhbeni list FNRJ, br. 92/1948), është zbatuar në të gjitha republikat jugosllave si dhe në Kosovë, pasi Kosova ishte pjesë e Serbisë. Po ashtu në vitin 1959

---

trupave serbe nga Kosova. Kjo rezolutë e përcakton statusin politik të Kosovë si protektorat të OKB-së, dhe jep administrimin e Kosovës po kësaj organizate ndërkombëtare. Sipas kësaj rezolute OKB ka përgjegjësin për administratën civile kurse NATO për sigurinë në Kosovë. Edhe pse rezoluta e bën Kosovën protektorat të OKB-së, në këtë rezolutë disa herë përmendet se Kosova është pjesë e Jugosllavisë. Ganezi, Kofi Annan, ishte sekretar gjeneral i OKB-së kur u miratua kjo rezolutë.



(Sluzhbeni list FNRJ, br.30/1959) dhe vitin 1961 miratohet Ligji Jugosllav i për ekzekutimin e sanksioneve penale i cili zbatohet edhe në Kosovë. Ky ligj përfshinë tërësinë e rregullave minimale për trajtimin e të burgosurve.

Gjatë asaj periudhe në Kosovë si kundër edhe në republikat Jugosllave dhe në Krahinën Autonome të Vojvodinës janë aplikuar ligjet jugosllave. Këtë periudhë e karakterizon fakti se Republikat dhe dy krahinat nuk kanë pasur ligje të vetat, por kanë ekzistuar ligjet federale të Jugosllavisë.

Gjatë kësaj periudhe kohore në shtetin Jugosllav, në të gjitha republikat, andaj edhe në Kosovë institucionet korrektuese ishin nën menaxhimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Jugosllavisë ku zbatoheshin ligjet e shtetit federal Jugosllavi (Beković, 2013, Beograd: 16).

### **3.3. Politika e dënimit në Kosovë gjatë periudhës 1968 – 1989**

Procesi i decentralizimit të Federatës Jugosllave ka filluar gjatë viteve gjashtëdhjeta dhe në fillim të viteve shtatëdhjeta të shekullit XX, pikërisht nga viti 1968 – 1974, me amandamentimin e Ligjit e Kushtetutës të Jugosllavisë .

Ligji Jugosllav për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale i miratuar në vitin 1968 (Sluzhbeni list SFRJ, br.15/1968, i 3/1970), sjell dy ndryshime të rëndësishme në sistemin federative të Jugosllavisë: Shërbimi i Ekzekutimit të Sanksioneve Penale i cili ka qenë nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Jugosllavisë, kalon në mbikëqyrje të organeve të drejtësisë, Kurse sa i përket aspektit të rregullimit normativ, materia e ekzekutimit të sanksioneve penale nga kompetenca federale kaloi në kompetencë të njësisve federale (në kompetencë të gjashtë

republika dhe të dy krahinave autonome-përkatësisht edhe të Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës)

Ky proces i decentralizimit të pushtetit jugosllav kulmoi në vitin 1974 me nxjerrjen e Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë<sup>9</sup>.

Me Ndryshimin e Kushtetutës Jugosllave bëhet decentralizimi I pushtetit si dhe I së drejtës material penale në republika dhe krahina. Tani gjashtë republikat jugosllave (Sllovenia, Kroacia, Bosna e Hercegovina, Serbia, Mali I Zi, Maqedonia dhe dy krahinat Kosova dhe Vojvodina nxjerrin Kushtetutat e veta ), ku bëhet ndarja e pushtetit në mes të Federatës jugosllave dhe njësive federative në lëmin e të drejtës materiale penale, kështu që në vend të Ligjit penale të Jugosllavisë së vitit 1951, me 1 korrik të vitit 1977, kanë hyr në fuqi nëntë ( 9 ) ligje penale (Ligji penal i Jugosllavisë, Ligjet penale të gjatë republikave dhe dy Ligjet penale të Krahinave). Me ndryshimet politike dhe decentralizimin e pushtetit nga Federate Jugosllave në Republika dhe Krahina Autonome pasojnë ndryshimet politike dhe kushtetues të republikave dhe Krahinave. Kështu Krahina Socialiste Autonome e Kosovës shpall Kushtetutën e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, e cila aprovohet nga Kuvendi I Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në mbledhjen e të gjitha dhomave, mbajtur me 27 shkurt 1974.<sup>10</sup> Në bazë të kësaj Kushtetute, në realizimin e të drejtave të përbashkëta, njerëzit punues, kombet e kombësitë e Kosovës

---

<sup>9</sup> Sluzhbeni list, SFRJ, nr. 9/1974, Kushtetuta e re republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë bënë ndryshime të rëndësishme duke bërë promovimin e konceptit të ndarjes së pushtetit e kompetencave nga sistemi federal me atë të republikave dhe Krahinave, pra bartje e kompetencave nga pushteti qendror federal në atë të 6 gjashtë Republikave dhe 2 dy Krahionave autonome në lëmin e të drejtës materiale penale, pasi në vitin 1977, hynë në fuqi 9 nëntë ligje penale (Ligji penal i RSFJ- Republika Socialiste federative e Jugosllavis, gjashtë Ligj Penale të gjashtë republikave dhe dy ligje penale të Krahinave autonome, njena ishte Kosova dha e dyte Vojvodina.

<sup>10</sup> Në bazë të neninit 45 alineja 1 pika 1, nenit 65 alineja 1 pika 1 dhe nenit 127 alineja 4 të Ligjit kushtetues të Krahinës Socialiste Auronome të Kosovës, Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e përbashkët të të gjitha dhomave me 27 shkurt 1974, merr vendim mbi shpalljen e Kushtetutës së Krahimnës Socialiste Autonome të Kosovës.

vendosin në Federatë Jugosllave mbi parimet e marrëveshjes reciproke të republikave e të krahinave autonome, të solidaritetit e të reciprocitetit, të pjesëmarrjes së barabartë të republikave e të krahinave autonome në organet e Federatës Jugosllave në pajtim me Kushtetutën e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, si dhe mbi parimin e përgjegjësisë së republikave dhe krahinave autonome për zhvillimin e vet dhe për zhvillimin e bashkësisë socialiste të Jugosllavisë si tërësi (Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1974). Sipas Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës jeta e njeriut është e pacenueshme, andaj dënimi me vdekje mund të përcaktohej përjashtimisht vetëm për format ma të rënda të veprave penale (Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1974:117). Veprat penale dhe sanksionet penale mund të caktohen vetëm me ligj. Askush nuk mund të konsiderohej fajtor për vepër penale përderisa kjo të mos vërtetohej me aktgjykim gjyqësor të formës së prerë (Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1974:119). Pas aprovimit të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, me Ligjin Kushtetues për zbatimin e kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës është përcaktuar që gjerë me 31 dhjetor 1975, të harmonizohen me Kushtetutën të gjitha ligjet që nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën.<sup>11</sup>

Në përputhje me Kushtetutën u harmonizuan ligjet ekzistuese dhe u nxorën Ligje të reja nga Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Kështu në bazë të nenit 335 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, nxirret Dekreti mbi shpalljen e Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (Ligji penal I Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, KK Nr. 011-25/77), i cili hynë në fuqi me 28 qershor

---

<sup>11</sup> Në bazë të nenit 335 të kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, nxirret Dekret për shpalljen e Ligjit Kushtetues për zbatimin e Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, të cilin e aprovoi Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e përbashkët të të gjitha dhomave më 27 shkurt të vitit 1974. KK. Nr. 011-10.

1977. Ky ligj fillimisht përcakton dispozitat e përgjithshme mbi ekzekutimin e dënimeve, dispozitat mbi masat edukuese e mbi dënimin e të miturve, dënimin me kusht me mbikëqyrjen mbrojtëse dhe veprat penale, si:

- Veprat penale kundër jetës dhe trupit,
- Veprat penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit,
- Veprat penale kundër të drejtave vetëqeverisëse,
- Veprat penale kundër marrëdhënieve të punës,
- Veprat penale kundër nderit dhe prestigjit
- Veprat penale kundër dinjitetit të personalitetit dhe të moralit,
- Veprat penale kundër martesës dhe familjes,
- Veprat penale kundër shëndetit të njerëzve,
- Veprat penale kundër ekonomisë,
- Veprat penale kundër pasurisë,
- Veprat penale kundër sigurisë të përgjithshme,
- Veprat penale kundër sigurisë në komunikacion,
- Veprat penale kundër jurisprudencës,
- Veprat penale kundër rendit publik dhe qarkullimit juridik,
- Veprat penale kundër detyrës zyrtare,

Ky ligj parashikon dënimin me burg jo më pakë se (10) dhjetë vjet ose me dënim me vdekje në rastet kur kush tjetrin e vret në mënyrë mizore, kur e vret dikë dhe me dashje ve në rrezik edhe jetën e të tjerëve, kush vret tjetrin për interes apo për të fshehur veprën penale, kush vret për shkak të hakmarrjes së paskrupullt, kush tjetrin e privon nga jeta për gjakmarrje, kush privon nga jeta personin zyrtar, ushtarak, dhe ata që kanë kryer disa vrasje (Ligji penal I Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, KK Nr. 011-25/77, pjesa

e dytë, kreu i gjashtë, neni 30 pika 1,2,3,4,5 dhe 6).

Me këtë Ligj nuk përcaktohej mënyra e vuajtjes së dënimit me burgim dhe dënimeve tjera kryesore dhe plotësuese, pasi ato përcaktoheshin me ligje të veçanta.

Ligji penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës përcakton qëllimin e dënimit dhe parimet kryesore që duhet respektuar gjatë vuajtjes së dënimit, kur bëhet fjalë për dënimet me burgim dhe dënimit me vdekje nga (neni 30 pika 2).

Legjislacioni penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës aplikohet ndaj secilit që në territorin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës kryen veprën penale të parashikuar me këtë legjislacion.

Sipas Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, qëllimi dënimit kishte të bëjë me faktin që me ekzekutimi i dënimit të realizohej qëllimi i dënimit i caktuar me ligjin penal dhe gjatë ekzekutimit të dënimit personit të dënuar nuk mund t' i shkaktohej vuajtje fizike as të fyhej dinjiteti njerëzor (Ligji penal I Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, KK Nr. 011-25/77, kreu i tretë, neni 6).

Për vetë faktin se me këtë Ligj ishte përcaktuar dënimi me vdekje, nuk mund të themi se ligji është në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare, edhe përkundër risive, ndryshimeve, në parashikimin e formave të reja të vrasjeve si vepra penale, te ndërprerja e shtatzënisë, lidhur me të drejtat nga sigurimi social, veprat kundër nderit, kundër dinjitetit, kundër shëndetit, kundër ekonomisë veprat penale kundër ekonomisë si dhe të veprave kundër sigurisë në komunikacion.

Pas Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në përputhje me ndryshimet Kushtetuese, Penale materiale dhe administrative, me 1 korrik të vitit 1977, hynë në fuqi Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (Ligji mbi ekzekutimin e Sansioneve Penale, 1977). Në bazë të këtij Ligji ekzekutoheshin sanksionet penale :

dënimet me burg, masat e sigurimit dhe masat edukuese. Po ashtu me dispozitat e këtij Ligji ekzekutohej dënimi me të holla dhe masat mbrojtëse të caktuara për delikt ekonomik si dhe dënimi me burg me masa të mbrojtjes të mjekimit të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve (Ligji mbi ekzekutimin e Sansioneve Penale, 1977 kreu I, neni 1, pika 1,2,dhe 3).

Sipas këtij Ligji ekzekutimi i sanksionit penal mund fillonte kur vendimi me të cilin është caktuar dënimi, i njëjti e merr formën e prerë. Ekzekutimi i sanksionit penal mund të fillojë edhe para se vendimi me të cilin është shqiptuar të ketë marrur formën e prerë, por vetëm kur kjo është caktuar me ligj (Ligji mbi ekzekutimin e Sansioneve Penale, 1977 neni 3, pika 1 dhe 2).

Gjykata që ka miratuar vendimin në shkallën e parë, nëse vetë është kompetente për ekzekutimin, ka për detyrë që vendimin e ekzekutueshëm të ia dërgojë organit kompetent për ekzekutimin më së voni brenda afatit prej tri ditësh nga dita kur këtë vendim e ka marrë nga gjykata më e lartë.

Kur plotësohen të gjitha kushtet për fillimin e ekzekutimit të sanksioneve penale organet kompetente kanë për detyrë të ndërmarrin veprimet përkatëse që ekzekutimi të zbatohet menjëherë (Ligji mbi ekzekutimin e Sansioneve Penale, 1977, neni 4 pika 2).

Ekzekutimi i sanksioneve penale mund të shtyhej vetëm në rastet dhe në kushtet e parashikuara me ligj (Ligji mbi ekzekutimin e Sansioneve Penale, 1977, neni 92).

Shtyrja e fillimit të vuajtjes së dënimit merr burg mund të praktikohej kur i dënuari i cili nuk ka filluar të vuajë dënimin me burg, në bazë të lutjes së tij mund ti shtyhet fillimi i vuajtjes së dënimit me burg në këto raste:

- Nëse është i sëmura nga ndonjë sëmundje e rëndë akute,
- Nëse i ka vdekur apo i është sëmurë rëndë ndonjë anëtar i familjes së ngushtë së të

dënuarit,

- Nëse shtyrja është e nevojshme për kryerjen ose përfundimin e punimeve të fushës ose sezonale ose të punimeve të shkaktuara nga fatkeqësitë e natyrës ose nga ndonjë fatkeqësi tjetër, e familja e të dënuarit nuk ka fuqi tjetër punëtore,

- Nëse i dënuari është i obliguar të kryejë ndonjë punë që e ka filluar, e për shkak të moskryerjes së kësaj pune do të shkactohej ndonjë dëm i konsiderueshëm,

- Nëse shtyrja i nevojitet të dënuarit për të mbaruar shkollimin ose për të dhënë provimin për të cilin është përgatitur,

- Nëse bashkë me të dënuarin është dënuar edhe bashkëshorti i tije ose anëtari tjetër i ekonomisë së përbashkët familjare, ose nëse ndonjë prej tyre tanimë është duke vuajtur dënimin me burg, e me dërgimin e të dënuarit për të vuajtur dënimin do të rrezikohej jeta normale e pleqve, të sëmurëve dhe të anëtarëve të mitur të familjes,

- Gruas së dënuar shtatzënë, pas gjashtë muajve të shtatzënisë dhe nënës deri sa fëmija e saj të mbushë një vjet, respektivisht gjashtë muaj pas lindjes nëse ka lindur fëmijën e vdekur ose që ka vdekur gjatë kësaj periudhe, dhe

- Nëse bashkëshortja e të dënuarit do të lindë fëmijë brenda dy muajve ose nga lindja akoma s'kanë kaluar tre muaj, e nuk ka anëtarë tjerë të ekonomisë shtëpiake që të i ndihmojnë

Lidhur me lutjen për shtyerjen e fillimit të vuajtjes së dënimit me burg vendos kryetari i gjykatës kompetente komunale nga neni 88 i këtij ligji i cili ka për detyrë që brenda afatit prej tri ditësh të vendosë lidhur me lutjen për shtyrje. Para nxjerrjes së aktvendimit mbi lutjen mund të bëhen verifikimet e nevojshme për konstatimin e fakteve të ritheksuara në lutje. Derisa të nxjerrët aktvendimi shtyhet fillimi i vuajtjes së dënimit me burg (Ligji mbi ekzekutimin e Sansioneve Penale, 1977, neni 93, pika 4).

Gjatë kësaj periudhe Kosova kishte krijuar infrastrukturën ligjore dhe vepronte në përputhje me ligjet e veta por duke përfillur edhe rregullat dhe standardet ndërkombëtare.

### **3.4. Politika e dënimit në Kosovë gjatë periudhës 1989 – 1999**

Kjo periudhë është e njëjtë me atë më pare të theksuar por karakterizohet me dhunën shtetërore serbe në funksion të serbizimit të Kosovës në disfafor të shqiptarëve me shumicë absolute të atij vendi. Të dhënat faktografike pasqyrojnë violence shtetërore serbe të pa bazuar edhe në ligjet e shtetit serb, e cila është shprehur në dhunime, keqtrajtime, plaçkitje, sakatime, kallje të shtëpive dhe vrasje të planifikuara më pare gjerë në shkallë të krimeve të luftës madje edhe të gjenocidit, të gjitha drejtuar kundër shqiptarëve Kosovar. Kjo periudhë është specifike për të keq, ashtu që rendi juridik i shtetit serb ani pse përmbante jo pak dispozita diskriminatore antishqiptare nuk përfillej kur ishin objektivat hegjemoniste serbe në spikamë.<sup>12</sup> Sistemi i ekzekutimit të sanksioneve penale në Kosovë ka qenë i ndryshëm në periudha të caktuara kohore dhe njëherit ka reflektuar në përputhje me zhvillimit dhe ndryshimet shoqërore. Ndryshimet në aspektin politik kanë imponuar edhe ndryshimin e rregullimit shoqëror e në përputhje me te ka ndryshuar edhe infrastruktura ligjore dhe sistemi i ekzekutimit të sanksioneve penale. Pas zhvillimeve të ndryshme politike në Kosovë, demonstratave të qytetarëve në vitin 1989, me kërkesë për të qenë Kosova Republikë e barabartë me të gjitha republikat në kuadër të Federatës Jugosllave, pasoi shtypja me dhunë e demonstruesve, burgosja dhe dënimi I tyre për shkak të kërkesave të tyre për të qenë të barabartë me të gjithë popujt tjerë në Federatën jugosllave. Pos dënimeve të qytetarëve pasuan edhe ndryshimet

---

<sup>12</sup> Lufat, dëbimet, intervenimi i faktorit ndërkombëtar



politike dhe ligjore në Republikën e Serbisë. Në vitin 1990, republika e Serbisë ndryshon kushtetutën e vet, suprimon autonomin e Kosovës dhe Kosovën e trajtojnë si pjesë të Republikës së Serbisë (Sluzhbeni glasnik Republike Srbije, br. 1/1990). Me këtë ndryshim të Kushtetutës Serbe Kosova e humb dhunshëm sovranitetin e vet dhe të drejtën për të qenë pjesë konstituive e Federatës jugosllave, çka tani trajtohet si pjesë e Republikës Serbe. Me ndryshimet politike pasojnë edhe ndryshimet në infrastrukturën e të drejtës penale material dhe të drejtës në përgjithësi. Serbia në këtë periudhë e sheh si të domosdoshme edhe ndryshimin e sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale dhe sistemin e drejtësisë në përgjithësi. Me këto ndryshime ajo sistemin e drejtësisë e së bashku me të edhe sistemin e ekzekutimit të sanksioneve penale e unifikon me sistemin e republikës së Serbisë (Z.M. Stevanovic, 2000: 10 – 14). Në vitin kalendarik 1997, Serbia e nxjerr Ligjin e Ekzekutimit të Sanksioneve Penale, i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar të vitit 1998 (Sluzhbeni glasnik Republike Srbije, 16, 1997). Ky ligj ka pasur qëllim që të jetë në përputhje me Kushtetutën e Serbisë e nxjerrur në vitin 1990, me të cilin kushtetutë në Kosovë tani zbatohen të gjitha ligjet e Serbisë dhe jot ë Kosovës. Kështu shteti serb proklamojnë sistemin unik të drejtësisë dhe të ekzekutimit të sanksioneve penale në kuadër të republikës së Serbisë (N. Maric – Petrovic, Kriza zatvora, 2007). Nga viti 1989 e gjerë në vitin 1999, Kosova nuk ka pasur organet e veta, andaj edhe sistemi i drejtësisë dhe i ekzekutimit të sanksioneve penale ka qenë pjesë e sistemit të Republikës së Serbisë. Pas ndryshimeve kushtetuese dhe atyre ligjore në Serbi, vendosen masat e dhunshme në Kosovë dhe mbi 100.000 të punësuar shqiptar konform me diskriminimin kombëtar të tyre janë larguar dhunshëm nga puna (Të dhënat nga Enti Statistikor I Kosovës për vitin 1992). E tërë kjo, periudhë karakterizohet me privimin e Kosovës deri atëherë si një nga tetë konstituentet federative nga të gjitha autorizimet shtetërore në favorin e shtetit serb

të unitarizuar. Së andejmi infrastruktura penale në përgjithësi dhe ajo për ekzekutimin e sanksioneve penale në veçanti janë uzurpuar dhe bartur nga juridiskcioni Kosovar në kundërshtim me rendin juridik të shtetit federativ, të vetë Serbisë e veçanërisht të Kosovës dhe janë transferuar në nivel të shtetit serb.

### **3.5. Politika e dënimit në Kosovë gjatë periudhës 1999-2008**

Në Kosovë, paqja konsiderohet e arritur e qëndrueshme sado e brishtë që mund të jetë. Drejtësia në anën tjetër, shumë thellë varet nga të kuptuarit e individit dhe grupeve etnike saqë paraqet pikërisht kërcënim për paqen e brishtë. Çka konsiderohet drejtësi tani më 2008, pas shpalljes së pavarësisë, mund të ndryshojë nga ajo që kemi konsideruar drejtësi më 1999. Gjersa për shumicën, pavarësia kuptohet si drejtësi përfundimtare e me këtë largohen të gjitha kërcënimet (p.sh. që ata përsëri do të vihen nën sundimin e Serbisë), për serbët e Kosovës mund të paraqet përtëritje të kërcënimeve (p.sh. që ata do të bëhen viktimat të hakmarrjes) (UNHCR. 2009).

Përfundimi i luftës në Kosovë me intervenimin ndërkombëtar ndikoi në ndarjen e qartë të fituesve dhe humbësve të konfliktit (Instituti Kosovar Për Kërkime Dhe Zhvillime Të Politikave, 2009). Pas luftës të vitit 1999, pasi që sektori i drejtësisë dhe i sigurisë si dhe struktura institucionale praktikisht nuk ekzistonin, misioni i KB-ve ishte përgjegjës për krijimin dhe mbledhjen e strukturave mjeteve urgjente të brendshme. Situata politike që u vendos pas luftës, nuk iu drejtua faktorit të drejtësisë, nuk iu drejtua shkeljeve masive të drejtave të njeriut dhe një numri të madh të çështjeve të ndjeshme përfshirë edhe personat e zhdukur. Siç pajtohen shumë ekspertë vendorë, drejtësia u flijua për të mirën e qëndrueshmërisë (Instituti Kosovar Për Kërkime Dhe Zhvillime Të Politikave, 2009).

Këto i bëjnë kushtet e Kosovës më të vështira në sferën e ballafaqimit me të kaluarën dhe e bëri Kosovën vend të “ndarë etnikisht dhe me popullatë pakicë të grumbulluar bashkë politikisht dhe gjeografikisht” (Hehir, Aidan, 2006, Vol.13, Nr.2: 200-213). Nismat e ndryshme për adresimin e së kaluarës duket të gëzojnë nivel të ulët të njohurisë në popullatë. Së pari, dialogu mes etnive pengohet nga urrejtja dhe mosbesimi dhjetëvjeçar ndër-etnik. Përgjithësisht nga pakica serbe dhe pjesërisht nga administrata ndërkombëtare besohet se shqiptarët e Kosovës nuk mund të gjykojnë drejtë dhe në mënyrë të paanshme krimet ndëretnike (BalkanInsight, 2008).

Së dyti, shoqëria në përgjithësi dukshëm beson që shkeljet e të drejtave të njeriut, padrejtësitë dhe dialogu nuk do të adresohen asnjëherë. Me të vërtetë ka mungesë të informatave, diskutimit dhe dialogut për të kaluarën, jo vetëm në shoqëri në përgjithësi por edhe në mes të vet shqiptarëve të Kosovës. Deri më tani nuk ka pasur diskutim publik për gjykimet që janë bërë për rastet e krimeve të luftës dhe shkeljeve masive të drejtave të njeriut para, gjatë apo pas luftës më 1999. Gjithashtu, ka dalë në pah një mendim tjetër i dëmshëm në lidhje me të drejtën ekskluzive të secilit grup etnik të madh për tu konsideruar si viktimë. Kur janë pyetur se a kanë bërë krime lufte pjesëtarët e grupeve të tyre, 78% të shqiptarëve të Kosovës e refuzojnë këtë pohim (Raport i UNDP-së: 16). Siç është rasti me vendet post-konfliktuale të ish-Jugosllavisë, e kaluara nuk ballafaqohet hapur me përfshirjen e hetimit të shtetit dhe vlerësimeve personale të konfliktit (Rangelov, LSE). Të tjera ngjashmëri mes Kosovës dhe vendeve të tjera të ish-Jugosllavisë përfshijnë “gjykimet vendore për krime të luftës kanë dështuar të adresojnë shkallën e mizorive dhe gjykatat kanë dështuar të ofrojnë drejtësinë e paanshme për të dyshuarit për krime lufte në jurisdikcionin e tyre pa marrë parasysh përkatësinë etnike dhe kombëtare” (Rangelov, LSE)

Nga viti 1999 deri në vitin 2008, kur është shpallur pavarësia e Kosovës, karakteristikë e përgjithshme përkitazi me ekzekutimin e sanksioneve penale është përmbartimi i masave juridike penale konform me dispozitat juridike të aplikuara edhe më parë po qese ndonjë sosh nuk ka pasur karakter discriminator (Rregullorja e UNMIK-ut, 21/99).

## **KAPITULLI IV**

### **PROCEDURA E EKZEKUTIMIT TE SANKSIONEVE PENALE**

#### **SIPAS LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS**

Nëse nuk është aprovuar kërkesa për shtyerjen e fillimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, personi i dënuar, posa të arrijë ne institucionin korrektues, paraqitet në zyrën e pranimit dhe vërtetohet identiteti i tij. Me këtë rast personi i dënuar fotografohet, i merren gjurmët e gishtërinjve, konstatohet gjendja e tij shëndetësore i plotëson disa formular dhe pastaj vendoset në zyrën e pranimit. Ne këtë rast personi i dënuar regjistrohet me të gjitha gjeneralët si dhe ora dhe data e ardhjes ne institucion. Personi i dënuar gjatë kohës së qëndrimit ne institucionin korrektues apo zyrën e pranimit njoftohet me rendin shtëpiak me obligimet dhe te drejtat e tij si person i dënuar. Personi i dënuar dërgohet në sektorë të tjera ku i nënshtrohet klasifikimit ne grupe apo nëngrupe te ndryshme (Halili, 2009: 114).

Gjykata kompetente duhet ta fillojë procesin e dërgimit të personit të dënuar në mbajtje të dënimit.

Gjykata kompetente e informon institucionin korrektues për datën kur personi i dënuar duhet të paraqitet në institucion dhe ia dorëzon vendimin e formës së prerë së bashku me të dhënat personale për personin e dënuar të cilat janë mbledhur gjatë procedurës penale.

Personi i dënuar me burgim mund të vendoset në qendrën e paraburgimit nëse kohëzgjatja e burgimit pas llogaritjes së paraburgimit ose të privimit tjetër nga liria lidhur me veprën penale nuk i kalon tre (3) muaj. Personi i dënuar me burgim afatgjatë vendoset në institucionin korrektues (Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale neni 12).

Nëse gjykata që ka marrë vendim në shkallë të parë nuk ka kompetencë për dërgimin e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim ose me burgim afatgjatë, ajo vendimin e formës së prerë së bashku me të dhënat personale të personit të dënuar të mbledhura gjatë procedurës penale ia dërgon gjykatës kompetente brenda tri (3) ditëve prej ditës kur vendimi merr formën e prerë. Personat e dënuar me burgim dhe me burgim afatgjatë transportohen në institucione korrektuese për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe me burgim afatgjatë në pajtim me urdhëresën e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë. Përbashkërisht, me kërkesë të personit të dënuar, Ministria e Drejtësisë mund ta ndërrojë vendin e ekzekutimit të dënimit për arsye të justifikueshme. Vendosja e personave në institucion, behet në kushte të cilat disponon secili institucion korrektues. Vendosja e të dënuarve nëpër pavijone, duhet t'u përgjigjet kushteve elementare higjienik dhe klimatike. Zakonisht personat e dënuar vendosen në lokalet e përbashkëta. Gjatë vendosjes në institucion merret parasysh mosha, vepra penale, shëndeti fizik dhe mental, gjinia etj. Në disa shtete dhe sisteme të caktuara, ndodh që personat e dënuar të vendosen natën në dhoma të veçanta, ndërsa ditën jetojnë dhe punojnë bashkërisht. Në lokalet ku vendosen të dënuarit duhet të ketë dritë të mjaftueshme për punë dhe lexim. Në lokalet ku jetojnë personat e dënuar duhet të ketë ujë të pijshëm të sigurohet ushqimi me kalori të caktuara, gjatë qëndrimit në institucione korrektuese. Kështu personave të dënuar u jepet ushqim ditor tri racione gjatë ditës. Ai duhet të jetë i shijshëm dhe i llojlojshëm. Të dënuarve që janë të kyçur në punë të rënda u jepet ushqim me kalori me të forta. Të dënuarve të sëmurë dhe të dënuarve që mbajnë dietë, u shërbehet dhe u sigurohet ushqimi i veçantë të cilin e përcakton mjeku. Nëpër institucione korrektuese, personave të dënuar, u sigurohet edhe veshmbathja adekuate, varësisht nga sezon dhe kushtet klimatike. Drejtoria e institucionit është e obliguar që personave të dënuar t'u sigurojë

veshmbathje varësisht nga kushtet dhe llojet e punëve të cilat i kryejnë. Veshmbathjen siguron institucioni pa pagesë. Veshmbathja dhe ndërresat e fjetjes-shtrojës dhe mbulojës të personave të dënuar duhet të mbahen pastër, të lahen dhe të kontrollohen në mënyrë permanente, Niveli higjienik duhet të kontrollohet nga shërbimi i veçantë i institucionit. Veshmbathja e personave të burgosur nuk guxon të jetë poshtëruese (Halili, 2009:214).

#### **4.1. Veprimet procedurale për ekzekutimin e sanksioneve penale**

E drejta e procedurës penale ka lidhje të ngushtë me të drejtën e ekzekutimeve të sanksioneve penale si degë e të drejtës penale në kuptimin e gjere e drejta e ekzekutimit të sanksioneve paraqet një sistem të dispozitave juridike me të cilin rregullohet procedura e ekzekutimit të dënimeve dhe masave për trajtim të detyrueshëm, si dhe masave të devirzitetit dhe masave edukuese ndaj të miturve. Prandaj lidhshmëria ndërmjet këtyre dy degëve juridike është e qartë sepse pa vendimet gjyqësore të cilat merren në procedure penale nuk do të kishte nevojë as për ekzekutimin e sanksioneve penale nuk do të mund të zbatohet vendimi gjyqësor.

##### *4.1.1. Ardhja e vendimeve të formës së prerë nga Gjykata*

Kur aktgjykimi për shqiptimin e dënimit bëhet i plotfuqishëm, formën e prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm, Gjykata themelore që ka dhënë dënimin është kompetente për dërgimin e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim ose burgim të përjetshëm. Kjo gjykatë e ka kompetencën edhe kur personi i dënuar ndërron vendbanimin apo vendqëndrimin e tij (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149,2013, neni

14, pika 1 dhe 2).

Në rastet kur nuk dihet vendbanimi apo vendqëndrimi i personit të dënuar, kompetente për dërgimin e personit të dënuar në mbajtje të dënimit me burgim ose burgim të përjetshëm është gjykata themelore që ka marrë vendim në shkallën e parë. Në rastet kur këtë vendim e merr Gjykata e Apelit, atëherë prapë kompetente për dërgimin e personit të dënuar në mbajtje të dënimit me burgim dhe burgim të përjetshëm është gjykata themelore e cila gjendet në të njëjtin ven-qytet ku gjendet gjykata e Apelit (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149,2013, neni 15)

Nëse personi i dënuar me burgim dhe burgim të përjetshëm gjendet në paraburgim, atëherë ai transferohet në institucion korrektues adekuat i paraparë për mbajtje të dënimit me burg ose burgim të përjetshëm.

#### *4.1.2. Aktgjykimi dhe aktvendimi që nuk e ka formën e prerë*

Ekzekutimi i sanksionit penal mund të fillojë edhe në rastet kur vendimi me të cilin është shqiptuar sanksioni penal nuk ka marrur formën e prerë. Një gjë e tillë mund të ndodhë vetëm në rastet kur kjo është paraparë shprehimisht me ligj (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149,2013, neni 6, pika 2).

Personi i dënuar me burgim ose burgim të përjetshëm, në rastet kur gjendet në paraburgim atëherë transferohet nga Qendra e Paraburgimit në institucion korrektues adekuat për mbajtjen e dënimit.

Të gjithë personat e dënuar me dënim me burg mbi pesëmbëdhjetë (15) vjet dhe ata të dënuar me burgim të përjetshëm dërgohen në Burgun e Sigurisë së Lartë. Në rastet kur personat e dënuar gjenden në liri, gjykata kompetente për ekzekutimin e vendimit i dërgon



thirrje që në afatin kohor të paraparë me ligj të paraqitet në institucionin korrektues për mbajtjen e dënimit (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149,2013, neni 16).

#### *4.1.3. Nxjerrja e urdhrin për ekzekutim të vendimit*

Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, gjykata kompetente e urdhëron me shkrim personin e dënuar që në ditën e caktuar të paraqitet në institucionin korrektues për mbajtjen e dënimit të shqiptuar me burgim ose me burgim të përjetshëm. Koha nga momenti i pranimit të urdhrin dhe ditës së paraqitjes së të dënuarit në institucion korrektues nuk duhet të jetë më i shkurtër se tetë (8) ditë dhe më e gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, 2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-201, neni 16, p.1 dhe 2).

Gjykata kompetente po ashtu njofton institucionin korrektues për datën dhe kohën kur personi i dënuar duhet të paraqitet në institucion për fillimin e mbajtjes së dënimit dhe ia dërgon vendimin e formës së prerë së bashku me të gjitha të dhënat personale që posedon për personin e dënuar.

#### **4.2. Fillimi i ekzekutimit të vendimeve**

Institucioni korrektues pasi të ketë marrur nga gjykata kompetente vendimin me të gjitha të dhënat për pasonin e dënuar me burgim apo burgim të përjetshëm, është i obliguar që ta njoftojë gjykatën se a është paraqitur personi i dënuar për mbajtjen e dënimit. Një veprim i tillë i njoftimit bëhet me qëllim që mbajtja e dënimit të fillojë në

kohën dhe datën e caktuar nga gjykata dhe në bazë të ligjit. Në rastet kur personi dënuar me burgim apo burgim të përjetshëm, pas marrjes së njoftimit nga gjykata kompetente për mbajtjen e dënimit ai nuk paraqitet në institucionin korrektues, atëherë gjykata urdhëron që personi i dënuar të sillet me forcë në institucion korrektues.

Në rastet kur personi i dënuar fshehët apo gjendet në arrati, atëherë gjykata urdhëron shpalljen e letër rreshtimit (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, 2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-201, neni 18, p.1). Personi i dënuar me burgim apo burgim të përjetshëm i cili në institucion korrektues sillet me forcë atëherë ai i paguan shpenzimet .

Fillimi i Ekzekutimit të dënimit me burgim apo burgim të përjetshëm llogaritet prej momentit dhe datës kur personi i dënuar është privuar nga liria.

#### *4.2.1. Fillimi Ekzekutimit me Burgim apo Burgim Afatgjatë*

Përmasimi i kushteve të jetesës së burgosurve dhe të paraburgosurve si dhe krijimi i kushteve në të cilat të burgosurit trajtohen në mënyrë humane,ligjore dhe diskriminuese janë të një rëndësie tepër të madhe në jetën bashkëkohore (<http://www.docstoc.com/docs/81466758/Drejtoria-e-Pergjithshme-e-Burgjeve>).

Për ekzekutimin e dënimit me burgim ose me burgim afatgjatë,është e domosdoshme të ekzistojë aktgjykimi i plotfuqishëm dhe I ekzekutueshëm I gjykatës kompetente.

Personi i dënuar me burgim ose burgim afatgjatë,nëse gjendet ne paraburgim, vetëm transportohet prej aty ne institucionin korrektues nëse gjendet në liri gjykata kompetente për ekzekutimin e dënimit I dërgon thirrje qe Brenda afatit të paraqitet në institucionin

korrektues. Si gjykatë kompetente për organizimin e ekzekutimit të dënimit me burgim është gjykata komunale ku gjendet vendbanimi i personave të dënuar ndërsa prej (1 janar 2013) gjykatë kompetente do të jetë gjykata themelore (<http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-199-alb.pdf>).

Nëse është fjala për personat e dënuar të cilëve nuk ju dihet vendbanimi ose kur ata gjenden jashtë vendit atëherë kompetente për dërgimin e të dënuarit në mbajtjen e dënimit është gjykata e cila e ka nxjerrë aktgjykimin në shkallë të parë.

Personit të dënuar i lihet një afat prej 8 ditësh të të përgatitët para se të shkoj në mbajtje të dënimit. Gjykata komunale si gjykatë ekzekutuese e informon institucionin korrektues për faktin se personi i caktuar është njoftuar dhe ka marrë thirrjen që të paraqitet në institucion, ditën e caktuar, me tërë rast ajo i dërgon edhe lëndën-dosjen dhe të gjitha shënimet lidhur me personin e dënuar. Shpenzimet për shkuarjen e personit të dënuar në institucion korrektues i paguan gjykata kompetente në rastet kur personi i dënuar paraqitet vullnetarisht për vuajtjen e dënimit. Në rastet kur personi i dënuar me dhunë dërgohet në ent, atëherë shpenzimet e rrugës i bartë vet ai.

Ekzekutimi i sanksioneve penale ka për qëllim risocializimin dhe riintegrimin e të dënuarit në shoqëri dhe përgatitjen e tij për jetë dhe sjellje të përgjegjshme. Ekzekutimi i sanksioneve penale po ashtu shërben për mbrojtjen e shoqërisë duke parandaluar kryerjen e veprave të tjera penale dhe duke përmbajtur të tjerët nga kryerja e veprave penale (*Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale I Kosoves neni 4*).

#### *4.2.2. Fillimi dhe shtyrja e ekzekutimit me burg dhe burgu afatgjatë*

Ekzekutimi i sanksionit penal fillon kur vendimi me të cilin është shqiptuar

sanksioni penal e merr formën e prerë dhe nëse për ekzekutimin e tij nuk ka pengesa ligjore (*Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale neni 6*). Në jetën e përditshme shpeshherë, personit i cili ka marrë thirrje që të shkoj në mbajtje të dënimit me burgim i paraqiten pengesa dhe veshtersi. Janë paraparë disa mundësi dhe rrethana kur personi i dënuar mund të kërkoj shtyerjen e fillimit të dënimit me burgim, ndërsa gjykata pasi ta shqyrtoj rastin mund të aprovoj këtë kërkesë. Shtyrja e mbajtjes së dënimit me burgim iniciohet me anë të lutjes së personit të dënuar, përpos lutjes së dënuarit duhet t'ia paraqes gjykatës dëshmi e prova të argumentuara për arsyet e kërimit të shtyrjes së fillimit të ekzekutimit të dënimit. Kjo bëhet në afatin prej tri ditësh, nga dita e marrjes së thirrjes nga gjykata që të shkoj në mbajtje të dënimit. Nëse lutja refuzohet, personi i dënuar ka të drejtë në ankesë të kryetari i gjykatës me të lartë në afat prej tri ditësh. Ankesa e tillë e pezullon ekzekutimin e dënimit me burgim. Arsyet për të cilat mund të kërkojë shtyrja e ekzekutimit të dënimit me burgim mund të jenë:

- 1) Të natyrës Shëndetësore,
- 2) Të natyrës Familjare,
- 3) Të natyrës Sociale,
- 4) Të natyrës Kontraktuese,
- 5) Të natyrës Materiale etj.

Për arsye shëndetësore, personi i dënuar mund të kërkojë që të shtyhet fillimi i mbajtjes së dënimit me burgim, **nëse ai është i sëmurë rëndë** në rast të tilla shtyrja e dënimit bëhet sa zgjat sëmundja. Rast tjetër është **kur femra shtatzënë, pas muajt të gjashtë të shtatzënisë, mund të kërkojë shtyerjen e fillimit të vuajtjes së dënimit me burgim**. Në këto raste gjykata e shtyn fillimin e mbajtjes së dënimit deri sa fëmija të mbush tre vjet. Rast tjetër është **kur personat e dënuar janë prindërit apo**

**bashkëshortet e një familjeje** dhe shkuarja e tyre do ta vështirësonte jetesën dhe mbajtjen e anëtarëve. Kësisoj dënimi mund të shtyhet për tre muaj gjatë kohës së punës sezonale, gjatë mbjelljeve, korrjeve, ose kur personi i dënuar ka obligime kontraktuese ndaj personave të tretë dhe shkuarja në mbajtjen e dënimit do tu shkaktonte dëme të mëdha personave të tretë (Halili, 2009: 145).

### **4.3. Shtyrja e ekzekutimit të vendimit**

Personi i dënuar me burgim, pas marrjes së vendimit për vajtje në mbajtje të dënimit, ai për shkaqe objektive mund të kërkojë shtyrjen e ekzekutimit të dënimit. Shtyrja e mbajtjes së dënimit mund të bëhet në bazë të kërkesës së personit të dënuar, e cila kërkesë i parashtrohet kryetarit të gjykatës kompetente themelore (Halili, 2009: 145). Personi i dënuar kërkesën për shtyrje të mbajtjes së dënimit e parashtron në afat prej shtatë (7) ditësh, nga dita e marrjes së vendimit për mbajtje të dënimit dhe kërkesës duhet t'ia bashkangjes arsyet dhe faktet për shtyrjen e mbajtjes së dënimit. Nëse i dënuari nuk bashkangjet prova, fakte dhe dëshmi për shtyrje të dënimit, kryetari i gjykatës kompetente themelore i ofron mundësinë personit të dënuar që këto fakte dhe të dhëna ti paraqes në afat prej tetë (8) ditësh me paralajmërim se në të kundërtën kërkesa e tij do të refuzohet. Nëse kërkesa e personit të dënuar refuzohet, atëherë ai ka të drejtë ankesë te kryetari i Gjykatës së Apelit në afat prej tri (3) ditësh. Ankesa e parashtruar kryetarit të Gjykatës së Apelit pezullon vendimin për ekzekutimin e dënimit me burg.

Shtyrja e vendimit për ekzekutimin e dënimit me burg mund të bëhet për arsye shëndetësore të personit të dënuar, atëherë kur ai është i sëmura rëndë apo nëse vuan nga ndonjë sëmundje akute të rëndë. Në raste të tilla shtyrja e ekzekutimit të dënimit bëhet

gjerë në shërimin e sëmundjes. Lidhur me sëmundjen e rëndë personi i dënuar është i obliguar që të sjell dëshmitë mjekësore nga ekspertët shëndetësor dhe nga institucioni adekuat shëndetësor (Halili, 2014: 214 dhe 215). Në rastet kur personi i dënuar është i gjinisë femërore dhe është shtatzënë në muajin e gjashtë (6) të shtatëzanisë, në raste të tilla gjykata mund të shtyjë ekzekutimin e mbajtjes së dënimit gjerë sa fëmiu të mbush tri (3) vjet. Shtyrje e mbajtjes së dënimit mund të bëhet edhe në rast se ndonjë nga anëtarët e ngushtë të familjes së personit të dënuar vuan nga ndonjë sëmundje e rëndë apo në rast se ka vdekur. Në këtë rast personit të dënuar mund të shtyhet mbajtja e dënimit gjerë në tre (3) muaj. Në rastet kur së bashku me personin e dënuar ftohet për mbajtje të dënimit edhe ndonjëri anëtar i familjes së ngushtë të personit të dënuar, apo në rast se gjendet në mbajtje të dënimit anëtari i ngushtë i familjes, atëherë mund të shtyhet mbajtje e dënimit gjerë në gjashtë (6) muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit të vendimit. Sipas dispozitave ligjore në fuqi, shtyrja e ekzekutimit të dënimit gjerë në tre (3) muaj mund të ndodhë në rastet kur personi i dënuar ka punë sezonale bujqësore që kërkojnë kryerje të domosdoshme si dhe në raste kur personi i dënuar ka ndonjë obligim pune me ndonjë palë të tretë. Shtyrja e mbajtjes së dënimit mund të bëhet edhe në rastet kur personi i dënuar gjendet në përfundim të shkollimit, ose kur ka për të iu nënshtruar provimeve të cilat ai i ka përgatitur. Në këto raste të shkollimit shtyrja e dënimit mund të jetë për gjashtë (6) muaj. Shtyrja e dënimit në raste të përmendura është më se e nevojshme për personin e dënuar dhe atij i mundëson që paraprakisht të krijojë kushtet për familjen e ngushtë dhe fillimi i dënimit të jetë i lehtë dhe pa ngarkesa psikike.

#### **4.4. Përfundimi i ekzekutimit të vendimit si formë e fundit e procesit**

Në rastin e mos aprovimit të kërkesës së personit të dënuar për shtyrje të vendimit për ekzekutimin e dënimit me burg, i njëjti është i obliguar që në datën dhe kohën e caktuar nga gjykata kompetente themelore të lajmërohet në institucion korrektues për fillimin e mbajtjes së dënimit. Për pranimin e personit të dënuar në institucion korrektues, njoftohet me shkrim gjykata themelore kompetente që ka pranuar vendimin për dërgim në mbajtje të dënimit (Halili, 2014:215 dhe 216). Në rastet kur personi i dënuar sillet në institucion korrektues nga organi i policisë, atëherë për pranimin e të dënuarit në institucion korrektues, policisë i lëshohet vërtetimi i pranimit. Me këtë përfundon procedura e vendimit për ekzekutimin e dënimit me burg apo burg të përjetshëm të personit të dënuar, por jo edhe ekzekutimi i dënimit. Kur institucioni korrektues pranon në mbajtje të dënimit personin e dënuar, fillimesh vërteton identitetin e tij, pastaj dokumentacionin lidhur me dënimin me burgim apo burgim të përjetshëm, pastaj evidentohen të gjitha të dhënat e tij personale si dhe data dhe koha e ardhjes së tij në institucion korrektues (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149,2013,neni 31, p.1). Pas pranimit në institucion korrektues, personi i dënuar i nënshtrohet kontrollimit detal mjekësor në afat prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti i pranimit. Po ashtu ai njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet që ka gjatë mbajtjes së dënimit.

Me të pranuar në institucion korrektues i dënuari fillimisht vendoset në objektin e pranimit. Ku ai do të qëndroj më së paku 30 ditë dhe maksimum tre (tre) muaj. Gjatë qëndrimit në objektin e pranimit ai njoftohet me rendin shtëpiak, të drejta, detyrimet dhe benificionet që mund ti ketë.

Gjatë qëndrimit në objektin e pranimit me të dënuarin punojnë ekspertë të lëmive të ndryshme, si; zyrtar të pranimit, zyrtar ligjor, zyrtar social, psikolog, psikiatër, mjek, mësues, instruktor, si dhe zyrtar të sigurimit. Gjatë kësaj periudhe studiohet personaliteti i të dënuarit, evidentohen nevojat e tij dhe përpilohet programi i trajtimit gjatë mbajtjes së dënimit.

Varësisht nga programi individual i trajtimit të të dënuarit, ai dërgohet në objektin adekuat për mbajtjen e dënimit të mëtejshëm.

Dënimi konsiderohet i përfunduar atëherë kur:

- Personi i dënuar ka mbajtur dënimin plotësisht dhe lirohet nga institucioni korrektues,
- Kur bëhet lirimi i parakohshëm,
- Kur iu është falur dënimi i mbetur dhe lirohet nga mbajtja e mëtejshme e dënimit,
- Kur amnistohet vepra penale ose dënimi i mbetur,
- Kur personi i dënuar lirohet me kusht nga pjesa e mbetur e dënimit (Hysi, 2009:168).

Lirimin e personit të dënuar nga institucioni korrektues bëhet në ditën e përfundimit të mbajtjes së dënimit të tij me burg. Nëse dita e lirit është ditë e shtune, e diele apo ditë feste zyrtare, personi i dënuar lirohet ditën e fundit të punës para asaj dite. Mirëpo një lirim i tillë nuk zbatohet për të dënuarit për kundërvajtje me më pak se shtatë (7) ditë burg. Personi i dënuar lirohet nga punët dhe obligimet në institucion korrektues së paku tre (3) ditë para ditës së lirit (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, 2013, neni 126).

Lirimi i parakohshëm i personit të dënuarve burgim mund të ndodhë atëherë kur



Drejtori i institucionit korrektues merr një vendim të tillë për arsye se i dënuari ka manifestuar sjellje të mirë, ka pasur suksese në punë dhe në aktivitete të tjera. Lirimin e parakohshëm të personit të dënuar mund ta lejoj Drejtori i institucionit korrektues atëherë kur personi i dënuar ka mbajtur të paktën  $\frac{3}{4}$  e dënimit me burg dhe nëse të njëjtit i ka mbetur jo më shumë se tre (3) muaj të dënimit.

Personi i dënuar me burg mund të lirohet nga mbajtja e dënimit edhe në rastet kur atij i falet pjesa e mbetur e dënimit. Kur Presidenti shpall falje, njoftohet personin që ka bërë kërkesën, personi që falet dhe Ministria e Drejtësisë (Ligji për falje Nr. 03/L-101, aprovuar me 12.12.2008, neni 8, p.2)

Personi i dënuar me burg i cili është falur e gjendet në institucion korrektues, lirohet në të njëjtën ditë kur institucioni korrektues e pranon vendimin për falje dhe jo më vonë se njëzetekatër (24) orë nga pranimi i vendimit.

Kur amnistohet vepra penale ose dënimi i mbetur, lirohet nga institucioni korrektues pësoni i dënuar dhe njëherit përfundon ekzekutimi i vendimit të prerë.

Pas amnistisë gjykata kompetente themelore vendos me vendim për dhënien fund të dënimit dhe lirimin e personit të dënuar nga institucioni korrektues.

Personi i dënuar lirohet me kusht nga pjesa e mbetur e dënimit në bazë të dispozitave ligjore të Kodit penal të Kosovës (Kodi Penal I Republikës së Kosovës Nr. 04/L-82,2012, neni 94), Ligjit për Ekzekutimin e sanksioneve Penale (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, 2013, neni 126) si dhe Rregullores për organizimin dhe funksionimin e panelit për lirim me kusht e nxjerrur nga Këshilli gjyqësor i Kosovës (Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e panelit për lirim me kusht, 22.02.2013, neni 12, p.1,2 dhe 3).

Për lirimin me kusht vendos Paneli për lirim me kusht. Aktvendimi i lirimit me kusht

i dorëzohet personit të dënuar brenda tri (3) ditëve dhe institucionit korrektues ku gjendet i personi i dënuar. Aktvendimi për lirim me kusht evidentohet në gjykatën themelore e cila ka dhënë dënimin. Aktvendimi përcakton datën se kur personi i dënuar duhet të lirohet me kusht nga pjesa e mbetur e dënimit. Institucioni korrektues është i obliguar që në datën e caktuar në Aktvendim ta lirojë personi e dënuar nga mbajtja e pjesës së mbetur të dënimit.

#### **4.5. Ekzekutimi i dënimit me gjobë**

Gjykata e cila e shqipton dënimin me gjobë për kryerje të veprës penale apo kundërvajtjes penale, ajo është kompetentën për urdhërimin e ekzekutimit të këtij dënimi (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013, neni 135).

Krahas dënimit me burgim, dënimi me gjobë është dënimi kryesor që zbatohet ndaj personave që kryejnë krime ose kundërvajtje penale (Hysi, 2012:143). Dënimi me gjobë dhe shuma që duhet të paguhet nuk mund të jetë më pakë se 100 Euro dhe nuk mund të tejkalojë shumën prej 25.000 Euro (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2 prill 2012, neni 46, paragrafi 1) Veprat penale të cilat kanë të bëjnë me terrorizëm, trafikim me njerëz, krim të organizuar ose vepra penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë materiale nuk mund të tejkalojë pagesën në shumë prej 500.000 Euro.

Gjykata është organi kompetent për shqiptimin e dënimit me gjobë dhe njëherit cakton afatet dhe mënyrën e pagesës së gjobës. Fati i pagesës së gjobë nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe as më i gjatë se tre (3) muaj. Në kushte dhe rrethana të arsyeshme gjykata mund të lejojë që dënimi me gjobë të paguhet me këste për

një periudhë kohore prej jo më shumë se dy (2) vjet (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2 prill 2012, neni 46, paragrafi 2).

Në rastet kur personi i dënuar nuk respekton afatet e pagesës së gjobës, nuk dëshiron të paguajë atë, atëherë gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim dhe një ditë burgim llogaritet njëzetë (20) Euro. Dënimi i tillë nuk mund të jetë më i gjatë se tri (3) vjet.

Në rastet kur personi i dënuar nuk ka mundësi të paguajë gjobën në tërësi, pjesën e mbetur të gjobës gjykata do ta zëvendësojë me dënim me burg. Kur personi i dënuar me gjobë nuk dëshiron të paguajë gjobën apo nuk ka mundësi të paguajë, atëherë gjykata me pëlqimin e tij mund të zëvendësojë atë me dënim me urdhër për punë me dobi të përgjithshme. Në këto raste tetë (8) orë punë në ditë llogaritet me njëzet (20) Euro (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2 prill 2012, neni 46, paragrafi 2).

#### **4.6. Ekzekutimi i Dënimit me Burgim dhe Burgim të përjetshëm**

Ekzekutimi i dënimit me burgim ose me burgim të përjetshëm bëhet në bazë të vendimit të formës së prerë dhe nëse për ekzekutimin e tij nuk ka pengesa ligjore, por ekzekutimi i dënimit mund të fillojë edhe para se vendimi gjyqësor të marrë formën e prerë (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013, shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 6, paragrafi 2 ).

Personi i dënuar me burgim ose burgim të përjetshëm, nëse gjendet në paraburgim ai vetëm transferohet nga paraburgimi në institucionin adekuat korrektues. Në rastet kur personi i dënuar me burg gjendet në liri, gjykata kompetente për ekzekutimin e dënimit i dërgon thirrje që brenda fatit të caktuar ligjor prej tetë gjerë në pesëmbëdhjetë (8-15) ditës

të lajmërohet në institucion korrektues për mbajtje të dënimit. Gjykata kompetente informon edhe institucionin korrektues për datën kur personi i dënuar duhet të paraqitet në institucion dhe njëherit ia dorëzon vendimin e formës së prerë së bashku me të dhënat personale për personin e dënuar (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 16). Institucioni korrektues e informon gjykatën kompetente se a është paraqitur personi i dënuar për mbajtjen e dënimit. Mbajtja e dënimit me burgim apo burgim të përjetshëm llogaritet prej datës kur personi i dënuar është paraqitur në institucion korrektues. Nëse personi i dënuar edhe pas marrjes së thirrjes për mbajtjen e dënimit nuk paraqitet në institucion korrektues, gjykata urdhëron që ai të sillet me forcë në mbajtje të dënimit. Nëse personi i dënuar fshehët, ose është në arrati, gjykata kompetente urdhëron shpalljen e letër rreshtimit. Shpenzimit për dërgim me forcë të personit të dënuar në institucion korrektues i bartë vetë personi i dënuar, kurse në rastet kur personi e dënuar paraqitet vetë në institucion korrektues shpenzimet e transportit ia kompenson institucioni korrektues (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149,2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 18). Kompetente për zbatimin dhe organizimin e ekzekutimit të dënimit është gjykata themelore ku gjendet vendqëndrimi dhe vendbanimi i personit të dënuar (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149,2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 14). Në rastet kur nuk dihen vendqëndrimi dhe vendbanimi i personit të dënuar, kompetent për dërgimin e personit të dënuar me burgim, ose burgim të përjetshëm është gjykata themelore që ka marrë vendim në shkallën e parë dhe nëse këtë vendim e ka marrë Gjykata e Apelit, atëherë kompetente është gjykata themelore e cila gjendet në selinë e Gjykatës së Apelit (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149,2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 15)

Kryesit e veprave të rënda penale të cilët dënohen me burgim dhe burgim të përjetshëm dërgohen në institucione korrektuese për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm, por në pajtim me aktin e vendosjes të Ministrit të Drejtësisë. Në rastet e veçanta, përjashtimisht me lutjen e personit të dënuar dhe kur ekzistojnë përmbarues të justifikueshme, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës mund të heqë dorë nga akti i vendosjes dhe mund të ndërrojë vendin e ekzekutimit të dënimit – institucionin korrektues ku do të ekzekutohet dënimi. Për të gjitha arsyet dhe veprimet e ndërrimit që ndërmerr Drejtori i Shërbimit Korrektues duhet që sa ma parë ta njoftojë me shkrim ministrin (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 11, paragrafi 2). Kundër vendimit të Drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit korrektues lejohet ankesa tek ministri në afatin e përcaktuar prej tetë (8) ditësh, nga dita e marrjes së vendimit. Mirëpo ankesa e parashtruar në afatin e caktuar ligjor nuk ndalon ekzekutimin e dënimit (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 11, paragrafi 3). Personi i dënuar me burg, në rastet kur pjesa e mbetur e dënimit nuk i kalon tre (3) muaj, mund të vendoset në Qendër të Paraburgimit, kurse kur dënimi është mbi tre (3) muaj, atëherë vendoset në Institucion korrektues adekuat. Personi i dënuar mbi tre (3) muaj e jo ma shumë se tri (3) vite, kur është për të parën herë i dënuar dhe kur paraqitet vetë për mbajtje të dënimit, ai vendoset në Institucionin korrektues- Qendrën korrektuese për dënime të shkurta. Në këtë institucion vendosen edhe personat e dënuar që gjenden në ndonjë institucion tjetër korrektues, por që mbajtja e dënimit për të mbajtur është tri apo më pak se tri vite.

Personi i dënuar me burgim të përjetshëm vendoset në institucionin korrektuese- Burgun e sigurisë së lartë. Në rastet kur vendimi i tij nuk është ende i plotfuqishëm ai

po ashtu vendoset në burgun e sigurisë së lartë por në objektin e caktuar për të paraburgosur.

Organet e administratës së Shërbimit Korrektues luajnë rol të rëndësishëm në ekzekutimin në praktikë të dënimit me burgim dhe burgim të përjetshëm, kur është vendosur vuajtja e tij në burg (Hysi, 2012:133). Ekzekutimi i dënimit me burgim apo burgim të përjetshëm mbahet në objektet e mbyllura të Institucioneve korrektuese dhe personi i dënuar nuk duhet ti nënshtrohet trajtimit çnjerëzor (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2 prill 2012, neni 92, paragrafi 1, 2 dhe 3).

#### **4.7. Ekzekutimi i Dënimit me burgim te pezulluar**

Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim është paraparë me Ligjin e Ekzekutimit të Sanksioneve Penale, ku personit të dënuar i jepet të drejtë që në raste të arsyeshme të kërkojë pezullimin e dënimit. Rrethanat që mundësojnë zbatimin e kësaj alternative kanë të bëjnë me personalitetin e personit dhe gjendjen e tij psikosociale, kushtet shëndetësore, mendore, rrezikshmërinë e pakët të personit, moshën, mënyrën e jetës, nevojat dhe kushtet familjare, shkollimi, puna, etj, (Hysi, 2012:296)

Pezullimi i ekzekutimit të dënimit mund të lejohet, me :

- kërkesën e personit të dënuar, apo
- me kërkesë të anëtarit të ngushtë të familjes së tij, ose
- me propozimin e drejtorit të institucionit korrektues

Në rastin kur personi i dënuar parashtron kërkesë për pezullim dënimi, apo kur anëtari i familjes së ngushtë parashtron kërkesë si dhe në rastin e propozimit të drejtorit të institucionit korrektues duhet të jepet edhe rekomandimi i Drejtorit të përgjithshëm të

Shërbimit Korrektues.

Ministri i Drejtësisë, pas marrjes së kërkesë dhe rekomandimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues, mund të lejojë pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, nëse për këtë ekzistojnë arsyet. Pezullimi nuk mund të zgjasë më shumë se tre (3) muaj (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 94, paragrafi 1).

Në rastet e pezullimit të dënimit për çështje të trajtimit mjekësor, pezullimi i dënimit mund të zgjasë gjerë në përfundim të trajtimit.

Në rastet e pezullimit të dënimit për çështje shëndetësore, personi i dënuar është i detyruar që çdo muaj të njoftojë Shërbimin korrektues për gjendjen e tij shëndetësore nëpërmjet Raportit mjekësor të nënshkruar nga komisioni prej tre (3) mjekëve të emëruar nga Ministri.

Vendimin mbi vazhdimin e pezullimit të dënimit e nxjerr Ministri në bazë të propozimit të komisionit të komisionit shëndetësor të përbërë nga tre (3) mjek, të cilët janë të emëruar nga Ministri. Në rastet e parapara të pezullimit të ekzekutimit të dënimit, kohëzgjatja e pezullimit të dënimit nuk llogaritet në kohëzgjatjen e dënimit.

Pezullimi i ekzekutimit të dënimit mund të bëhet edhe për shkak të mjeteve të jashtëzakonshme juridike. Në rastet kur Gjykata kompetente e cila vendos lidhur me kërkesën për rishikimin e procedurës penale, e paraqitur në favor të personit të dënua mund të pezullojë ekzekutimin e dënimit edhe para se aktvendimi të merre formë të prerë me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 95).

Pezullim i ekzekutimit të dënimit me kërkesë të prokurorit të shtetit kompetent çdo

herë lejohet derisa të merret vendimi për ushtrimin e mjetit juridik. Vendimi për pezullimin e ekzekutimit të dënimit e humb vlefshmërinë, nëse prokurori i shtetit nuk e shfrytëzon mjetin juridik brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e vendimit për pezullim (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 19,paragrafi 2 ).

Ministri i Drejtësisë revokon pezullimin e ekzekutimit të dënimit nëse vërtetohet se arsyeja për lejim e pezullimit nuk ka ekzistuar, apo në rast se personi i dënuar nuk lajmërohet në Shërbimin Korrektues pas skadimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit.

#### **4.8. Ekzekutimi i Dënimeve plotësuese**

Krahas dënimit kryesor, gjykata mund të japë ndaj të dënuarit një ose disa dënime plotësuese, të parashikuara me nenin 62 të kodit penal (Hysi, 2012:145). Në Penologjinë bashkehore në tërësi e në veçanti në sistemin bashkehore penitensiar, dënimet plotësuese paraqesin një lloj të veçantë të sanksioneve penale, të cilat kanë rol preventiv dhe parandalues të kriminalitetit (Halili, 2014:236).

Këto dënime plotësuese duhet të shqiptohen me qëllim të evitimit të gjendjes së rrezikshme e cila mund të sjellë si pasojë përsëritjen e sjelljeve të caktuara kriminale. Ekziston mendimi dhe bindja e bazuar se përsosja dhe zgjerimi i dënimeve plotësuese, do të ndikonte dukshëm në pengimin e disa formave të kriminalitetit tek ne dhe në botën bashkehore (Halili, 2014:235).

Kodi penal i Kosovës parasheh parasheh dënimet plotësuese të cilat mund të shqiptohen së bashku me dënimin kryesor ose alternativ, dhe ato janë:

- heqja e të drejtës për tu zgjedhur,



- urdhri për kompensimin e humbjes apo dënimit,
- ndalimi i ushtrimit të funksioneve publike ose në shërbimin publik,
- ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës,
- ndalimi i drejtimit të automjetit,
- marrja e lejes së vozitjes,
- konfiskimi,
- urdhri për publikimin e aktgjyqimit dhe
- dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës.

Dënimi plotësues me ndalimin e drejtimit të automjetit ose marrjen e sendit mund të shqiptohet së bashku me dënimin me kusht, me vërejtjen gjyqësore ose me lirim nga dënimi.

Ekzekutimi i këtyre dënimeve plotësuese të parapara me nenin me nenin 62 të Kodit Penal të Kosovës fillon së bashku me ekzekutimin e dënimit kryesor ose dënimit alternativ (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2 prill 2012, neni 72).

Ekzekutimi i këtyre dënimeve fillon pas mbajtjes së dënimit me burg, me përjashtim të konfiskimit dhe urdhrin për publikimin e aktgjyqimit.

Ligji i ekzekutimit të sanksioneve penale nga neni 159 -171, në mënyrë të përpiktë parasheh ekzekutimin e këtyre dënimeve plotësuese.

#### *4.8.1. Heqja e të drejtës për tu zgjedhur*

Heqja e të drejtës për tu zgjedhur si dënim plotësues është paraparë me nenin 63 të Kodit Penal të Kosovës. Këtë dënim gjykata ia shqipton personit të dënuar në kohëzgjatje

një gjeri në katër vjet, nëse ai me qëllim që të zgjidhet kryen ndonjë nga veprat penale kundër të drejtave të votimit ose ndonjë vepër tjetër penale për të cilën është paraparë dënimi me më së paku dy vjet burgim (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2 prill 2012, neni 63). Ekzekutimi i dënimit – heqja e të drejtës për tu zgjedhur është paraparë me nenin 159 të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 159).

Ekzekutimi i këtij dënimi bëhet atëherë kur gjykata kompetente vendos që kryesit t'ia heqë të drejtën për tu zgjedhur sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës. Gjykata menjëherë ia dërgon aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon stacionit të policisë në territorin e së cilës personi i dënuar ka vendbanimin e tij për ekzekutimin e këtij dënimi plotësues. Njësia administrative e stacionet të policisë e njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës dhe Komisionin Lokal të Zgjedhjeve ku personi i dënuar e ka vendbanimin dhe i njofton se personit të dënuar i është hequr e drejta për tu zgjedhur me vendim të formës së prerë të gjykatës. Në rastet kur personi i dënuar ndërton vendbanimin ai e njofton gjykatën dhe policinë për vendbanimin e tij të ri. Stacioni i policisë në territorin e të cilit personi i dënuar ka pasur vendbanimin e mëhershëm e njofton stacionin e policisë për vendbanimin e ri e personit të dënuar.

#### *4.8.2. Urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit*

Në rastet kur gjykata dënon personin i cili shpallet fajtor për çfarëdo vepre penale që përfshin vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë, atëherë do të urdhërojë kryesin e veprës që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës. Caktimi i vlerës së

kompozimit duhet të jetë në proporcion me vlerën e çfarëdo pasurie të vjedhur, pasurie të humbur, të dëmtuar apo të shkatërruar. Neni 64 paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës parasheh se kryesi i veprës penale obligohet që të kompozoj viktimën për çfarëdo humbje të të ardhurave të cilat i pëson si rezultat i veprës penale. Ligji i ekzekutimit të sanksioneve penale në dispozitat e tij nuk e ka paraparë procedurës dhe mënyrën e ekzekutimit të këtij dënimi plotësues (Halili, 2014: 236).

Sipas Kodit Penal të Kosovës ky dënim plotësues ekzekutohet pasi vendimi të merr formën e prerë dhe njëherit të bëhet i ekzekutueshëm.

#### *4.8.3. Ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës*

Shqiptimi i këtij dënimi plotësues ka për qëllim pengimin e kryesit të veprës penale që në të ardhmen të përsërisë sjelljen delikuyente dhe kriminale duke ushtruar profesionin e tij, zejen, veprimtarin apo detyrën e caktuar. Ky dënim plotësues u shqiptohet personit i cili më parë ka kryer sjellje kriminale duke keqpërdorur profesionin e tij, mjeshtërinë dhe zejen e caktuar. Gjykata është organ kompetentë për të vlerësuar sesa është e nevojshme që këtyre personave tu ndalohet ushtrimi i profesionit, veprimtarisë apo detyrës me qëllim që në të ardhmen të pengohen veprimet e tyre kriminale. Dënimi i tij plotësues i shqiptohet delikumenteve dhe individëve të profesioneve të caktuara si mjekëve, infermierëve, punëtorë të arsimit, financiere, arkatarve dhe disa profesioneve tjera ku individët duke ushtruar detyrën e tyre kryen veprime dhe sjellje jo ligjore. Personave të tillë, përveç dënimit me burg apo me gjobë për shkak të kryerjes së veprës penale, u shqiptohet edhe dënim plotësues i ndalimi të ushtrimit të profesionit, të veprimtarisë apo detyrës për një kohë të caktuar. Ky dënim i shqiptuar mund të zgjasë prej një deri në pesë

vjet (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2 prill 2012, neni 63,paragrafi 1 dhe 2).

Në rastet kur gjykata vendos që kryesit t'ia ndalojë ushtrimin e profesionit, veprimtarisë së pavarur, detyrës udhëheqëse ose administrative, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, menjëherë ia dërgon vendimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon ndërmarrjes publike, apo private ku personi i dënuar ka qenë i punësuar. Në rastet kur personi i dënuar nuk i përmbahet ndalesës së ushtrimit të profesionit, veprimtarisë, ose detyrës ndërmarrja publike apo private, organi përgjegjës e njofton gjykatën për mos respektim të ndalesës (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 163).

#### *4.8.4. Ndalimi i drejtimit të automjetit*

Në varësi të natyrës së veprës ose kur çmohet e nevojshme nga gjykata (për efekte parandaluese), ndaj të dënuarit mund të hiqet një dënim i tillë plotësues (Hysi, 2012:147).

Shqiptimi i këtij dënimi parashihet nga neni 67 i Kodit Penal të Kosovës kurse ekzekutimi i tij parashihet nga neni 64 i Ligjit të Ekzekutimit të Sanksioneve Penale. Personi i cili rrezikon sigurinë në trafikun publik gjykata mund të vendosë që t'ia ndalojë drejtimin e automjetit dhe vendimin e tillë me të gjitha të dhënat ia dërgon organit kompetentë për dhënien e lejeve të vozitjes në territorin ku personi i dënuar ka vendbanimin, me qëllim të ekzekutimit të këtij dënimi plotësues. Gjatë caktimit të këtij dënimit gjykata përcakton edhe afatin e zgjatjes e që mund të zgjasë prej një viti deri në pesë vjet. Ky dënim ndaj disa kategorive të kryesve të veprave penale në trafikun publik, mund të shqiptohet edhe për kohë të përhershme, atëherë kur vërtetohet se të dënuarit

janë të pa aftë për drejtimin e automjetit dhe drejtimi i automjetit nga ta mund të paraqet rrezik objektiv për sigurinë e qytetarëve në trafik. Organi kompetent publik për dhënien e lejeve të vozitjes në territorin ku i dënuari e ka vendbanimin e përhershëm ka për obligim ligjor që të bëjë ekzekutimin e këtij dënimi. Në rastet kur personi i dënuar nuk i përmbahet ndalimit të drejtimit të automjetit, organi kompetent i autorizuar për dhënien e lejes së vozitjes e njofton gjykatën për mos respektimin e ndalimit të tillë.

#### *4.8.5. Marrja e sendeve – konfiskimi*

Personat e dënuar të cilët gjatë kryerjes së veprës penale përdorin mjete të ndryshme, atëherë atyre u shqiptohet dënimi plotësues marrja e sendeve me të cilët është kryer vepra penale. Gjykata gjatë caktimit të këtij dënimi plotësues merr apo konfiskon të holla gjatë lojës së bixhozit, mjete narkotike, valuta të ndryshme, mjete me të cilat është kryer vepra penale ose sendet që kanë dalë nga vepra penale, si dokumenta të falsifikuara, gjëra të vjedhura etj. Gjatë ekzekutimit të këtij dënimi gjykata vendos nëse sendet e konfiskuara do të shiten sipas Ligjit për Procedurë Përmbartimore, do ti dorëzohen organit kompetent, muzeut të kriminalistikës, ose institucionit përkatës, apo nëse ato do të asgjësohen. Gjatë ekzekutimit të këtij dënimi sendet e konfiskuara mund edhe të shiten dhe mjetet nga to depozitohen në buxhetin e Kosovës.

#### *4.8.6. Dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës*

Gjykata si organ kompetent për shqiptimin e dënimit, ajo mund të urdhërojë dëbimin e të huajit nga territori i Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej një deri në dhjetë vjet

dhe në këtë rast merr parasysh llojin dhe peshën e veprës penale që ka kryer i huaji motivet e kryerjes dhe lidhjen e kryesit me Republikën e Kosovës. Kohëzgjatje e dëbimit llogaritet nga dita kur vendimi gjyqësor merr formën e prerë. Koha e mbajtur në burg ose në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi. Kompetent për ekzekutimin e këtij dënimi është stacioni policor në territorin ku personi i dënuar ka vendqëndrimin. Ky dënim nuk mund të shqiptohet dhe të ekzekutohet nëse është në kundërshtim me të Drejtën Ndërkombëtare (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2 prill 2012, neni 71,paragrafi 3).

#### **4.9. Ekzekutimi i urdhërimeve te tjera te Gjykatës**

Nëse shteti në të cilin është kryer vepra penale nuk dëshiron që atë person ta ndjekë penalisht apo nuk mund ta bëjë këtë ngase ai është larguar nga territori i tij dhe është kthyer në shtetin e vetë dhe nëse shtetit i vetë nuk dëshiron ta ekstradoj,ndjekja penale dhe ndëshkimi mundë të realizohen në këtë mënyrë;shteti ku kryesi e ka kryer veprën penale heq dorë,ia beson këtë të drejtë,të drejtën e zhvillimit të procedurës penale dhe të ndëshkimit shtetit në të cilin gjendet kryesi i veprës penale. Kjo mënyrë e bashkëpunimit ndërkombëtar në lëmin e së drejtës penale mbështetet në parimet e solidaritetit dhe mirëbesimit ndërshtetëror. Kjo formë e bashkëpunimi ndërkombëtar në vitet e fundit po praktikohet sidomos për rastet e veprave penale kundër sigurisë së trafikut rrugor (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82, 2 prill 2012, neni 71,paragrafi 3).

**Ekzekutimi i aktgjykimit penal të huaj** kuptojmë rastet kur një personi i është dhënë dënimi në shtetin ku e ka kryer veprën penale dhe ai më pas i dorëzohet shtetit tjetër,zakonisht shtetit shtetësinë e të cilit e ka apo ku e ka vendbanimin e përhershëm,me

qëllim që atje ta mbaj dënimin. Çështja e ekzekutimit të aktgjykimit penal të huaj, është rregulluar me normat kushtetuese dhe ligjore të shteteve. Me anë të këtyre normave interne, në procedurë paraprake kërkohet që të konstatohet nëse janë plotësuar kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e aktgjykimit të huaj penal. Kjo procedurë paraprake duhet të konstatoj nëse është bërë parashkrimi i ekzekutimit të dënimit, nëse gjykata vendëse më parë ka nxjerrë aktgjykim për atë veprë penale, nëse dënimi është shqiptuar me procedurën e cila i ka respektuar garancitë minimale të gjykimit objektiv etj. Mirëpo duhet theksuar se me këtë procedurë të shikimit të aktgjykimit penal të huaj, nuk është e lejuar vërtetësia e provave dhe kualifikimi juridikë, sepse me këtë do të kundërshtohet kuptimi i ndihmës juridiko-penale ndërkombëtare.

**Nocioni dhe qëllimi i ekstradimit;** Që të mund të aplikohet parimi real, parimi i personalitetit aktiv dhe pasiv, parimi universal, e sidomos parimi territorial i veprimit të legjislacionit penal, është e nevojshme që të respektohet bashkëpunimi midis shteteve. Një ndër format më të rëndësishme të bashkëpunimit të shteteve në këtë drejtim, që mundëson shqiptimin apo ekzekutimin e dënimit kryesit të veprës penale, është edhe ekstradimi i fajtorit. Me ekstradim, në të drejtën penale dhe në të drejtës penale ndërkombëtare, nënkuptojmë dorëzimin e kryesit të veprës penale prej një shteti në shtetin tjetër, me qëllim që kryesi të dënohet për veprën penale të kryer, ose me qëllim që ndaj tij të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me aktgjykim të plotfuqishëm. Siç shihet nga ky përkufizim, me ekstradim mundësohet që kryesi i veprës penale të ndëshkohet edhe në rastet kur arratiset prej një shteti në shtetin tjetër me qëllim që t'i shmanget dënimit. Ekstradimi më së shpeshti bëhet në rastet kur ndonjë person kryen ndonjë veprë penale në një shtet dhe para se të zbulohet, gjatë procedurës penale, apo pasi që i është dhënë dënimi, arratiset në shtetin tjetër me qëllim që t'i shmanget dënimit., Në rastet e kështilla,

shteti në të cilin gjendet ai person, ia dorëzon shtetit në të cilin e ka kryer veprën penale. Mirëpo, ekstradimi bëhet edhe në rastet kur ndonjë person në shtetin e huaj kryen veprë penale kundër shtetit tjetër ose shtetasit të huaj. Në këso raste, shteti ku është kryer vepra penale ka më tepër interes që kryesi të ndëshkohet në vendin e vet. Në shtetet sovraane, çështja e ekstradimit është rregulluar në mënyrë parimore me dispozita kushtetuese dhe me konventa ndërkombëtare dhe me marrëveshje bilaterale. Në baze të konventave ndërkombëtare, marrëveshjeve bilaterale dhe dispozitave kushtetuese, ekstradimi është rregulluar në mënyrë të hollësishme me normat e kodit të procedurës penale të shteteve. Lidhur me këtë, thjesht për shkaqe politike, ngase ekstradimin mund ta aplikojnë vetëm shtetet sovraane, në vend të termit ekstradim, përdoret shprehja — transfer, transferimi i të pandehurit.

Në kontratën për ekstradim duhet cekur se për cilat lloje të veprave penale do të bëhet dorëzimi i fajtorit. Kjo bëhet në këto të mënyra:

**1) me anë të metodës së enumeracionit, me ç'rast cekën llojet e veprave penale për të cilat do të bëhet ekstradimi;**

**2) me anë të metodës eliminatore, me ç'rast cekën llojet e veprave penale për të cilat nuk do të bëhet ekstradimi;**

**3) metodës së klauzolës gjeneralë, me ç'rast lloji i veprave penale, për të cilat do të bëhet ekstradimi, caktohet sipas llojit dhe masës me të bute të dënimit**

**Parimi i ekstradibilitetit lidhur me ekstradimin;** Me termin ekstradibilitet nënkuptojmë llojet e veprave penale për të cilën kryesit e tyre nuk mund të ekstradohen. Ekstradimi është i mundur vetëm për ato lloje të veprave penale të cilat janë të përcaktuara me marrëveshje ndërkombëtare apo me legjislacionin e brendshëm. Në këtë kontekst parimi i ekstradibilitetit do të thotë se ekstradimi (dorëzimi) i fajtorit do të bëhet vetëm



në rastet kur është fjala për veprat penale më të rënda. Zakonisht me klauzolë gjenerale përjashtohet mundësia e ekstradimit për vepra penale të lehta. ky përjashtim është paraparë përshaka se procedura e ekstradimit është mjaftë e ndërlikuar,e gjatë dhe e shtrenjtë. Lidhur me limitet e dënimit të paraparë, më së shpeshti ekstradimi është përjashtuar për veprat penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në një vit,ndërsa nëse është fjala për ekstradimin i cili kërkohet për ekzekutimin e dënimit,mundësia e refuzimit të ekstradimit është paraparë nëse është dhënë dënimi me burgim deri në katër vite. Këto limite janë të parapara edhe në Konventën Evropiane për Ekstradim.

Në të drejtën e brendshme dhe në kontratat ndërkombëtare ,parimi i ekstradibilitetit realizohet në dy metoda;

*-Metoda e enumeracionit dhe*

*-Metoda e eliminacionit*

**Sipas metodës së enumeracionit** në mënyrë decitive ceken veprat penale për të cilat do të bëhet ekstradimi,ndërsa veprat e tjera përjashtohen nga mundësia e ekstradimit.

**Sipas metodës së eliminacionit** mundësia e ekstradimit është paraparë për të gjitha veprat penale .përveç kategorive të posaçme të cilat janë të përjashtuara për shkak të natyrës së tyre siç janë veprat penale politike apo se fjala është për vepra penale të lehta.

#### *4.9.1. Parimi i identitetit të normave lidhur me ekstradimin*

Sipas parimit të identitetit të normave,vepra për të cilën kërkohet ekstradimi duhet të konsiderohet si vepër penale sipas ligjit të shtetit ku gjendet fajtori dhe ligjit të shtetit ku kërkohet ekstradimi. Parimi i identitetit të normave buron nga kontratat ndërkombëtare

mbi ekstradimin. Ky parim shërben për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut ngase personi i huaj nuk mundë privohet nga liria dhe ti kufizohen edhe liritë dhe të drejtat e tij në shtetin ku është duke banuar,përshkak të kërkesës për ekstradim për veprën e cila në atë shtet nuk është paraparë si vepër penale.

#### *4.9.2. Parimi i specialitetit lidhur me ekstradimin*

Sipas këtij parimi personi mund të ndiqet penalisht apo të ndëshkohet vetëm për atë vepër për të cilën është bërë ekstradimi e jo edhe për ndonjë vepër tjetër penale. Ky parim është rregulluar me marrëveshje bilaterale apo multilaterale si dhe me konventa ndërkombëtare. Këtë parim e përvetëson edhe legjislacioni ynë penal i cili në nen.526 parg.1 ka paraparë që;

*-I huaji nuk mundë të ndiqet për vepër tjetër penale të kryer par transferimit*

*-Ai nuk mundë të dënohet për vepër tjetër penale të kryer par transferimit të tij*

*-Ndaj tij nuk mundë të shqiptohet dënimi me i rëndë nga ai për të cilin është dënuar*

*-Ai nuk mundë ti dorëzohet shtetit të tretë për ndjekje penale të veprës së kryer para lejimit të transferit të tij.*

#### *4.9.3. Parimi i disponibilitetit*

Parimi i disponibilitetit është një parim shumë i rëndësishëm në të drejtën tonë procedurale civile, që shprehet në norma të ndryshme procedurale. Përkufizimi më i ngjeshur i kuptimit të nocionit të disponibilitetit është dhënë në shprehjen latine: “ *Nemo*

*iudex sine actore*”, që do të thotë : “Nuk ka gjykatë (gjyqtarë) paditës “sipas përkthimit ad literam”. Për të dhënë kuptimin dhe rëndësinë e këtij parimi në të drejtën procedurale civile është e nevojshme një analizë më e gjerë. Në radhë të parë duhet pasur parasysh se parimi i disponibilitetit në procedurën civile është vazhdim i disponibilitetit në të drejtën civile. Fitimi dhe ushtrimi i të drejtave subjektive civile varet nga bartësi i tyre, dmth nga subjekti i tyre. P.sh. është në varësi të vullnetit të personit si subjekt i së drejtës a do të blejë një send, a do të pranojë një dhuratë etj. Po kështu varet nga vullneti i tij a do të ushtrojë të drejtën e mbrojtjes me padi në gjykatë, kur i shkelet ose i mohet një e drejtë subjektive. P.sh. varet nga vullneti i pronarit të truallit ose banesës a do të ngrejë padi në gjykatë kundër një tjetri që i ka pushtuar. Siç shihet, për t’u zhvilluar procesi gjyqësor me palë kundërshtare, kërkohet që personi fizik ose juridik i interesuar të ngrejë padi në gjykatë, për të mbrojtur ose realizuar një të drejtë subjektive kundër një subjekti tjetër për të cilin pretendon se ia ka shkelur ose mohuar atë (wordpress.com/2013/05/leksionet-e-procedures-civile.pdf (qasur me 10.11.2014)).

*Parimi i disponibilitetit shprehet në disa drejtime dhe në faza të ndryshme të procesit gjyqësor: “Vetëm palët mund të venë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor....” thuhet në paragrafin e parë të nenit 2 të Kodit të Procedurës Civile. Siç dihet gjykata vihet në lëvizje me ngritjen e padisë nga i interesuari. Më drejtpërdrejtë shprehet neni 153 i Kodit : “Gjykimi i një çështje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadiesë më shkrim”. Pra është e drejta e personit të vendosë a do të ngrejë padi në gjykatë. Dhe pa u ngritur padija nuk mund të fillojë procesi gjyqësor. Një drejtim tjetër i shfaqjes së këtij parimi është e drejta e paditësit të caktojë a do të mbrohet vetë a me anë të përfaqësuesit (nenet 97 e 154 ), të bëjë pohime e të japë sqarime, të zgjidhi mosmarrëveshjen me palën tjetër me pajtim, të heqë dorë nga gjykimi ose nga e drejta e*

*padisë, të ushtrojë ankim ose rekurs kundër vendimit të gjykatës, të kërkojë ekzekutimin e vendimit, të paraqesë prova ose të kërkojë marrjen e tyre, (nenet 214 e 281, 158/b, 201, 452,472, 511 etj). Në dallim nga legjislacioni i mëparshëm procedural civil, në Kodin e Procedurës Civile në fuqi, disponimi mbi këto të drejta nuk mund të kufizohet. Kështu për heqjen dorë nga gjykimi ose nga e drejta e padisë, nuk kërkohet pëlqimi i gjykatës dhe i të paditurit mjafton që paditësi të heqë dore dhe gjykata është e detyruar, pra e përsëris e detyruar të mbyllë çështjen dhe i padituri nuk ka asnjë të drejtë të shprehet. Kjo sepse padia disponohet vetëm nga paditësi dhe askush nuk mund të cenojë apo kufizojë të drejtën e tij (Omari ,1993:167-269).*

*Në legjislacionin tonë procedural në fuqi, prokurorit i është njohur vetëm përjashtimisht e drejta për të ushtruar kërkesë për zhvillimin e procesit gjyqësor për shpalljen e zhdukjes ose të vdekjes së një personi dhe për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, gjykime këto të posaçme pa palë kundërshtare (nenet 375 e 382 ). Për këto çështje do të flitet posaçërisht. Ajo që ka rëndësi këtu është fakti se në procesin gjyqësor me palë kundërshtare nuk cenohet parimi i disponibilitetit.*

*Një drejtim tjetër me rëndësi ku shprehet parimi i disponibilitetit është ai i përfaqësimit. Përfaqësuesi me prokurë vepron brenda tagrave që i janë dhënë nga i përfaqësuari. “Në çdo rast nuk mund të kryejë akte që sjellin disponimit e së drejtës, përveç rasteve kur ka fituar pikësynim në mënyrë të shprehur”, thuhet në nenin 97 paragrafi i dytë të Kodit të Procedurës Civile (Omari, 1993:167-269). “Akte që sjellin disponimit e së drejtës” janë ato që siç u tha, mund të kryhen vetëm nga paditësi vetë. Nga përfaqësuesi mund të kryhen vetëm kur i është dhënë një e drejtë e tillë në mënyrë të shprehur nga titullari i së drejtës. Të tilla janë akte p.sh. ngrirja e padisë, zgjidhja e çështjes me pajtim, heqja dorë nga gjykimi i çështjes ose nga e drejta e padisë. Këto*

*veprime i kryen vetëm paditësi. Përfaqësuesi i kryen këto veprime vetëm kur ne aktin e përfaqësimit si p.sh. prokure, ne mënyre te shprehur i është dhënë e drejta nga paditë sipër te kryer këto veprime ne vend te tij. Mosrespektimi i kësaj kërkesë të ligjit sjell si pasojë prishjen e vendimit të gjykatës, për shkak të pavlefshmërisë së veprimit të pa autorizuar të përfaqësuesit (Omari, 1993:167-269).*

#### *4.9.4. Pengesat për ekstradimin lidhur me kryerësin e veprës penale*

Krahas kushteve materiale juridike,të cilat duhen të përmbushen që të mundë të bëhet ekstradimi,janë edhe disa rrethana apo shkaqe,të cilat,nëse ekzistojnë,e bëjnë të pamundshëm ekstradimin,paraqiten pengesë për ekstradim. Këto rrethana ju referohen;

- Kryesit të veprës penale
- Shkaqet humanitare
- Llojit të veprës penale
- Parimit territorial të ligjit penale dhe
- Pengesave procedurale për zhvillimin e procedurës penale

**Kryesit të veprës penale** si pengesë për ekstradimin e tij është ;-*Shtetësia*,që do të thotë se shtetasi i vendit nuk ekstradohet. Këtë zgjidhje e kanë përvetësuar një numër i madh i kontratave ndërkombëtare mbi ekstradimin si dhe legjislacionet e brendshme. Sipas KPP shtetasi i Kosovës nuk mundë të ekstradohet në rastet *kur shtetësinë e ka fituar pas kryerjes së veprës penale* . Po ashtu personi që e gëzon *të drejtën e azilit* apo të drejtën e *mbrojtjes të paraparë për refugjatë*.

*Shkaqet humanitare si pengesë për ekstradim* të cilat janë paraparë në Konventa evropiane dhe në të drejtën e brendshme të disa shteteve të cilat mundë të rezultojnë me

refuzimin e ekstradimit janë;mosha e shtyrë,sëmundja,mosha e miturisë,nëse personi ka jetuar gjatë në at shtet etj. Në KPP të Kosovës nuk janë paraparë këto shkaqe ,mirëpo meqë këto janë të parapara në konventa ndërkombëtare ,kjo nuk është pengesë për refuzimin e ekstradimit e personit në shtetin tjetër.

I kanë kontribuar numër i madh i kontratave bilaterale midis shteteve me të cilat rregullohet çështja e ekstradimit si dhe konventa evropiane që i dedikohet këtij instituti. Sipas Konventës Evropiane mbi ekstradimin është paraparë se kërkesa për ekstradim do të refuzohet për këto lloje të veprave penale ;

*1. Vepra penale politike*

*2. Vepra penale ushtarake*

*3. Vepra penale Financiare*

*4. Vepra penale të shtypit dhe*

*5. Veprat penale që ndiqen sipas padisë private.*

### **Procedura për ekstradimin e të pandehurve dhe personave të dënuar**

Procedura e ekstradimit është qeshje e rëndësishme për organet te cilat e aplikojnë këtë institut. Kjo procedure duhet te zhvillohet ne mënyre profesionale dhe ne baze te dispozitave te legjislacionit penal te shtetit dhe konventave ndërkombëtare. Veçmas kjo procedure është e rëndësishme për personin ndaj te cilit zbatohet, ngase kjo procedure implikon ne vete edhe kufizime serioze te lirive dhe te drejtave te njeriut, siç është marrja ne pyetje, paraburgimi etj. Zakonisht kërkesës për ekstradim si arsyetim duhet ti bashkëngjiten këto prova: *te dhëna për identitetin e te pandehurit apo te dënuarit (emri dhe mbiemri, fotografia, shenjat e gishtërinjve etj.), vendimin për caktimin e*

*paraburgimit, lëshimi i fletearrestit kur i pandehuri gjendet ne arrati apo ndonjë vendim tjetër i ngjashëm i gjykatës me te cilin janë ceke edhe provat për ekzistimin e dyshimit te bazuar kundër kryesit te caktuar te veprës penale.* Dispozitat juridike me te cilët rregullohet instituti i ekstradimit i kane përvetësuar dy sisteme te dorëzimit te kryesit te veprës penale (Salihu, 2003):

*-sistemin administrativ dhe*

*-sistemin e përzier*

**Sipas sistemit administrativ** i cili për një kohe te gjate ka qene dominant, arsyeshmërinë e kërkesës për ekstradim dhe vendim definitiv lidhur me dorëzimin e ka nxjerre organi administrativ i shtetit ku është gjetur kryesi i veprës penale. Po ashtu ky organ i ka nxjerre edhe te gjitha vendimet lidhur me zhvillimin e procedurës për ekstradim dhe sigurimin e pranisë se personit te kërkuar.

**Sipas sistemit te përzier** vlerësimi i arsyeshmërisë se kërkesës për ekstradim dhe zhvillimi i procedurës është ne kompetence te gjykatës, ndërsa vendimin definitiv, nëse do te lejohet ekstradimi, e nxjerr organi administrativ apo organi ekzekutiv-politik i shtetit. Ky sistem ne te drejtat e brendshme tani është me i përhapur ngase është ne pajtim me konceptin se vetëm gjykatat paraqesin organe me adekuate për mbrojtjen e te drejtave te njeriut.

Varësisht si janë te rregulluara raportet midis vendimeve te gjykatave dhe te organeve administrative lidhur me kërkesën për ekstradim ne te drejtën e tanishme njihen tri variante te sistemit te përzier.

**Sipas variantit te pare** vendimi i gjykatës për bazueshmërine e kërkesës për ekstradim, për organin administrativ ka vetëm karakter këshillëdhënës, kështu qe ky organ vendos lirisht për lejimin apo refuzimin e ekstradimit.

**Sipas variantit te dyte** është e përvetësuar e ashtuquajtura veto e gjykatës. Sipas këtij varianti nëse gjykata konstaton se kërkesa e shteti te huaj nuk është e bazuar, kjo e obligon organin administrativ dhe se këndejmi ky organ nuk mund ta lejoje ekstradimin.

**Sipas variantit te trete** lidhur me kërkesën për ekstradim vendos organi administrativ, mirëpo kundër vendimit te organit administrativ mund ti ushtrohet ankese gjykatës, kështu qe ne ketë variant definitivisht vendos gjykata.

Legjislacioni penal i Kosovës e ka përvetësuar sistemin e përzier i cili me tepër ka premisa te variantit te pare ngase për lejimin e ekstradimit vendimin e nxjerr organi administrativ, përkatësisht organi publik kompetent, ne ketë rast ministria e drejtësisë.

Me normat e se drejtës ndërkombëtare dhe me normat e kodit te procedurës penale te Kosovës, kryesisht janë te rregulluara këto çështje te procedurës se ekstradimit (Salihu, 2003):

*-mënyra e komunikimit midis shteteve*

*-privimi i përkohshëm i te pandehurit nga liria*

*-rasti i konkurrimit te kërkesave te shume shteteve*

*-çështja e transitit*

*-dorëzimi i sendeve te cilat janë marre nga i pandehuri dhe*

*-shpenzimet e ekstradimit*

### **Masat e ngjashme me ekstradimin**

Krahas ekstradimit aplikohen edhe disa masa nga ana e shteteve me te cilat ne një mënyre arrihet efekti i dorëzimit te personit shtetit tjetër. Këto masa ne legjislacionet penale te brendshme konsiderohen si lloje te sanksioneve penale, por te cilat ne fakt janë një lloj ekstradimi i fshehur apo forma te posaçme te ekstradimit. Si masa te këtilla te



ngjashme ne ekstradimin ne literaturën juridiko penale dhe ne praktike njihen:

***-ekstradimi i përkohshëm***

***-dëbimi i te huajit nga shteti dhe***

***-rrëmbimi***

**Me ekstradim te përkohshëm** nënkuptojmë dorëzimin e kryesit te veprës penale shtetit tjetër, me qëllim te zhvillimit te procedurës penale dhe pas përfundimit te procedurës, kthimin e tij ne shtetin i cili e ka ekstraduar.

**Dëbimi i te huajit nga shteti**-është mase e cila shqiptohet me vendim te organit kompetent, me aktgjykim te gjykatës apo me vendim te organit te policisë. Shteti ka te drejte ta përzëre nga territori i vet shtetasin e huaj apo personin pa shtetësi, i cili ne territorin e tij është me banim te përkohshëm apo te përhershëm. Qe te mund te shqiptohet kjo mase duhet te ekzistojnë shkaqe te caktuara, siç janë p.sh: veprimtaria armiqësore, hyrja ilegale, keqpërdorimi i vrazhde i mikpritjes dhe shkaqe te ngjashme.

**Rrëmbimi i personit**-situata te tilla janë kur personi rrëmbehet nga shteti ku është duke banuar apo ku haset dhe dërgohet ne shtetin tjetër, ne shtetin i cili është i interesuar ta dënoje. Rrëmbimin mund ta bëjnë zyrtaret e organeve shtetërore te vendit (prestaret e shërbimit sekret) te shtetit i cili është i interesuar ta dënoje atë person si dhe individët te cilët punojnë për llogari te shtetit te caktuar.

Ne doktrinën e se drejtës penale dhe ne përgjithësi ne atë juridike te gjitha mënyrat e rrëmbimit te personave dhe dërgimi i tyre ne shtetin tjetër, ne mënyre unanime konsiderohen si veprime te kundërligjshme me te cilat cenohet e drejta e brendshme dhe e drejta ndërkombëtare (Salihu, 2003).

#### **4.10. Transferi i procedurës penale shtetit te huaj**

Transferimi i procedurës penale shteti te huaj shprehet ne rastet kur shteti ne te cilin e ka kryer veprën penale personi i huaj, ndjekjen penale ia beson shtetit tjetër. Transferimi i procedurës penale i besohet shtetit, shtetasin e te cilit e ka kryesi i veprës penale apo shteti ku e ka vendbanimin e përhershëm. Me fjale te tjera transferimi shprehet ne rastet kur personi kryen një vepër penale ne një shtet ndërsa procedura penale dhe shqiptimi i dënimit behet ne shtetin ku kryesi e ka shtetësinë apo vendbanimin. Instituti i transferimit, cedimit te ndjekjes penale me te gjitha tiparet e tije bene pjese ne lëmin e se drejtës penale ndërkombëtare, përkatësisht ne segmentin e ndihmës juridiko-penale ndërkombëtare ne kuptimin e gjere. Transferi i ndjekjes penale behet ne baze te lutjes se shtetit ku është kryer vepra penale. Shteti i cili merr përsipër ndjekjen penale, procedurën penale e zhvillon sipas legjislacionit te vet. Procedura për transferimin e ndjekjes penale sipas lutjes se shtetit ku është kryer vepra penale apo shteti i cili dëshiron ta marr përsipër ndjekjen penale është relativisht e shpejte dhe nuk kërkon formalitete te mëdha. Kjo procedure realizohet nëpërmjet ministrisë se drejtësisë, apo nëse është përcaktuar me marrëveshje bilaterale realizohet drejtpërdrejte ne mes te organeve te gjyqësisë, ndërsa ne raste urgjente realizohet edhe nëpërmjet Interpolit.

Burimet juridike ndërkombëtare dhe nacionale ne baze te cilave behet transferi i procedurës penale janë:

***•konventa evropiane mbi transferimin e procedurës penale e nxjerre ne vitin 1972, përmes se cilës janë zgjidhur ne mënyrë parimore çështjet kryesore te transferimit te ndjekjes penale. Ne baze te kësaj konvente janë lidhur një mori kontratash bilaterale***

*midis shteteve me te cilat rregullohet ky institut.*

Qe te mund te behet transferimi i ndjekjes penale, sipas konventës se lartpërmendur duhet te përmbushen dy kushte te karakterit primar:

*a) qe personi i cili transferohet me qellim te ndjekjes penale te ketë vendqëndrim te përhershëm ne vendin ku transferohet, apo te ketë shtetësinë e atij vendi dhe*

*b) vepra te konsiderohet si vepër penale ne legjislacionet e te dy vendeve, pra te ekzistojë identiteti i normave*

Krahas konventës evropiane ne konsolidimin dhe masivizimin e institutit te transferimit te ndjekjes penale ka rendësi te posaçme edhe **marrëveshja-model** e aprovuar me rezolutën e asamblesë se përgjithshme te OKB-se.

*Transferi i procedurës penale sipas legjislacionit penal te Kosovës*-Ndjekja penale e personit te huaj mund ti transferohet juridiksionit, shtetit te huaj sipas kushteve te reciprocitetit. Pra kusht elementar për transferimin e ndjekjes penale është qe vepra penale te jete kryer nga personi i huaj ne territorin e Kosovës dhe qe te ekzistojë reciprociteti, qe edhe shteti ku transferohet i pandehuri te veproje njësojë ndaj Kosovës. Kusht tjetër i cili duhet te përmbushet është qe kryesi i veprës penale te gjendet ne territorin e Kosovës dhe se fundi qe te mund te behet transferimi i ndjekjes penale duhet qe kryesi i veprës penale te jete shtetas i huaj apo person pa shtetësi.

Instituti i transferimit te ndjekjes penale mund te aplikohet edhe ne raste kur vepra penale është kryer nga i huaji jashtë territorit te Kosovës, por kryesi gjendet ne Kosove, nëse sipas parimit universal te veprimit te legjislacionit penale, vepra e tille bën pjese ne pushtetin represiv te Kosovës (Salihu, 2003).

Vendimin për dorëzimin e lendes gjate procedurës paraprake e merr kolegji prej tre gjyqtarësh ne baze te propozimit te prokurorit publik. Transferimi i ndjekjes penale mund

te lejohet nga gjykatat tona për shtetasit e huaj te cilët ne territorin e Kosovës kane kryer vepra penale për te cilët është parapare dënimi me burgim deri ne 10 vjet, ndërsa për veprat penale kundër sigurisë se trafikut nuk është parapare kurrfarë kufizimi lidhur me dënimin.

*Parimet themelore lidhur me transferimin e procedurës penale*-Parimet te cilat duhet te respektohen qe te mund te behet transferimi i personit te pandehur janë:

*a) Vepra penale për te cilën akuzohet i pandehuri duhet te jete ekstradibile. Nga kjo rezulton se është i përjashtuar, nuk lejohet transferimi apo marrja përsipër e procedues për veprat për te cilat është i përjashtuar ekstradimi (p.sh veprat politike, ushtarake dhe fiskale).*

*b) Transferimi mund te behet vetëm ndaj shtetasve te huaj apo personave pa shtetësi.*

*c) Duhet te ekzistojë identiteti i normave. Përkatësisht vepra për te cilën kërkohet transferimi duhet te konsiderohet vepër penale si ne shtetin ku gjendet i pandehuri, ashtu edhe ne shtetin ne te cilin kërkohet te transferohet.*

*d) Duhet te respektohet parimi i legalitetit. Ky parim lidhur me transferimin do te thotë qe shteti ne te cilin transferohet i pandehuri mund ta zhvillojë procedurën penale vetëm për vepra penale te parapara ne legjislacionin e vet.*

#### **4.11. Njohja e aktgjykimeve penale te gjykatave te huaja te shteteve te huaja**

Njohja ndërkombëtare e aktgjykimit penal shprehet në rastet kur një person për veprën penale të kryer është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm në një shtet dhe ai aktgjykim njihet, pranohet në shtetin tjetër, i njihet efekti eksterritorial. Situata të tilla vijnë

në shprehje p.sh. (një shtetas kosovar kryen veprën penale në Gjermani dhe nga gjykata gjermane dënohet me aktgjykim të plotfuqishëm dhe më pas me lutjen e të dënuarit apo me kërkesën e organeve kompetente të Kosovës, Gjermania e dorëzon kosovarin që ta mbaj dënimin në vendin e vetë) (Salihu, 2003)

### **Parimi i imputit të dënimit të gjykatës së shtetit të huaj**

Me imput të dënimit të gjykatës së huaj nënkuptojmë llogaritjen e dënimit të cilën kryerësi e ka mbajtur në shtetin tjetër në llojin dhe masën e dënimit për të njëjtën veprë të shqiptuar nga gjykata vendore. Ky parim është paraparë për rastet kur nuk njihet aktgjykimi i huaj në shtetin tjetër, përkatësisht kur kryesi dënohet për të njëjtën veprë. Këtë parim e njeh edhe e drejta jonë penale, madje me një dimension e dhe me të gjerë, ngase përveç dënimit të mbajtur në juridiksionin tjetër, në dënimin e shqiptuar nga gjykata e Kosovës do të llogaritet edhe paraburgimi dhe heqja e lirisë gjatë procedurës së transferimit.

### **Ekzekutimi i aktgjykimit të huaj penal. Kushtet themelore të cilat duhet të përmbushen për ekzekutimin e aktgjykimit të gjykatës së shtetit të huaj**

Ekzekutimi i aktgjykimit të huaj penal është formë e bashkëpunimit ndërkombëtare në çështjet penale. Me këtë formë të bashkëpunimit nënkuptojmë rastet kur personi i dënuar në shtetin tjetër, dënimin e mbanë në shtetin e vet apo në shtetin ku e ka vendbanimin e përhershëm.

Ekzekutimi i aktgjykimit penal të shtetit tjetër behet në bazë të njohjes paraprake të aktgjykimit penal të huaj apo në bazë të konventës ndërkombëtare apo legjislacionit të brendshëm. Shkaqet më të rëndësishme lidhur me personin e dënuar të cilat e arsyetojnë ekzekutimin e aktgjykimit të huaj penal në vendin, përkatësisht në shtetin e vet

janë; mundësia që i dënuari të mbaj kontakte me familjen e vet, ekzekutimi i dënimit bëhet më human, në vendin e vetë janë gjasat më të mëdha për risocializimin e tij etj.

Kushtet themelore të cilat duhet të përmbushen me rastin e ekzekutimit të aktgjykimit penal të huaj kryesisht janë të ngjashme me kushtet të cilat kërkohen për ekstradim;

- **Identiteti i normave** (sipas këtij kushti që të mundë të ekzekutohet aktgjykimi i huaj penal, duhet që vepra për të cilën është dënuar personi, të parashihet si vepër penale në të dy shtetet, në shtetin ku është dënuar dhe në shtetin ku kërkohet të bëhet ekzekutimi i dënimit.

- **Reciprociteti** (ky kusht duhet të përmbushet në aspektin juridikë dhe në atë faktikë. Në aspektin juridikë reciprociteti konsiderohet se është përmbushur nëse në të drejtën e brendshme dhe në kontratat ndërkombëtare të shteteve është paraparë mundësia e ekzekutimit të aktgjykimit të huaj penal, ndërsa në aspektin faktikë, reciprociteti konsiderohet se është përmbushur nëse shteti që kërkon nga shteti tjetër ekzekutimin e aktgjykimit penal të gjykatave të tij, më parë në raste të ngjashme ka mundësuar ekzekutimin e aktgjykimeve të tilla penale) (Salihu, 2003)

- **Aktgjykimi penal duhet të jetë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm** (Që të mund të ekzekutohet aktgjykimi i huaj, ai sipas të drejtës së brendshme të shtetit ku është nxjerrë, përpos i plotfuqishëm, duhet të jetë edhe i ekzekutueshëm)

- *Dënimi nën minimumin e caktuar nuk mund të ekzekutohet në shtetin e huaj*

- *Shtetësia e të dënuarit*

- *Pëlqimi i të dënuarit*

- *Lloji i veprave penale apo situatat e caktuara si pengesë për transferimin e personit për ta mbajtur dënimin në shtetin tjetër*

*-Transferimi i mbikëqyrjes ndaj personave të dënuar me kusht apo të liruar me kusht*

#### **4.12. Ekzekutimi i urdhërimeve të tjera te gjykatës**

Realizimi në praktikë i efektivitetit të së drejtës penale në luftimin e kriminalitetit është i lidhur ngushtë me zbatimin e normave të Kodit të Procedurës Penale që përcakton rregullat në bazë të të cilave vepron sistemi i drejtësisë penale e të fillimit të procedimit penal (ndjekjes penale), të mbledhjes e verifikimit të provave, paraqitjes së akuzës nga prokurori në gjykatë të shqyrtimit gjyqësor dhe deri te marrja e vendimit gjyqësor përfundimtar i formës së prerë, si dhe ekzekutimi i tij.

Gjithashtu e drejta penale e kryen funksionin e saj për mbrojtjen e vlerave të rëndësishme individuale e shoqërore nga veprat penale, duke qenë e lidhur ngushtë edhe me penologjinë e të drejtën penitenciare. Penologjia ka për objekt studimi ekzekutimin e vendimeve penale, që shënon realizimin e plotë të drejtësisë penale, të funksioneve të sistemit të drejtësisë penale.

Pas vënies në ekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, fillon zbatimi i së drejtës penitenciare, e cila ka për objekt trajtimin e personave të dënuar me burgim apo me sanksione penale të tjera për ekzekutimin e dënimeve alternative dhe kontrollin e tyre nga Shërbimi i Provës, duke u vënë në zbatim normat e procedurës penale si dhe ligji i posaçëm (Salihu, 2003).

Në këndvështrimin institucional, ekzekutimi i vendimeve penale të formës së prerë është shumë i rëndësishëm, por dhe problematik, me shqetësimet që evidentohen herë pas here, si në kuadrin ligjor, ashtu dhe në praktikën e organeve të ngarkuara me urdhërimin,

vënien në ekzekutim dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, ç'ka është evidentuar në monitorimet, analizat dhe raportet e prokurorisë dhe institucioneve të tjera shtetërore, si dhe të organizatave jofitimprurëse në këtë fushë. Problemi më i mprehtë që del nga anketimi, është mosekzekutimi i vendimeve gjyqësorë të formës së prerë në të cilat debitorë janë institucionet buxhetore. Kjo është dhe pika më e dobët dhe e vështirë e tërë sistemit përmbartimor në marrëdhëniet procedurale-civile që krijohen me segmente të veçanta të administratës publike, të cilat në kundërshtim të plotë me frymën e ligjit nuk pranojnë ose hezitojnë t'i ekzekutojë vullnetarisht urdhërimet e gjykatave.

Në kuptimin material ,me ekzekutim të vendimeve penale do të kuptojmë: Zbatimi i urdhërimeve që përmban vendimi i formës së prerë dhe i vendimeve që sipas kodit të procedues penale ,kanë ekzekutim të menjëhershëm.

#### **4.13. Ekzekutimi i vendimeve që nuk kanë marr forme te prerë**

Në kuadër të sistemit të normave juridike me të cilat rregullohet realizimi i kërkesave penale-juridike të lindura me kryerjen e veprës penale, vërehen tri degë të së drejtës:-e drejta penale (e drejta materiale penale apo e drejta penale në kuptimin e ngushtë të fjalës);- e drejta e procedurës penale (e drejta e procedurës penale apo formale penale); dhe- e drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale (e drejta e ekzekutive penale). E drejta penale, e drejta e procedurës penale dhe e drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale-juridike janë pjesë e së drejtës penale në kuptimin e gjerë të fjalës. Studimi i konceptit të procedurës penale mbështetet në definimi e procedurës penale si në aspektin e veprimeve procedurale penale të cilat ndërmerren me qëllim të ndriçimit të veprës penale dhe zbulimit të kryesit të saj, ashtu edhe duke u nisur nga marrëdhëniet procedurale



penale të cilat zhvillohen ndërmjet subjekteve të procedurës penale.

Përmes formës së prerë vendimi gjyqësor merr përmbajtjen përfundimtare, kurse procedura penale përfundimin final. Plotfuqishmëria formale do të thotë se vendimi i gjykatës nuk mund të atakohet me mjete të rregullta juridike. Plotfuqishmëria materiale do të thotë pamundësi e zhvillimit të procedurës së re penale për të njëjtën vepër penale. Në procedurën penale të dy llojet e cekura të plotfuqishmërisë vijnë në të njëjtin moment. Forma e prerë apo plotfuqishmëria arrijnë vetëm në aspektin e shprehjes apo diapozitivit të aktgjykimit, respektivisht aktvendimit, derisa arsytimi nuk hynë në fuqinë ligjore. Me dispozitat juridike duhet të rregullohet dhe sigurohet që vendimi gjyqësor i nxjerrë në procedurën penale të ekzekutohet kur për këtë të plotësohen kushtet ligjore. Me fjalë tjera procedura penale është e drejtuar në nxjerrjen e llojeve të ndryshme të vendimeve, sidomos të aktgjykimit me hyrjen në fuqi e të cilit kuptohet se ngjarja konkrete penale është zgjedhur në mënyrë përfundimtare. Në aspektin e ekzekutimit ai paraqet realizimin e kërkesës penale juridike të përcaktuar gjatë gjykimit dhe përmbajtur në vendimin e plotfuqishëm gjyqësor, gjegjësisht realizimin e vendimit i cili është nxjerrë gjatë procedurës penal. Forma e prerë dhe ekzekutueshmëria sipas rregullit vijnë në të njëjtën kohë. Aktvendimi gjyqësor nuk mund të ekzekutohet para se të hyjë në fuqi. Ligji procedural parasheh kushtet e caktuara për ekzekutueshmërinë e vendimeve ashtu që aktgjykimi ekzekutohet: kur ai është i formës së prerë; i dërguar si i tillë; kur për ekzekutimin e tij nuk ekzistojnë pengesa ligjore (Neni 135, par. 2).

Aktvendimi, sipas rregullit ekzekutohet kur të ketë hyrë në fuqi. Ndërkaq, aktvendimi mund të ekzekutohet edhe para marrjes së klauzolës së formës së prerë nëse është rregulluar kështu, në mënyrë eksplicite me ligj, (caktimi i paraburgimit).

Ekzekutimi i urdhëresës fillon menjëherë pas nxjerrjes së saj, nëse organi që e lëshon

atë nuk e cakton ndryshe (neni 138. par. 1).

### ***Në përgjithësi për mjetet juridike***

Aktgjykimi duhet të jetë në pikëpamje të gjendjes faktike- i drejtë, kurse në raport me zbatimin e të drejtës penale materiale dhe procedurale-ligjor. Mirëpo, edhe përkundër normave ligjore për zhvillimin e procedurës penale, është e mundur që gjykata ta marrë vendimin i cili nuk është i drejtë apo ligjor. Për tu penguar që vendimi i tillë të mos prodhoj pasoja juridike, shfrytëzohet mjete juridik.

**Mjeti juridik është mjet i këtij lloji me të cilin palët dhe personat tjerë të autorizuar e thyjnë vendimit e nxjerrë në procedurën penale me qëllim që ai të ndryshohet apo të abrogohet** (Grubaq, 2006: 429.; Pavishiq, 2005: 439.)

Nga sa u cek mund të përfundohet se rëndësia e mjeteve juridike është evitimi i veprimit juridik të vendimeve gjyqësore të padrejta dhe kundërligjore, gjegjësisht marrja e vendimeve gjyqësore të drejta dhe ligjore. Të drejtën e shfrytëzimin të mjetit të caktuar juridik e njohin edhe dokumentet ndërkombëtare duke paraparë që çdo njëri të ketë të drejtë në mjetin efikas juridik kundër vendimit të gjykatës (Neni 2. par. 3, pika a e PNDPCP, dhe Neni 2. par. 1. i Protokollit 7 të KEDNJ). Në këtë kuptim çdo njëri i gjykuar nga gjykata për vepër penale ka të drejtë të kërkoj nga gjykata më e lartë rishqyrtimin e dënimit apo aktgjykimit të tij. Me këtë e drejta për parashtrimin e mjetit juridik është e pandashme nga e drejta për gjykim të drejtë (H., Sijerçiq-Çoliq, M. Hadžiomeragiq, M. Jurçeviq,, D. Kaurinoviq, M. Simoviq, 2005: 756)

Teoria e të drejtës së procedurës penale e njeh ndarjen e mjeteve juridike në:

#### ***1. Mjete të rregullta dhe***

## *2. mjete të jashtëzakonshme juridike*

Me mjet të rregullt juridik hedhet poshtë vendimi i cili ende nuk ka marrë formën e prerë, dhe qëllimi i tij është rishqyrtimi i korrektësisë së vendimit gjyqësor para formës së tij të prerë.

Me mjete të jashtëzakonshme juridike thyhen vendimet e formës së prerë.

Mjetet e jashtëzakonshme juridike shfrytëzohen në masë të kufizuar dhe me përjashtime kundër vendimeve gjyqësore të cilat tashmë kanë marrë formën e prerë. Sipas KPPPK, mjetet e rregullta juridike janë: ankesa lidhur me aktgjykimin e shkallës së parë; ankesa lidhur me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe ankesa kundër aktvendimit.

Kurse mjetet e jashtëzakonshme juridike janë: rishikimi i procedurës penale; zbutja e jashtëzakonshme e dënimit; kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

*-Mjetet juridike suspensive dhe jo suspensive*, mjeti juridik suspensiv e shtynë ekzekutimin e vendimit të kundërshtuar. Mjeti juridik jo suspensiv nuk e shtynë ekzekutimin e vendimit. Sipas rregullit, mjetet juridike të rregullta janë suspensive, kurse mjetet juridike të jashtëzakonshme janë jo suspensive.

*-mjetet juridike devolutive dhe jo devolutive*, mjeti juridik jo devolutiv ka për pasojë se me rastin e mjetit juridik në çështjen penale gjykohet para gjykatës më të lartë e jo para asaj gjykate e cila e ka marrë vendimin tashmë të kundërshtuar. Mjet juridik jo devolutiv është ai për të cilin vendos e njëjta gjykatë e cila edhe e ka marrë vendimin i cili kundërshtohet.

*-mjetet juridike të plota dhe jo të plota*, mjeti juridik i plotë mund të deklarohej nga të gjitha bazat ligjore, kurse mjeti juridik jo i plotë vetëm nga disa baza. Mjetet juridike të rregullta sipas rregullit janë të plota, kurse mjeti juridik i jashtëzakonshëm është jo i

plotë.

Procedura për mjet juridik për nga natyra e saj është fakultative, e jo obligative. Në të vërtetë, pasi të ketë përfunduar procedura e shkallës së parë me vendim gjyqësor, gjykimi për çështjen e caktuar penale është e mundur të vazhdohet vetëm në bazë të përdorimit të mjetit juridik nga ana e subjektit të autorizuar. Të gjitha vendimet e gjykatës të marra në shkallën e parë nuk rishqyrtohen, madje as me kërkesë ex officio të gjykatës por vetëm sipas kërkesës së personave të autorizuar.

#### **4.14. Ekzekutimi i masave mjekësore**

Në aspektin teorik, prej vitesh janë bërë diskutime të ndryshme, rreth pyetjes nëse moszbatimi pa shkaqe ligjore i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duhet trajtuar si aspekt i procesit të parregullt gjyqësor? Megjithëse janë shfaqur mendime të ndryshme, deri më sot edhe në këtë plan, ky problem nuk ka marrë një përgjigje të zyrtarizuar institucionale. Në një aspekt tjetër, në praktikën gjyqësore moszbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, është evidentuar si një shqetësim shumë i madh, që duket se del tej kufijve të kompetencave të organeve që duhet të merren me zbatimin e këtij detyrimi ligjor, sepse aktualisht në vendin tonë numërohen mijëra vendime të pazbatuara, pa shkaqe të përlegjura ligjore.

Ekzekutimi i vendimit, përbën një element thelbësor të konceptit të shtetit ligjor e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë” dhe se “asnjë organ shtetëror nuk mund të verë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror, detyrohet të marrë masat përkatëse, për zbatimin e tyre.

Në veçanti qenësore edhe sa i përket standardeve Evropiane konsistojnë masat

mjekësore.

Masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepër penale, ndërsa masat edukuese mund të jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale.

Masat mjekësore janë:

1. Mjekimi i detyruar ambulator
2. Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor

Vendimi gjyqësor për masat mjekësore dhe edukuese është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken rrethanat për të cilat ai është dhënë, por në çdo rast, gjykata, kryesisht, është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj (Ligji, Nr.7895).

Masa mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohet në institucionin mjekësor të specializuar sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë mbi kërkesën e prokurorit. Me urdhrin e ekzekutimit, dërgimi në institucion i të dënuarit të arrestuar bëhet nga organi ku është mbajtur i dënuari, dhe kur është i lirë, nga policia e shtetit.

Masa mjekësore me mjekim të detyruar ambulator ekzekutohet në institucionet mjekësore të vendbanimit të të detyruarit. Kur në to nuk ka specialistë përkatës, shoqërohet në çdo rast nga këto institucione në rrethin më të afërt ku ka të tillë. Kur në ekzekutim të kësaj mase sillen pengesa nga i detyruari, prokurori urdhëron ekzekutimin e detyruar nga Policia e Shtetit dhe, kur është vendi, i paraqet kërkesë gjykatës për ndryshimin e masës në mjekim të detyruar në një institucion mjekësor (Ligji, Nr.8331, datë 21.4.1998).

Ne te gjitha studimet dhe rekomandimet e specialisteve ne rang botëror, rezulton se mjekimi i detyruar ne institucionin mjekësor rekomandohet për aq kohe sa komisioni mjekoligjor e sheh te arsyeshëm, sepse izolimi dhe institucionalizimi shkakton me shume dem se dobi ne raport me mjekimin ne komunitet (GJYKATA E APELIT TIRANE, KOLEGJI PENAL, Vendimi Nr. 517 Akti, Nr. 330). Dhe ashtu siç është raportuar nga Avokati i Popullit ([http://www.parlament.al/web/pub/ligjet\\_20\\_11\\_2013\\_14414\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/ligjet_20_11_2013_14414_1.pdf):5), aktualisht mbi 100 të dënuar me sëmundje mendore janë të mbyllur në spitalin e burgut në vend që të marrin trajtimin e detyruar mjekësor të parashikuar nga neni 46 KPSH në struktura të posaçme (Neni 46 KPSH). Edhe pse kjo situatë është e diktuar nga një mungesë objektive e infrastrukturës (ECHR, Dybeku v. Albania, 2007), problemi i shkeljes sistematike dhe në mënyrë të vazhdueshme i të drejtave të njeriut nga ana e Shtetit, veçanërisht e asaj për të qenë i lirë dhe i sigurt së bashku me të drejtën për të mos iu nënshtruar torturës dhe trajtimeve çnjerëzore e degraduese, është haptazi i dukshëm siç vëren edhe Avokati i Popullit. Ligji “Mbi shëndetin mendor” përcakton se trajtimi i rezervuar të dënuarve me sëmundje mendore duhet të jetë i njëjtë si ai i rezervuar pacientëve që marrin trajtim psikiatrik (Neni 28 L. 44/2014). Në po këtë ligj parashikohet edhe mundësia që këto persona të trajtohen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, por kjo është vetëm në kuadrin e një mase të përkohshme siç sqarohet në projekt-ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998, —Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve, të ndryshuar.”. Trajtimi psikiatrik brenda reparteve të posaçme të burgjeve është i mundur vetëm për aq kohë sa Gjykata e ka të nevojshme për të vendosur mbi mjekimin e detyruar në institucione të posaçme siç parashikohet në Ligjin “Mbi shëndetin mendor”.

Masat e mjekimit të detyrueshëm edhe në Republikën e Kosovës është i rregulluar me ligj, kjo sipas nenit 76 të Ligjit të përkohshëm penal të Kosovës, veprimet e përcaktimit të masës së mjekimit të detyrueshëm psikiatrik të kryerësit që mentalisht është i papërgjegjshëm ose i cili ka aftësinë e zvogëluar mentale, do të përcaktohen në mënyrë të veçantë me ligj. Së këndejmi, në kaptinën mbi masat e mjekimit të detyrueshëm është përcaktuar vetëm masa e mjekimit të vartësve nga droga ose alkooli.

Mjekimi i detyrueshëm rehabilitues i vartësve nga droga dhe alkooli, kjo masë mund t'i shqiptohet kryerësit që e ka kryer veprën penale nën ndikimin e drogës ose të alkoolit, nëse konstatohet se faktori kryesor që ka ndikuar në kryerjen e veprës penale ka qenë i lidhur me varësinë e tij nga droga ose alkooli dhe nëse ekzistojnë gjasat për mjekimin e tij të suksesshëm (neni 77 i LP të Kosovës). Gjykata këtë masë mund t'ia shqiptojë kryerësit të veprës penale nëse janë plotësuar këto kushte:

1) Vepra penale duhet të jetë kryer nën veprimin vendimtar të varësisë nga alkooli ose narkotikët. Do të thotë, duhet të bëhet fjalë për kryerësin tek i cili ekziston gjendja e varësisë ndaj përdorimit të alkoolit ose të narkotikëve. Këta janë personat që në mënyrë permanente ndiejnë nevojën për konsumimin e alkoolit ose të narkotikëve dhe të cilët, edhe pse të vetëdijshëm për pasojat e dëmshme që paraqiten në këtë rast, nuk janë në gjendje t'i shmangen këtij përdorimi. Midis kryerësit të veprës penale dhe të kësaj varësie duhet të ekzistojë lidhja shkakore;

2) Kjo masë ka karakter suplementar, prandaj shqiptohet vetëm nëse kryerësit i është dhënë dënimi, vërejtja gjyqësore ose lirimi nga dënimi.

Këto kushte janë caktuar në mënyrë kumulative. Edhe kur ato plotësohen gjykata mundet, por nuk është e domosdoshme, të shqiptojë masën e sigurisë së mjekimit të

detyrueshëm nga varësia. Pra, shqiptimi i kësaj mase është gjithëherë fakultativ edhe pse natyrës dhe përmbajtjes së masës dhe qëllimit të saj që duhet të realizojë (siç thotë emërtimi) më tepër do t'i përgjigjej shqiptimi i saj i detyrueshëm nëse janë plotësuar kushtet e caktuara me ligj.

Mosharmonizimi midis obligueshmërisë në titullin e masës dhe të anës fakultative të shqiptimit të saj arsyetohet në mënyra të ndryshme, nga të cilat për ne është e pranueshme ajo që ka të bëjë me mungesën e enteve për mjekim.

Nëse kjo masë është shqiptuar së bashku me dënimin me gjobë, me vërejtjen gjyqësore ose me lirimin nga dënimi, gjykata mund të vendosë, me pëlqimin e të dënuarit, që masa të ekzekutohet në liri. Nëse kryerësi nuk i nënshtrohet trajtimit në liri pa arsye ose nëse arbitrarisht e ndërprente trajtimin, gjykata mund të urdhërojë që trajtimi të zbatohet në entin shëndetësor (neni 77 alineja 2 e LP të Kosovës).

Nëse mjekimi i detyrueshëm rehabilitues nga droga ose alkooli është shqiptuar bashkë me dënimin me burgim, mund të zgjasë deri në skadimin e dënimit. Ndërkaq, nëse është shqiptuar bashkë me dënimin me gjobë, me vërejtjen gjyqësore ose me lirimin nga dënimi, trajtimi nuk mund të zgjasë më gjatë se dy vjet. Ndërkaq, gjykata duhet që në çdo dy muaj të rishqyrtojë ekzekutimin e kësaj mase në mënyrë që të konstatojë se a është e nevojshme që ajo të vazhdohet.

#### **4.15. Roli i Gjykatave dhe Prokurorisë në ekzekutimin e sanksioneve penale**

Gjykata e kryen funksionin gjyqësor si një nga funksionet esenciale të shoqërisë së organizuar njerëzore.

Funksioni gjyqësor reflektohet në zbatimin e sistemit të caktuar të normave juridike



mbi marrëdhëniet konkrete shoqërore. Duke zbatuar sistemin e caktuar të normave juridike mbi marrëdhëniet konkrete shoqërore, gjykata shqyrton kundërthëniet në shoqëri dhe zgjidh konfliktin e interesave përmes prizmës së kontesteve gjyqësore.

Funksioni themelor i gjykatës në procedurën penale është që ajo si organ i pavarur dhe i paanshëm në procedurën e paraparë me ligj të vendos se a ka kryer vepër penale i pandehuri dhe ta zbatoj të drejtën pozitive penale. Për funksionin gjyqësor në procedurën penale të Kosovës, janë kompetente gjykatat e rregullta: gjykatat komunale, gjykatat e qarkut dhe Gjykata Supreme e Kosovës. Gjykatat themelohen me ligj dhe sipas ligjit përcaktohen kompetencat, struktura dhe organizimi i tyre si dhe procedura në mënyrë që të sigurohet barazia në procedurë dhe parimi i së drejtës si njëri nga parimet themelore në procedurë para gjykatës („Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 21/1978, ndryshimet dhe plotësimet, „Gazeta Zyrtare e KSAK“, nr. 2/1989).

#### *Parimet e kryerjes së funksionit gjyqësor*

Parimet themelore në të cilat bazohet organizimi dhe veprimtaria e gjykatave ushtrojnë ndikim të drejtpërdrejtë në realizimin e funksionit gjyqësor. Në këtë kuptim rëndësi të posaçme ka parimi: i pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore; ligjshmërisë; i emërimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve; kolegjalitetit dhe shumë shkallshmërisë.

#### *Parimi i paanshmërisë dhe pavarësisë gjyqësore:*

KEDNJ parasheh që secili ka të drejtë që për aktakuzën e drejtuar kundër tij të kërkoj që të vendosë gjykata e paanshme dhe e pavarur (neni 6. par. 1)<sup>13</sup>. Nga pozita juridike e

---

<sup>13</sup> GJEDNJ, me rastin e vendimit se a është ndonjë gjykatë e pavarur apo jo, merr në shqyrtim si vijon: a) mënyrën e emërimit të gjyqtarëve; b) kohëzgjatjen e mandatit; c) garancitë kundër presionit të jashtëm; d) atë se gjykata e caktuar, a len përshtypjen e gjykatës së pavarur. Shih psh: Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar (1984.). Gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë i emëron PSSP të KB me propozim të

gjqtarit, profesionalizmi i tij dhe “pjekuria morale”, si kushte themelore të paanshmërisë së tij, varet se si do të realizohet në praktikë pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës penale;

*-Parimi i ligjshmërisë:*

Ky parim është në lidhje të ngushtë me parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës. Në të vërtetë gjykatat janë të detyruara të gjykojnë në bazë të ligjit. Në këtë kuptim, gjyqtarët gjykojnë vetëm sipas bindjes së tyre të lirë gjyqësore të bazuar në dispozitat ligjore;

*-Parimi i emërimit dhe shkarkimit:* Ky parim përfshinë kushtet për përzgjedhjen e kandidatëve në funksionin gjyqësor, emërimin, avancimin në shërbim dhe ndërprerjen e titullit të gjyqtarit. Në pajtim me këtë parim, për të gjitha çështjet e përmendura duhet të vendosë organi i cili është i pavarur nga pushteti ekzekutiv apo pushteti legjislativ, në bazë të ligjit dhe në kuadër të procedurës së paraparë me ligj.<sup>34</sup>;

*-Parimi i kolegjalitetit:* Ky parim ka të bëjë me organizimin e brendshëm të gjykatës dhe mendrën e punës së gjykatës. Sipas këtij parimi gjykata komunale gjykon në trupin gjykues të përbërë nga një gjyqtarë dhe dy gjyqtarë porotë. Gjykata e Qarkut gjykon në trup gjykues të përbërë nga një gjyqtarë dhe dy gjyqtarë porotë, gjegjësisht për veprat e rënda penale në trup gjykues të përbërë nga dy gjyqtarë dhe tre gjyqtarë porotë. Në shkallën e dytë gjykon nga tre, pesë gjyqtarë, kurse në shkallën e tretë gjykon kolegji gjykues i përbërë nga tre, gjegjësisht pesë anëtarë (gjyqtarë profesionist). Me këtë parim është paraparë edhe përjashtimi për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burg deri në tri vjet apo gjoba me të holla si dënim kryesor meqenëse për ato vepra penale gjykon gjyqtari individual në gjykatën komunale (neni 22,24,26).

*-Parimi i shumëshkallshmërisë:* Ky parim nënkupton atë që për një çështje penale

---

Këshillit (Neni 5. Rregullorja UNMIK-a 2001/28).

vendosin shumë gjykata, do të thotë gjykata të ulëta dhe të larta (në procedurë sipas ankesës).

Nëse gjykata në territorin e së cilës i pandehuri e ka vendbanimin e përhershëm apo të përkohshëm tashmë e ka filluar procedurën, atëherë ajo gjykatë është kompetente, dhe pse është kuptuar për vendin e kryerjes së veprës penale (Neni 30, par. 1-2). Nëse nuk është i njohur vendi i kryerjes së veprës penale, as vendbanimi i përhershëm apo i përkohshëm i të pandehurit, ose që të dy janë jashtë territorit të Kosovës, atëherë kompetente është gjykata në territorin e së cilës *i pandehuri është arrestuar apo i është dorëzuar vet organeve të rendit* (Neni 30, par. 3).

Koneksiteti paraqet lidhjen e cila ekziston midis një apo më shumë objekteve. Koneksiteti mund të jetë subjektiv, objektiv dhe i përzier apo subjektiv-objektiv. Koneksiteti subjektiv ekziston atëherë kur një person ka kryer shumë vepra penale. Koneksitetin objektiv e kemi atëherë kur në kryerjen e një vepre penale kanë marrë pjesë shumë persona apo në mënyrë tjetër, janë të kanë lidhje të drejtpërdrejt me veprën e kryer penale (bashkëpjesëmarrje). Koneksiteti i përzier ekziston në atëherë kur shumë persona janë akuzuar për shumë vepra penale, kurse midis veprave të kryera penale njëkohësisht ekziston lidhje dhe prova të njëjta.

*Paditësi i autorizuar në procedurën penale.*

Në pajtim me parimin akuzator, funksioni i ndjekjes penale i është besuar paditësit të autorizuar. Paditësi i autorizuar kërkon nga gjykata që në procedurën penale ta vërtetoj se a është kryer vepra penale; personi i akuzuar a është kryesi i asaj vepre; a është përgjegjës penalisht dhe a mund të zbatohen ndaj tij sanksionet penale. Veprimtaria procedurale e paditësit të autorizuar me të cilën ai nga gjykata kërkon konstatimin e ekzistimit të kërkesës penale juridike në rastin konkret, në literaturë quhet akuzë penale.

Në këtë kuptim, akuza penale është aktivitet procedural i paditësit të autorizuar e cila ka të bëjë me veprimet e llojllojshme procedurale, me të cilat nga gjykata kërkohet që në procedurën penale të konstatojë ekzistimin e kallëzimit penal-juridik dhe varësisht nga rezultati i këtij konstatimi, ndaj personit të akuzuar të zbatohen sanksionet gjegjëse penale (Grubaç, 2006: 134. – 135.; H.I. Sijerçiq-Çoliq, 2005, fq. 161).

Funksioni i ndjekjes penale është i vendosur para së gjithash si funksion publik i cili realizohet në interesin publik, pra ndjekja penale realizohet sipas detyrës zyrtare nga ana e prokurorit publik. Krahas veprave penale që ndjekjen sipas detyrës zyrtare, ekzistojnë vepra penale ndjekja e të cilave është e lidhur për propozimin e të dëmtuarit. Ajo që është specifike për ato vepra penale është se funksionin e ndjekjes penale e ushtron prokurori publik pasi që i dëmtuari të ketë paraqitur propozimin e tillë. Gjithashtu ekzistojnë edhe vepra penale të cilat mund të ndjekjen sipas padisë private dhe në rastin e tyre si paditë paraqitet paditësi privat.

Në aspektin e veprave penale të cilat ndjekjen sipas detyrave zyrtare KPPPK krahas prokurorit publik pranohet edhe i dëmtuari si paditës (paditës subsidiar), i cili realizon ndjekjen penale në rastet kur prokurori publik nuk fillon ndjekjen penale.

#### *Organizimi i prokurorisë dhe parimet specifike*

Organizimi i prokurorisë në Kosovë, është i rregulluar me Ligjin Mbi Prokurorinë dhe i është përshtatur organizimit të gjykatave „ (Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 32/1976, ndryshimet dhe plotësimet nr. 42/1977, 44/1982. i 44/1984). Me këtë ligj janë themeluar: Prokuroria Komunale, Prokuroria e Qarkut, dhe ajo e Kosovës. Si gjyqtarët ashtu edhe prokurorët në Kosovë i emëron PSSP-ja (Neni. 5. Rregullorja e UNMIK-ut 2001/28).

Rregullimi i prokurorisë është i bazuar në parimet e caktuara siç janë:

*Parimi i bashkimit të prokurorisë:* Sipas këtij parimi prokuroria është e ngritur në parimin e bashkimit organizativ, sepse gjitha prokuroritë së bashku e formojnë unitetin organizativ në të cilin prokuroritë më të ulëta i nënshtrohen prokurorisë më të lartë;

*Parimi i ligjshmërisë:* Çdo prokurori sipas këtij parimi e ushtron funksionin e vet në bazë të dispozitave gjegjëse ligjore. Prokuroria domosdo ndërmerr ndjekjen penale sa herë që plotësohen kushtet ligjore, do të thotë kur ekzistojnë provat se është kryer vepra penale (parimi i legalitetit të ndjekjes penale).

*Parimi i rregullimit monokrat:* Sipas këtij parimi vetëm një person, kurse ky person është prokurori kryesor, e përfaqëson prokurorinë dhe e drejton punën e saj. Ky parim ka të bëjë me mënyrën dhe formën e ushtrimit të funksionit të ndjekjes penale nga ana e atij prokurori i cili gjendet në krye të organizatës së caktuar të prokurorisë. Prokurori i cili gjendet në krye të prokurorisë, funksionin e ndjekjes penale mund ta ushtroj drejtpërdrejt vet ose ato aktivitete ja delegon ose ja beson prokurorëve tjerë në prokurorinë në krye të së cilës gjendet. Me këtë rast ai atyre mund t'u jap udhëzimet e nevojshme për t'i kryer ato punë ashtu që prokurorët gjatë aktivitetit të tyre realizimin e funksionit të ndjekjes e ushtrojnë vet për ushtrimin ligjor të punëve dhe detyrave;

*Parimi i rregullimit hierarkik:* Ky parim nënkupton subordinimin e prokurorive më të ulëta ndaj atyre më të larta, gjegjësisht nënshttrimin e prokurorisë më të lartë asaj më të ulëtës. Parimi i rregullimit hierarkik aplikohet edhe brenda prokurorisë konkrete. Pra, prokurori i cili gjendet në krye të prokurorisë konkrete udhëheqë me punën e tij, bënë ndarjen e punëve brenda saj, mund të ndërmerr edhe kryerjen e punëve të caktuara në atë mënyrë që i kryen ato në vend të prokurorit të caktuar apo që ato punë ia beson prokuroritë tjetër në atë prokurori. Ndërkaq, krahas parimit të hierarkisë së brendshme dhe vendosjes

monokratike, sipas ligjit, çdo prokuror edhe pa autorizim të posaçëm mund të ndërmerr çfarëdo veprimi në procedurën para gjykatës apo organit tjetër shtetëror, të cilën punë do të mund ta kishte marrë prokurori kryesor.

Veprimi i ndërmarr në procedurë nga cilido anëtar i prokurorisë e obligon prokurorin në tërësi, madje edhe atëherë kur është ndërmarr në kundërshtim me udhëzimin e prokurorit kryesor. Prandaj, për procedurë prokurorit nuk i duhet autorizimi, sepse gjykata nuk e verifikon se a ka vepruar prokurori në pajtim me udhëzimin, kurse gjatë procedurës prokurorët mund të ndërrohen. Lidhur me sa u tha ka të bëjë edhe dhënia e udhëzimeve të detyrueshme. Udhëzimet kanë karakter intern dhe e obligojnë atë prokurorë të cilit i jepen ato; pra, ato nuk e udhëzojnë edhe gjykatën, sepse për gjykatën është meritore deklarata, gjegjësisht veprimi i prokurorit i ndërmarr në procedurë pa marrë parasysh se a është në pajtim me udhëzimin e dhënë apo jo;

*Parimi i devolucionit:* Ky parim nënkupton të drejtën e prokurorit më të lartë që të ndërmerr dhe drejtpërsëdrejti t'i kryejë punët nga kompetenca e prokurorit më të ulët (p.sh. prokurori kryesor i Prokurorisë së Qarkut, mund të ndërmerr ndjekjen penale në vend të Prokurorit Komunal dhe në ndonjë rast të procedurës konkrete penale ta kryej atë para gjykatës komunale kompetente);

*Parimi i substitucionit:* Ky parim nënkupton të drejtën e prokurorit të rangut më të lartë që përfaqësimin e caktuar apo ndërmarrjen e veprimeve procedurale në ndonjë lëndë ta përjashtojë nga kompetenca e prokurorit kompetent të rangut më të ulët, dhe atë t'ia besojë prokurorit tjetër kompetent.

#### 4.16. Roli i gjykatës në ekzekutimin e vendimeve penale

Një vendim gjyqësor i formës së prerë mbetet abstrakt nëse nuk e konkretizohet në jetë me përmbushjen e detyrimit nga i dënuari, për këtë arsye etapa e fundit e një procesi gjyqësor, ekzekutimi i vendimit penal bëhet akoma më i rëndësishëm. Sipas raportit të veçantë të Avokatit të Popullit “ Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë” të vitit 2012: *“Numri i ankesave të qytetarëve drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit për të ndërhyrë pranë autoriteteve përgjegjëse për të realizuar të drejtën e tyre të fituar gjyqësish, vazhdon të rritet. Bashkë me numrin e ankesave për këtë objekt, rritet dhe fatura financiare e shtetit për detyrimet që ky i fundit (në rastet kur është debitor) i ka individëve gjyqfitues.”* ([http://www.parlament.al/web/pub/2012\\_raporti\\_per\\_vendimet\\_gjyqesore\\_15413\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/2012_raporti_per_vendimet_gjyqesore_15413_1.pdf))

Sipas nenit 142 § 3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (1998) organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore. Ky detyrim i organeve shtetërore për ekzekutimin e vendimeve penale parashikohet edhe në nenin 2 § 1 i Kodit të Procedurës duke shtrirë rrethin e subjekteve në ekzekutim edhe tek subjektet të tjera si gjykatat, prokurori, i pandehuri, mbrojtësi i tij, paditësi, i padituri civil, oficeri dhe agjenti i policisë gjyqësore, zyrat vendore të shërbimit të provës, shërbimi përmbarimor etj. apo edhe çdo person juridik dhe shtetas shqiptar.

Akti më i rëndësishëm juridik që parashikon ekzekutimin e vendimeve penale është Kodi i Procedurës Penale, parashikohet në Titullin IX dhe ndahet në katër krerë:

I. Vënia në ekzekutim të vendimeve, nenet 462 – 469 ;

II. Shqyrtimi nga gjykata i çështjeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve, nenet 470- 480;

III. Gjendja gjyqësore, nenet 481-484 ;

IV. Shpenzimet procedurale, nenet 485-487.

Ndërsa në mënyrë të posaçme ekzekutimi i vendimeve penale rregullohet edhe nga ligje si : ligji nr. 8331 datë 21/04/1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale ” i ndryshuar, ligji nr. 8328 datë 16/04/1998 “ Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve ”i ndryshuar, ligjin nr. 10494 datë 22/12/2011 “ Për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”, ligji nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor ” etj (<http://www.ligjet.org.>). dhe akte të tjera normative të dala në zbatim të këtyre ligjeve.

Me ekzekutim të vendimit penal sipas nenit 2 të ligjit nr. 8331/1998 kuptohet :  
*“Zbatimi i urdhërimeve që përmban vendimi penal i formës së prerë dhe i vendimeve që sipas Kodit të Procedurës Penale, kanë ekzekutimi të menjëhershëm, me synimin e riedukimit të të dënuarve, të rivendosjes së të drejtave të personave të proceduar padrejtësisht dhe të drejtave të subjekteve juridike të cenuara nga vepra penale, duke ndikuar në parandalimin e tyre. ”*

Pra qëllimi i ekzekutimit të vendimit penal përkon me vetë qëllimin e dënimit penal atë të riedukimit dhe parandalimit të autorit të veprës penale dhe po ashtu nëpërmjet ekzekutimit të vendimit penal rivendosen në vend të drejtat e personave që janë cenuar nga vepra penale ose personave që padrejtësisht janë proceduar për këtë vepër penale. Rolin e gjykatës si mbikëqyrës dhe kontrollues në këtë fazë e cilëson edhe Prof. Dr Vasilika Hysi në librin e saj “Penologjia ” (Hysi, 2012: 163).

I. Objekt i ekzekutimit të vendimit penal janë dy kategori vendimesh :

•Vendime që nuk kanë marrë formë të prerë ose vendime me ekzekutim të menjëhershëm (neni 21 i ligjit nr. 8331/1998). Të tillë vendimesh ekzekutohen nga



organet përkatëse sapo shpallen nga gjykata në çdo shkallë gjykimi (qoftë e shkallës së parë, gjykatë e apelit etj.) ku përfshihen: vendimi i pafajësisë (neni 388 i Kodi i Procedurës Penale), pushimi i gjykimit të çështjes (neni 387, 462§2 i Kodi i Procedurës Penale), vendimi i përjashtimit nga dënimi, kur shuhet ose hiqet masat personale shtrënguese për shkak se masa e dënimit është me e vogël se koha e paraburgimit, kur i dënuari lirohet me kusht, kur mbaron afati ligjor i masës personale shtrënguese, etj. kur arrestimi në flagrancë apo ndalimi vleftësohet i paligjshëm, vendimet penale që përmbajnë sekuestrim si masë provizore kur jepet një dënim me konfiskim, kur caktohet pranohet kërkesa e prokurorit në hetime paraprake për caktimin e një mase sigurimi për të pandehurin etj.

- Vendime që kanë marrë formë të prerë ku edhe në ligjin nr. 8331/1998 parashikohen në mënyrë të veçantë ekzekutimi i të tillë vendimesh kur i dënuari dënohet: me burgim, me gjobë, me dënime alternative, me dënime plotësuese, urdhërime të tjera (Neni 462 i Kodi i Procedurës Penale).

## II. Subjektet e ekzekutimit të vendimeve penale janë :

- Prokurori – është i vetmi organ i cili inicion, mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale të çdo lloj forme si: vendimet me burgim, masat e sigurimit personal, dënimet plotësuese etj.

- Policia e shtetit ekzekuton vendimet në bashkëpunim me policinë gjyqësore dhe policinë ushtarake, ndihmon prokurorin të ekzekutoj dënimet me burgim, dënimet plotësuese të parashikuar nga neni 30 § 3,7,8 të Kodit Penal ;

- Përmbarimi gjyqësor privat ose shtetëror ekzekuton dënimin me gjobë dhe shpenzimet gjyqësore, dënimin plotësues të parashikuar nga neni 30 pika 2 i Kodit Penal, detyrimin civil ;

- Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ekzekutojnë dhe mbikëqyrin dënimet me burgim, masën e sigurimit personal të “Arrestit me burg”,

- Shërbimi i provës i cili mbështet dhe mbikëqyr ekzekutimin e dënimeve alternative (Neni 6 § 1 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 25.3.2009);

- Organe të tjera shtetërore ose persona juridik që ekzekutojnë dënimet plotësuese të parashikuar nga neni 30 § 1,4,6 të Kodi Penal ;

- Gjykata, ka rol aktiv dhe pasiv i cili shpërfaqet në rolin e saj mbikëqyrës, vendimmarrës, informues në procesin e ekzekutimit të vendimeve penale .

Së pari – Gjykata gjatë ekzekutimit të vendimit penal ka rol pasiv e konkretisht kur informohet nga institucionet e tjera që ekzekutojnë vendimin penal, si në rastin e nenit 246 § 6 i Kodi i Procedurës Penale (Neni 246 : “6. Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, gjykata që ka dhënë vendimin duhet të informohet nga prokurori për të arrestuarin. Informacioni jepet me shkrim dhe përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, për pyetjen e të pandehurit dhe të personave të tjerë, për përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit. Kur është rasti, gjykata mund të revokojë ose të zëvendësojë masën e sigurimit.”) ku prokurori çdo dy muaj informon gjykatën për të arrestuarin. Po ashtu kur prokurori fillon dhe përfundon ekzekutimin e vendimit penal njofton me shkrim gjykatën që ka dhënë vendimin (neni 463 § 4 i Kodi i Procedurës Penale dhe neni 20 § 4 të ligjit nr. 8331/1998), Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale njofton gjykatën që ka dhënë vendimin në rast lirimi të një të burgosuri etj. (neni 67 § 5 i ligjit nr. 8328/1998 ) etj. E drejta e gjykatës për tu informuar mbi mënyrën e ekzekutimit të vendimit penal të dhënë prej saj është një kontroll më shumë ndaj organeve që ekzekutojnë drejtpërdrejtë vendimin dhe po ashtu një garanci për të dënuarin, të arrestuarin etj. për ruajtjen e të drejtave të tij gjatë

ekzekutimit të vendimit penal. Në çdo rast kur nga ky informim, gjykata ka detyrimin të ndërhyjë menjëherë kur ka vend të ndonjë veprë penale të kryer nga ana e punonjësve të këtyre institucioneve apo të ndërhyrë në ndonjë formë tjetër.

Së dyti- Gjykata ka rol aktiv në lidhje me ekzekutimin e vendimit penal ku ky rol shpërfaqet në vendimmarrjen e saj qoftë me kërkesën e palëve si prokurorë, i dënuar/ i pandehur, mbrojtësi i tij por edhe kryesisht (ex officio) gjykata mund të mbikëqyr dhe merr vendime për zgjidhjen e situatave që bien ndesh me ligjin dhe nuk kanë gjetur zgjidhje nga organet e tjera që ekzekutojnë vendimet penale :

•Me nismën e subjekteve procedurale gjykata merr në shqyrtim kërkesa si :

1. Lirim i të burgosurit për shkak të paqartësisë së identitetit të tij, të të arrestuarin (Neni 472 të Kodit të Procedurës Penale);

2. Korrigjim i emrit të të pandehurit, të dënuari (neni 473 të Kodit të Procedurës Penale);

3. Caktimi i vendimit që do të ekzekutohet kur për të njëjtin fakt ka disa vendime gjyqësore ose të prokurorit (neni 474 të Kodit të Procedurës Penale);

4. Bashkimin e dënimeve në një të vetëm (neni 475 të Kodit të Procedurës Penale dhe neni 56 i Kodit Penal );

5. Shtyrja e ekzekutimit të vendimit penal (neni 476 të Kodit të Procedurës Penale);

6. Lirimi me kusht (neni 477 të Kodit të Procedurës Penale dhe neni 64 i Kodit Penal);

7. Revokimi i vendimit për shkak të shfuqizimit të veprës penale (neni 479 i të Kodit të Procedurës Penale );

8. Shuarja e veprës penale, shuarja e dënimit kryesor, shuarja e dënimit plotësues, konfiskimi ose kthimi i sendeve të sekuestruara etj. (neni 480 të Kodit të Procedurës

Penale);

9. Përcakton llojin e sigurisë së burgut (neni 22 § 2 i ligjit nr. 8331/1998) apo transferimin e të dënuarit nga një burg i sigurisë më të ulët në të lartë kur e kërkon i dënuari dhe anasjelltas kur kërkimin e bën prokurori;

10. Pezullimi i ekzekutimit të urdhrit për punë në interes publik, kur e kërkon prokurori (sipas nenit 31 3 paragrafi i fundit i ligjit nr. 8331/1998 );

11. Revokimin e vendimit alternativ për shkak të shkeljes nga të pandehurit të kushteve të dënimit alternative apo mospërbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata, ndryshimin e detyrimit të vendosur, shtimin e detyrimeve të tjera, zëvendësimin e tyre me një sanksion tjetër (sipas nenit 62§4 të Kodit Penal );

12. Konvertimet e gjobave në burgim në rastet e parashikuar nga neni 33 i ligjit nr. 8331/1998 dhe neni 34 i Kodi Penal si p.sh kur i dënuari nuk ka mundësi pagese pjesërisht apo tërësisht, nuk respekton afatet e pagesës, ka ndryshime të vendbanimit të të dënuarit dhe nuk e ka njoftuar tek përmbarimi gjyqësor etj.

13. Ndryshimin e dënimit plotësuese të parashikuar nga neni 30 §9 i Kodit Penal, kur botimi i vendimit gjyqësor bëhet i pamundur për tu publikuar nga media e shkruar a televizive.

14. Heqjen me masës mjekësore ose daljen nga insititucioni mjekësor për të sëmurin mendor apo institucioni riedukues për të mitur (sipas nenit 46 të Kodit Penal);

15. Shqyrton çdo ankesë të të dënuarit ose të paraburgosurve që nuk janë zgjidhur administrativisht nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale përkatëse (neni 40 i ligjit nr. 8328/1998);

16. Konfirmon ose anulon masat e përkohshme si regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, të caktuara nga Drejtori i Përgjithshme e Burgjeve ndaj të dënuarit (sipas nenit 55 të ligjit

nr. 8328/1998 );

17. Ankimet e të dënuarve për mos dhënie të lejeve shpërblyese nga Drejtori i Përgjithshme e Burgjeve (sipas nenit 59 § 7 i ligjit nr. 8328/1998) apo të lejeve të veçantë nga Drejtori i Përgjithshme e Burgjeve (sipas nenit 60§3 i ligjit nr. 8328/1998);

18. Uljet e dënimit për çdo vit të vuajtjes së dënimit (sipas nenit 63 të ligjit nr.8328/1998).

•Me nismën e vet, kryesisht ajo merr vendime në fazën e ekzekutimit të vendimit penal si :

1. Deklaron të shuar veprën penale ose të dënimit dhe merr masat përkatëse që rrjedhin prej

këtij vendimi pa kërkesë të palëve (sipas nenit 480 § 2 i Kodit të Procedurës Penale);

2. Vendos shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik dhe ndjek ekzekutimin e kësaj mase (sipas nenit 46 të Kodit të Procedurës Penale);

3. Verifikon çdo vit, nëse ekzistojnë kushtet për vazhdimin e masës mjekësore ambulatory, të shtrimit në një institucion të posaçëm mjekësor të të dënuarit të sëmurë psikik ose në një institucion edukimi për të miturin që ka kryer vepër penale nën moshën 14 vjeç.

Së treti- gjykata ka për detyrë të jetë mbështetëse dhe të informoj menjëherë subjektet që të fillojnë, vazhdojnë a ndërpresin ekzekutimin e vendimit penal në varësi të vendimmarrjes së saj. Kështu, gjykata dërgon kopjet e vendimeve penale të dënimeve alternative, prokurorit dhe vë në dijeni drejtorin e Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale përkatëse ku do ekzekutohet vendimi (sipas nenit 31/4, 31/5v31/6,31/9 të ligjit nr. 8321/1998) ose prokurorisë së rrethit gjyqësor ku jeton i dënuari në rastet e lirimit me kusht (sipas nenit 31/6 të ligjit nr. 8321/1998), vë në dijeni Institucioni i Ekzekutimit të

Vendimeve Penale përkatëse me një kopje të vendimit në rast ulje të dënimit, kur revokohet ose ndryshohet vendimi i dënimit alternativ gjykata i njofton vendimin personit të dënuar, mbrojtësit të tij, shërbimit të provës dhe prokurorit (nenit 31/10 të ligjit nr. 8331/1998 .

Në të gjitha rolet e mësipërme gjykata duhet të veproj me operacionalitet, me shpejtësi në rastet e gjykimit të kërkesave për revokim, ndryshim të detyrimeve tek dënimet alternative për shkak të emergjencës së gjykimit duke respektuar të gjitha afatet që parashikon Kodi Penal ose ligji i posaçëm nr. 8331/1998 si p.sh kërkesa për revokim të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim gjykohet brenda 7 ditëve nga momenti i paraqitjes së kërkesës në gjykatë, ose brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës vendos për pezullimin e ekzekutimit të urdhrit për punë me interes publik (sipas nenit 31/3 të ligjit nr. 8331/1998 ) etj.

Po ashtu gjykata duhet të jetë korrekte në arsyetimin me shpejtësi të vendimeve pasi kjo sjell, në efektin zinxhir edhe në vonesën e nxjerrjes së urdhrit të ekzekutimit nga prokurori, në ekzekutimin e vendimit nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale përkatëse apo zyrat vendore të shërbimit të provës etj. Në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve e miratuar me VKM nr. 303 datë 25/03/2009 e ndryshuar, në nenin 6 parashikohet se pranimi i të paraburgosurve në Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale, bëhet çdo ditë të javës, pasi të jetë vendosur nga gjykata masa e sigurimit "arrest në burg". Po ashtu në pikën 3 të këtij neni parashikohet se mungesa e një dokumenti ndër to edhe të vendimit të gjykatës sjell që Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale të mos e pranoj të paraburgosurin. I njëjti rregullim është edhe për pranimin e të dënuarve ku sipas nenit 7 të kësaj Rregullore parashikohet se :”1. *Pranimi i të dënuarve në Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale bëhet me urdhër të Drejtorit të*

*Përgjithshëm të Burgjeve, pasi të jetë lëshuar urdhri i ekzekutimit për vendimin e gjykatës.*

*2. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve nxjerr urdhrin e pranimit brenda një afati 3-ditor nga dita e ardhjes së urdhrin të ekzekutimit për vendimin e gjykatës”. Në pikën 3 të këtij neni parashikohet se mungesa qoftë edhe e një dokumenti (vendimi gjyqësor i formës së prerë, urdhri i ekzekutimit të prokurorit etj.) sjell mospranimin e të dënuarit në Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale.*

*Sipas nenit 113 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se:” 1. Origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda pesë ditëve nga bërja e tyre. Për aktet e ankueshëm njoftohen prokurori dhe personat që me ligj i njihet e drejta të bëjnë ankim.” Ndërsa në Republikën e Kosovës situata paraqitet edhe më e ngadaltë për sa i përket kohës se kur gjyqtari duhet të shkruaj vendimin. Sipas nenit 369 §1 të Kodi të Procedurës Penale të Kosovës parashikohet se :”1. Aktgjykimi i shpallur duhet të përpilohet me shkrim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga shpallja e tij, kur i akuzuari gjendet në paraburgim ose i është caktuar paraburgimi, ndërsa në raste të tjera brenda tridhjet (30) ditëve nga dita e shpalljes. Kur rasti është i ndërlikuar, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga presidenti i gjykatës që të zgjasë afatin për përpilimin me shkrim të aktgjykimit deri në gjashtëdhjetë (60) ditë”.*

Gjykata duhet të respektoj afatet e parashikuar në ligjet e posaçme si p.sh neni 48 i ligjit nr. 8331/1998, gjykata për 24 orë dërgon prokurorit kopjen e vendimit të formës së prerë që përmbajnë dënim me burgim ose vendimet që përmbajnë dënime penale ose urdhërime të tjera, i dërgohen prokurorit nga gjykata jomë vonë se 3 ditë nga marrja formë të prerë. Kur është vendosur pezullimi ose shtyrja e ekzekutimit të vendimit, afatet e mësipërme fillojnë nga data që gjykata anulon pezullimin ose plotësohet afati i shtyrjes.

Në raportin e Komitetit Shqiptar të Helsinkut “*Mbi situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale janar – dhjetor 2011*” u konstatua se ka pasur vonesa në lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit penal me burgim nga ana e Prokurorisë konkretisht në Paraburgimin e Vlorës vonesa shkonte deri në \_\_\_\_\_ pesë \_\_\_\_\_ muaj (http://www.ahc.org.al/site/doc/Raport\_burgje\_paraburgim\_final%20shkurt%202012.pdf).

Gjithashtu gjykata duhet të jetë e kujdesshme edhe në krijimin e drejtë të ndërgjyqësish në gjykimin e kërkesave në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale. Në nenin 471 pika 4 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se:”4. *Seanca zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësve. i interesuari, kur e kërkon, dëgjohet personalisht ose me letërporosi.*” Vihet re në gjykimet si lirimet me kusht, kërkesat për revokim të vendimit të dënimit alternative etj. që si subjekt procedural përveç prokurorit, të dënuarit apo mbrojtësit të tij të jenë edhe Drejtori i Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale përkatëse ku ndodhet i dënuari dhe Zyra Vendore e Shërbimit të Provës .Arsyetimi i këtij grupi gjyqtarësh është referuar neneve 31/6 §2,3 të ligjit nr. 8331/1998 ku parashikohet se” *Pas paraqitjes së kërkesës për lirimin me kusht, drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të personit të dënuar dhe një raport për të. ... (omissis)*

*Gjykata i kërkon shërbimit të provës të paraqesë një raport për kushtet familjare dhe prejardhjen*

*shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete, për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimimit.... (omissis)*”.Në këtë mënyrë në të gjitha ato lloj kërkesash ku parashikohet marrja e një raporti vlerësues tek Zyra Vendore e Shërbimit të Provës si p.sh



neni 59/a të Kodi Penal etj. vihet re se këto palë edhe pse legjitimohen gjatë gjykimit, nuk u jepet e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Apelit.

Mendoj se thirrja e palëve të tjera të ndryshme nga ato të parashikuar si palë të domosdoshme nga neni 471 të Kodit të Procedurës Penale e “fryn” dhe e zvarrit procesin gjyqësor. Si palë të vetme që duhet të marrin pjesë në gjykimet e kërkesave gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal janë prokurori, mbrojtësi i të dënuarit ose i dënuari kur nuk ka zgjedhur mbrojtës. Këtë mbrojtje ligjore ka parashikuar vetë Kodi në kreun që rregullon gjykimet të tilla. Fakti se në disa institucione ndodhen prova të rëndësishme për procesin dhe pa të cilat gjykata nuk mund të marrë vendim përfundimtar, jo domosdoshmërisht u jep atyre (institucioneve) atributet e subjekteve procedurale. Procesi gjyqësor penal i gjykimi të themelit si subjekte procedurale njih prokurorin që ndjek hetimet, ngre akuzën dhe paraqet kërkesën për gjykim të të pandehurit dhe të pandehurin dhe /ose mbrojtësin e tij si dhe të paditurin dhe paditësin civil. Edhe faza e ekzekutimit të këtij vendimi penal të formës së prerë duhet të këtë së paku këto subjekte procedurale. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe Zyra Vendore e Shërbimit të Provës nuk janë subjekte procedurale që duhet të ftohen në të tilla gjykimesh porse janë institucione që kanë dokumente, hartojnë raporte me kërkesë të gjykatës dhe mbështesin këtë të fundit për të vlerësuar nëse sjellja e të dënuarit është e tillë që të aplikohet dënimi alternativ. Këto janë edhe institucione që ekzekutojnë dhe mbikëqyrin vendimin e gjykatës më pas.

Nëse do të pranohet kjo logjikë, gjykata duhet të bënte palë në gjykim edhe çdo institucion tek të cilat ndodhen prova të rëndësishme apo që japin informacion gjykatës para se të marrë vendimin përfundimtar si p.sh Arkiva e Gjykatës ku merret një dosje që i përket të dënuarit, informacioni që merret në Kryesekretari sipas nenit 477 të Kodi të Procedurës Penale se i dënuari për gjashtëmujorin e fundit nuk ka vendim rrëzimi për

kërkesë lirim me kusht, Ministria e Drejtësisë ku merren vërtetimi i gjendjes gjyqësore nëse i dënuari është recidivist apo jo, qendrat shëndetësore ku gjenden kartelat mjekësore të të dënuarit etj. Nëse legjislatori kërkon që në gjykim të futet një palë përtej atyre të parashikuar nga neni 471 të Kodit të Procedurës Penale e parashikon specifikisht siç është në rastin e nenit 19 § 4 i ligjit 10494 datë 22/12/2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave ,të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor“ ku në rast se shkelen kushtet e Mbikëqyrjes Elektronike, gjykata dëgjon në seancë prokurorin, përfaqësuesin e Shërbimit të Provës, të dënuarin dhe më pas vendos për vazhdimin e ME-se me të njëjtat kushte, zëvendësimin, revokimin e saj sipas nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale ose nenit 31/10 të ligjin nr. 8331/1998 etj.

#### **4.17. Roli i policisë ne ekzekutimin e sanksioneve penale**

Shërbimet e policisë gjyqësore organizohen dhe funksionojnë pranë të gjitha shkallëve të prokurorive dhe gjykatave, me qëllim që të sigurohet kryerja e veprimeve procedurale penale në fazën e hetimit paraprak.

Një rol i veçantë i takon policisë gjyqësore për marrjen dhe administrimin e provave të veprës penale. Praktika ka shumë shembuj pozitivë, kur janë mbledhur provat, janë verifikuar dhe akuza e dërguar nga prokurori është pranuar nga gjykata, e cila ka dhënë fajësinë e të pandehurit.

Por ka edhe mjaft raste kur nuk i është kushtuar kujdes i duhur marrjes së provave. Shembull tipik është 21 janari 2011.

Sipas Kodit të Procedurës Penale, Policia Gjyqësore është në varësi profesionale të prokurorit, kurse varësia hierarkike dhe raportet e saj me Ministrinë e Brendshme

rregullohen me dispozitat e Kodit të Procedurës Penal e sidomos të ligjit të posaçëm të përmendur më lart.

Bazuar në normat e Kodit të Procedurës Penale të gjitha veprimet procedurale penale të policisë gjyqësore që janë parashikuar në ligj, kontrollohen nga prokurori. Këto dispozita sigurojnë rregullshmërinë e veprimeve procedurale sipas ligjit dhe janë në mbrojtje të lirive e të drejtave themelore të njeriut, posaçërisht të personave të akuzuar.

Në praktikë është vërejtur se jo gjithnjë respektohen e zbatohen ligjet nga policia, sidomos në lidhje me ndalimet, trajtimin e të paraburgosurve, përdorimin e dhunës kundër tyre, dhe torturën apo shkaktimin e vdekjes nga përdorimi i dhunës (rasti i Korçës i disa viteve më parë) etj. Në këtë drejtim, veç të tjerash, ka ndikuar edhe mungesa e kontrollit për zbatimin efektiv e me përpikëri të ligjit.

Në kuadër të identifikimit të prioriteteve kryesore strategjia sektoriale e rendit publik, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.14 datë 9.01.2008 përmban shërbime dhe detyra për funksionimin e Policisë Gjyqësore nga zbatimi i të cilave varet efektiviteti i ligjit penal në luftimin e kriminalitetit. Policia gjyqësore gjatë veprimtarisë së saj bashkëpunon e bashkëvepron edhe me seksionet e tjera të policisë, si me policinë e shtetit, policinë tatimore, policinë ndërtimore dhe organet e tjera sipas ligjeve në fuqi. Sa më i organizuar dhe efektiv do të jetë ky bashkëpunim e bashkëveprim, aq më tepër do të rritet efektiviteti i ligjit penal dhe procedural penal për luftimin e kriminalitetit dhe parandalimin e tij Gjithashtu janë miratuar një sere aktesh të tjera që kanë rëndësi, pasi forcojnë veprimtarinë hetimore të oficerëve të policisë gjyqësore, duke nisur nga rekrutimi, shpërblimet e shtesat në pagë e duke vijuar me llogaridhënien përmes parashikimeve të procedimit disiplinor (Raporti për monitorimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë i hartuar nga Fondacioni Soros).

- Urdhri “Për përcaktimin e kriterëve për dhënien e shtesës së pagës për vështirësi pune për oficerët e policisë gjyqësore. Ky urdhër saktëson kriteret për shtesa page kur oficeri është caktuar ose është transferuar përkohësisht në një seksion me kushte të vështira për shkak të logjistikës ose rrezikut që lidhet me veprimtarinë, ose kur veprimtaria kërkon kompetenca të specializuara dhe të jashtëzakonshme, volumi i punës është jashtëzakonisht i madh dhe çështjet janë veçanërisht komplekse për shkak të numrit dhe rëndësisë së krimeve, numrit të të pandehurve, implikimeve ndërkombëtare dhe volumit të provave.

- Udhëzim “Për përcaktimin e kriterëve për shpërblimin për merita profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore”. Ky akt udhëzon drejtuesit e prokurorive për të vlerësuar meritat profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore, bazuar në disa kriterë të përcaktuara, siç janë: njohuri dhe zotërim të kompetencave të specializuara në lidhje me teknologjitë speciale dhe disiplinat teknike, prodhimtari më të lartë se mesatarja ose angazhim për të punuar jashtë orarit, menaxhim të mirë të rasteve komplekse, rezultatet e arritura në koordinimin e grupeve të mëdha hetimore e bashkëpunim me grupe në nivel kombëtar e ndërkombëtar, cilësia e akteve procedurale të nxjerra.

- Udhëzim “Për kryerjen dhe përfundimin e hetimeve të kallëzuar drejtpërdrejt në prokurori apo të filluara kryesisht”. Ky udhëzim përcakton disa rregulla lidhur me rastet kur përfundon hetimi nga seksionet e policisë gjyqësore, delegimin e hetimit shërbimit të Policisë Gjyqësore, krijimin e grupeve të përbashkëta hetimore, njohjen e prokurorit me organizimin e shërbimit të policisë gjyqësore etj.

- Udhëzim “Për procedurat e konkurrimit për caktimin në seksion të punonjësve të policisë - Udhëzim “Për procedimin disiplinor të punonjësve të policisë gjyqësore”.

Udhëzimi parashikon rregullat që zbatohen gjatë procedimit disiplinor duke përfshirë ndër të tjera parimet e ligjshmërisë, objektivitetit, gjykimit me gojë dhe kontradiktoritetit në përputhje me procesin e rregullt ligjor.

#### **4.18. Roli i institucioneve të vuajtjes së dënimit me burgim**

Shërbimi i provës ndryshon nga një vend në një tjetër edhe në lidhje me aktivitetin që kryen. Në disa vende shërbimet e provës janë të kompletuara, d.m.th., që mbulojnë të gjitha fushat e “punëve të shërbimit të provës”. Në vende të tjera ky shërbim ka funksion me të kufizuar, p.sh. mund të merret me përgatitjen e raporteve për në gjykata. Edhe grupet kryesore të synuara të shërbimit të provës variojnë. Në Angli dhe Wells, Irlandë dhe Norvegji shërbimi i provës ka në fokus autorët e veprave penale të cilët paraqesin shkallë të lartë rrezikshmërie, në Holandë fokusi vendoset mbi ata autorë të veprave penale të cilët janë ose mund të motivohen për të ndryshuar, ndërsa në Skoci dhe Spanjë fokusi përqendrohet mbi autorët e rinj në moshë. Edhe niveli i punës me të rinjtë ndryshon nga njëri vend në tjetrin. Edhe pse zakonisht sistemet e shërbimit të provës merren me autorët e mitur të veprave penale, në shumicën e vendeve sistemi i drejtësisë për të mitur ndryshon shumë nga ai për të rritur dhe ekzistojnë organizma të veçantë, përgjegjësia kryesore e të cilave është të punojnë me të dënuarit e mitur (Waggrave, Lode. RJ and beyond, 2006).

Këto ndryshime në fushën e shërbimit të provës komplikohen edhe më tej për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme që pëson ky shërbim. Ristrukturimi organizativ është një tipar konstant i shërbimit të provës, megjithatë ky shërbim ka kaluar edhe në një proces zhvillimi (ndonjëherë edhe me ndryshime radikale) në lidhje me orientimin profesional.

Kohët e fundit shërbimi i provës është vënë në qendër të vëmendjes të politikës dhe si rrjedhojë ndikohet më tepër nga ndryshimet e politikave dhe ideologjive politike. Këto tipare të fushës së shërbimit të provës e shtojnë vështirësinë e të gjeturit të një përkufizimi të thjeshtë dhe të kuptueshëm të "shërbimit sprovues". Përpjekjet e deri tanishme për të përkufizuar shërbimin sprovues kane dështuar. Për shembull Kombet e Bashkuara deklarojnë se vënia në provë është një ndëshkim, një metodë për të trajtuar të dënuar të veçantë dhe që konsiston në pezullimin me kusht të dënimit penal dhe i dënuari vihet nën mbikëqyrje dhe merr udhëzime ose trajtim individual. Shërbimi sprovues përkufizohet pak me gjerësisht si: "Një mënyrë ndëshkimi me bazë sociale-pedagogjike që karakterizohet nga një kombinim i mbikëqyrjes dhe ndihmës. Aplikohet falas për ata të dënuar të përzgjedhur në bazë të personalitetit të tyre kriminal, llojit të krimit dhe pranimi nga ana e tyre, në raport me një sistem, qëllimi i të cilit është t'i japë të dënuarit mundësinë për të ndryshuar përjasjen ndaj jetës në shoqëri dhe të bëhet pjesë e mjedisit social të zgjedhjeve pa rrezik se mund të shkelë përsëri ndonjë normë penale shoqërore." (Cartledge, 1995) Në teorinë dhe praktikën moderne penale dënimi penal ka disa karakteristika të tij në funksion të qëllimeve që synon të përmbushë. Së pari, çdo person që kryen një veprë penale do të ndëshkohet për kryerjen e saj, me një dënim që i korrespondon shkeljes së ligjit që ai ka bërë. Për disa prej tyre, burgimi është i pashmangshëm, për të garantuar kështu edhe mbrojtjen e shoqërisë dhe sigurinë publike. Dënimi penal synon të arrijë rehabilitimin e personit, autor i veprës penale si dhe ta parandalojë atë nga kryerja e veprave të mëtejshme kriminale, si edhe për personat e tjerë të lëkundshëm në shoqëri. Synimi i dënimit është parandalimi i veprimtarisë së rrezikshme të autorit, përmirësimi dhe edukimi i tij dhe, ndikimi pozitiv edukues tek personat e tjerë që mund të jenë kontingjente për kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Dëmi që i ka shkaktuar autori viktimës mund të “riparohet” dhe kështu krimi mund të reduktohet duke e kthyer sërish personin në komunitet por në këtë rast të rehabilituar. Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë ekziston një kapitull i veçantë me alternativa të cilat jepen ndaj personit autor të veprës penale, si pjesë e karakterit human të dënimit. Zakonisht këto alternativa të dënimit me burgim jepen kur nga gjykata vlerësohet se rrezikshmëria shoqërore e autorit dhe e veprës penale është e vogël, si edhe kur kjo gjykatë mendon se me zbatimin e masave të tilla i arrihet më së miri qëllimeve të dënimit. Alternativat e dënimit nuk janë lloje të veçanta dënimesh por janë një mënyrë e ekzekutimit të tyre. Në këtë rast gjykata e cakton më parë masën e dënimit ndaj autorit të veprës penale dhe në qoftë se shikon se plotësohen kushtet përkatëse, ajo vendos për zbatimin e një prej alternativave të dënimit. Gjithashtu, për herë të parë u përcaktua me ligj krijimi i një institucioni të ri shtetëror të quajtur shërbimi i provës. Në nenin 31/7 të ligjit nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale’” përcaktohet edhe funksioni i shërbimit të provës si një organ shtetëror në varësi të Ministrisë së Drejtësisë i cili i paraqet gjykatës dhe prokurorit informacione dhe raporte, ndihmon në ekzekutimin e alternativave të dënimit me burgim si dhe ndihmon të dënuarin të kapërcejë vështirësitë e ndryshme për riintegrimin social të tij. (më gjerësisht do të trajtohet më poshtë). Që prej vitit 1995 kur hyri në fuqi, Kodi Penal ka ndryshuar vazhdimisht, por në ndryshimet e fundit të bëra me ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’”, të ndryshuar, krahas dispozitave të tjera ndryshuan dhe u përmirësuan dispozitat që lidhen me Kreun VII të këtij kodi me titull “Alternativat e dënimit me burgim” si dhe në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Ndryshimet e reja ligjore japin më shumë hapësirë për zbatimin në praktikë të alternativave të dënimit me burgim. Duhet theksuar se këto alternativa të dënimit aplikohen ndaj personit vetëm në rast se gjykata e ka dhënë më parë dënimin për të, i cili duhet patjetër të jetë me burgim deri në një masë të caktuar. 1. Në ndryshimet e fundit që iu bënë Kodit Penal u fut një alternativë e re e quajtur “Gjysmëliria” (neni 58) e cila zëvendësoi alternativën e mëparshme “Copëzimi i dënimit me burgim”. Kjo alternativë e dënimit aplikohet ndaj personit vetëm në rast se gjykata jep dënimin deri në një vit. Që të japë këtë alternativë, duhet që gjykata të konstatojë se i dënuari ka rrethana të rënda familjare, mjekësore, arsimore, profesionale apo shoqërore. Rrethanat e rënda familjare mund të ekzistojnë kur personi p.sh., ka pasur një fatkeqësi familjare dhe kur ai nuk ka asnjë lloj ndihme tjetër në familje përveç vetes së tij. Ai mund të ketë rrethana të rënda shëndetësore kur me raport mjekësor vërtetohet se vuan nga një sëmundje e rëndë. Në qoftë se me vuajtjen e dënimit në burg personi do të humbiste edhe aftësitë profesionale atëherë gjykata mund të aplikojë ndaj tij gjysmëlirinë. Kur vuajtja e dënimit shkakton reagime nga shoqëria ose personi mund të humbasë reputacionin që ka, atëherë këto rrethana mund t’i konsiderojmë si shoqërore. Në ndryshimet në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, siç e përmendëm, krijohet për herë të parë shërbimi i provës (Kreu II/1 i ligjit), i cili do të merret me ekzekutimin e alternativave të dënimit me burgim të parashikuara nga Kodi Penal. Shërbimi i provës është organi shtetëror që paraqet informacion para autoriteteve gjyqësore, mbikëqyr ekzekutimin e dënimit alternativ dhe ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social. Rregullat e hollësishme të organizimit, të drejtave, detyrimeve, rekrutimit dhe masave disiplinore, trajnimeve, vlerësimit të punës, dhe kodit etik në shërbimin e provës, përcaktohen në rregulloren e brendshme që do të miratohet nga Ministri i Drejtësisë. Është e rëndësishme



që me daljen e ligjit të hartohen aktet nënligjore më emergjente për funksionimin praktik të këtij shërbimi në shkallë vendi. Gjithashtu, këto ndryshime duhet të pasohen edhe nga ndryshime në ligjin organik të organizimit dhe funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë-ligji nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë.” Shërbimi i provës i paraqet raport prokurorit (me kërkesë të tij) gjatë fazës së hetimeve paraprake apo gjykatës gjatë shqyrtimit gjyqësor, para dhënies së vendimit apo para se të vendosë për dhënien, ndryshimin apo mbarimin e tij. Në çdo rast ky raport kërkohet për vlerësimin e rrethanave shoqërore. Kur gjykata vendos pezullimin e vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me një dënim alternativ, i dërgon menjëherë vendimin shërbimit përgjegjës të provës për ekzekutimin e dënimit alternativ. Në qoftë se personi i dënuar është i burgosur, gjykata dërgon një kopje të vendimit në institucionin e ekzekutimeve të vendimeve penale ku mbahet i dënuari, për lirim të tij. Shërbimi Shqiptar i burgjeve është një sistem kombëtar nën autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë, si me poshtë: Ndërsa sipas KP rregullat mbi mënyrën e vuajtjes së dënimit, të drejtat dhe detyrat e të dënuarve caktohen me ligj të veçantë.

Dhe për këtë ka dale ligji nr 8328 dt 16.04 1998.

Sipas këtij ligji Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim institucionet e vuajtjes së dënimit në Shqipëri ndahen në; Burg i sigurisë së lartë; Burg i zakonshëm; Burg i sigurisë së ulët; Institute të veçanta.

Secili nga këto institucione ka një regjim të veçantë të përcaktuar në ligjin në fjale dhe në rregulloren e institucionit. Ky klasifikim ka rëndësi sepse ndikon në organizimin me të mirë të procesit të trajtimit dhe edukimit të të dënuarve dhe në klasifikimin e dhe ndarjen e tyre në përputhje me rrezikshmërinë e veprës dhe personalitetin e tyre. Burgu i sigurisë së lartë shërben për ekzekutimin e vendimeve me burgim për personat që

karakterizohen nga rrezikshmëria e madhe shoqërore, p.sh autoret e krimit te organizuar .Neni 13 i ligjit parashikon se ne këto institucione e vuajnë dënimin ata persona qe ne kohen e kryerjes se veprës penale apo gjate vuajtjes se dënimit janë karakterizuar nga sjellje dhe qëndrime qe e bëjnë te pamundur qëndrimin e tyre ne kategori te tjera te burgjeve. Pra siç shihet rrëgjimi I këtij burgu është me I rrepte se institucionet e tjera. Ne burgjet e sigurisë se larte vërtetë te dënuarve u kufizohen disa te drejta por jo te drejtat e njohura ne kushtetute dhe ne ligjin ne fjale. Burgu I sigurisë se zakonshme është institucioni ne te cilin vuhet dënimi nga te gjithë te dënuarit, përveç atyre te sigurisë se larte dhe personave qe vuajnë nga paaftësi mendore dhe fizike. Këto burgje kane një rrëgjim me te bute dhe kane forma te larmishme ne trajtimin e te dënuarve (neni 14 I ligjit) Ne burgun e sigurisë se ulet sipas nenit 15 te ligjit e kryejnë dënimin personat qe kane kryer një kundervajtje penale ose një vepër penale nga pakujdesia dhe qe janë përsëritës. Te dënuarit ne burgje te sigurisë se zakonshme qe u ka mbetur edhe 6 muaj për te përfunduar dënimin me burgim mund te transferohen dhe te vuajnë pjesën e mbetur te dënimit ne burgje te sigurisë se ulet.

**KAPITULLI V**

**VËSHTRIM KRAHASUESE E LEGJISLACIONIT TË**

**KOSOVËS ME VENDE TË TJERA**

**5.1. Vështrim krahasuese e legjislacionit të Kosovës me vende të tjera lidhur me sanksionet penale dhe sistemin e institucioneve të ekzekutimit të tyre në rajon**

Në kushtet e globalizmit ndeshemi në planin ndërkombëtar jo vetëm me krizën ekonomike globale, por edhe me rrjedhojat e saj, me krizën e shoqërisë bashkëkohore, të sistemit të vlerave dhe të rritjes së vazhdueshme të krimit të organizuar dhe të kriminalitetit në tërësi. Kjo gjendje ndikon në formimin e opinioneve dhe të teorive negative apo skeptike ndaj sistemit të drejtësisë penale. Sipas këtyre opinioneve, derisa sistemi i drejtësisë dhe vetë e drejta penale nuk përballon dot rritjen e kriminalitetit, ato ndodhen në krizë dhe nuk mund të pritët shumë prej tyre. Derisa ajo nuk luan rolin e saj mbrojtës nga krimi, prandaj të zëvendësohet me masa sigurimi. Këto pikëpamje e teori nuk janë të pranueshme derisa bien në kundërshtim me përvojën historike dhe realitetin objektiv të shoqërisë bashkëkohore (Ela Elezi, Efektiviteti i legjislacionit dhe sistemit të drejtësisë penale kundër kriminalitetit në procesin e integritetit evropian, Universiteti i Tiranës, Tiranë 2013). Vendet e Bashkimit Evropian po zhvillojnë atë që tashmë quhet “e drejta penale evropiane”, me të cilën kuptojmë: “tërësinë e normave penale (materiale, procedurale dhe penitenciare) të përbashkëta për disa shtete të Evropës me qëllim që të luftohet më me sukses kriminaliteti, sidomos kriminaliteti i organizuar ndërkombëtar”.

Ky përkufizim është bërë qëllimisht mjaft i gjerë dhe nuk pozicionohet as në lidhje me natyrën e këtyre rregullave të përbashkëta (norma bashkëpunimi dhe/ose norma harmonizimi dhe unifikimi) dhe as në lidhje me atë se çfarë është Evropa (Corstens, Vermeulen, 2010:12). Në vitin 1997, për herë të parë në Evropë u hodh ideja e Corpus juris, që zakonisht i referohet tërësisë së ligjeve dhe akteve të tjera normative në një vend. Në kontekstin evropian nënkupton një përmbledhje idesh se si duhet të hartohet ligji evropian në mënyrë që të parandalojë dhe luftojë mashtrimet me fondet evropiane. Corpus juris është një studim i publikuar në vitin 1997 nga tetë juristë akademikë të BE (një prej tyre britanik). Ai nuk ishte një dokument zyrtar i Komisionit Evropian, por një material studimor i kërkuar prej tij. Qëllimi i studiuesve nuk ishte krijimi i një kodi penal ose procedural penal për BE, por hartimi i parimeve ligjore që do të ishin të vlefshme për të gjithë vendet anëtare në luftën kundër krimit financiar në Evropë. Vendimi për ngritjen e grupit të punës vinte nga shqetësimi i mashtrimit dhe keqpërdorimit të fondeve të BE dhe fakti se 80% e mashtrimeve kishin natyrë që dilte jashtë kufijve të një shteti dhe ishte më e vështirë të hetoheshin. Studimi evidentoi dy pengesa kryesore:

1. autoritetet e drejtësisë penale kishin kompetencë vetëm brenda juridiksionit të tyre, pra mund të nisnin një procedim penal nëse vepra penale kryhej në shtetin e tyre dhe

2. Ndryshimet midis sistemeve ligjore, që nga përkufizimi i veprës penale, dënimet dhe procedura penale, duke bërë të mundur që personat që kryenin mashtrimin të mbeteshin të padënuar. U vërejt se këto pengesa nënkuptonin se ligji ishte shumë kompleks dhe joefektiv në luftimin e mashtrimit me fondet e BE. Gjithashtu jo domosdoshmërisht krimet kryheshin në territorin e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Studimi arriti në konkluzionin se zgjidhja e këtij problemi mund të realizohej në tre mënyra:

- Asimilimi – shtetet anëtare do detyroheshin me anë të Traktateve të siguronin që ligjet e tyre të mbronin fondet evropiane nga mashtrimet;

- Bashkëpunimi – shtetet anëtare mund të punonin së bashku për të luftuar këtë krim ndërkombëtar duke përdorur instrumente të ndryshme të bashkëpunimit, si Evropol dhe Interpol;

- Harmonizimi – shtetet anëtare mund të miratonin masa ligjore identike, si p.sh. përkufizim i njëjtë për veprën penale dhe rregullat e procedurës, në mënyrë që të krijohet një sferë ligjore e vetme për mashtrimet me fondet e BE. Studimi nxirrte në pah nevojën e një përgjigje radikale ndaj absurditetit të hapjes së kufijve për kriminelët dhe mbylljes për agjencitë e zbatimit të ligjit. Megjithatë propozimi i tyre nuk parashikonte miratimin e një kodi penal apo kodi të procedurës penale të unifikuar, por një grup rregullash penale që kufizoheshin në mbrojtjen penale të interesave financiare të Bashkimit Europian (Juris 2007-08 :.40). Studimi i Corpus juris ishte origjina e konceptit të unifikimit, harmonizimit (përafrimit) dhe asimilimit në të drejtën penale evropiane. Reformat e fundit legjislativë paraqesin tiparet e dekriminalizimit dhe depenalizimit për shumë figura të veprave penale. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut përfaqëson shembullin kryesor të shkrirjes së të drejtës common law dhe civil law. Ajo përbën dhe bazën për një të kod penal evropian në të ardhmen (Pavišić, 2002). Procesi i harmonizimit të së drejtës nuk nënkupton përcaktimin e rregullave fikse, por zgjedhjen dhe përshtatjen e disa parimeve përcaktuese në krijimin e standardeve minimale të tutelës, të cilat funksionojnë vetëm nëse garantojnë të drejtat themelore të njeriut. Harmonizimi i së drejtës penale rrjedh edhe nga themelimi i disa institucioneve ndërkombëtare gjyqësore si Gjykata Evropiane, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian, Gjykata e Hagës për krimet e luftës (dhe krijimi i Tribunalit penal ndërkombëtar), në jurisprudencën e të cilave është përpunuar

një rend procedural i cili ka ndikim thelbësor në rendin juridik të brendshëm të shteteve të veçanta. Nevoja e harmonizimit të së drejtës penale vjen edhe si pasojë e ekzistencës së institucioneve juridike të bashkëpunimit ndërkombëtar si ekstradimi apo ndihma juridike, efektiviteti i të cilave nënkupton një të drejtë penale të zbatueshme gjerësisht.

Duke u bazuar në këtë teori janë bërë reformat e rëndësishme në Kodin Penal që nga viti 1998 e deri në vitin 2013, mbështetur në nevojat që ka diktuar praktika e vendit tonë, si dhe në rekomandimet e Këshillit të Evropës, konventat ndërkombëtare, aktet e tjera juridike ndërkombëtare si dhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, arrijmë në përfundimin se e drejta penale në stadin e sotëm u përgjigjet kërkesave të luftimit të krimit të organizuar e kriminalitetit në tërësi. Gjithashtu shteti shqiptar bazohet në një strategji të përcaktuar për forcimin e sistemit të drejtësisë penale, e cila i është nënshtruar reformave të vazhdueshme, po bëhet gjithnjë e më shumë efektiv në luftimin e krimit të organizuar dhe kriminalitetit në tërësi. Mjafton të përmendim masat e fundit për digjitalizimin e gjyqësorit dhe rishpërndarjen e gjyqtarëve sipas nevojave të gjykatave e qarqeve. Nisur nga këto fakte, na duket e drejtë pikëpamja e shprehur nga penalisti V. Kambovski se: “E drejta penale nuk është në krizë, por në krizë është ambienti shoqëror, në të cilin ajo i realizon funksionet e saj dhe qëllimi kryesor i reformave është që ai të ndikohet sa më tepër që është e mundur, të kthehet në binarët e respektimit të vlerave themelore socio – etike të shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut(Kambovski 2007:56). E drejta penale dhe krejt drejtësia penale janë mjete i fundit, sado i fortë që të jenë, nuk mund të parandalojnë kriminalitetin, derisa ky është i lidhur ngushtë me strukturën shoqërore dhe kontradiktat sociale, të cilat janë jashtë mundësive të drejtësisë penale për t’u rregulluar. Kriminaliteti është fenomen shoqëror dhe i vazhdueshëm, bashkudhëtar i shoqërisë njerëzore. Me gjithë luftimin që zhvillohet

kundër tij, përsëri kriminaliteti merr forma të reja, gjithnjë më të sofistikuara dhe shkencat e kriminologjisë, sociologjisë, politikës penale, të së drejtës penale etj. nuk kanë arritur deri tani të gjejnë mjete dhe forma më efikase për luftimin e zhdukjen e tij, veçse rekomandojnë disa masa parandaluese që të mos bëhet edhe më kërcënues për shoqërinë e jetën e personit. E drejta penale ushtron ndikimin e saj që të zbatohen ligjet në fuqi, sepse sa më mirë e më fort ato të zbatohen, aq më pak do të ketë shkelje të tyre, vepra penale. Nga ana tjetër nuk mund të ushqehet asnjë iluzion se e drejta penale është e gjithëfuqishme për luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Përkundrazi, përvoja historike shekullore e vendeve të ndryshme tregon se ajo ka qenë dhe mbetet mjete i fundit për të kontrolluar dhe mbajtur nën presion shtetëror nëpërmjet normave të saj kriminalizuese e penalizuese, nën kërcënimin e dënimit penal ata që kryejnë ose tentojnë të kryejnë vepra penale. Por, nuk mund të mendohet se e drejta penale në bashkëpunim me kriminologjinë do të mund të zhdukin shkaqet e kriminalitetit. Kriminologjia i studion dhe evidenton shkaqet e kushtet favorizuese të kriminalitetit dhe mjaftohet me rekomandimet për marrjen e masave parandaluese, por nuk mund t'i eliminojë ajo. Autorët italianë Fiandaca e Musco vënë në dukje se mbrojtja juridike penale përveç karakterit ndihmës ka karakter fragmentar. Ajo mbulon vetëm një rreth të caktuar të të mirave juridike dhe vetëm forma të caktuara të sulmit ndaj atyre të mirave(Musco:32).

Rendet penale evropiane e kanë ndërtuar sistemin e tyre të sanksioneve në një grup dispozitash me elementin ndëshkues. Sistemi më i përhapur është ai që bën dallimin midis dënimit dhe masave të sigurisë (sistemi dopio binar në sistemin gjerman të Zweispurig) dhe në lidhje me dënimin kemi privimin e lirë dhe dënimin monetar. Ky sistem përdoret nga shumë shtete, si ai italian, kroat, gjerman etj.

*5.1.1. Sanksionet penale dhe institucionet e ekzekutimit të tyre sipas legjislacionit penal shqiptar*

Kodi i Procedurës Penale miratuar me ligjin Nr 6069 datë 25.12.1979 hyri në fuqi në datë 01.04.1980. Ai zëvendësoi Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale të vitit 1953, dhe ishte i ndarë në pjesën e përgjithshme dhe pjesën e posaçme 109 (në të cilën përfshihej hetimi e gjykimi). Në dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij kodi u përcaktuan; përmbajtja, detyrat, bazat, parimet dhe subjektet e legjislacionit procedural penal. Ky kod si dhe i gjithë legjislacioni i asaj periudhe u mbështet në Kushtetutën e vitit 1976. Ai përbënte regres të dukshëm në krahasim me legjislacionin egzistues, ishte shprehje e qartë e shkeljes së të drejtave e lirive themelore të shtetasve, legjitimonte pabarazinë e subjekteve procedurale me ligj. Karakteristikë e këtij Kodi janë parashikimet e mangëta dhe të përgjithshme që bëhen disa instituteve, duke u lënë rrugë të lirë veprimeve arbitrare pa kurrfarë procedure, pa asnjë detyrim të parashikuar për organin procedues për njoftimin e palëve që çënohen, të detyrimit për ti vënë në dijeni, të drejtën e ankimit etj...

Parashikimet në këtë kod vinin në kundërshtim të plotë me standartet demokratike të proceseve penale, të shprehura në veçoritë e mëposhtme; Në literaturën juridike – penale të Shqipërisë i është dhënë rëndësi e madhe trajtimit të dënimit penal. Kjo dëshmohet në Komentarin e Kodit Penal (pjesa e përgjithshme), artikujt shkencorë të botuar etj.

Megjithëse në Kodin Penal nuk jepet përkufizimi i dënimit penal dhe i qëllimit të tij, doktrina e së drejtës penale e ka plotësuar këtë mangësi: “Me dënim penal në të drejtën penale të Republikës së Shqipërisë, kuptohet ajo masë shtrënguese, që zbatohet nga shteti



nëpërmjet gjykatave, në bazë të ligjit, kundër personave fajtorë që kanë kryer veprë penale”.

Baza juridike e këtij përkufizimi është në Kodin Penal ku thuhet se: “Askush nuk mund të dënohet penalisht për një veprë që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale. Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj.” (neni 2)

- Sanksionoi me ligj varësinë e gjykatës, prokurorisë dhe organeve të hetimit nga partia shtet. Në nenet 3 e 4 të këtij kodi u njohën parimet e udhëheqjes nga politika e partisë, lufta e klasave, vija e masave etj... (Në nenet 2, 3 dhe 4 të këtij kodi përcaktohen detyrat, bazat dhe parimet e legjislacionit proçedural penal ku përcaktohet se “Legjislacioni proçedural penal udhëhiqet nga politika e partisë punës... ka për detyrë të mbrojtë shtetin socialist, partinë e punës.. udhëhiqet nga parimi i luftës klasave, ligjshmërisë socialiste etj..”)

- Nuk njohu as formalisht parimet demokratike të proçesit penal atë të barazisë së palëve, prezumimin e pafajësisë, mbrojtjen me avokat, oralitetin, provave gjyqësore etj..

- Përrjashtoi prokurorinë nga kryerja dhe drejtimi i veprimtarisë hetimore, hetimet ju ngarkuan organit të hetuesisë me të drejta të pakufizuara e të pakontrolluara jo vetëm nga prokuroria por edhe nga gjykata. (Në nenet 6, 7 të këtij kodi përcaktoheshin kompetencat e organit të prokurorisë dhe hetuesisë ne proçesin penal. Në këto parashikime organi i prokurorisë gjatë hetimit të çështjeve nuk kishte asnjë të drejtë proceduriale, për të kontrolluar, ndryshuar, kryer apo drejtuar veprimtarinë hetimore.)

- Gjykata nuk kishte asnjë të drejtë proceduriale për të vendosur mbi veprimet e paligjshme të organeve të hetimit gjatë hetimit të çështjeve, çdo ankim ndaj veprimeve apo vendimeve të hetuesit shqyrtoheshin po nga organet e hetuesisë.

- Nuk njihet e parashikohet pavarshmëria e akteve apo provave, si rezultat i veprimeve procedurale të kryera në mënyrë të paligjshme apo në kundërshtim me ligjin. Në nenin 14 të tij u parashikua e drejta formale e pjesëmarrësve në procesin penal për të paraqitur prova, kërkuar plotësimin e hetimeve, ankimit ndaj vendimeve të hetuesit e gjykatës (2 Ndonëse në nenin 15 të këtij kodi parashikohet se “Provat janë të gjitha të dhënat që merren në formën e parashikuar nga ky kod, dhe që vërtetojnë...” Ndërsa në nenin 143 parashikohet se nga gjykata në gjykimin e çështjes ka të drejtë të marrë çdo provë ....”).

Në Kodin Penal krahas parimit të ligjshmërisë, përcaktohen edhe parime të tjera kryesore që janë edhe parime të penalizimit, siç janë: dënimi penal zbatohet vetëm ndaj personave fajtorë për kryerjen e veprës penale, dënimi penal ka karakter individual, dënimi penal zbatohet vetëm nga gjykata, duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit Penal dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në ligj për veprën penale, si dhe diferencimin në caktimin e dënimit, duke marrë parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese (neni 47). Nga përmbajtja e këtij neni kuptohet qartë penalizimi praktik, që nuk është gjë tjetër veçse përgjegjësia individuale– diferencimi dhe individualizimi i dënimit.

Elementi themelor i politikës penale të shprehur në penalizim është dhënia e drejtësisë, në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit, për të cilën flitet në parimet e Kodit Penal (neni 1/c). Reformat ligjore të viteve 2001 – 2013, kanë sjellë ndryshime kryesore edhe në penalizimin e veprave penale, duke zgjeruar e shtuar dënimin me burgim të shoqëruar me gjobë. Këto ndryshime erdhën si rezultat i kriminalizimit të veprave penale të reja, e posaçërisht të formave të ndryshme të krimit të organizuar (trafiqet e paligjshme, pastrimi i parave, korrupsioni, terrorizmi etj.) Për këto krime u

ashpërsuan masat e dënimit me burgim. Deri me reformën e vitit 2013, Kodi Penal parashikonte në nenin 32 se: “Dënimi me burgim për krime jepet për një kohë nga pesë ditë deri në njëzetepesë vjet. Për kundërvajtje penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga pesë ditë deri në dy vjet” (Neni 32 i Kodit Penal deri në vitin 2013).

Reforma e vitit 2013 solli një ndryshim thelbësor në lidhje me sistemin e dënimeve. Kështu paragrafi i parë i nenit 32 u ndryshua si vijon: “Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet.” Ky ashpërsim i dënimeve u bë me qëllim luftimin e disa krimeve të cilat kanë gjetur përhapje të gjerë kohët e fundit, si ato që lidhen me mbrojtjen e familjes, fëmijëve, kundër gjakmarrjes, vrasjet në rrethana të tjera cilësuese për shkak të cilësive të viktimës etj.

Reforma e vitit 2013 e bërë vetëm një vit pas asaj të marsit të vitit 2012 ishte një reformë e cila nuk u diktua nga ndonjë studim kriminologjik apo pas dështimit të ndonjë mase parandaluese. Problemi nuk qëndron te dënimet, por fillon që me zbulimin dhe hetimin e këtyre krimeve. Shembuj janë vrasja e disa deputetëve dhe një gjyqtari këto vitet e fundit, autorët e të cilëve ende nuk janë gjetur. Strukturat përkatëse shtetërore duhet të hartojnë strategji më të plota dhe të marrin masat e duhura për të parandaluar këto krime dhe të mos mjaftohen me ashpërsimin e dënimit, i cili nuk do të sjellë uljen e kriminalitetit, përkundrazi do të lërë shkak për abuzime dhe tentativa të korrupsionit në sistemin e drejtësisë penale.

Pas reformës së vitit 2013, në lidhje me dënimet, Kodi Penal parashikon këto dënime maksimale në këtë numër paragrafësh:

<b>Me gjobë</b>	<b>Deri 3 muaj</b>	<b>Deri 6 muaj</b>	<b>Deri 1 vit</b>	<b>Deri 2 vjet</b>	<b>Deri 3 vjet</b>	<b>Deri 4 vjet</b>	<b>Deri 5 vjet</b>
302	14	12	35	62	80	12	98

<b>Deri 6 vjet</b>	<b>Deri 7 vjet</b>	<b>Deri 8 vjet</b>	<b>Deri 10 vjet</b>	<b>Deri 12 vjet</b>	<b>Deri 15 vjet</b>	<b>Deri 20 vjet</b>	<b>Deri 25 vjet</b>
5	35	18	71	3	49	26	3

<b>Jo më pak se 5 vjet</b>	<b>Jo më pak se 7 vjet</b>	<b>Jo më pak se 10 vjet</b>	<b>Jo më pak se 15 vjet</b>	<b>Jo më pak se 20 vjet</b>	<b>Jo më pak se 25 vjet</b>	<b>Jo më pak se 30 vjet</b>	<b>Burgim i përjetshëm</b>
4	1	2	24	11	2	5	25

Sipas Vjetarit Statistikor të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2012 (Vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë 2012):

<b>Periudha</b>	<b>Të dënuar</b>	<b>Me gjobë</b>	<b>Deri 2 vjet</b>	<b>2 – 5 vjet</b>	<b>5 – 10 vjet</b>	<b>10 – 25 vjet</b>	<b>Burgim të përjetshëm</b>
<b>2008</b>	7602	2897	3650	510	320	210	13
<b>2009</b>	7259	2942	3340	577	292	157	10
<b>2010</b>	7854	3270	3671	558	241	149	7
<b>2011</b>	9,071	3,838	4,234	630	259	155	13
<b>2012</b>	6,446	1,388	3,886	696	367	118	11

Me vendime përfundimtare për vepra penale të ndryshme sipas Kodit Penal (civil) janë gjykuar 11039 persona prej të cilëve:

Dënuar	8679
Deklaruar të pafajshëm	359
Është vendosur pushimi i çështjes	2001
<b>Totali</b>	<b>11039</b>

Në vitin 2011 kemi këtë numër të personave të dënuar:

Të dënuar për kundërvajtje penale	3,101
Të dënuar për krime	5,970
<b>Gjithsej</b>	<b>9,071</b>

*5.1.2. Sanksionet penale dhe institucionet e ekzekutimit të tyre sipas legjislacionit penal të Kroacisë*

Në **Kroaci** dënimet (kazne) parashikohen në dy kategoritë klasike të burgimit (zatvor) si dënim i privimit të lirisë dhe dënimi me gjobë (novčana kazna). Dënimi i privimit të lirisë është një dënim kryesor, ndërsa dënimi me gjobë parashikohet si dënim kryesor dhe dënim plotësues. Dënimet nuk parashikohen vetëm si masa sigurimi, por edhe si masa paralajmërimi (ku përfshihen dënime të kontrollit të lirisë si dënimi me kusht me mbikëqyrje). Për të miturit parashikohen në mënyrë të veçantë dënimet edukative (odgojne mjere).

Arsyeja përse kam vendosur që të krahasoj legjislacionin penal në fushën e ekonomisë, kodet penale për të gjitha shtetet e ish Federatës Jugosllave, duke përfshi Kroacinë dhe Sllovenin si anëtare tani të Bashkimit Evropian, qëndron për faktin që të gjitha këto shtete duke përfshi edhe Kosovën, për një kohë të gjatë deri në shkatërrimin e Jugosllavisë në vitet e nëntëdhjeta kanë pasur në zbatim legjislacionin penal të ish RSFJ-së.

Kjo situatë nuk ka penguar që secila nga republikat e kësaj federate të kenë edhe

legjislacionin e tyre penal por gjithsesi të ndikuar dhe të bazuar nga ai federativ. Andaj krahasimi i legjislacionit të këtyre vendeve e posaçërisht ai i shtetit Slloven dhe Kroat do të ndihmonin shtetet e tjera të Ballkanit si Kosovën, Serbin, Maqedoninë, Malin e zi dhe Bosnjë Hercegovinën si udhërrëfyes se si e kanë rregulluar legjislacionin penal ne fushën e ekonomisë që ka treguar rezultate konkrete ne zhvillimin e ekonomive të tyre dhe luftën e suksesshme ndaj korrupsionit dhe dukurive negative. Një arsye tjetër ka qenë edhe një mundësi e mirë me u pajise me literaturë dhe informata të nevojshme për këtë punim doktrate.

Kodi penal i Kroacisë i miratuar në vitin 2011, e që ka filluar të zbatohet nga viti 2013, ka paraparë standardet të larta ndërkombëtare dhe konsiderohet ndër ligjet më bashkëkohorë. Kodi kroat i ka sistemuar veprat penale në fushën ekonomike si grup në vete me emërtim të ri “veprat penale kundër ekonomisë” në kapitullin e XXIV nga neni 246 e deri te neni 265( Shih : Kodin Penal të Republikës së Kroacisë i vitit 2011, (Gazeta Zyrtare me nr 124/11)). Nëse e krahasojmë me ligjin penal të Kroacisë të vitit 1997, ky grup i veprave penale ndryshonte si në përmbajtje ashtu edhe në emërtimin e tyre(Shih: Ligjin Penal të Republikës së Kroacisë,(Gazeta Zyrtare nr. 110/1997, kreu XXI). Duke pasur parasysh faktin që Kodi penal i Kroacisë është hartuar plotësisht në përputhje me standardet dhe direktivat e Bashkimit Evropian, ka arritur që në një masë të madhe të rregulloj dhe inkriminojë veprimet kriminale në fushën ekonomike duke paraparë edhe politika ndëshkimore të larta për këto vepra penale dhe atë: dënime me gjobë dhe burgim deri në 10 vjet, pastaj ka paraparë konfiskimin e pasurisë të fituar me vepër penale. Ligjvënësi kroat ka ndëshkuar edhe tentativën për ta kryer veprën penale për disa nga veprat e parapara shprehimisht me ligj. Ndërsa, nëse e krahasojmë politiken ndëshkimore me at të vendit tonë shohim se sanksionet penale që i ka paraparë kodi penal i Kosovës

për këto vepra sa i përket dënimit me burgim janë më të larta sepse për disa nga veprat penale parashihet dënimi deri në 12 vjet burg. Mendoj që ligji penal i Kroacisë është përcaktuar për privimin nga liria vetëm në masën sa është e domosdoshme për ekzekutimin e sanksioneve penale në pajtim me ligjet pozitive në fuqi dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (Sadiku, 2010).

Kodi penal i Kroacisë përfundimisht ka vendosur standarde të larta në luftimin e veprimeve kriminale me gjithë plotësimet dhe ndryshimet e bëra në frymën e standardeve ndërkombëtare ka trashëguar dispozita ligjore nga legjislacioni penal i ish Jugosllavisë.

### *5.1.3. Sanksionet penale dhe institucionet e ekzekutimit të tyre sipas legjislacionit penal të Sllovenisë*

Krahasimi i kodit penal të Sllovenisë është bërë me qëllim që të shihet qartë rruga e ndryshimeve demokratike që ka pasur ky shtet duke u bërë pjesë e familjes evropiane pa marrë parasysh faktin që ishte pjesë e ish federatës jugosllave ku një pjesë e republikave tjera ende janë në fillim të rrugës të aderojnë në këtë familje. Gjithashtu, do të ishte me interes të shihet se si i ka rregulluar kodi penal Slloven veprat penale kundër ekonomisë, cila është politike ndëshkimore dhe sa ka qenë ndikimi i faktorit ndërkombëtar për ndryshimet e bëra.

Kodi penal i Sllovenisë në kapitullin 24 i ka paraparë 26 lloje të ndryshme të vepra penale kundër ekonomisë të cilat i ka sistemuar në kaptinë të veçantë. Gjatë trajtimit të këtyre veprave penale vërehet qartë ndikimi që ka pasur legjislacioni penal i RSFJ-së, siç është vërejtur edhe me rastin e trajtimit të veprave penale dhe ligjeve penale të vendeve tjera që ishin pjesë e RSFJ-së. Për dallim nga shtetet e tjera të Ballkanit, Sllovenia ka

treguar një gatishmëri të lartë për ta luftuar veprimtarinë kriminale në fushën e ekonomisë.

Kodi penal i Sllovenisë përmban këto vepra penale kundër ekonomisë(Kodin penal të Sllovenisë të vitit 2004(Gazeta zyrtare e R S), nga neni 225 deri me 250) si:

- “Keqpërdorimi i pozitës së monopolit”,
- “Mashtrimi i kreditorëve”,
- “Mashtrimi i letrave me vlerë”,
- “Komunikimi i paautorizuar i sekretit tregtar”,
- “Falsifikimi i parasë”,
- “Shpëlarjen e parasë dhe Evazionin fiskal”,
- “Kontrabandimin e mallrave” etj.

Gjatë krahasimit të veprave penale kundër ekonomisë sipas kodi penal të Sllovenisë konstatojmë se ka shumë ngjashmëri por ka edhe dallime që vlen të përmenden jo vetëm në përmbajtje por edhe në llojin dhe numrin e tyre. Kodi penal i Kosovë i vitit 2012, ka parapa 35 lloje të veprave penale(kodi penal të Kosovës të vitit 2012 (Gazeta zyrtare e R së Kosovës nr. 19/13) kapitulli XXV), që disa prej këtyre veprave si: “Cenimi i të drejtës së patentës”,

“Cenimi i të drejtës së autorit”, “Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm”, “Tregtia e ndaluar”, “Prodhimi i ndaluar”, “Marrëveshja dhe mashtrimi me letrat e qeverisë”, janë disa nga veprat penale që nuk i ka parapa ligjvënësi slloven në kapitullin e veprave penale kundër ekonomisë. Nëse e vështrojmë në aspektin e politikës ndëshkimore mundë të konstatojmë se dënimet e parapara për vepra penale kundër ekonomisë sipas ligjit penal të Sllovenisë janë të larta. Ligji parasheh dënime me gjobë dhe me burg deri në 12 vite, p.sh për veprën penale “Evazioni Fiskal”, dënimi me burg



është parapa deri në 12 vite për kryesin, ndërsa për veprat penale “ Falimentimi”, “Falsifikimi dhe shpërlaja e parave” deri në 10 vjet burg. Sipas mendimit tim ligjvënësi Slloven me të drejtë ka parapa këto dënime të larta për këto vepra duke pasur parasysh që ekonomia e vendit të ruhet nga falimentimi dhe veprat që kanë ndikim në destabilizimin e ekonomisë së vendit apo më mirë të themi që e varfërojnë buxhetin e vendit dhe që ndikojnë në rritjen e informalitetit dhe krimit ekonomik.

#### *5.1.4. Sanksionet penale dhe institucionet e ekzekutimit të tyre sipas legjislacionit penal Serbisë*

Kodi Penal i Republikës së Serbisë, veprat penale kundër ekonomisë, i ka paraparë në kreun njëzetedy si grup të veçante të sistemuar nga neni 223 e deri në nenin 245(Kodi Penal të Republikës së Serbisë i vitit 2012,(Gazeta Zyrtare nr. 121/2012)). Ligjvënësi Serb ka inkriminuar veprat penale kundër ekonomisë në 25 lloje. Duke qenë ligji i dytë në rajon për nga numri i veprave penale të inkriminuar në fushën e ekonomisë,meqenëse kodi penal i Kosovës i vitit 2012, ka parapa numrin më të madh të veprave penale 35. Sikur shumica e ligjeve të rajonit dhe ky ligj penal i ka kushtuar kujdes të rëndësishëm mbrojtjes juridiko-penale nga veprat penale kundër ekonomisë.

Artikulli 4 i Kodit Penal përcakton qëllimin e përgjithshëm të parashkrimit dhe shqiptimin e sanksioneve penale, si shtypjen e akteve të cilat cenojnë dhe rrezikojnë vlerat e mbrojtura nga legjislacioni penal. Qëllimi i dënimit në kuadër të qëllimit të përgjithshëm të sanksioneve penale është: 1) Parandalimi një shkelësin nga kryerja e veprave penale dhe sigurimin e ndikimit rehabilitues në mënyrë që ai / ajo nuk kryen vepra penale pas kësaj; 2) Ndikimi të tjerëve për të mos kryer vepra penale; 3) Shprehja e dënimi sociale

për një vepër penale dhe detyrimin e respektimit të ligjit; 4) Sigurimi forcën dhe ndikimin morale në zhvillimin e përgjegjësisë sociale.

Në vazhdim po paraqes disa vepra penale që i ka Kodi penal i Serbisë (Kodi Penal të Republikës së Serbisë i vitit 2012, (Gazeta Zyrtare nr. 121/2012)), kundër ekonomisë e që janë të inkriminuar edhe në kodin penal të Kosovës siç janë:

- “Falsifikimi i parasë”,
- “Falsifikimi i letrave me vlerë”,
- “Shpëlarja e parasë”,
- “Keqpërdorimi i pozitës së monopolit”,
- “Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi”,
- “Tregtia e ndaluar”, etj.

Këto vepra penale të specifikuar më lartë gjenden në të gjitha ligjet penale bashkëkohore të cilat janë hartuar bazuar në standarde të kërkuara nga Bashkimi Evropian. Gjatë analizimit të dispozitave ligjore të kiti ligji penal shihet se ai është krijuar nga ndikimi i drejtpërdrejtë i ligjit penal të RSFJ-së (Ligji Penal të RSFJ-së, 1997), e cila praktik i ka përcjellë edhe republikat e tjera të ish RSFJ-së. Në aspektin e politikës ndëshkimore ligjvënësi serbë është përcaktuar për dënime tejet të ashpra. Dënimet e parapara për këto vepra penale janë dënimi me gjobë dhe burg, pra dënime kumulative.

Kodi penal i Serbisë, ka paraparë konfiskimin e pasurisë në rastet e parapara shprehimisht me ligj. Dënimi më i lartë me burg në kuadër të këtij grupi të veprave penale është parapara për veprën penale “Falsifikimi i parasë”, sidomos për mënyrën e kualifikuar të kryerjes deri në pesëmbëdhjetë vjet burg dhe dënimi me gjobë.

Gjatë krahasimit të këtij ligji, duke parë anët pozitive dhe negative të tij mund të

konstatojmë se ligji në fjalë ka arritur një përparim të theksuar në inkriminimin e veprave penale kundër ekonomisë, por mendoj se ende nuk i plotëson standardet e një ligji bashkëkohor i cili do të garantoj sukses në luftën kundër kriminalitetit ekonomik e në veçanti kundër evazionit fiskal. Ajo që qartë vërehet edhe në këtë ligj është ndikimi që ka pasur legjislacioni penal i RSFJ-së, sidomos në përmbajtjen e veprave penale të para.

## **KAPITULLI VI**

### **ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONEVE TË EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE**

Institucionet korrektuese në gjithë botën janë institucione të vështira për tu udhëhequr, pasi paraqesin nivel të lartë të kufizimit të lirisë dhe të drejtave të njeriut, ku çdo herë është prezent rreziku i eskalimit të situatave jo të dëshirueshme, situatave tensionuese, dinamike dhe komplekse për tu menaxhuar si duhet dhe në përputhje me ligjin. Përkundër vështirësive, mbajtja e rregullit, sigurisë dhe përmbushja e standardeve minimale për trajtimin e të burgosurve, janë element shumë me rëndësi në krijimin e raporteve respektuese staf– të burgosur, raporte të cilat janë sfidë e vazhdueshme në punën e përditshme në Institucionet korrektuese. Unë besojë se mënyra si i trajtojnë shoqëritë ata të cilëve u është hequr liria, është provë vendimtare e përkushtimit ndaj drejtave të njeriut. Në botë ekzistojnë një numër i madh traktatesh dhe standardesh ndërkombëtare për drejtimin e shërbimeve në burgje (Coyle, 2005). Republika e Kosovës si shtet i ri, krahas infrastrukturës ligjore, në këtë lëmi mbështet dhe përfillë zbatimin e këtyre marrëveshjeve, me qëllim të një organizimi dhe funksionimi sa ma të mirë të Institucioneve korrektuese në përgjithësi.

#### **6.1. Shërbimit Korrektues të Kosovës– organizmi dhe funksioni**

Shërbimi Korrektues i Kosovës është themeluar menjëherë pas luftës, më 05 Nëntor 1999 fillimisht me hapjen e Qendrës së Paraburgimit në Prizren.

Personeli vendor ishte kryesisht staf që kishin punuar para lufte.

Në maj të vitit 2000 për herë të parë rekrutohen personel korrektues të rinj në bazë të konkursit.

Shërbimi Korrektues është një shërbim funksional dhe i avancuar në të gjitha fushat; Kjo ka ardhur si rezultat i ndihmës së bashkësisë ndërkombëtare që nga themelimi; Investimet e vazhdueshme nga buxheti i Republikës së Kosovës;

Përkrahja dhe mbështetja nga Organizatat e ndryshme jo qeveritare dhe qeveritare; Shumë organizata ndërkombëtare kanë përgëzuar Shërbimin Korrektues për qasje dhe punë profesionale (<http://aksp.rks-gov.net/?page=2,144>).

Shërbimi Korrektues i Kosovës, ka për mision që në bashkëpunim me të gjithë partnerët e Drejtësisë dhe në përshtatshmëri të vazhdueshme me ligjet në Kosovë synon të korrektojë dhe risocializojë të burgosurit duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën dhe religjionin si dhe siguron një ambient të sigurt për stafin, të burgosurit dhe shoqërinë. Shërbimi Korrektues është i vendosur në promovimin e barazisë në të gjitha sferat e punës dhe veprimit. SHKK-ja vepron si dhe është një shoqëri e barbarët gjithmonë në ngritje duke respektuar barazinë gjinore, përkatësin kombëtare, të drejtën e mendimit dhe besimit, statusin social etj. Fakte këto të cilat janë të dëshmuar në personelin e punësuar si dhe të burgosurit nën kujdesin tonë. Ndalimi i cilit do lloj të diskriminimit është një prej prioriteteve kryesore të SHKK-së dhe pjesë e agjendës së gjerë të barazisë, gjë e cila është esenciale për udhëheqjen e sigurt dhe të suksesshme të SHKK-së. Për të ngritur nivelin e barazisë e vetmja mënyrë e drejtë është të sigurohemi se gjithë trajtohen më mënyrë të drejt, pa dallim ngjyre, gjinie, race, besimi, bindje politike, statusi social dhe aftësive psikike-Fizike. E arritur dhe sfidë për të gjithë. SHKK-ja është përgjegjës për administrimin e të burgosurve, paraburgosurve, dënuarve, miturve në bazë të ligjeve të aplikueshme të Kosovës, si dhe konventave Evropiane dhe

rregulloreve te tjera te lëshuara në institucionet përkatëse. SHKK-ja është përgjegjës për menaxhimin e institucioneve të niveleve të ndryshme të sigurisë dhe mbikëqyrjen e personave nën kujdesin e SHKK-së.

#### *6.1.1. Profesionalizmi ,synimi dhe objektivat e këtij shërbimi*

Stafi dhe Udhëheqësit bashkë veprojnë në mënyrë profesionale me të burgosurit. Puna së bashku, ndihma ndaj të tjerëve si dhe ngritja e marrëdhënieve të jashtme dhe brendshme Duke qenë punëtor I cili zgjedh vlerat profesionale, vazhdon të besoj në vlerat inspiruese përparimtare, inkurajon punëtorët që të kenë krenari për punën e tyre, për vlerat dhe kontributin që ofrojnë. Mundëson dhe siguron që personat të marrin përgjegjësi personale për veprimet e tyre. Profesionalizmi i personelit të SHKK-s vlerësohet në periudha të ndryshme kohore me qëllim të përcaktimit të nivelit profesional të tyre. Duke qenë të vetëdijshëm për detyrat tona specifike dhe madhore synimet tona janë të ndërlidhura edhe me zhvillimet e shoqërisë në përgjithësi, besojmë se roli dhe synimet tona të arritura në të kaluarën dhe ardhmen do të jenë fundamentale për një shoqëri ku dominon ligji dhe respektohen lirit dhe të Drejtat e të gjithëve. Synimet tona strategjike do jenë: **1.** Sigurimi I një menaxhimi efektive për të burgosurit. Duke ndryshuar kushtet për menaxhimin dhe zbatimin e rregulloreve në pajtim me drejtat e të burgosurve, duke zhvilluar praktikat që më së miri do të përshtaten, **2.** Kontributi në reduktimin e Recidivizmit, SHKK-ja synon të reduktoj nivelin e recidivizmit duke ofruar programe për rehabilitim dhe ri-integrim të suksesshëm të burgosurve. **3.** Rritjen e aftësive dhe kapaciteteve. Për punë të suksesshme SHKK-ja ka nevojë për ngritje të aftësive vepruese dhe kapaciteteve (teknologji dhe infrastrukturë.), **4.** Nxjerrja e vazhdueshme e

rregulloreve të brendshme që ndihmojnë në konkretizimin e dispozitave të përgjithshme të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe respektimin e të drejtave të burgosurve; **5.** Krijimi i kushteve për arsimim të obligueshëm fillor dhe atë profesional për të burgosur, dhe ofrimi I programeve adekuate për aftësime profesionale të ndryshme; **6.** Bashkëpunimi me Organizatat Qeveritare dhe Jo Qeveritare në interes të shërbimit në përgjithësi si dhe të burgosurve në veçanti (www.md-ks,ballina,departamentet.-Shërbimi Korrektues I Kosovës).

## **6.2. Si funksionon shërbimi korrektues i Kosovës, dhe baza ligjore e tij**

Shërbimi Korrektues ka filluar të jetë operativ në nëntor të vitit 1999 fillimisht në qendrën e paraburgimit Prizren. Gjendja në atë periudhë fillestare kohore ishte e mjerueshme, me infrastrukturë të shkatërruar, nuk kishte as kushtet elementare për të operuar.

Fillimisht me ndihmën e donatorëve si dhe më punën e tërë stafit në të gjitha nivelet u krijuan disa kushte më elementare, dhe deri në vitin 2001, viti I cili shënoi fillimin e funksionimit të mirëfilltë, tani Shërbimi vepron dhe ka nën administrim institucionet si:

*- Burgun e Dubravës;*

*- Qendrën Korrektuese Lipjan;*

*- Qendrën e Paraburgimit Prizren;*

*- Qendrën e Paraburgimit Prishtinë;*

*- Qendrën e Paraburgimit Gjilan;*

*- Qendrën e Paraburgimit Pejë*

**- Qendrën e Paraburgimit Mitrovicë;**

Duke pas parasysh mundësit dhe punët të cilat janë duke I zhvilluar më intensitet të lartë besojmë së shumë shpejt do të vejmë në funksione dhe institucione të tjera shtesë në funksion të cilat i takojnë dhe do të shërbenin për perfeksionin e shërbimit dhe arritjen e synimeve si në të mirë të atyre që ne i kemi nën kujdes po ashtu edhe të stafit.

Shërbimi korrektues i Kosovës funksionojnë në përputhje me infrastrukturën ligjore ekzistuese, si që është Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Kodin Penal i Kosovës, Kodin e Procedurës, Kodin për të Mitur si dhe në bazë rregullave dhe standardeve ndërkombëtare..

Në veçanti Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ka për qëllim ekzekutimin e sanksioneve penale, sanksioneve kundërvajtëse dhe masave të trajtimit të detyrueshëm, si dhe aplikimin e masës së paraburgimit.

Ekzekutimi i sanksioneve penale ka për qëllim risocializimin dhe riintegrimin e të dënuarit në shoqëri dhe përgatitjen e tij për jetë dhe për sjellje të përgjegjshme (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013, shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 4:1).

Ekzekutimi i sanksioneve penale, po ashtu shërben për mbrojtjen e shoqërisë duke e parandaluar kryerjen e veprave tjera penale dhe duke përmbajtur të tjerët nga kryerja e veprave penale.

Organ Ekzekutiv për Ekzekutimin e Sanksioneve penale është Shërbimi Korrektues i Kosovës i cili është organ qendror i administratës shtetërore, profesional, i pavarur, i uniformuar dhe pjesërisht i armatosur, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013, shpallur me



Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 205:53).

Shërbimi Korrektues i Kosovës është përgjegjës për kryerjen e këtyre punëve:

- Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm;

- Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e burgimit të të miturve dhe masave edukuese,

- Organizimin e programeve që i kontribuojnë korrektimit, përgatitjes për lirim dhe mbikëqyrjes afatgjatë të personave të dënuar me burgim dhe burgim të përjetshëm;

- Vlershmin e rrezikut kriminogjen dhe përcaktimin e nevojave për trajtim të kryerësve të veprave penale;

- Udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar në përfundim të dënimit të tyre;

- Ndërmarrjen e masave me qëllim të arsimimit dhe aftësimit profesional të personelit civil dhe të zyrtarëve korrektues të punësuar;

- Të bashkëpunoj me institucionet përkatëse, shoqatat dhe organizatat të cilat merren me problemet e ekzekutimit të sanksioneve penale; (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 205)

Shërbimi korrektues i Kosovës ka statusin e personit juridik, ka shenjën e vet identifikuese dhe ka selinë në Prishtinë.

Shërbimi Korrektues i Kosovës ka strukturën e vetë organizative, andaj për kryerjen e punëve dhe detyrave nga kompetenca e shërbimit themelohet

- Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues me seli në Prishtinë si dhe

- Institucionet Korrektuese.

Shërbimi Korrektues i Kosovës si përgjegjës për krijimin e sigurisë dhe funksionimin ligjor të Institucioneve Korrektuese ka nxjerrur këto Rregulla të Brendshme;

Lista e Rregullave të Brendshme për Institucionet Korrektuese, Rendet Shtëpiake, Rregullat për staf:

- Qëllimi dhe domthënja;
- Fshehtësia e informacionit;
- Shpërndarja dhe zbulimi i informacionit;
- Ankesat dhe pakënaqësitë e të burgosurve;
- Udhëzimet e mediave;
- Ushqimi i të burgosurve;
- Pranimi i të burgosurve;
- Menaxhimi i të burgosurve të kategorisë-rrezikshmëria e lart dhe shumë e lart;
- Përcjellja e të burgosurve me siguri nga ana e Oficerëve të Shërbimit Korrektues;
- Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit ;
- Procedurat e lirimimit;
- Transferimi i të burgosurve;
- Numri i të burgosurve;
- Vdekja në burg;
- Procedurat e kartelav telefonike;
- Menaxhimi i të burgosurve me rrezikshmëri të lartë për arratisje;
- Kontrollimi i zonës rrethuese të sigurimit;
- Kontrollimi i hyrje daljeve në burg;

- Kontrollimi i automjeteve që hynë e dalin në burg;
- Kontrollimi i çelësave (funksionimi I tyre);
- Kontrollimi i veglave;
- Kontrollimi – bastisjet e (të burgosurve dhe të vizitorëve);
- Shkeljet disiplinore nga të burgosurit;
- Shkeljet e ligjit nga të burgosurit ;
- Ndarja e të burgosurit (dërgimi në vetmi);
- Ndarja e të miturve;
- Parandalimi i incidenteve të sigurisë
- Përdorimi i forcës;
- Përdorimi i armëve të zjarrit;
- Administrimi i armëve të zjarrit;
- Vizitat ;
- Pushimi jashtë burgut;
- Ofrimi i shërbimit mjekësor;
- Konstatimi i gjendjes mjekësore dhe pëlqimi për trajtim mjekësor ;
- Protesta me refuzim të ushqimit ;
- Parandalimi i vetëvrasjes dhe vetëlëndimeve;
- Përcjellja e të burgosurve në raste të jashtëzakonshme;
- Rregullat e brendshme të punës së njësitit për transportin e të burgosurve;
- Rregullat e brendshme të punës për përdorimin e armëve të zjarrit;
- Kategorizimi i të burgosurve;
- Tretmanët-Regjimet për të dënuar;
- Tretmanët-Regjimet për të mitur;

- Tretmanët-Regjimet për të paraburgosur;

- Tretmanët-Regjimet për të femra të dënuara,

### **Rendi Shtëpiak i Qendrave të Paraburgimit dhe Qendrave Korrektuese**

•Rendi Shtëpiak për të burgosur në Qendrën Korrektues për dënime të gjata në Dubravë,

- Rendi Shtëpiak për të mitur në Qendrën Korrektues në Lipjan,

- Rendi Shtëpiak për të paraburgosur në 06 Qendrën e Paraburgimit,

Procedurat e punës në Shërbimin Korrektues të Kosovës:

- Procedura për dhënien e beneficioneve personave të dënuar dhe të mitur;

- Klasifikimi dhe Riklasifikimi i të dënuarve;

- Koncepti I arsimimit të burgosurve ;

- Koncepti I punësimit të burgosurve në Institucionet Korrektues;

- Zhvillimi I programeve për të dënuar dhe të mitur;

- Trajnimet e stafit në të gjitha nivelet e Shërbimit Korrektues të Kosovës;

- Destinomi I Institucioneve Korrektues;

- Planifikimi I dënimit për të burgosur ;

- Procedura për pushim në shtëpi të burgosurve;

- Procedura për arsimimin dhe edukimin e të miturve në Qendrën Korrektuese në

Lipjan;

Rregullat për Staf të Shërbimit Korrektues:

- Standardet e sjelljes Profesionale;

- Kodi I disiplinës;

- Orari I punës së Personelit;

- Uniforma e Stafit Korrektues;

•Rregulloret për shërbyesit civil që zbatohen edhe për SHKK-së(Sijerçiq – Çoliq, Haliloviq, 2007).

### **6.3. Struktura organizative e Shërbimit Korrektuese**

#### *6.3.1. Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues*

Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues e mbikëqyrë, përcjellë ligjshmërinë e punës dhe veprimet të institucioneve korrektuese dhe të njësive organizative të Shërbimit Korrektues.<sup>14</sup>

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues udhëheqë edhe Zyrën Qendrore të Shërbimit Korrektues. Në Zyrën Qendrore të Shërbimit Korrektues janë të themeluara Drejtoritë dhe sektorët, me të cilat udhëheqin personat të cilët caktohen në postin e udhëheqësit nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues.

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues emërohet në bazë të konkursit të hapur nga Ministria e Drejtësisë. Për punën e tij Drejtori i Përgjithshëm i përgjigjet drejtpërsëdrejti Ministrit të Drejtësisë.

Shërbimi Korrektues ka edhe zëvendës drejtorët e Përgjithshëm të cilët emërohen sipas procedurës, dhe kushteve të parapara për Drejtorin e Përgjithshëm.

Strukturën organizative të Zyrës Qendrore të Shërbimit Korrektues të Kosovës më

---

<sup>14</sup> Shërbimi Korrektues mbikëqyrë udhëheq dhe menagjon punën e institucioneve korrektuese, si: Qendrave të praburgimit, Qendrave korrektuese, Qendrave për të mitur dhe femra si dhe Burgun e sigurisë së lartë. Ky shërbim ka Drejtorinë Qendrore në Prishtinë dhe mbikëqyr nga Ministria e Drejtësisë. Varësisht nga vendet dallon edhe emri i institucionit që mbikëqyr burgjet. Në disa vende hasim termin Drejtoria e Burgjeve, në disa Enti për ekzekutimin e sanksioneve penale, në disa Shërbimi korrektues. Si do që të jet qëllimi është i njëjtë, pasi të gjitha kanë për qëllim menagjimin dhe mbikëqyrjen e punës së institucioneve ku bëhet ekzekutimi i sanksioneve penale.

së mira e pasqyron organografi i më poshtëm,.

Një strukturë e tillë është paraparë në bazë të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Në zyrën Qendrore të Shërbimit Korrektues të Kosovës janë të punësuar gjithsejtë 60 gjashtë dhjetë zyrtar, të cilët punojnë në sektorë të ndryshme. Stafi profesional i zyrës qendrore mbështet dhe ndihmon punën profesionale të të gjitha institucione. Fushat kryesore që janë të paraqitura edhe sipas organogramit dhe strukturës organizative kanë të bëjnë me :

- Çështjet ligjore dhe administrative,
- Siguria e personave dhe stafit, si dhe
- Trajtimi i të burgosurve

Në kuadër të këtyre tri shtyllave kryesore ekzistojnë edhe drejtoritë dhe sektor të ndryshëm si sektori financave, sektori i transportit të burgosurve, sektori i inxhinieringut, sektori për arsimim dhe aftësim profesional, sektori shëndetësor, personeli, logjistika, sektori për agro-ekonomi dhe prodhim në institucione korrektuese (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 206 dhe 207: 53 dhe 54).

### *6.3.2. Llojet e institucioneve korrektuese*


Shërbimi Korrektues i Kosovës menaxhon dhe mbikëqyrë punën e të gjitha institucioneve korrektuese. Sipas Ligjit të Ekzekutimit të Sanksioneve Penale, në Shërbimin Korrektues ekzistojnë këto lloje të institucioneve korrektuese:

- Qendrat e paraburgimit, për ekzekutimin e paraburgimit dhe dënimeve me burgim

deri në tre (3) muaj,

- Burgjet, për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe burgim të përjetshëm,
- Burgjet për femra, për ekzekutimin e dënimit me burgim, burgim për të mitur të shqiptuar ndaj femrave,
- Burgjet për të mitur, për ekzekutimin e burgimit për të mitur,
- Institucionet edukativo-korrektuese për ekzekutimin e masave edukative të dërgimit të kryesit të mitur në institucionin edukative-korrektues,
- Qendrat korrektuese për dënime të gjata dhe të shkurta,
- Spitali dhe ambulancat e institucioneve korrektuese, për trajtimin e personave të paraburgosur dhe personave të dënuar.

# ORGANOGRAMI I DREJTORISË QENDËRORE TË BURGJEVE TË KOSOVËS





### *6.3.3. Organizimi i institucioneve të ekzekutimit e sanksioneve penale për të rriturit*

Institucionet për ekzekutimin e sanksioneve penale për të rritur janë të përcaktuara me Ligjin e ekzekutimit të sanksioneve penale dhe në përputhje me faktin se a kemi të bëjmë me masën e paraburgimit apo me dënimin e shkurtër me burg 3 muaj gjerë në 3 vjet apo dënimin e gjatë me burgim të gjatë gjerë në 25 vjet apo me burgimi të përjetshëm, në këtë mënyrë janë të organizuara dhe funksionojnë edhe institucionet për ekzekutimin e sanksioneve penale në Kosovë. Varresht se a kemi të bëjmë me masën e paraburgimit, dënimin me burg të shkurtër, dënimin me burg të gjatë apo dënimin me burg të përjetshëm, ekzistojnë edhe institucionet adekuate për ekzekutimin e sanksioneve penale. Në kuadër të Shërbimit korrektues të Kosovës, funksionojnë këto institucione për ekzekutimin e sanksioneve penale për të rritur:

- Qendrat e paraburgimit, për ekzekutimin e paraburgimit dhe dënimeve me burgim deri në tre (3) muaj,
- Burgjet, për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe burgim të përjetshëm,
- Burgjet për femra, për ekzekutimin e dënimit me burgim, burgim për të mitur të shqiptuar ndaj femrave,
- Qendrat korrektuese për dënime të gjata dhe të shkurta,

## **6.6. Qendrat e paraburgimit, për ekzekutimin e paraburgimit dhe dënimeve me burgim deri në tre (3) muaj**


Masa e paraburgimit ekzekutohet në institucionet përkatëse korrektuese, e ato janë Qendra Paraburgimit, ku vendosen personat e dyshuar për të cilët supozohet se kanë kryer veprë penale (Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale në Kosovë, paragrafi 1,2 dhe 3). Personave të dyshuar u caktohet paraburgimi dhe vendosën në Qendra të Paraburgimit në bazë të aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake të gjykatës kompetente. Gjyqtari I procedurës paraprake nxjerr Aktvendim për paraburgim në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit, pas seancës dëgjimore (Kodi i Procedurës penale të Kosovës, Nr. 04/L-123, neni 188). Bashkë me aktvendimin për caktimin e paraburgimit institucionit korrektuese përkatës - Qendra së Paraburgimit I dërgohet edhe urdhri me shkrim për pranim të personit të paraburgosur. Qendra e Paraburgimit lëshon vërtetim me shkrim për pranimin e të paraburgosurit, ku shënohen të dhënat e të paraburgosurit si dhe data dhe koha e pranimit (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149). Me rastin e pranimit në Qendrën e Paraburgimit., kryhet kontrolli mjekësor I të paraburgosurit, njoftohet me rregullat institucionale, si dhe me të drejtat dhe detyrimet gjatë kohës së zbatimit të masës së paraburgimit. Të paraburgosurit të cilët së bashku kanë marrur pjesë në kryerjen e veprës penale sistemohen në lokale të veçantë (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149). Vetë nocioni Qendër e Paraburgimit ka të bëjë me Institucionin ku bëhet Organizimi, zbatimi dhe mbikëqyrja e ekzekutimit të masës së paraburgimit, të caktuar nga Organi kompetent i Drejtësisë, për dyshim se personi ka kryer veprë penale.

Në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës funksionojnë gjashtë (6) Qendra të Paraburgimit si : - Qendra e Paraburgimit në Prishtinë, Qendra e Paraburgimit në Prizren, -Qendra e paraburgimit në Pejë, Qendra e paraburgimit në Gjilan, Qendra e Paraburgimit në Lipjan dhe Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë

Të gjitha Qendrat e paraburgimit kanë strukturë të njëjtë organizative, kurse për nga numri i stafit thuaja se përafërsisht kanë numër të njëjtë të stafit dhe kapacitetet e tyre përafërsisht janë të njëjta me pak specifika për nga hapësirat poseduese dhe rregullimi infrastrukturor. Struktura organizative e Qendrave të Paraburgimit është pasqyruar në organogramin e mëposhtëm, si:

Pasi Qendrat e Paraburgimit gjenden në të gjitha Qytetet ma të mëdha të Kosovës, kapacitetit I tyre nuk është i madh, çka mesatarisht këto institucione mund të pranojnë 70 – 90 të paraburgosur. Në Qendrat e Paraburgimit pos personave me masë të paraburgimit, mbajnë dënimin edhe personat e dënuar me burg gjerë në tre muaj. Kjo kategori i të dënuarve u nevojitet institucioneve për kryerjen e punëve të ndryshme, si për pastrim mirëmbajtje, punë në kuzhinë, etj. Shikuar në tërësi Qendrat e Paraburgimit janë objekte të vjetra, me kapacitete të vogla dhe ma një strukture organizative të njëjtë. Këto institucione datojnë që nga vitet 60 të shekullit XX njëzet. Vlen të ceket se Qendra e Paraburgimit në Prishtinë dhe ajo në Mitrovicë datojnë që nga viti 1953. Për shkak të vjetërsisë së tyre këto institucione janë rinovuar disa here dhe janë krijuar kushte minimale për akomodimin e të paraburgosurve.

Në vijim në tabelë kemi strukturën organizative të 6 Qendrave të Paraburgim (Rregullat e brendshme të punës, Sistematizimi i vendeve të punës, stafi i Qendrave të Paraburgimit, Prishtinë 2009)



### Qendra e paraburgimit në Prishtinë

INSTITUCIONI	Kapaciteti
Qendra e Paraburgimit në Prizren	75 par.+20 den=95
Qendra e Paraburgimit në Pejë	65 par.+15 den=80
Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë	70 par.+20 den=90
Qendra e Paraburgimit në Gjilan	65 par.+30 den=95
Qendra e Paraburgimit në Prishtinë	65 par.+15 den=80
Qendra e Paraburgimit në Lipjan	70 par.+25 den=95
<i>Totali</i>	555

Për krijimin e kushteve sa më të mira për akomodim, këto institucione janë rinovuar nga disa herë, nga viti 2000, e gjerë në vitin 2014. Me renovimin e tyre janë krijuar kushte pak më të mira për akomodim, por nuk ofrojnë kushte të mjaftueshme dhe të nevojshme për shëtitje, rekreacion, për shfrytëzim të kohës së lirë dhe nevoja tjera për të

paraburgosur. Vlen të ceket se edhe për nga kapaciteti këto institucione kanë mbetur të vogla. Duke i parë nevojat për shtimin e kapaciteteve, Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës kanë filluar të ndërtojnë Qendrën e re të Paraburgimit në Prishtinë me kapacitet prej 300 të paraburgosurve si dhe Qendrën e re të Paraburgimit në Gjilan po ashtu me kapacitet prej 300 të paraburgosurve. Këto institucione pritet të përfundojnë së ndërtuari kah fundi i vitit 2015 dhe të vihen në funksion ka fillimi i vitit 2016. Me funksionalizimin e këtyre dy institucioneve të paraburgimit, Shërbimi Korrektues i Kosovës do të ketë kapacitete të mjaftueshme për akomodimin e personave të paraburgosur. Vlen të ceket se në mungesë të kapaciteteve të mjaftueshme për të paraburgosur, të gjitha institucionet janë të stërngarkuara dhe kanë të akomoduar të paraburgosur mbi kapacitetin e tyre. Për këtë arsye të stërngarkimit të institucioneve, Shërbimi korrektues i Kosovës shpesh është kritikuar nga monitoruesit vendor dhe ata ndërkombëtar.

#### **6.7. Burgjet, për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe burgim të përjetshëm**

Personat e dënuar me burgim dhe burgim të përjetshëm dërgohen në institucion korrektues për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm, në pajtim me aktin e vendosjes të Ministrit të Drejtësisë (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149). Gjykata themelore e cila ka dhënë dënimin është kompetente për dërgimin e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim, ose me burgim të përjetshëm (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale neni 14 paragrafi 1) .

Në kuadër të këtyre institucioneve për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe burgim të përjetshëm, Shërbimi korrektuese i Kosovës posedon:

- Burgun e sigurisë së lartë,
- Qendrën Korrektuese për dënime të gjata dhe
- Qendrën Korrektuese për dënime të shkurta

## **6.8. Burgu i sigurisë së lartë**

Burgu i sigurisë së lartë, si institucion i rëndësishëm së veçantë për Shërbimin Korrektues të Kosovës, është lëshuar në funksion në fillim të vitit 2014. Një institucion i tillë i ka munguar Kosovës në të kaluarën, andaj si pasojë e kësaj shpesh kanë ndodhur ikje të burgosurve nga institucionet.

Me vendimin e Gjykatës kompetente ,në Burgun e sigurisë së lartë prahen personat e dënuar me burgim të përjetshëm, personat e dënuar mbi 15 pesëmbëdhjetë vjet burg, përsëritësit e veprave penale, personat e dënuar e të klasifikuar me rrezikshmëri të shumë të lartë si dhe personat e paraburgosur të klasifikuar me rrezikshmëri shumë të lartë (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 206 dhe 207: 53 dhe 54).

Kur personi i dënuar prahet në institucion, së pari vërtetohet identiteti i tij, baza dhe autorizimi për burgim ose burgim të përjetshëm dhe më pas i nënshtrohet kontrollimit mjekësor. Në regjistrin dhe dosjen e personit të dënuar shënohen të dhënat, si baza dhe autorizimi për burgim ose burgim të përjetshëm, data dhe koha e pranimit, raporti mjekësor dhe të dhënat tjera personale. Me rastin e pranimit i personi i dënuar njoftohet me shkrim për të drejtat dhe detyrimet që i ka gjatë mbajtjes së dënimit (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 31, paragrafi 1,2dhe3).

Për të dënuarit me burgim dhe burgim të përhershëm është më se e nevojshme një siguri maksimale me rastin e vendosjes dhe ruajtjes së tyre në institucion korrektues.

Institucioni korrektues, burgu i sigurisë së lartë është institucion i tipit të mbyllur dhe ka siguri maksimale fizike, teknike dhe materiale. Sigurinë fizike e karakterizon rrethoja e dyfishtë e perimetrit të jashtë me mure të larat, të forta dhe me rrethoja teli gjembor mbi mure. Krahas mureve fizike ekzistojnë edhe vendshiqimet, nga të burgosurit vëzhgohen dhe përcillen nga stafi korrektues. Këto vendshiqime në mes veti janë të lidhura me staza shëtitëse, në të cilat stafi korrektues i armatosur shëtit, përcjell dhe siguron të burgosurit në këtë institucion (Rregullat e brendshme të punës për Burgun e sigurisë së lartë, mars 2014).

Pos sigurisë fizike ekziston edhe siguria teknike e institucionit, pasi çdo objekt dhe të gjitha vendet ku qëndrojnë, shëtisin, punojnë, dhe merren me sport të burgosurit përcillen me sistemin digjital të kamerave. Vlen të ceket se dhomat e fjetjes së të burgosurve nuk kanë sistem të përcjelljes me kamera si dhe dhomat për vizita të lira.

Kapaciteti i këtij institucioni është për 400 të burgosur dhe është paraparë të punojnë 300 punëtor, prej tyre 250 oficer korrektues të ubiformuar dhe të armatosur dhe 50 staf civil për shërbime të ndryshme administrativo – teknike.

Pasi këtë vit është lëshuar në funksion theksojë se ende ky institucion nuk ka plotësuar numrin e stafit të planifikuar dhe po ashtu ende nuk ka numër të plot të të burgosurve sa është edhe kapaciteti i tije.

## 6.9. Qendra Korrektuese për dënime të gjata

Kjo qendër korrektuese është institucionin tipit të mbyll, por posedon edhe objektin e tipit gjysmë të hapur. Ky institucion ka tetë (8) pavijone-objekte për vendosjen e të burgosurve në tipin e mbyllur dhe një objekt për vendosjen e të burgosurve në tipin gjysmë të hapur. Në të mund të vendosen të burgosurit e dënuar me dënim me burg mbi tri (3) vjet e gjerë në pesëmbëdhjetë (15) vite burg. Në këtë institucion është paraparë që të vendosën edhe të burgosurit me dënim të përjetshëm, por pasi ta kanë mbajtur minimum 1/3 e dënimit me burgim të përjetshëm në Burgun e sigurisë së lartë. Në kushtet dhe rrethanat normale në këtë institucion mund të vendosën tetëqind (800) të burgosur në tipin e mbyllur dhe njëqind (100) të burgosur në tipin gjysmë të hapur. Institucion ka siguri fizike, teknike dhe materiale, pasi këtu të dënuarit janë me dënime të gjata. Mirëpo objekti I tipit gjysmë të hapur që ka kapacitet për njëqind (100) të burgosur ka vetëm siguri materiale, që do të thotë oficer korrektues që përcjellin lëvizjet e të burgosurve, kurse nuk ka pengesa fizike dhe teknike (nuk ka mure dhe sistem të kamerave). Në këtë institucion punojnë një numër I konsiderueshëm I stafit dhe atë 450 oficer korrektues të uniformuar dhe 150 staf civil të profesioneve të ndryshme Në kuadër të këtij institucioni ekzistojnë edhe drejtorit që merren me punë profesionale me të burgosur, si :

- Drejtoria për siguri,
- Drejtori për trajtimin e të burgosurve,
- Drejtoria për administratë,
- Drejtoria për shëndetësi
- Drejtoria për punësimin e të burgosurve
- Drejtoria për njësinë ekonomike



- Drejtoria për arsim dhe aftësim Professional të të burgosurve,

- Drejtoria për kulturë dhe sport.

Në kuadër të këtyre drejtorive ekzistojnë edhe sektorë të ndryshëm. Në kuadër të qendrës Korrektuese për dënime të gjata në Dubravë – Istog ekziston burgu për të dënuar dëshmitar të mbrojtur, spitali për të burgosur, shkolla e mesme dhe katër punëtori të aftësimit Professional për të burgosur me gjithsejtë 12 profesione.

Institucioni posedon amfiteatrin për shfaqje kulturore, sallën e edukatës fizike dhe fushat e sportit.

Po ashtu edhe trajnimeve të stafit i kushtohet një kujdes, andaj aty ekziston objekti për trajnimin teorike dhe praktike të stafit si dhe poligoni I gjuajtjes me armë të zjarrit. Për staf mbahen ligjërata nga instruktorët e certifikuar si dhe ushtrimet fizike e taktike të nevojshme për punën profesionale të oficerëve korrektues.

Institucioni posedon 80 hektar tokë punues ku ka të mbjellura të ndryshme, serrat e perimeve si dhe fermën e lopëve së bashku ne thertoren.

Një numër i konsiderueshëm i të burgosurve punësohen në serrat, agrikulturë, fermë si dhe në punëtoritë e këtij institucioni (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149) .

#### **6.10. Qendra korrektuese për dënime të shkurta**

Qendra korrektuese për dënime të shkurta në Smrekonicë është institucion I tipit gjysmë të hapur, andaj nuk ka siguri fizike në fermë të mureve të të larta, por a vetëm rrethoj teli dhe siguri materiale-oficer korrektues dhe staf civil Professional për punë me të burgosur, të cilët mbikëqyrin dhe përcjellin të burgosurit. Në këtë institucion vendosën

të burgosurit e dënuar gjerë në tri (3) vite dhe të dënuarit që mbetja e dënimit është tri vite. Të dënuarit me dënime të gjata në Dubravë, pasi të mbajnë një pjesë të dënimit dhe mbretja të jetë tri vite mund të transferohen në këtë institucion për dënime të shkurta. Në këtë institucion nuk mund të vendosen personat që janë recidivist dhe përdorues të mjeteve narkotike, pa marrur parasysh se dënimi I tyre është gjerë në tri (3) vite. Qendra korrektuese për dënime të shkurta ka kapacitet për vendosjen e dyqind (200) të burgosurve. Posedon objektet për aktivitete kulturore dhe sportive si dhe punëtorit për punësimin e të burgosurve. Po ashtu ka sipërfaqe të konsiderueshme të tokës dhe serat për prodhimin e perimeve. Në kuadër të institucionit ekziston ambulanca me mjek të përhershëm dhe staf ndihmës medicinal. Në këtë institucion punojnë gjithsejtë janë të punësuar 60 punonjës prej tyre tridhjetepesë (35) oficer korrektues dhe njëzetepesë (25) staf civil profesional të profesioneve të ndryshme për punë me të burgosurit.

Në kuadër të këtij institucioni ekzistojnë edhe drejtorit që merren me punë profesionale me të burgosur, si :

- Drejtoria për siguri,
- Drejtori për trajtimin e të burgosurve,
- Drejtoria për administratë,
- Drejtoria për kulturë dhe sport.

Në kuadër të drejtorive ekzistojnë edhe sektorë të ndryshëm, si ai i punësimit të burgosurve, i përkujdesjes shëndetësore, sektori për të drejtat dhe beneficinet e të burgosurve

## **6.11. Burgjet për femra, për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe masës së paraburgimit**

Ekzekutimi i burgimit për femra si dhe masa e paraburgimit për femra mbahet në Qendrën Korrektuese femra në Lipjan (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 208 dhe 207: 54)

Në kuadër të kësaj qendre korrektuese ekziston objekti për femra, që ka siguri fizike (i rrethuar me mure të latë) dhe siguri teknike e materiale. Ky objekt ka kapacitet për akomodimin e gjashtëdhjetë (60) femrave. Në kuadër të këtij objekti ekziston reparti me hyrje të veçanta për të mitura femra. Si te dënuarat femra njashtu dhe te të paraburgosurat punojnë stafi i uniformuar-oficere korrektuese dhe ai civil profesional i gjinisë femërore. Në këtë institucion punojnë gjithësej tridhjetë (30) oficere korrektuese dhe dhjetë (10) civil profesional (punëtore sociale, instruktore, punëtor arsimor, punëtore për aktivitete sportive dhe kulturore). Në këtë institucion ekziston punëtoritë për aftësim profesional të burgosurave femra si, (rrobaqepësi, hoteleri, pastičeri, gjellëbërës). Në kuadër të institucionit ekziston reparti i rrobaqepësisë, ku femrat e aftësuara profesionalisht punësohen në këtë repart. Po ashtu ekziston edhe objekti hotelerisë –fazan, ku femrat e aftësuara profesionalisht punojnë në këtë objekt si dhe në kuzhinën e institucionit. Në kuadër të këtij institucioni ekzistojë sektorët që merren me çështje profesionale në punën me të burgosura femra, si :

- Sektori i sigurisë,
- Sektori për trajtim të të burgosurave,
- Sektori për sport dhe aktivitete kulturore,

- Sektori për arsimim dhe aftësim profesional

## **6.12. Organizimi i institucioneve të ekzekutimit e sanksioneve penale për të mitur**

Për kryerje të veprave të lehta penale të miturve mund tu shqiptohen masat e diverzitetit dhe masat edukative, kurse për kryerje të veprave të rënda penale dënimi që mund të u shqiptohet të miturve është gjoba, urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe burgimi për të mitur (Kodi i drejtësisë për të mitur, Nr. 03/L-193, 2010, neni 7). Në përputhje me dënimin e shqiptuar dhe moshën e të miturit, janë të përcaktuara edhe institucionet adekuate për mbajtjen e dënimit. Në institucionet e ekzekutimit të sanksioneve penale për të mitur, si që është Qendra korrektuese për të mitur dërgohen personat e dënuar me burg për të mitur, kurse në kuadër të këtij institucioni ekziston edhe objekti i veçantë ku vendosën dhe mbajnë masën edukative të dërgimit të kryesit të mitur në institucionin edukative-korrektues. Institucion i veçantë i destinuar për ekzekutimin e dënimit me burg për të mitur për persona të rijnë madhor dhe për ekzekutimin e masës edukuese-korrektuese për të mitur, është Qendra Korrektuese për të mitur në Lipjan.

### *6.12.1. Qendra Korrektuese për të mitur në Lipjan.*

Burgim i për të mitur mbahet në institucion korrektues për të mitur dhe në raste të jashtëzakonshme, në pavijone të ndara të institucionit korrektues për persona madhor (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 136, p.1). Të miturit të cilët kanë

arritur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet dhe kanë kryer veprë penale të dënueshme me mbi pesë (5) vjet burgim, dërgohen në mbajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese për të mitur në Lipjan (Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Nr.03/L-193, 2010, neni 136). Burgimi për të mitur nuk mund të shqiptohet më pak se gjashtë (6) muaj dhe më shumë se dhjetë (10) vjet dhe shqiptohet në muaj dhe vite të plota. Maksimumi I dënimit për të mitur dhjetë (10) vjet shqiptohet për vepra të rënda penale e dënueshme me burgim afatgjatë, ose kur I mituri kryen dy vepra penale në bashkim, ku secila është e dënueshme me burgim prej më shumë se dhjetë (10) vjet (Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Nr.03/L-193, aprovuar me 08.07.2010, neni 34 pika 2). Pa marruar parasysh gjatësinë e dënimit me burg për të mitur prej 6 muaj gjerë në 10 vjet, që I është shqiptuar të miturit për veprë penale, ai dërgohet për mbajtje në Qendrën Korrektuese për të mitur. Të miturit të cilët bëhen madhorë gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim të të miturit duhet të vendosen në pavijone të ndara të institucionit. Të mituri mbajnë dënimin e tyre me burgim për të mitur në Institucion korrektues për të mitur derisa të mbushin moshën njëzetetë (23) vjet (Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Nr.03/L-193, aprovuar me 08.07.2010, neni 136 pika 3). Nëse deri në këtë moshë ata nuk e kanë mbajtur dënimin e plotë, ata transferohen në institucion korrektues për të rritur (Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Nr.03/L-193, aprovuar me 08.07.2010, neni 136 pika 3).

Në Qendrën Korrektuese për të mitur, ekziston rregull që të miturit të vuajnë dënimin e tyre së bashku. Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale për ndarjen nga personat tjerë të dënuar aplikohen përshtatshëm për ndarjen e të miturve nga personat tjerë të dënuar (Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Nr.03/L-193, aprovuar me 08.07.2010, neni 137 pika 4). Qendra korrektuese për të mitur ofron kushte për akomodim, edukim, arsimim, aftësim Professional, në përputhje me normat dhe

standardet ndërkombëtare. Të miturit në këtë institucion korrektues nëse nuk kanë kryer shkollën fillore, janë të obliguar ta vijojnë mësimin në klasën ku ata e kanë ndërprerë. Arsimimi fillor dhe i mesëm për të mitur në këtë institucion korrektues organizohet dhe mbahet nga stafi që cakton Ministria e Arsimit dhe dëftesat dhe diplomat i lëshon Ministria e Arsimit. Aftësimi Professional i të miturve mbahet në dy punëtori të aftësimit Professional në Institucionin korrektues. Në këto punëtori me të miturit punojnë instruktorët e licencuar nga Ministria e punës dhe Mirëqenies Sociale. Vlen të ceket se nga kjo ministra mbikëqyret aftësimi Professional I të miturve dhe njihet kjo ministra ua lëshon diplomat e aftësimit Professional. Secila nga këto punëtori ofrojnë nga 3 profesione profesionale dhe të miturit zgjidhin vet se çfarë aftësimi Professional dëshirojnë. Po ashtu kujdes i veçantë i kushtohet edhe zhvillimit psiko-fizik të të miturve, pasi këtu me të mitur punojë instruktor dhe staf i kualifikuar për ushtrime fizike si dhe psikolog edhe psikiatër për trajtim adekuat psikik të të miturve. Rëndësi të veçanta i kushtohet shëndetit të tyre dhe këtu punon shërbimi shëndetësor 24 orë me mjek, stomatolog dhe teknik medicinal të mjaftueshëm. Në këtë institucion janë të vendosur në pavijon ndaras të miturit me masë të paraburgimit dhe trajtimi i tyre është në përputhje me ligjin dhe aktet tjera nënligjore.

Ky institucion është i tipit gjysmë të hapur, nuk posedon elemente të sigurisë fizike (mure të larta) në formë të mbikëqyrjes së lëvizjeve dhe punës së të miturve, por kanë elemente të sigurisë material (oficer korrektues pa mjete të sigurisë) që e pengojnë arratisjen e personave të mitur nga institucioni. Ky institucion ka kapacitete për vendosjen e njëqindnjëzet (120) të miturve të ndër në 3 objekte ,njëri objekt për të mitur të dënuar me burg për të mitur, jeni për të mitur të paraburgosur dhe jeni për të mitur me masë edukuese korrektuese. Në Qendrën Korrektuese për të mitur janë të punësuar

njëqindnjëzet (120) staf Professional, prej tyre shtatëdhjetë (70) janë oficer korrektues, kurse pesëdhjetë (50) staf civil Professional i lëmive dhe fushave të ndryshme. Për një punë sa më profesionale dhe efikase me të mitur në këtë institucion janë të formuara drejtorit, si: Drejtoria për siguri, Drejtori për trajtimin e të miturve, Drejtoria për arsimim dhe aftësim Professional, Drejtoria për aktivitetet kulturo-sportive, Drejtoria për administratë, Drejtoria për shëndetësi, Drejtoria për punësimin e të miturve, Drejtoria për njësinë ekonomike.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare ky institucion ofron aktivitete të brendshme dhe të jashtme kulturore për të miturit dhe posedon infrastrukturë shumë të mire për këto aktivitete.

*6.12.2. Institucionet edukativo-korrektuese për ekzekutimin e masave edukative të dërgimit të kryesit të mitur në institucionin edukativo-korrektues,*

Në kuadër të Qendrës Korrektuese për të mitur ekziston pavijoni i veçantë për vendosjen e të miturve të cilëve Gjykata u ka shqiptuar masën;- dërgim në institucionin edukativ (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013,shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 208, pika 1.4). Kur të miturve u nevojitet mbikëqyrje e plot nga edukatorët adekuat dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të miturit. Kjo masë shqiptohet jo ma pak se tre (3) muaj dhe jo më gjatë se dy (2) vjet (Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Nr.03/L-193, aprovuar me 08.07.2010, neni 28 pika 1). Në këtë institucion vendosën edhe të miturit të cilëve Gjykata u ka shqiptuar masën; - Dërgim në institucion edukativo-korrektues. Kjo masë u shqiptohet të miturve të cilët kanë kryer veprë penale të dënueshme me burg për më t tepër se tri (3) vjet dhe

kur ka nevojë për edukim të specializuar. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të zgjatë më pak se një (1) vit dhe më shumë se pesë (5) vjet (Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Nr.03/L-193, aprovuar me 08.07.2010, neni 28 pika 2 dhe 3). Në qendrën korrektuese për të mitur, në pavijonin e veçantë, vendosën të miturit të cilëve nga ana e Gjykatës u është shqiptuar masa edukative dhe masë edukativo-korrektuese. Të miturit vendosen ndaras varësisht nga masa e shqiptuar dhe kanë hyrje të veçanta në këtë pavijon. Varësisht nga masa e shqiptuar me të miturit punojnë edukatorët, punëtorët social, psikologët, pedagogët, mjekët, instruktorët, punëtorët e arsimit dhe staf profesional sipas nevojës dhe individëve.

*6.12.3. Burgjet për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm - Burgu i sigurisë së lartë*

Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nenin 209, paragrafi 2 ku flitet për tipet e institucioneve korrektuese, Burgun e sigurisë së lartë e klasifikon si institucion të tipit të mbyllur me elemente të sigurisë fizike dhe materiale, me zyrtar korrektues të armatosur, me mure rrethuese dhe rrethoje rrethuese, me pajime teknike dhe pajimet tjera të nevojshme që pengojnë arratisjen e personave të dënuar (Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013, shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013, neni 209, paragrafi 2).

Në këtë institucion vendosen personat e dënuar me burgim të gjatë dhe të përjetshëm si dhe personat e klasifikuar me rrezikshmëri shumë të lartë, personat e paraburgosur të klasifikuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë si dhe personat e dënuar me burgim të përjetshëm. Në këtë institucion vendosen edhe personat e dënuar të tjerë të cilët gjatë



mbajtjes së dënimit, për shkak të sjelljeve të tyre janë kategorizuar si persona me rrezikshmëri të lartë dhe është e pamundur që ata të qëndrojnë në institucione tjera.

Ky ligj nuk e ka zgjidhur çështjen në mënyrën ma të mirë, kur përcakton se kush duhet të vendoset në Burgun e sigurisë së lartë. Ligji nuk parasheh që në Burgun e sigurisë së lartë të vendosen femrat e dënuara me burgim të përjetshëm dhe të miturit e dënuar me burg për të mitur e që manifestojnë sjellje që ata klasifikohen me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë. Në këtë drejtim vendosja e femrave me burgim të përjetshëm dhe të klasifikuara me rrezikshmëri shumë të lartë nuk është zgjidhur si duhet dhe në përputhje me rregullat dhe standardet ndërkombëtare. Andaj në kuadër të Qendrës Korrektuese për femra apo edhe në kuadër të Burgut të sigurisë së lartë duhet të parashihet një aneks për femrat e dënuara me burgim të përjetshëm dhe me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë. Në këtë tip të institucionit vendosen që në fillim personat e dënuar me burgim të përjetshëm por edhe mund të transferohen më pas të dënuar që paraqesin rrezikshmëri për institucion ose ata persona të cilët shkaktojnë probleme të natyrave të ndryshme në institucionet tjera (Hysi, 2012:115). Seksione të tilla të sigurisë së lartë duhet të parashihen edhe në institucionet tjera si në Qendrën korrektuese për femra njashtu edhe në qendrën korrektuese për të mitur dhe në qendrën korrektuese për dënime të gjata. Qendrat e paraburgimit nuk kanë nevojë të kenë seksione të sigurisë së lart, pasi ato janë institucione të tipit të mbyllur dhe konsiderohen si të sigurta.

#### *6.12.4. Burgu për të dënuar dëshmitar të mbrojtur*

Ky institucion i tipit të mbyllur me elemente të sigurisë fizike dhe materiale, me zyrtar korrektues të armatosur, me mure rrethuese dhe rrethoje rrethuese, me pajime

teknike dhe pajimet tjera të nevojshme që pengojnë arratisjen e të dënuarve dëshmitar të mbrojtur, bën pjesë në Burgjet me siguri të lartë. Sipas Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve neni 4 paragrafi 1, masat e mbrojtjes mund të zbatohen para, gjatë dhe pas procedurës penale për personin e rrezikuar në lidhje me hetimet

për veprat penale në vijim: (Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve Nr. Nr. 04/-L-015, aprovuar me 29.07.2011, neni 4 paragrafi 1)

- vepër penale kundër Kosovës, shtetasve dhe banorëve të saj;
- vepër penale kundër të drejtës ndërkombëtare;
- vepër penale kundër ekonomisë;
- vepër penale kundër detyrës zyrtare;

Neni 14 i Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve parasheh Regjimin e veçantë për personat e mbrojtur në Institucione Korrektuese.

Me qëllim të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të dëshmitarit bashkëpunues përderisa ai është i privuar nga liria u ofrohet trajtim i veçantë dhe masa mbrojtëse për mbrojtjen e dëshmitarit, që rezulton në një trajtim më ndryshe por jo dukshëm më të mirë se të burgosurve tjerë. Ky regjim i veçantë përfshin trajtimin e veçantë që mund të rezultojë në një trajtim më ndryshe por jo dukshëm më të mirë se të burgosurve tjerë. Për dëshmitarin e dënuar të mbrojtur i cili është bashkëpunues ekziston institucioni adekuat i ndarë dhe i destinuar për kategori të tillë të të burgosurve (Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve Nr. Nr. 04/-L-015, aprovuar me 29.07.2011, neni 14). Mirëpo brengosës është fakti si të dënuarit si dëshmitar të mbrojtur nuk janë paraparë me Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, çka është nevojë e domosdoshme e ndryshimit dhe plotësimit të këtij ligji. Kjo kategori e të dënuarve në Kosovë dita më ditë është duke u rritur dhe po paraqitet nevoja që institucionet korrektuese por edhe faktorët tjerë relevant të drejtësisë të merren më

seriozisht dhe më profesionalisht me këtë kategori të dënuarve. Të dënuarit dëshmitar të mbrojtur dukshëm I kanë ndihmuar dhe po i ndihmojnë drejtësisë në Kosovë për zbulimin e veprave të rënda si dhe zbulimin e kryerësve të këtyre veprave. Përkundër mungesës së dispozitave ligjore për të dënuarit dëshmitar të mbrojtur, në kuadër të Institucioneve korrektuese ekziston Burgu për dëshmitar të mbrojtur, i cili plotëson kërkesat dhe standardet ndërkombëtare dhe është në funksion që nga viti 2012. Ky institucion është ndërtuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe është funksional. Stafi është i trajnuar për kryerjen e punëve me këtë kategori të të burgosurve. Lëvizjet e të dënuarve dëshmitar të mbrojtur janë të kufizuara por edhe të mbikëqyra mirë. Dalja e kësaj kategorie të burgosurve jashtë institucionit bëhet me përcjellje dhe siguri maksimale, por njëherit duke bashkëpunuar edhe me Policinë e Kosovës dhe me faktorët tjerë relevant të sigurisë. Në këtë institucion kanë qasje vetëm personeli i cili punon aty si dhe faktorët tjerë relevant për drejtësi dhe siguri në Kosovës ,varësisht nga nevoja për ta vizituar apo kryer ndonjë punë apo detyrën zyrtare. Mbrojtja e dëshmitarëve parashihet edhe me Kodin e procedurë penale në nenin 220 (Kodi i Procedurës penale të Kosovës, Nr. 04/L-123, neni 220, kodi është. aprovuar me 13.12.2012, shpallur me dekretin nr.DL-057-2012, gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 37/28, Prishtinë ,dhjetor 2012). Duke pasur parasysh një përvojë të menaxhimit të kësaj kategorie të të burgosurve që nga viti 2012, si dhe duke pasur përbuzë faktin si trajtohen kjo kategori e të burgosurve në institucionet Evropiane dhe Botërore, vlen të ceket se në këtë drejtim institucionet e Kosovës kanë kushte ligjore dhe institucionale për trajtimin e tyre. Për të qenë trajtimi sa më adekuat i të dënuarve dëshmitar të mbrojtur nevojitet që të ndërtohen objektet përcjelle për plotësimin e nevojave dhe të drejtave të parapara me ligj dhe rregulla për këtë kategori të dënuarve. Objektet përcjelle për rekreacion dhe sport, për aktivitete fizike, për

shfrytëzim të vizitave të lira dhe atyre familjare si dhe për shfrytëzim të pushimit javor, mujor dhe vjetor. Nga kjo rrjedh se shërbimi korrektues i Kosovës në veçanti dhe Ministria e Drejtësisë duhet seriozisht të merren me plotësimin e kushteve për trajtim adekuat të të dënuarve dëshmitar të mbrojtur. Për sigurimin e tyre duhet krijuar kushte teknike fizike dhe staf profesional të trajnuar sa më mirë dhe sa më profesionalisht për trajtim dhe sigurim të të dënuarve dëshmitar të dënuar të mbrojtur. Burgu për të dënuar dëshmitar të mbrojtur plotëson kushtet për akomodimin e të burgosurve, por duhet ngritur edhe objektet tjera përcjelle të cilat sigurojnë një trajtim më adekuat dhe në përputhje me normat dhe standardet ndërkombëtare.

Në këtë institucion puna dhe detyrat e përditshme kryhen në përputhje me Ligjin për dëshmitarët t mbrojtur, Kodin e Procedurës penale si dhe rregullat e Brendshme institucionale.

### **6.13. Organizimi i shërbimit të provës**

Privimi i lirisë në vendet e përparuara të Evropës, për një sërë veprash me rrezikshmëri të vogël shoqërore vlerësohet si sanksion i alternativës së fundit dhe si rrjedhojë zbatohet atëherë kur rrezikshmëria e veprës penale të kryer do të bënte të pamundur vendosjen e ndonjë mase tjetër alternative. Në mënyrë të veçantë, vendet e Evropës perëndimore përpiqen të kufizojnë sa të jetë e mundur burgimin duke tentuar drejt formave zëvendësuese të një trajtimi jo-shtrëngues. Kjo bazohet në premisën se burgimi përveçse jep efekte negative tek shkelësit e ligjit ka dhe një kosto financiare shumë të lartë për shoqërinë. Duke marrë shkas nga përvoja e suksesshme e këtyre vendeve, alternativat e dënimit me burgim janë prezantuar në kodin penal të Shqipërisë

në vitin 1995, por me rishikimin e vitit 2008 u ndryshuan dhe u përmirësuan përcaktimet në lidhje me to, përmirësime të cilat lejojnë hapësirë më të gjerë për zbatimin në praktikë të tyre, rezultat i të cilës është dhe fillimi i funksionimit të institucionit të shërbimit të provës i cili mbikëqyr ekzekutimin e këtyre dënimeve. Si pjesë e reformës në sistemin e drejtësisë, me ligjin nr. 10 024, datë 27.11.2008, "për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998, "për ekzekutimin e vendimeve penale", kuvendi i Shqipërisë ka miratuar kuadrin normativ-ligjor për ngritjen dhe funksionimin e institucionit të shërbimit të provës si organ shtetëror i specializuar për mbikëqyrjen e dënimeve alternative ndaj burgimit. Në pothuaj 5 vite punë, shërbimi i provës tashmë është një institucion i konsoliduar në sistemin e drejtësisë penale, operatorët e së cilës janë ndërgjegjësuar se reforma në sistemin e ekzekutimit të dënimeve penale nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të shërbimit të provës në Shqipëri, ka përmirësuar ndjeshëm drejtësinë restauruese në vendin tonë (Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve Nr. Nr. 04/-L-015, aprovuar me 29.07.2011).

Shërbimi i provës bashkëpunon ngushtësisht me aktore të tjerë të sistemit të drejtësisë penale si gjykata, prokuroria, policia e shtetit, drejtorja e përgjithshme e burgjeve, në faza të ndryshme të procesit nëpër të cilin kalon një shkelës i ligjit. Thelbi i rolit të shërbimit të provës si një vlerë e shtuar në sistemin e drejtësisë penale mbetet ai vlerësues, parandalues dhe trajtues, me synim uljen e aktivitetit kriminal në shoqëri dhe më shumë siguri për jetesën. Që prej fillimit të funksionimit të Shërbimit të Provës në vitin 2009 e deri në fund të vitit 2013, numri i personave të cilët janë vendosur me vendim gjykate në njërin prej alternativave të dënimit me burgim është 9356, mbikëqyrja e të cilëve realizohet mbi bazën e programeve individuale të trajtimit. Nëse nuk do të ishin aplikuar alternativat e dënimit me burgim, atëherë këta 9356 persona do të kishin vuajtur

dënimin me burg, në një nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP). Kështu, vetëm gjatë vitit, numri i të dënuarve me dënime alternative që iu shtua numrit të të dënuarve që mbikëqyreshin nga Shërbimi i Provës, në të gjithë vendin është 1939. Siç reflektohet dhe në tabelën e mëposhtme, alternativa e dhënë më shpesh nga gjykata është Pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia në periudhë prove në masën 7553 të dënuar, e ndjekur nga Lirimi me kusht në masën 823 të dënuar dhe puna në interes publik në masën 798, qëndrimi në shtëpi në masën 181. Ende e pa zbatuar mbetet alternativa e Gjysmëlirisë e cila gjatë periudhës 2009-2013 është dhënë vetëm në një rast unik.

<b>Nr.</b>	<b>APLIKIMI SIPAS LLOJIT TË DËNIMEVE ALTERNATIVE [VITI 2009 - 2013]</b>	<b>Kodi Penal</b>	<b>Të dënuar</b>	<b>Të dënuar në %</b>
1	Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në periudhë prove	Neni 59	7553	80.72
2	Lirimi me kusht	Neni 64	823	8.80
3	Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik	Neni 63	798	8.52
4	Qëndrimi në shtëpi	Neni 59/a	181	1.95
5	Gjysmëliria	Neni 58	1	0.01
-	<b>Total</b>	-	<b>9356</b>	<b>100%</b>

Gjatë vitit 2013, janë kërkuar 803 raporte vlerësimi për të dënuarit apo të pandehurit personat nën hetim, prej të cilëve 587 kanë qenë kërkesa për raport vlerësimi nga gjykata dhe 216 të tilla nga prokuroria.

**KËRKESA PËR RAPORT VLERËSIMI [VITI  
2013]**

Kërkesë për raport vlerësimi nga Gjykata	587
Kërkesë për raport vlerësimi nga Prokuroria	216
<b>Total</b>	<b>803</b>

## **KAPITULLI VII**

### **BASHKËPUNIMI PENALE NDËRKOMBËATR NË FUSHË NË FUSHËN E EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT**

Që të mund të realizohet parimi real, parimi i personalitetit aktiv, pasiv, parimi universal dhe parimi territorial i legjislacionit penal, është e nevojshme që të respektohet bashkëpunimi midis shteteve. Një ndër format e bashkëpunimit midis shteteve që mundëson shqiptimin apo ekzekutimin e dënimit kryesit të veprës penale, është edhe ekstradimi i fajtorit. Me ekstradim, në të drejtën penale nënkuptojmë dorëzimin e kryesit të veprës penale prej një shteti në shtetin tjetër, me qëllim që kryesi të dënohet për veprën penale të kryer, ose me qëllim që ndaj tij të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me aktgjykimin e plotfuqishëm. Ekstradimi është forma kryesore e ndihmës juridike midis shteteve në fushën e së drejtës penale dhe në masë të konsiderueshme mundëson luftimin e kriminalitetit në përmasa ndërkombëtare. Për nga natyra e tij është institucion i përzier meqë ngërthen në vete elemente të së drejtës penale, të procedurës penale dhe elemente ndërkombëtare. Në vendet e pranuar ndërkombëtarisht si shtete sovraane, për shkak të rëndësisë, kushtet e ekstradimit janë të rregulluara me kushtetutë. Sipas Kornizës kushtetuese për vetëqeverisjen e përkohshme të Kosovës (nenet 8.1.(i) 8.1 (m) dhe 8.1.(o) instituti i ekstradimit është në kompetencë ekskluzive të përfaqësuesit special të KB dhe si e tillë nuk është rregulluar fare me dispozitat kushtetuese. Çështja e ekstradimit në shtetet sovraane është rregulluar përpos me kushtetutë edhe me konventa ndërkombëtare dhe marrëveshje bilaterale.

Në KPPPK, kaptina XLVIII, neni 516-532, është përcaktuar procedura dhe kushtet të cilat duhet të përmbushen që të mund të ekstradohet kryesi i veprës penale.



Në kontratë për ekstradim duhet cekur se për cilat lloje të veprave penale do të bëhet dorëzimi i fajtorit .Kjo bëhet në tri mënyra:

1. Metoda e enumeracionit, me ç'rast cekën llojet e veprave penale për të cilat do të bëhet ekstradimi ;

2. Me anë të metodës eliminatore, me ç'rast cekën veprat penale për të cilat nuk do të bëhet ekstradimi dhe

3. Me anë të metodës së klauzolës gjenerale, me crast lloji i veprave penale , për të cilat do të bëhet ekstradimi , caktohet sipas llojit dhe masës më të butë të dënimit.

Kushtet të cilat duhet të plotësohen për ekstradimin e personit në shtetin e huaj sipas dispozitave të KPPPK:

Në legjislacionet penale të shteteve bashkehoë si dhe në kontratat, përkatësisht konventat ndërkombëtare, janë sajuar disa parime të përgjithshme të cilat respektohen me rastin e ekstradimit.

Sipas nenit 517 të KPPPK, ekstradimi (transferi) i kryesit të veprës penale në shtetin e huaj mund të bëhet nëse plotësohen këto kushte:

1. Shtetasi i vendit nuk mund të ekstradohet ;
2. Që vepra për të cilën kërkohet ekstradimi nuk është kryer në territorin e Kosovës kundër banorit të Kosovës;
3. Që të ekzistoj identiteti i normës;
4. Identiteti i personit , ekstradimi i të cilit kërkohet është vërtetuar;
5. Që ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se shtetasi i huaj , ka kryer vepër penale ose për këtë ekziston aktgjykimi i formës së prerë;
6. Që ekstradimi të mos kërkohet për vepër penale për të cilën parashihet dënim me vdekje , derisa shteti i cili kërkon ekstradimin nuk garanton se dënimi me vdekje nuk do

të shqiptohet ose nuk do të ekzekutohet;

7. Që të mos ekzistoj rreziku real që personi , ekstradimi i të cilit kërkohet të mos trajtohet ose dënohet në mënyrë johumane;

8. Që ekstradimi të mos kërkohet për vepra penale politike apo ushtarake ;

9. Që personi, ekstradimi i të cilit kërkohet nuk e gëzon të drejtën mbrojtjes të paraparë për refugjatë në Kosovë;

10. Që ekstradimi të mos jetë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare ose standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;

11. Kushti i specialitetit, që personi të mund të ndëshkohet vetëm për atë veprë penale për të cilën është ekstraduar;

12. Që vepra penale të mos jetë parashkruar dhe

13. Që shtetasi i huaj, ekstradimi i të cilit kërkohet , ende nuk është liruar ose dënuar në formë të prerë nga gjykata vendore për veprën penale për të cilën kërkohet ekstradimi, që procedura penale të mos zbatohet në Kosovë kundër tij për veprë penale të paraparë me nenin 100 të KPPK dhe kur procedura penale ka filluar për veprë penale të kryer kundër banorit të Kosovës, kërkesa pasuroro juridike për të dëmtuarin të jetë siguroa.

### **7.1. Nevoja për bashkëpunim rajonal si nevojë e parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit**

Bashkëpunimi ndërkombëtar mund të ketë disa forma:

- ekstradimi;

- ndihma e ndërsjellë ligjore për "të miturit" (p.sh. komunikimi i informacionit dhe i provave);

- zbatimi dhe marrja parasysh nga një

Shtet i vendimit të marrë nga një

Shtet tjetër- transferimi i procedimeve;-rregullimi i shumëllojshmërisë së juridiksioneve. Fakti se cilat nga këto forma bashkëpunimi është më e mirë varet nga tiparet e veçanta të çështjes që është në shqyrtim.<sup>15</sup> Përzgjedhja e njëjës apo tjetrës formë varet shumë nga natyra e veprës, kërkesat e procesit penal, në veçanti kur përfshihet dhe paraqitja e provave; dhe nga personaliteti i autorit të veprës; vëmendje e veçantë gjatë përzgjedhjes i kushtohet natyrës së dënimit ose masës, dhe zbatimit të tij/saj. Nevoja e hartimit të kësaj konvente lindi për faktin se shtetet kanë lloje të ndryshme të juridiksionit penal: territorial, racione personale, ose universal, ose juridiksion për të dënuar veprat që cenojnë sigurinë ose reputacionin e tij; që, kurdo që një veprë përfshin një element të huaj, mund të ketë mbivendosje të dy ose më shumë kompetencave të tilla juridiksionale që çon në konflikte pozitive të juridiksionit. Kompleksiteti i këtyre çështjeve shpjegohet nga vetë natyra e të drejtës tradicionale penale, e mishëruar fort në parimin e sovranitetit territorial të shtetit. Gjykatat penale, thuajse e zbatojnë të drejtën e tyre penale pa dallim. Si rrjedhim, problemet e të drejtës penale janë më të vështira të zgjidhen sesa problemet në fusha të tjera të ligjit, ku konfliktet e legjislacionit dhe të juridiksionit mund të zgjidhen me anë të aplikimit të së drejtës së huaj nga gjykata kombëtare ose nëpërmjet harmonizimit të dispozitave ligjore përkatëse. Qëllimi i Konventës është të krijojë një sistem të ngjashëm për transferimin e procedimeve për proceset penale dhe rregullimin e shumëllojshmërisë së proceseve gjyqësore. Konventa të tjera evropiane përfshijnë dispozita që lidhen me këtë objekt, por nuk e rregullojnë atë plotësisht. Për shembull, Neni 21 i Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë për Çështjet Penale përcakton

---

<sup>15</sup> Konventa Evropiane mbi Transferimin e Procedimeve në Çështjet Penale (ETS No. 073)

procedurën për paraqitjen e një kërkesë për procese gjyqësore dhe parashikon se Shteti pritës njofton Shtetin kërkuar për veprimet e marra për kërkesën. Rregulla të plota për çështjen, por të cilat zbatohen vetëm për veprat që lidhen me trafikun rrugor, përfshihen në Konventën Evropiane për Dënimin e Veprave të Trafikut Rrugor. Sistemi i kësaj Konvente është i ngjashëm në shumë aspekte me sistemin e prezantuar në Konventën e sipërpërmendur<sup>16</sup>.

Procesi i harmonizimit të së drejtës nuk nënkupton përcaktimin e rregullave fikse, por zgjedhjen dhe përshtatjen e disa parimeve përcaktuese në krijimin e standardeve minimale të tutelës, të cilat funksionojnë vetëm nëse garantojnë të drejtat themelore të njeriut. Harmonizimi i së drejtës penale rrjedh edhe nga themelimi i disa institucioneve ndërkombëtare gjyqësore si Gjykata Evropiane, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian, Gjykata e Hagës për krimet e luftës (dhe krijimi i Tribunalit penal ndërkombëtar), në jurisprudencën e të cilave është përpunuar një rend procedural i cili ka ndikim thelbësor në rendin juridik të brendshëm të shteteve të veçanta. Nevoja e harmonizimit të së drejtës penale vjen edhe si pasojë e ekzistencës së institucioneve juridike të bashkëpunimit ndërkombëtar si ekstradimi apo ndihma juridike, efektiviteti i të cilave nënkupton një të drejtë penale të zbatueshme gjerësisht. Gjithashtu kontribut të rëndësishëm jep edhe shkëmbimi dhe bashkëpunimi i punonjësve të policisë apo gjykatës, gjë që sjell njohjen e rrethave juridike të shteteve të ndryshme dhe hartimin e politikave penale të ngjashme për luftën kundër kriminalitetit.

---

<sup>16</sup> Konventa Evropiane mbi Transferimin e Procedimeve në Çështjet Penale (ETS No. 073)

## **7.2. Arritje dhe Sfida në fushën e bashkëpunimit penal ndërkombëtar dhe rajonal lidhur me ekzekutimin e dënimeve penale**

Nisur nga formulimi i nenit 122 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, që parashikon se çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar, përbën një pjesë të rëndësishme të sistemit të brendshëm juridik që zbatohet drejtpërdrejt, përveç rasteve kur për të kërkohet nxjerrja e një ligji, pranohet tashmë epërsia e të drejtës ndërkombëtare në raport me të drejtën e brendshme dhe afirmohet në këtë mënyrë, shkëputja nga zgjidhja doktrinare dualiste<sup>17</sup>.

Duke pranuar epërsinë e së drejtës ndërkombëtare, edhe normat e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut bëjnë pjesë ndër burimet normative të Republikës së Shqipërisë. Ky pozicion specifik i Konventës Europiane në raport me vetë Kushtetutën, me marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe me ligjet e vendit pasqyrohet në nenin 17 paragrafi i dytë i Kushtetutës, në të cilin thuhet: *“Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.”* Mënyra e formulimit të këtij paragrafi kushtetues të shpie në konkluzionin se të drejtat dhe liritë themelore të individit, të parashikuara në Kushtetutë, duhen interpretuar në funksion të dispozitave përkatëse të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ky *status i veçantë kushtetues*, që i jepet dispozitave të Konventës Europiane, lidhet vetëm me kufizimet dhe veçanërisht, ndaj këtyre të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë. Pikërisht, kjo

---

<sup>17</sup> Etilda (SALIU) GJONAJ, rigjykimi i çështjes në zbatim të vendimit të gjykatës evropiane të të drejtave të njeriut, Avokatia 7, Tiranë

pozitivë e veçantë kushtetuese që i është dhënë dispozitave të Konventës, e bëjnë atë të vetëzbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut në këtë drejtim, ka pranuar qoftë karakterin e vetëzbatueshëm të Konventës, ashtu edhe kryerjen e veprimeve pozitive nga ana e shteteve, për të përputhur të drejtën e brendshme me parimet e shpallura në të. Në realitetin shqiptar duhet pranuar se, përgjithësisht, normat ndërkombëtare dhe specifikisht dispozitat e Konventës Europiane, nuk kanë arritur ende të konceptohen si pjesë integrale e jurisprudencës gjyqësore. Pranimi nga ana e Republikës së Shqipërisë i juridiksionit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut do të thotë, se prokurorët dhe gjyqtarët shqiptarë duhet të kuptojnë tashmë, se vendimet e tyre nuk përfundojnë brenda kuadrit të legjislacionit të brendshëm, por mund t'i nënshtrohen edhe kontrollit gjyqësor të kësaj gjykate, në raport me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve<sup>18</sup>.

Një shkelje e të drejtave dhe lirive të shtetasve, e parashikuar nga Konventa përpara se të konstatohet nga Gjykata e Strasburgut, duhet detyrimisht t'i nënshtrohet juridiksionit të brendshëm gjyqësor. Shkelja e të drejtave dhe lirive themelore të konstatuar nga Gjykata e Strasburgut, nënkupton një moszbatim të dispozitave të Konventës nga autoritetet e vendit përkatës. Konventa Europiane, duke qenë pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe drejtpërdrejtë e zbatueshme, kërkon dhe mjetin ligjor efikas me anë të të cilit të ballafaqojë shkeljet që mund t'i bëhen individëve, si dhe të kërkojë dhe të përshtatë pajtueshmërinë e ligjit me të. E drejta për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, për të kërkuar një gjykim të karakterit kushtetues, iu përket disa subjekteve të përcaktuara në nenin 134 të Kushtetutës<sup>19</sup>. Ajo që ndeshet më tepër në jurisprudencën e kësaj gjykate

---

<sup>18</sup> Etilda (SALIU) GJONAJ, rigjykimi i çështjes në zbatim të vendimit të gjykatës evropiane të të drejtave të njeriut, Avokatia 7, Tiranë

<sup>19</sup> Foto Çelari, Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore si çështje e rëndësishme për procesin e rregullt gjyqësor. Vlorë 2010

lidhet me kontrollin e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe me gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese, për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet ligjore, për fitimin e këtyre të drejtave, të parashikuara nga nenin 131 shkronja “a” dhe “f”. Këto dy kompetenca të Gjykatës Kushtetuese, lidhen me konceptin e zbatimit të drejtpërdrejtë të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, në sistemin e brendshëm ligjor. Referimi i drejtpërdrejtë tek dispozitat e Konventës Europiane dhe te jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, për rastet e sipërcituara, gjendet në shumë vendime të Gjykatës Kushtetuese. Më poshtë po i referohem jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, që ka për orientim zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave të Konventës Europiane.

E drejta për një proces të rregullt ligjor, nuk është një e drejtë që mund të mbulojë të gjitha të drejtat e tjera kushtetuese që janë atribut i individit. Po t'i referohemi nenit 6 të K.E.D.NJ, do të gjejmë një kuptim më të gjerë në formulimin e tij. Në konceptin e nenit 6 të Konventës Europiane, parashikohen disa nga të drejtat dhe liritë e njeriut, të cilat në Kushtetutën tonë nuk gjenden të parashikuara vetëm në nenin 42 të saj. Janë edhe nenet 30, 31 dhe 33 të Kushtetutës, të cilat në tërësinë e tyre të japin kuptimin e një përafrimi me nenin 6 të Konventës. Procesi i rregullt ligjor është, një nga të drejtat e individit që lidhet me rregullsinë e një gjykimi të zakonshëm. Neni 42 pika 1 e Kushtetutës, vetëm sa e përmend procesin e rregullt ligjor, por pa i dhënë atij, ndonjë kuptim të hollësishëm. Atë që nuk e jep Kushtetuta, është përpjekur ta zgjidhë praktika e Gjykatës Kushtetuese, e cila është orientuar kryesisht edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut e të gjykatave kushtetuese europiane. Në të drejtën e individit, për një proces të rregullt gjyqësor, përfshihen mjaft të drejta dhe garanci kushtetuese e ligjore. *Shkelja e*

*garancive kushtetuese, që parashikohen në kreun e lirive dhe të drejtave vetjake, të analizuara nga këndvështrimi i procedurave të ndjekura, janë konsideruar nga Gjykata Kushtetuese, pjesë përbërëse të një procesi të parregullt ligjor. Megjithëse jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, ka filluar të marrë një fizionomi të saj në drejtim të kuptimit që paraqet neni 42 dhe 131 shkronja “f” e Kushtetutës, për procesin e rregullt ligjor, ende nuk ka një qëndrim të konsoliduar dhe nuk kuptohet lehtë, se çfarë përfaqëson ai. Prandaj, nuk mendoj se i jep zgjidhje kuptimit të procesit të rregullt ligjor, interpretimi si objekt i këtij koncepti kushtetues, pasi është jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, e cila, duke u pozicionuar gradualisht edhe duke u orientuar më drejt, shmang njëkohësisht çdo keqkuptim. Nëpërmjet procesit të rregullt ligjor, kontrollohet më shumë procedura e rregullt gjyqësore, por jo vetëm ajo, pasi nuk përjashtohet edhe procedura administrative nga ky koncept. Në vendimin 76/2002<sup>20</sup>, Gjykata Kushtetuese përpiqet të bëjë dhe dallimin që ekziston, ndërmjet nenit 6 të K.E.D.NJ. dhe nenit 42/1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë. *Ndërsa në Konventë parashikohet e drejta e individit për një gjykim të drejtë penal ose civil, në nenin 42/1 të Kushtetutës dhe në jurisprudencën e saj, e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ.* Në këtë çështje jurisprudenca kushtetuese, e konsolidoi qëndrimin e mbajtur më parë, duke mos e kufizuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, vetëm për çështjet gjyqësore .*

Gjykata Kushtetuese, është përpjekur në praktikën e saj gjyqësore, të bëjë një dallim thelbësor të rolit të saj si autoritet që garanton respektimin e Kushtetutës, nga funksioni i dhënies së drejtësisë, që mbetet atribut i organeve të pushtetit gjyqësor. Kjo është një

---

<sup>20</sup> Foto Çelari, Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore si çështje e rëndësishme për procesin e rregullt gjyqësor. Vlorë 2010



çështje mjaft delikate, që në fakt ka krijuar edhe ndonjë keqkuptim në praktikë. Në këtë drejtim, nuk ka qenë dëshira e Gjykatës Kushtetuese të gjejë parregullsitë e procesit, vetëm në procedurat gjyqësore, por në fakt, vetë formulimi i nenit 131 shkronja “f”, që kërkon paraprakisht shterrimin e mjeteve juridike, për t’iu drejtuar kësaj gjykate, nuk e shmang kontrollin kushtetues mbi vendimet gjyqësore. Tendenca për ta orientuar Gjykatën Kushtetuese, në një pozicion që të mos konfondohej me shkallët e tjera të gjyqimit, por të evidentojë nga kontrolli i kushtetutshmërisë së vendimeve gjyqësore, vetëm problemet esenciale që prekin procesin e rregullt ligjor, ndihet vazhdimisht e pranishme në praktikën e saj.<sup>21</sup>

1. Në vendim thuhet: *“Gjykatës Kushtetuese i rezulton se Kuvendi gjatë procedurës së ndjekur për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, nuk i është përmbajtur pikërisht respektimit të këtyre standardeve. Kështu, Kuvendi i ka konsideruar të mirëqena, të gjitha akuzat e drejtuara ndaj kërkuesit, duke u mbështetur vetëm në diskutimet e deputetëve pa argumentuar shkeljet konkrete, pa njoftuar rregullisht kërkuesin për përmbajtjen e materialit në ngarkim të tij, pa i dhënë kohën e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe pa e dëgjuar atë për të parashtruar prapësimet rreth këtyre akuzave.”*

Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese për çështje të ndryshme, si dhe qëndrimeve të mbajtura, të cilat duhet të analizohen për çdo rast konkret, vihet re se qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese, nuk ka qenë dhe nuk është, të orientojë dhe të vërë detyra për gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, por të krijojë dhe të konkludojë një praktikë të saj sa më të konsoliduar, për t’i dhënë kuptimin kushtetues të drejtës së

---

<sup>21</sup> Universiteti Planetar i Tiranës, Procesi i rregullt ligjor, Garancite procedurale te te pandehurit ne nje proces penal, Dispencë, Tiranë, 2012

individëve për një proces të rregullt ligjor.<sup>22</sup>

*E drejta për një seancë të drejtë e të ndershme*, përfshin të gjitha procedurat dhe garancitë që qëndrojnë në thelb të konceptit, për gjykim të drejtë. E drejta për një shqyrtim të drejtë në gjykimet penale, specifikohet nga një numër i të drejtave konkrete, si e drejta për t'u konsideruar i pafajshëm, e drejta për t'u gjykuar pa vonesë të panevojshme, e drejta për të përgatitur mbrojtjen, e drejta për t'u mbrojtur vetë personalisht ose përmes avokatit, e drejta për të thirrur dëshmitarë etj. Sidoqoftë, standardet ndërkombëtare që udhëheqin drejtimin e gjykimit, bëjnë të qartë se këto të drejta të përmendura specifikisht, përbëjnë *garanci minimale*. Respektimi i secilës prej këtyre garancive, nuk siguron në të gjitha rastet e rrethanat se, një seancë ka qenë e ndershme dhe e drejtë. E drejta për gjykim të drejtë, është më e gjerë se shumica e garancive individuale dhe varet nga i gjithë drejtimi i gjykimit. Garancitë që ofron neni 31 i Kushtetutës, në analizë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane, të cilat lidhen *me njoftimin e akuzës të pandehurit* nga organi procedues dhe *me dhënien e kohës së mjaftueshme për t'u mbrojtur*, kur janë konstatuar nga Gjykata Kushtetuese, si e drejte e shkelur e individit, kanë sjellë cenimin e të gjithë procesit, dhe shfuqizimin e vendimeve gjyqësore si antikushtetuese.

Realizimi i *së drejtës së të pandehurit për t'u mbrojtur*, përbën thelbin e procesit të rregullt ligjor. Në vendimin nr.3/2001 Gjykata Kushtetuese arsyeton se, *“nga Gjykata e Apelit, ku është shqyrtuar apeli i prokurorit që kërkonte ndryshimin e vendimit në një dënim më të rëndë, edhe pse kërkuesi ishte në mungesë, nuk është marrë asnjë masë për të realizuar mbrojtjen e tij... Kjo do të garantonte një minimum të domosdoshëm të mbrojtjes së të drejtave të tij dhe do të siguronte një proces të rregullt ligjor.”*<sup>23</sup>

---

<sup>22</sup> Universiteti Planetar i Tiranës, Procesi i rregullt ligjor, Garancite procedurale te te pandehurit ne nje proces penal, Dispencë, Tiranë, 2012

<sup>23</sup> Universiteti Planetar i Tiranës, Procesi i rregullt ligjor, Garancite procedurale te te pandehurit ne nje proces penal, Dispencë, Tiranë, 2012

Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, vihet re qëndrimi tashmë i konsoliduar *për të mos hyrë në analizën dhe vlerësimin e provave*, të rrethanave, si dhe të mënyrës së zgjidhjes së çështjeve, pasi dihet që kjo është një atribut i gjykimit të zakonshëm. Në vendimin nr.20/2000, pretendimit të kërkuarit, për proces të parregullt ligjor, ajo i përgjigjet duke arsyetuar: *“Nëse ky gjykim është shoqëruar me mangësi në hetime, ose në vlerësim të gabuar të provave, kjo është një çështje që i takon vetëm juridiksionit gjyqësor...”*<sup>24</sup>

Qëndrimi i mbajtur deri tani në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, përgjithësisht ka krijuar fizionominë për një kuptim më të drejtë të nocionit kushtetues për një proces të rregullt ligjor. Praktika e kësaj Gjykate edhe mund të ndryshojë (mbi bazën e faktorëve që lejojnë ndryshimin e jurisprudencës), megjithatë, mendoj se qëndrimet e deritashme, shkojnë në përshtatje edhe me konceptin që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe veçanërisht K.E.D.Nj, kanë sanksionuar për mënyrën e shqyrtimit të ankesave të individëve për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka filluar të pasqyrohet dhe të zërë një vend të konsiderueshëm edhe në praktikën e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, të cilat kanë arritur të kuptojnë tashmë se vendimet e tyre nuk mund të mbeten për t’u vlerësuar e gjykuar vetëm brenda legjislacionit shqiptar.<sup>25</sup> Kjo për faktin se me ratifikimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ndodhemi përpara shqyrtimit të çështjeve shqiptare nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, vendimet e së cilës, për nga efektet juridike, mbartin në vetvete edhe sanksione ndaj shtetit, kur ai nuk ka respektuar të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve të tij. Konventa Evropiane e

---

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> OSBE Ppresenca në Shqipëri, Analizë e sistemit ligjor në Shqipëri, Tiranë, 2004

të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, nënshkruar në Romë më 4 nëntor 1950, është ratifikuar nga Shqipëria më 2 dhjetor 1996. Protokollin nr. 11 i Konventës, i cili ka hyrë në fuqi, më datë 1 nëntor 1998, parashikon detyrimin e gjykatës, për të shqyrtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkesat individuale. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, është ratifikuar tashmë nga Republika e Shqipërisë dhe si e tillë, ajo përbën një akt normativ në fuqi në gjithë territorin e vendit, sipas përcaktimit të nenit 122 të Kushtetutës. Vetë Konventa, është një traktat ndërkombëtar, me anë të të cilit shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, janë angazhuar të garantojnë të drejtat njerëzore themelore, për gjithë ato persona që janë nën juridiksionin e tyre. Konventa me mekanizmat e saj realizon mbrojtjen që ajo parashikon, si në përfshirjen e normave të saj në të drejtën e brendshme, duke mos lejuar konflikt ndërmjet tyre, ashtu dhe në përmirësimin e procedurave për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore. Pikërisht, këtë ka pasur parasysh ligjvënësi, që ka bërë një parashikim të tillë në nenin 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Por ajo që është më e rëndësishme, është krijimi i një instrumenti, për të kontrolluar zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga shtetet palë në këtë konventë. Dhe ky instrument, është Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Një prej arsyeve që justifikuan kooptimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë në sistemin gjyqësor të Kosovës, përveç dyshimeve të justifikuara mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e profesionistëve vendorë në fillim ishte dhe mungesa, në perceptimin e përgjithshëm profesional, e kapacitetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rekrutuar rishtazi në sistem për të administruar drejtësinë në këtë fazë të brishtë post-konfliktuale. Por nëpërmjet Rregullores 2000/64 UNMIK-u shpallte hapur se qëllimi i sigurimit të pranisë ndërkombëtare në gjyqësor ishte gjykimi i rasteve objekt i punës së ndërkombëtarëve, duke mos konsideruar më në rend të ditës ndërtimin e kapaciteteve në gjyqësorin kosovar.

Ndërveprimi ndërmjet gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe kolegëve të tyre vendorë pothuajse u ndërpre. Edhe në rastet ku jo të tre anëtarët e kolegjit të formuar sipas Rregullores 2000/64 ishin ndërkombëtarë, barriera si mungesa e komunikimit për shkak të gjuhës e bënë këtë ndërveprim pothuajse të pamundur dhe në mjaft raste roli i gjyqtarit vendor në këto kolegje miske, të paktën në perceptimin e përgjithshëm, ishte thjesht formal. Por duhet theksuar gjithashtu se bashkëveprimi ndërmjet kolegëve vendorë dhe ndërkombëtarë tanimë nuk konsiderohej i dobishëm as prej vendorëve. Në opinionin e përgjithshëm të magistratëve kosovarë gjyqtarët ndërkombëtarë nuk shikoheshin më si “shpëtimtarët” e sistemit gjyqësor dhe aq më pak besohej se ata do të kontribuonin në “ringritjen” dhe modernizimin e gjyqësisë kosovare në përputhje me standardet perëndimore të synuara. Gjyqtarët ndërkombëtarë, rëndom shiheshin si juristë të cilëve u mungonte njohja e sistemit ligjor këtu dhe eksperiencia në këtë sistem. Duhet thënë se gjyqtarët ndërkombëtarë të rekrutuar prej UNMIK-ut në vitet 2000-2001 vinin kryesisht prej Afrikës, Azisë dhe Evropës Juglindore, ndërsa ishte e vështirë për Amerikanoveriorët apo Europiano-perëndimorët të shkëputeshin prej gjykatave në vendet e tyre për të shërbyer, për një periudhë 6-mujore në Kosovë<sup>26</sup>. Ky element perceptohej gjerësisht në komunitetin e magistratëve kosovarë si burim dyshimi në profesionalizmin dhe kualifikimin e këtyre magistratëve për të shërbyer cilësisht në sistemin gjyqësor vendor. Një perceptim i tillë shkonte deri aty sa t’u vishte gjyqtarëve ndërkombëtarë në Kosovë një tis arrogance që motivohej shpesh me trajtimin material të tyre të pakrahasueshëm me atë të kolegëve vendorë dhe me imunitetin diplomatik që gëzonin zyrtarët gjyqësorë ndërkombëtarë si nëpunës të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Megjithëse ngritja e

---

<sup>26</sup> “Lessons from the Deployment of International Judges and Prosecutors in Kosovo” prej International Center for Transitional Justice, March 2006, fq. 15-17

kapaciteteve në gjyqësorin e Kosovës është parë gjithmonë si prioritet prej UNMIK-ut në kuadrin institucional pothuajse nuk ka pasur përpjekje në këtë drejtim. Ngritja kualitative e performancës dhe përmirësimi cilësor profesional i prokurorisë dhe gjyqësorit të Kosovës është artikuluar shpesh si nevojë në rrethin e përfaqësuesve ndërkombëtarë në këto institucione, por ky artikulum nuk është shoqëruar me veprime konkrete. Nëse në vitet e para të ndërfutjes në sistem të profesionistëve ndërkombëtarë, këta të fundit organizonin dhe merrnin pjesë në trajnime të përbashkëta profesionale me kolegët e tyre vendorë<sup>27</sup>, një praktikë e tillë erdhi duke u harruar për t'u braktisur me kohë plotësisht. Madje, as miratimin i legjislacionit të ri penal<sup>28</sup> nuk u pa si një rast i mirë për të përfituar në këtë drejtim, duke organizuar seminare apo trajnime të përbashkëta mes gjyqtarëve/prokurorëve ndërkombëtarë dhe atyre vendorë për ballafaqimin e paqartësive, njehsimin e të kuptuarit të institucioneve të reja dhe ravijëzimin e praktikave të njehsuara në zbatimin e këtij legjislacioni.

---

<sup>27</sup> "Review of the Criminal Justice System in Kosovo", OSCE/legal System Monitoring Section 2001

<sup>28</sup> Në 6 prill 2004 në fuqi hyri Kodi i Ri i Përkohshëm i Procedurës Penale dhe Kodi i Ri i Përkohshëm Penal i Kosovës. Këto dy ligje të rëndësishme u shpallën nëpërmjet Rregulloreve të UNMIK-ut Nr. 2003/26

## **SHTOJCA A**

### **LIGJE DHE RREGULLORE**

Dihet fare mire se shteti serb veçanërisht gjate periudhës 1991 kur e pat suprimuar me dhune autonominë politike te Kosovës e deri në vitin 1999, kur në Kosovë patën hyrë forcat e NATO-s( Rangelov) të quajtura KFOR( Rangelov) dhe UÇK-ja( Rangelov), ndër të tjera masa të dhunës shtetërore antishqiptare pat miratuar dhe zbatonte dispozita juridike diskriminatore në favorin serb dhe në disfavorin shqiptar. Përfaqësuesi Special i Sekretarit Gjeneral të OKB-ës për Kosovën I inspiruar edhe nga Shoqata e Juristëve të Kosovës, pate miratuar rregulloren e UNMIK-ut, nr.21/99, me të cilën I pate fuqizuar të gjitha dispozitat e deri atyshme të karakterit discriminator. Ndër kaq dispozitat juridike të karakterit parimor dhe në harmoni me standardet e shteteve të së drejtës, me atë Rregullore ka qenë lënë në fuqi.

Së andejmi sanksionet penale në Kosovë nga viti 1999 gjer në shpalljen e pavarësisë së sajë në vitin 2008, kryesisht janë përmbaruar në konformistet me parimet juridike valide edhe në rrafshin ndërkombëtar. Gjatë kësaj periudhë janë miratuar jo pak akte juridike referuar ekzekutimit te sanksioneve penale. Akte juridike këtilla janë miratuar kryesisht ne forme te rregulloreve(Kodi Penal i Kosoves nr 25 / 2003, KODI I Procedures Penale i Kosoves nr. 1). Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13 “Për Krijimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit”.

Rregullorja e UNMIK-ut 2005/52 “Për krijimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës”.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/8 “Për krijimin e Këshillit Gjyqësor dhe Prokuroria

të Kosovës”, prill 2001.

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 “Për caktimin e gjyqtarëve /prokurorëve ndërkombëtarë dhe/ose ndryshimin e vendit të zhvillimit të gjykimit.”

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/34 “Mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/6 Për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të prokurorëve ndërkombëtarë dhe gjyqtarëve ndërkombëtarë”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/6 “Për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të prokurorëve ndërkombëtarë dhe gjyqtarëve ndërkombëtarë”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/5 “Për krijimin e Gjykatës ad hoc të instancës së fundit dhe prokurorisë ad hoc”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

Rregullorja e UNMIK –ut 1999/6 “Për rekomandimet mbi strukturën dhe administratën e shërbimit gjyqësor dhe të prokurorisë”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/7 “Për Emërimin dhe Shkarkimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”, Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut.

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, ndryshim plotësim (2008/03-L-003)

Kodi Penal i Kosovës, ndryshim plotësim (2008/03-L-002)

Kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it (2008/03-L-053)

Letërnjoftimin (2008/03-L-099)

Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ndryshim i Ligjit nr. 03/L-045 (2008/03-L-107)

Noterin ë(2008/03-L-010)

Policinë (2008/03-L-035)

Procedura përmbare (2008/03-L008)

Agjencinë Kosovare për Inteligjencë (2008/03-L-063)



Azil (2008/03-L066)

Faljen (2008/03-L-101)

Gjykata Kushtetuese (2008/03-L-121)

Instituti Gjyqësor të Kosovës (2006/02-L-25)

Këshillin e sigurisë së Kosovës (2008/03-L-050)

Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (2008/03-L-052)

Diskriminimi (2004/3)

Në procedure të caktuar, para miratimit të dispozitave penale referuar ekzekutimit të sanksioneve penale, vlerësohet koherenca e tyre me legjislacionin e Unionit Europian (Acquitas Communitarie) Administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (2010/03-L-189)

Agjencinë e Kosovës për Forenzikë (2011/04-L-064) Ligji është miratuar në Kuvend me 14.10.2011, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-042-2011, Datë 01.11.2011

Ligji për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore (2011/04-L-067) Ligji është miratuar në Kuvend me 24.05.2012, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-028-2012, Datë 08.06.2012

Akademinë e Kosovës për siguri publike (2011/04-L-053) Ligji është miratuar në Kuvend me 21.10.2011, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-045-2011, Datë 15.11.2011

Amnistinë (2013/04-L-209) Ligji është miratuar në Kuvend me 11.07.2013, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-51-2013, Datë 17.09.2013

Armët (2009/03-L-143) Ligji është miratuar në Kuvend me 17.09.2009, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-025-2009, datë 13.10.2009.

Aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës (2010/03-L-238) Ligji është miratuar në Kuvend me 28.10.2010, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-068 -2010, Datë 09.11.2010.

Azil (2011/04-L-073) Ligji është miratuar në Kuvend me 21.12.2011, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-057-2011, Datë 30.12.2011

Bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale (2011/04-L-031) Ligji është miratuar në Kuvend me 31.08.2011, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-027-2011, Datë 31.08.2011.

Bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale (2013/04-L-213); Ligji është miratuar në Kuvend me 31.07.2013, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-47-2013, Datë 19.08.2013

Bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit (2013/04-L-216); Ligji është miratuar në Kuvend me 31.07.2013, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-40-2013, Datë 19.08.2013

Deminim humanitar (2011/04-L-089); Ligji është miratuar në Kuvend me 15.03.2012, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-011-2012, Datë 02.04.2012

Ekzekutimin e sanksioneve penale (2010/03-L-191); Ligji është miratuar në Kuvend me 22.07.2010, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-043-2010, Datë 09.08.2010.

Ekzekutimin e sanksioneve penale (2012/04-L-149) Ligji është miratuar në Kuvend me 29.07.2013, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-35-2013, Datë 16.08.2013

Gjykatat (2010/03-L-199) Ligji është miratuar në Kuvend me 22.07.2010, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-047-2010, Datë 09.08.2010.

Inspektoratin Policor të Kosovës(2010/03-L-231); Shpallur, në pajtim më nenin 80.5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, datë 10.11.2010

Këshillin Gjyqësor të Kosovës(2010/03-L-223); Ligji është miratuar në Kuvend me 30.09.2010, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-053 -2010, Datë 18.10.2010

Këshillin Prokurorial të Kosovës (2010/03-L-224); Ligji është miratuar në Kuvend me 30.09.2010, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-051 -2010, Datë 18.10.2010

Kodi i drejtësisë për të mitur (2010/03-L-193) Ligji është miratuar në Kuvend me 08.07.2010, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-039-2010, Datë 28.07.2010.

Kodi i procedurës penale (2012/04-L-123): Ligji është miratuar në Kuvend me 13.12.2012, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-57-2012, Datë 21.12.2012

Kodi penal i Republikës së Kosovës (2011/04-L-082) Shpallur me Vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-399, datë 22 qershor 2012

Kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë (2012/04-L-140); Ligji është miratuar në Kuvend me 11.02.2013, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-02-2013, Datë 26.02.2013

Marrëveshjet ndërkombëtare (2011/04-L-052); Shpallur në pajtim me nenin 80.5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, datë 08.12.2011

Mbrojtjen e dëshmitarëve (2011/04-L-015); Ligji është miratuar në Kuvend me 29.07.2011, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-020-2011, Datë 12.08.2011

Parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit (2013/04-L-218); Ligji është miratuar në Kuvend me 31.07.2013, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-43-2013, Datë 19.08.2013

Policinë (2011/04-L-076); Ligji është shpallur me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr.04-V-310, datë 02.03.2012

Procedurën përmbaremore (2012/04-L-139); Ligji është miratuar në Kuvend me 20.12.2012, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-01-2013, Datë 03.01.2013

Prokurorin e Shtetit (2010/03-L-225); Ligji është miratuar në Kuvend me 30.09.2010, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-049 -2010, Datë 18.10.2010.

## Akte nënligjore për ekzekutimin e sanksioneve penale në Kosovë

Në mesin e burimeve të tjera të së drejtës penale, duhet cekur ato ligje apo norma juridike të cilat paraqiten si burim indirekte, plotësuese dhe sekondare. Këtu në radhë të parë duhet cekur kodin e procedurës penale dhe ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale, si burime të rëndësishme për të drejtën penale konsiderohen ligji për organizimin e gjykatave, ligji për prokurorinë dhe ligji për policinë. Në mesin e burimeve anësore dhe plotësuese duhet cekur disa dispozita të normave tjera juridike. Kjo është kur situata kur ligji në mënyrë të drejtpërsëdrejti, apo në mënyrë indirekte i referohet apo udhëzojnë ndonjë normë tjetër juridike, e cila e qartëson apo e plotëson normën juridike penale. Këto janë të ashtuquajturat normat blankete. Psh. neni 152. të KPPK, parashihet si vepër penale kushdo që në kundërshtim me dispozitat ligjore mbi ndërprerjen e shtatzënisë dhe me pëlqimin gruas shtatëzanë ndërpre në shtatzëninë. Ose vepra penal trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor, neni 219. të KPPK. Si burime indirekte dhe plotësuese të së drejtës penale janë gjithashtu ligjet tjera dhe normat apo aktet nënligjore si deh aktet e përgjithshme. Gjithashtu si burim i drejtës penale janë edhe rregullat e profesioneve, rregullat teknike ,në raste kur ligji penal u referohet këtyre. Burimet indirekte dhe plotësuese janë më se të domosdoshme, ngas me teknikën juridike të kodit penal nuk është e mundur të parashihen të gjitha ngjarjet, situatat në jetën e përditshme e as t'i përcjell me norma juridike zhvillimin e shpejt të teknikës dhe shkencës. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm zbatohet si në gjykimet civile ashtu edhe penale<sup>29</sup>. Procedura penale ekzekutive në Kosovë është e rregulluar me Kodin e Procedurës Penale të

---

<sup>29</sup> Res judicata është një çështje që është vendosur përfundimisht përmes vendimit gjyqësor. Shih Fjalorin "Black's Law" Edicionin e Tetë, (Shtetet e Bashkuara, Thomson West, 2004) fq. 1336

Kosovës<sup>30</sup> dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Aktgjykimi në gjykatën penale të shkallës së parë shpallet nga kryetari i trupit gjykues menjëherë pasi të merret nga gjykata.<sup>38</sup> Kësaj shpalljeje verbale i pason aktgjykimi me shkrim. Aktgjykimi duhet “të përpilohet me shkrim brenda pesëmbëdhjetë ditë nga shpallja e tij kur i akuzuari gjendet në paraburgim, ndërsa brenda tridhjetë ditë në rastet tjera”(KPPK, 2003).

Aktgjykimet penale mund të ekzekutohen vetëm kur “kur është bërë dorëzimi dhe kur për ekzekutimin e tij nuk ka pengesa ligjore” ( Ligji Nr. 03/L – 191 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, 22 korrik 2010). Një pengesë ligjore për ekzekutim është se aktgjykimi nuk merr formë të prerë deri kur “nuk mund të kundërshtohet me ankesë ose kur nuk lejohet ankesë” ( Ligji Nr. 03/L – 191 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, 22 korrik 2010). Është në këtë fazë procedurale, në pikën e aktgjykimit përfundimtar, kur i pandehuri definohet si “person i dënuar”( KPPK,Neni 151(4, 2003)) dhe sanksioni ndaj tij mund të caktohet.

Duke qenë se Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve penale vetëm në parim rregullon kompetencat, përgjegjësitë, organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Korrektues, aktet nënligjore (rregulloret, udhëzimet administrative, rregullat e brendshme, rendet shtëpiak etj), përcaktojnë dhe kompletojnë infrastrukturën ligjore të Shërbimit korrektues të Kosovës. Për nga numri dhe vëllimi si dhe pesha e tyre aktet e brendshme normative të Shërbimit Korrektues të Kosovës janë mjaft voluminoze. Vetë ndjeshmëria e punës së këtij shërbimi dikton dhe kërkon krijimin e rregullave të shumta me qëllim të rregullimit të të gjitha segmenteve të punës në këtë shërbim. Disiplina e kërkuar, hierarkia e brendshme dhe vendimmarrës, përcaktimi i përgjegjësive të qarta të gjitha aktorëve të

---

<sup>30</sup> Res judicata është një çështje që është vendosur përfundimisht përmes vendimit gjyqësor. Shih Fjalorin “Black’s Law” Edicionin e Tetë, (Shtetet e Bashkuara, Thomson West, 2004) fq. 1336

Shërbimit Korrektues, standardet e ndryshme teknike, shëndetësore, rregullat e komunikimit me botën e jashtme etj, kërkojnë infrastrukturë të plotë legislative (Sijerçiq – Çoliq, Haliloviq, 2007).

### **Udhëzime administrative**

Ministria e Drejtësisë ka nxjerrur këto udhëzime administrative që i referohen Shërbimit Korrektues të Kosovës:

1. Udhëzim administrativ për pranimin dhe vendosjen e personave të burgosur në institucionet korrektuese
2. Udhëzim administrativ për ofrimi i shërbimeve mjekësore ne institucionet korrektuese
3. Udhëzim administrativ për veshmbathje dhe paraqitje te stafit të uniformuar te institucioneve te shërbimit korrektues të Kosovës
4. Udhëzim administrativ për ushqimin e te burgosurve ne institucionet korrektuese
5. Udhëzim administrativ mbi llogaritjen e dënimeve dhe lirimin për personat e dënuar
6. Udhëzim administrativ vizitat
7. Rregullore e brendshme për menaxhimin e parave private të burgosurve
8. Udhëzim administrativ kushtet e punës dhe shpërblimi për punën e të burgosurve në institucionet korrektuese
9. Udhëzim administrativ për trajtimin e të burgosurve në institucionet korrektuese
10. Udhëzim administrata për pushim jashtë institucionit korrektues
11. Udhëzim administrativ për pakot higjienike dhe pakot ushqimore

12. Udhëzim administrativ korrespondenca
13. Udhëzim administrativ për, kushtet e punës dhe kompensimi në rast të paaftësisë së shkaktuar në punë për të burgosurit.
14. Udhëzim administrativ orari i punës i personelit të SHKK-ës
15. Orari i punës të stafit korrektues
16. Udhëzim administrativ pushimet e personelit të SHKK-ës
17. Udhëzim administrativ procedurat e disiplinës
18. Udhëzim administrativ dosjet e personelit
19. Udhëzim administrativ ndërprerja e mardhënjes së punës për personelin e SHKRKës
20. Udhëzim administrativ mbi vlerësimin e kryerjes së punëve
21. Udhëzim administrativ organizimi dhe strukturimi i shërbimit korrektues të republikës së Kosovës
22. Udhëzim administrativ procedurat e mundësive të barabarta
23. Udhëzim administrativ procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave
24. Udhëzimin administrativ mbi periudhën provuese
25. Udhëzimi administrativ procedurat e rekrutimit udhëzim administrativ procedurat e kontratave
27. Udhëzim administrativ për përshkrimin e detyrave të punës
28. Udhëzimi administrativ për kalimin e kohës në lokalet e veçanta të institucioneve korrektuese
29. Udhëzimi administrativ për menaxhimin zyrtarë të arkivit në SHKK



## PËRFUNDIMEVE DHE REKOMANDIME

Legjislacioni penal dhe ai procedural penal vihen në mbrojtje të interesave të gjithë shoqërisë, nga këto legjislacione parashikohen veprat dhe sanksionet penale, rregullat procedurale të hetimit, gjykimit e dënimit të autorëve, ekzekutimit vendimeve penale, të drejtat e detyrimit e organeve dhe subjekteve procedurale penale. Është detyrë kushtetuese e ligjore e organeve të ndjekjes penale, të cilat nën autoritetin dhe në emër të shtetit të luftojnë kriminalitetin, duke ushtruar ndjekjen penale ndaj autorëve të veprave penale në përputhje të plotë me Kushtetutën, me legjislacionin penal dhe me konventat ndërkombëtare në mbrojtje të drejtave e lirive themelore të individit.

Legjislacioni procedural penal në vetvete përbëhet nga tërësia e gjithë rregullave procedurale që normojnë e rregullojnë gjithë procesin penal, duke vendosur një ekuilibër sa më të drejtë midis mbrojtjes së interesave të shoqërisë duke luftuar me efektivitet kriminalitetin, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, zhvillimin e një procesi penal duke respektuar e mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të individit. Një nga institutet më të rëndësishme të së drejtës procedurale penale është ai i “provave penale dhe procesit të provuarit” i cili me të drejtë është konsideruar si instituti bosht i kësaj të drejte. Rëndësia e provave penale dhe e procesit të provuarit përcaktohet nga vetë qëllimin dhe përmbajtja e legjislacionit penal. Instituti i provave penale dhe procesit të provuarit, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmbajtjen dhe detyrën e kësaj shkence, me atë që quhet procesi i zbulimit dhe i të provuarit të së vërtetës në procesin penal.

Sanksionet penale janë masa të dhunshme penalo-juridike të cilat i shqipton gjykata në procedurën e përcaktuar në ligj ndaj kryesit të veprës penale, me qëllim të mbrojtjes së

shoqërisë dhe individit nga kriminaliteti, ndërsa konsistojnë në marrjen apo kufizimin e lirive dhe të drejtave të caktuara apo në terheqjen e vërejtjes kryesit se do ti merren apo kufizohen liritë apo të drejtat nëse sërish kryen veprë penale.

Karakteristikat themelore të sanksioneve penale – Janë: a) me anë të sanksioneve penale shoqëria mbron nga kriminaliteti vlerat më të rëndësishme të individit dhe të bashkësisë shoqërore; b) sanksionet penale mund tu shqiptohen vetëm kryersve të veprave penale; c) ndaj kryersve të veprave penale mund të shqiptohet vetëm ai sanksion penal i cili është paraparë me ligj në momentin e kryerjes së veprës penale (parimi i legalitetit); ç) sanksionet penale mund ti shqiptojë vetëm gjykata në bazë të procedurës së përcaktuar me ligj; d) me anë të sanksioneve penale, kryersve të veprave penale u merren apo u kufizohen liritë dhe të drejtat e tyre.

Llojet e sanksioneve penale në përgjithësi – Njihen disa lloje të sanksioneve penale: dënimet kryesore, dënimet alternative, dënimet plotësuese, masat sigurose, masat edukative, dënimi me kusht dhe vërejtja gjyqësore.

Llojet sipas sistemit tonë penal – Janë: 1. Dënimet kryesore, 2. Dënimet alternative, 3. Dënimet plotësuese, dhe 4. Vërejtja gjyqësore.

Dënimet kryesore – Shqiptohen ndaj personave madhorë, të cilët janë penalishttë përgjegjshëm për veprën penale të kryer, dmth., personi duhet të jetë psikikisht i shëndoshë dhe që veprën penale ta këtë kryer me fajin e tij (me dashje apo nga pakujdesia). Për nga natyra dhe brendia e tyre, në tërë sistemin e sanksioneve penale dënimet kryesore janë qortim social-etik të intensitetit të lartë, me të cilat kryesit të veprës penale i merren apo i kufizohen liritë dhe të drejtat e rëndësishme.

Dënimet alternative – Në brendinë e tyre janë substitute, zëvendësim i dënimit me burgim. Kryesi i veprës penale në vend që të dënohet me burgim nga ana e gjykatës, atij

i terhiqet vërejtja dhe njëherit i caktohen obligime të cilat duhet ti përmbushë brenda afatit të caktuar nga gjykata. Dënimet alternative mund të revokohen dhe të shndërrohen në dënim me burgim.

Dënimet plotësuese – Janë të karakterit sekondar dhe i plotësojnë dënimet kryesore. Sipas kodit penal, këto dënime gjithëherë mund të shqiptohen vetëm së bashku me dënimin kryesor. Në rastet kur gjykata konstaton se vetëm me shqiptimin e dënimit kryesor nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit, do ta shqiptojë edhe njërin nga dënimet plotësuese. Gjer me hyrjen në fuqi të kodit penal të Kosovës, shumica dërrmuese e dënimeve plotësuese, që parashihen me kodin penal, janë konsideruar si masa siguruese.

Vërejtja e gjykatës – Si lloj i sanksionit penal, në brendinë e saj është e karakterit parapenal. Është e paraparë për llojet e lehta të veprave penale. Me këtë lloj të sanksionit penale kryesit të veprës penale gjykata ia terheq vërejtjen dhe e qorton dhe njëherit ja bën me dije se nëse sërish kryen veprë penale, do ti shqiptohet lloji i sanksionit penal më të rëndë. Vërejtja e gjykatës shqiptohet me vendim të gjykatës.

Ndryshe nga ligji shqiptar ku rolin kryesor e ka prokurori në ekzekutimin e vendimit gjyqësor (në komunikimet me Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale përkatëse për sistemimin e të dënuarit, në përcjelljen e kërkesave që paraqet në gjykatë mbi mënyrën e ekzekutimit, ruajtine e kontateve të vazhdueshme me Shërbimin e Provës për ekzekutimin e dënimeve alternative etj.) në Republikën e Kosovës është gjykata që ka rol aktiv dhe kryen veprime të drejtëpërdrejta me institucionet korrektuese, po ashtu edhe këto të fundit njoftojnë gjykatën kur nuk është paraqitur i dënuari vullnetarisht, nuk gjendet etj (Ligji Nr. 04/L-149 “Për Ekzekutimin E Sanksioneve Penale” Gazeta Zyrtare datë 28/08/201, nenet 16-18). Kryetari i gjykatës themelore gjykon kërkesat për shtyrjen

e ekzekutimit, revokimin e shtyrjes së ekzekutimit etj (Ligji Nr. 04/L-149 “Për Ekzekutimin E Sanksioneve Penale” Gazeta Zyrtare datë 28/08/201, nenet 23§1 Dhe 27 § 1). dhe ankimi ndaj këtij vendimi bëhet tek Kryetari i Gjykatës së Apelit. Sipas Raportit të CEPEJ në 22 shtete të Europës është gjykata subjekti që ekzekuton vendimet gjyqësore penale. Në përgjithësi, këto gjyqtarë nuk janë të njëjtët me ato që kanë dhënë vendimin e formës së prerë por Këshilli i Europës inkurajon shtetet antarë që gjyqtarët të jenë të specializuar dhe të veçantë vetëm për ekzekutimin e vendimeve penale duke rritur kështu shpejtësinë dhe cilësinë e gjyqimit (Ligji Nr. 04/L-149 “Për Ekzekutimin E Sanksioneve Penale” Gazeta Zyrtare datë 28/08/201, neni 24§1). Ka vende të tjera që kanë qasje tjetër në ekzekutimin e vendimeve penale si p.sh në pesë shtete si Armenia, Belgjika, Islanda, Moldavia dhe Suedia ekzekutimi i vendimit penal i lihet autoriteteve të burgjeve (korresponduese me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Shqipëri), në shtete të tjera si Bullgaria, Kroacia, Finlanda, Gjerogjia, Lituania, Sllovakia, Ukraina etj. Ministria e Drejtësisë ekzekuton vendimet gjyqësore penale. Në 16 vende të tjera përfshin edhe Gjermaninë etj. u lihet institucioneve të veçanta, të pavarura nga pushteti gjyqësor, ndërsa në Irlandë është policia e shtetit, në Qipro i ekzekuton një kompani private dhe agjentët e saj nën mbikqyrjen e Ministrisë së Drejtësisë (Ligji Nr. 04/L-149 “Për Ekzekutimin E Sanksioneve Penale” Gazeta Zyrtare datë 28/08/201:29-30).

### **Rekomandimet:**

1. Sugjerohet më tepër bashkëpunim mes Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës, përmbarimit gjyqësor, gjykatës dhe prokurorisë në moszvarritjen e proceseve gjyqësore kur gjykohen kërkesat e të dënuarve

apo prokurorisë në fazën e ekzekutimit të vendimit penal për shkak të mosparaqitjes pa shkak të arsyeshëm të subjekteve procedurale, të dokumentacionit të ndodhur tek ta etj. Në këtë raste masat ndëshkuese të parashikuar në ligj ndaj këtyre institucioneve si gjobitja, do të disiplinonte palët dhe do të rriste përgjegjësinë e këtyre subjekteve të cilat kanë për detyrë të ekzekutojnë vendimet gjyqësore penale dhe jo të bëhen pengesë duke ulur në këtë mënyrë edhe besimin e qytetarëve ndaj organeve të drejtësisë.

2. Të gjithë institucionet që marrin pjesë në ekzekutimet e vendimeve penale e sidomos kur veprimet e tyre janë me afat të përcaktuar në ligj duhet t'i zbatojnë ato korrektësisht duke i marrë si afate detyruese dhe jo si afate orientuese si p.sh afati 7 ditë për të gjykuar kërkesën për ndryshimin ose revokimin e dënimit alternativ, 5 ditë për të pezulluar ekzekutimin e urdhërit për punë në interes publik etj. po ashtu edhe prokuroria dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve duhet të zbatoj afatet e tyre për të nxjerrë urdhërin për të ekzekutuar vendimet penale, për të pranuar të dënuarin në Institucion etj.

3. Proçedurat e ekzekutimit të vendimit penal sipas Opinionit nr.12 (2010) “Mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore” të Këshillit KONSultativ të Gjyqtarëve Europian të Këshillit të Europës duhet të orienton që ekzekutimi i vendimeve gjyqësore penale të mos jetë burokratik dhe me shpenzime të larta por me veprime sa më direkte të insitucioneve në zbatimin e këtyre vendimeve.

4. Mendoj se duhet të parashikohet në Kodin e Proçedurës Penale ose në ligjin nr. 8331/1998 rritje të kompetencave të gjykatës që të mbikqyr zbatimin e vendimit penal qoftë edhe kryesisht dhe të mos presë në çdo rast që të investohet nga ana e të dënuarit apo të prokurorit, të krijohen mundësi që gjyqtari i ekzekutimit të vendimeve penale të bëj vizita periodike në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale që ndodhet në territorin e gjykatës ku të dënuarit të kenë kontakte drejtpërdrejtë me gjyqtarintë shtohen

mënyrë logjistike, kapacitete njerëzore për të monitoruar postën elektronike ose një numër pa pagesë (numër jeshil) për të dënuarit/ të paraburgosurit, të krijohen faqe zyrtare anonime të ankesave të të dënuarve për në Gjykatë për shkelje të të drejtave të tyre themelore gjatë kryerjes së burgimit ose gjatë paraburgimit etj.

5. Të publikohen periodikisht nga një organ i pavarur, si p.sh nga Komitetit Shqiptar i Helsinkit, Avokati i Popullit një raport mbi efektivitetin e ekzekutimeve të vendimeve penale ose të krijohet një strategji kombëtare mes disa organeve shtetërore të përfshira në këtë lëndë si: Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Brëndëshme, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit Gjyqësor etj. të arrijnë objektiva afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë etj. Në nëntor 2010 Këshilli Gjyqësor Kombëtar në Republikëne Kosovës publikoi Strategjinë shtetërore “Për zvoglimin e të lëndëve të vjetra të grumbulluara “ ku në një memorandum të përbashkët janë parashikuar detyrat e institucioneve të përfshira dhe çdo vit hartohet një raport mbi arritjet për të zvogluar dosjet e prapambetura civile, penale etj. të pa ekzekutuara e cila ka përmisuar situatën e ekzekutimeve të vendimeve penale të vonuara.

## LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

### Literaturë:

- 1) Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008 [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf ]
- 2) Andrew, Coyle, Drejtimi I burgut nga këndvështrimi I të drejtave të njeriut 2005, komiteti Shqiptar i Helsinkit
- 3) Berislav Pavišić, La comparazione dei principali sistemi penali europei, Università degli Studi di Macerata, Facoltà di Giurisprudenza, Corso integrativo di Diritto e Procedura Penale Comparati, dhjetor 2002
- 4) Borislav Petroviq, E drejta penale, Ssarajevë /Pristinë 2006, FSK/S - 14/06
- 5) Cartledge (1995) in: Harris, R. et al Probation Round the World, Coles, B. (1995) Youth and Social Policy, London: UCL Press
- 6) Council of Europe, European Rules for Juvenile Offenders Subject to Sanctions Or Measures Business & Economics - 2009
- 7) Cowdery, N. AM QC, Effectiveness of the criminal law, Legal Studies State Conference 2008, Rosehill, 27 Mars 2008
- 8) Halili, Ragip, (2014), Penologjia, UP. Prishtinë, Fakulteti Juridik
- 9) Hysi V. (2012) “Penologjia” Tiranë, Shqipëri, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.
- 10) Instituti Kosovar Për Kërkime Dhe Zhvillime Të Politikave, Drejtësia tranzicionale në Kosovë, Prishtinë, qershor 2009
- 11) Isuf Sadiku, Ekzekutimi i Sanksioneve Penale në Dritën e Akteve më të reja Ndërkombëtare, Botuar nga autori, Prishtinë 2010

- 12) Kambovski, V. E drejta penale, pjesa e përgjithshme, SHB Furkan ISM, Shkup 2007, f.56
- 13) Keçmezi-Basha Sabile, Të burgosurit politikë shqiptar në Kosovë 1945-1990, Prishtinë 2009, Logos A,
- 14) N. Maric – Petrovic, Kriza zatvora, 2007, Beograd, str. 398
- 15) Omari, L. Shteti i së drejtës, Tiranë 2002,
- 16) Opširno o ovom vanrednom pravnom lijeku *Murati, R.*: Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja. Prishtinë, 2006.
- 17) Pavarini, M. Lo scopo della pena, Roma 1997,
- 18) Penal i Kosovës. Këto dy ligje të rëndësishme u shpallën nëpërmjet Rregulloreve të UNMIK-ut Nr. 2003/26
- 19) Pradel, J. Corstens, G. Vermeulen, G. E drejta penale evropiane, Botimet Papirus, Tiranë 2010, f.12
- 20) Puto, A., E drejtë ndërkombëtare publike, Tiranë, 2010
- 21) Ragip Halili, Penologjia, e drejtja e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë, 2014
- 22) Rangelov, Iavor. Hyrja në BE, kushtet dhe drejtësia kalimtare në ish-Jugosllavi, LSE
- 23) Raporti për monitorimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë i hartuar nga Fondacioni Soros
- 24) Res judicata është një çështje që është vendosur përfundimisht përmes vendimit gjyqësor. Shih Fjalorin “Black’s Law” Edicionin e Tetë, (Shtetet e Bashkuara, Thomson West, 2004) fq. 1336



- 25) Review of the Criminal Justice System in Kosovo, OSCE/legal System Monitoring Section 2001
- 26) Sahiti, E., E Drejta e Procedurës Penale, f. 54, u shtyp në “Rominor” prishtinë, 2005
- 27) Salihu, Ismet, (2012), E Drejta Penale, Botimi I pestë, Un.Fama, Prishtinë, f. 28
- 28) Scozzari dhe Giunta kundër Italisë [DHM], nr. 39221/98 dhe 41963/98, GJEDNJ 2000-VIII, para. 249; Assanidze kundër Gjeorgjisë [DHM], nr. 71503/01, GJEDNJ 2004-II, para. 198
- 29) Sluzbeni glasnik Republike Srbije, 16, 1997
- 30) Službëni list FNRJ, br. 47&1951
- 31) Sluzhbeni list, SFRJ, nr. 9/1974, Kushtetuta e re republikës Socialiste Federative të Jugosollavisë
- 32) Sylejmanov, Zoran , (2000 ), Pedagogjia, Shkup, f..36
- 33) tephen, N. leksion i vitit 1999 në Annual Lawyers’ Lecture për qëndrën St James Ethics Centre
- 34) Thomas Hammarberg, Komisionar për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës; Zbatimi me të Meta i Vendimeve Gjyqësore Zbeh Besimin në Drejtësinë e Shtetit; 31 gusht 2009.
- 35) UNHCR. Serbia dhe Mali i Zi: Kosovë. Instituti Kosovar Për Kërkime Dhe Zhvillime Të Politikave, Drejtësia tranzicionale në Kosovë, Prishtinë, qershor 2009
- 36) V. I. Bayer 1995., fq. 12–13, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në kuadër të legjislacionit penal në Kosovë, shih më hollësisht R. Murati: „Protection of Human Rights Under Kosovo's Criminal Code and Criminal Procedure Code“. Chicago-Kent Law Review, 80 (2005) 1, str. 99. – 116.

37) Vladimir, B. Beković, Sistem Izvršenja krivičnih sankcija, 2013, Beograd, f. 16

38) Vlado Kambovski, Kazneno- Pravnata Reforma Pred Predizvicitë na XXI VEK, Pravni Fakultet Skopje, 2002, fq. 156.

39) Wagrave, Lode. RJ and beyond – an Agenda for Europe, Paper presentation at the Conference of the European Forum for RJ, Barcelona, Spain 15-17 June 2006

40) Z.M. Stevanovic, Osnovne karakteristike i pravci reforme izvršenja krivičnih sankcija (Zbornik radova), 2000, Beograd, str. 10 - 14

### **Burime Parësore**

1) ABA-CEELI, Analiza e Kornizave Legjislative për Përmbarimin e Vendimeve, CEELI Koleksioni i Letrave nga Hulumtimi, Uashington, D.C., korrik 2003, fq. 1

2) Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara Rezolutën 45/111, datës 14 dhjetor, 1990

3) Azra Adžajlić-Dedović, Restorativno pravosuđe, Sarajevë / Prishtinë, 2007

4) Berislav Pavišić, La comparazione dei principali sistemi penali europei, Università degli Studi di Macerata, Facoltà di Giurisprudenza, Corso integrativo di Diritto e Procedura Penale Comparati, dhjetor 2002

5) Ekstradimi sipas instrumenteve ligjore të BE-së ngjashmëritë dhe ndryshimet me instrumentet e Këshillit të Evropës, Tiranë 2010, Xhafo J. : E drejta penale ndërkombëtare, Tiranë 2009

6) Fornasari, G. Appunti sul sistema sanzionatorio albanese, f.241

7) H., II, Sijerçiq-Çoliq, 2005., fq. 101. Përkufizime të ngjashme të mjeteve juridike mund të hasim edhe te librat tjerë apo te komentet të drejtave të procedurave penale (M., Grubaq, 2006., fq. 429.; B. Pavishiq, 2005., fq. 439.)

8) Hajrija Sijerçiq – Çoliq, Haris Halilović, E drejta e procedurës penale me vështrim të posaçëm në procedurën penale të Kosovës, Prishtinë, 2007

9) Hehir, Aidan. Ndërtimi i Krahinës Autonome. Teoria identifikuese dhe dështimi I UNMIK-ut. Paqëruajtja ndërkombëtare, Vol.13, Nr.2, f. 200-213 (qershor 2006)

10) Kodi i drejtësisë për të mitur i Republikës së Kosovës nr.03&L-193 Prishtinë, 20 gusht 2010

11) Kodi i Drejtësisë për të mitur të Kosovës, nr. 03&L-193, gazeta Zyrtare e Kosovës, 20.08.2010, Prishtinë

12) Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, shpallur në “Gazeta zyrtare” UNMIK – Rreg. Nr. 25, me 6 korrik 2003 dhe ka hyrë në fuqi me 6 Prill 2004, neni 37 pragrafi 2

13) Kodi i Procedurës penale të Kosovës, nr. 04&L – 123, 13 dhjetor 2012, Prishtinë, shpallur me dekretin nr. DL-057-2012, të datës 21.12.2012, nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

14) Kodi Penal i Francës (Gazeta Zyrtare 22 shtator 2002).

15) Kodi Penal I Republikës së Kosovës, nr.04/L-082, Prishtinë, 13 korrik 2012,. I cili ligj ka hyrë në fuqi me 1 janar të vitit kalendarik 2013.

16) Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2010, (nën Rezolutën e KSKB-ve, 1244/1999), SEC (2010) 1329, Bruksel, 9 nëntor 2010,

17) Komitetit Shqiptar të Helsinkut (2012) “Raport mbi situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale janar–dhjetor 2011” Tiranë.

- 18) Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1974, “Rilindja” Prishtinë,
- 19) Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, Prishtinë
- 20) Lessons from the Deployment of International Judges and Prosecutors in Kosovo prej International Center for Transitional Justice, March 2006, fq. 15-17
- 21) Mirsad Abazoviq, Elmedin Muratbegoviq, Haris Haliloviq, Muhamed Budimliq, Edina Beqirevq, Politika e luftimit të kriminalitetit, Prishtinë 2006
- 22) Ligji i ekzekutimit të sanksioneve penale nr.04/L-149, 23 korrik 2013 Prishtinë
- 23) Ligji I Ri për Gjykatat në Kosovë -<http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-199-alb.pdf>
- 24) Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013, shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013,
- 25) Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale nr.04/L-149, aprovuar me 29.07.2013, shpallur me Dekreti Nr.DL-0035-2013,
- 26) Ligji mbi ekzekutimin e Sansioneve Penale, 30 qershor 1977, gazeta zyrtare e Republikës së Sërbisë, nr.26, e datës 30 qershor 1977, i cili ligj ekzekutoheshin sanksionet penale aplikohet në mënyrë unioke në mbarë territorin e Republikës Socialiste të Sërbisë.
- 27) Ligji Nr. 03/L – 191 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, 22 korrik 2010.
- 28) Ligji Nr. 04&L-149, Prishtinë, 29 korrik 2013, Shpallur me dekretin Nr. DL.035-2013, nga Presidentja e Republikës së Kosovës.
- 29) Ligji Nr. 04/L-149 “Për Ekzekutimin E Sanksioneve Penale” Gazeta Zyrtare datë 28/08/201, nenet 16-18.
- 30) Ligji nr. 8328 datë 16/04/1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve ” i ndryshuar.

- 31) Ligji penal I Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, KK Nr. 011-25/77
- 32) Ligji për falje Nr. 03/L-101, aprovuar me 12.12.2008, neni 8, p.2.
- 33) Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve Nr. 04/-L-015, aprovuar me 29.07.2011, neni 4 paragrafi 1
- 34) Ligji për Procedurën Përmbaremore nr. 03/L-008. Aprovuar me 02.06.2008, neni 4, 5, dhe 7
- 35) Ligji për Prokurorinë Publike të Kosovës „Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 32/1976, ndryshimet dhe plotësimet nr. 42/1977, 44/1982. i 44/1984. Ky ligj është lënë në fuqi me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24. Në procedurë e sipër është nxjerrja e Ligjit për Prokurorinë e Kosovës, i cili parasheh një strukturë tjetër për Prokurorinë e Kosovës.
- 36) LIGJI, Nr.7895, datë 27.1.1995, KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË Neni 46, Masat mjekësore dhe edukuese, Rregullat për revokimin e vendimit gjyqësor që përmban masën mjekësore dhe edukuese, parashikohen në Kodin e Procedurës Penale.
- 37) LIGJI, Nr.8331, datë 21.4.1998 (Ndryshuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008) PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE, KREU V, EKZEKUTIMI I URDHËRIMEVE TË TJERA, Neni 45, Ekzekutimi i masës mjekësore
- 38) Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit u miratua më 10 qershor 1999,
- 39) Rregullat e brendshme të punës për Burgun e sigurisë së lartë, mars 20014
- 40) Rregullat e brendshme të punës, Sistematizimi i vendeve të punës, stafi i Qendrave të Paraburgimit, Prishtinë 2009.
- 41) Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e panelit për lirim me kusht, 22.02.2013, neni 12, p.1,2 dhe 3
- 42) Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24

43) Rregullorja e UNMIK-ut, 21/99, për Aplikim e Ligjit në Kosovë

### **Burime Dytësore**

1) Avokati i Popullit, Të drejtat e të burgosurve, Akte ligjore në ndihmë të të burgosurve jashtë Shqipërisë, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, Shqipëri, 2009, fq. 6

2) BalkanInsight, KB: Asnjë dëshmi për Trafikimin e Organeve në Kosovë, 16 prill 2008,

3) Ela Elezi, Efektiviteti i legjislacionit dhe sistemit të drejtësisë penale kundër kriminalitetit në procesin e integritimit evropian, Universiteti i Tiranës, Tiranë 2013

4) Gjykata e Apelit Tirane, Kolegji Penal, Vendimi Nr. 517 Akti, Nr. 330

5) H., Sijerçiq-Çoliq, M. Hadžiomeragiq, M. Jurçeviq,, D. Kaurinoviç, M. Simoviç, 2005., fq. 756.

6) Avokati i Popullit (2012) “*Raport i Veçantë për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë*”, faqja 2, [http://www.parlament.al/web/pub/2012\\_raporti\\_per\\_vendimet\\_gjyqesore\\_15413\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/2012_raporti_per_vendimet_gjyqesore_15413_1.pdf)

7) ECHR, Dybeku v. Albania, 2007, <http://www.shendetesia.gov.al/al/newsroom/deklarata-per-shtyp/spitali-i-psikiatrie-ligjore-beqaj-detyrim-per-ata-qe-kane-nevoje-per-kete-sherbim>, aksesuar më Maj 2014.

8) European Commission For The Efficiency Of Justice (CEPEJ) ” *Enforcement of court decisions in europe*, University Nancy (France) / Swiss Institute of comparative law and discussed by the CEPEJ-GT-EVAL at their 8th meeting, faqe 28.,

[http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/series/etudes8execution\\_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/series/etudes8execution_en.pdf), akses i fundit 12/06/2014.

9) <http://aksp.rks-gov.net/?page=2,144>

10) <http://balkaninsight.com/en/main/news/944>

11) [http://www.ahc.org.al/site/doc/Raport\\_burgje\\_paraburgim\\_final%20shkurt%202012.pdf](http://www.ahc.org.al/site/doc/Raport_burgje_paraburgim_final%20shkurt%202012.pdf).

12) <http://www.docstoc.com/docs/81466758/Drejtoria-e-Pergjithshme-e-Burgjeve>

13) <http://www.euromove.org.uk/index.php?id=13934>

14) [http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/Raporti-Vjetor-Keshilli-Gjyqesor-i-Kosoves-alb\\_868988.pdf](http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/Raporti-Vjetor-Keshilli-Gjyqesor-i-Kosoves-alb_868988.pdf),

15) <http://www.ligjet.org>.

16) [http://www.parlament.al/web/pub/ligjet\\_20\\_11\\_2013\\_14414\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/ligjet_20_11_2013_14414_1.pdf), f. 5.

17) [http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2004regs/RA2004\\_46\\_law.pdf](http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2004regs/RA2004_46_law.pdf)

18) [http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2004regs/RA2004\\_46\\_law.pdf](http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2004regs/RA2004_46_law.pdf)

19) <https://wcd.coe.int/VieëDoc.jsp?Ref=CCJE>

(2010)2&Language=lanEnglish&Ver=original&BackColorInternet=DBDCF2&BackColorIntranet=FDC864&BackColorLogged=FDC864,

20) Komisioneren për Mbrojtjen nga Diskriminimi 20.11.2013, aksesuar më 25.05.2014 nga [http://www.parlament.al/web/pub/ligjet\\_20\\_11\\_2013\\_14414\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/ligjet_20_11_2013_14414_1.pdf)

21) Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Seancë dëgjimore për progresraportin e vitit 2013 me Avokatin e Popullit dhe

22) Konferenca kombëtare, Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore te formës se prere ne mbrojtje te drejtave te individëve, Tiranë, 2003, <http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/ctools/Konf2003.pdf>, fq. 18

23) Kuvendi i Shqipërisë, Projekt-ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve””, të ndryshuar.” [http://www.parlament.al/web/PROJEKTLIGJ\\_P\\_R\\_DISA\\_SHTESA\\_DHE\\_NDRYSHI\\_ME\\_N\\_LIGJIN\\_NR\\_8328\\_DAT\\_16\\_4\\_1998\\_P\\_R\\_T\\_DREJT\\_16180\\_1.php](http://www.parlament.al/web/PROJEKTLIGJ_P_R_DISA_SHTESA_DHE_NDRYSHI_ME_N_LIGJIN_NR_8328_DAT_16_4_1998_P_R_T_DREJT_16180_1.php) .

24) Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Departamenti i Statistikës; Raporti-2010: Statistika e gjykatave të rregullta, faqe 18. E qasshme në Internet në [http://www.kgjks.org/repository/docs/RAPORTI\\_VJETOR\\_Pergjithshm\\_2010\\_SHQI\\_P\\_879988.pdf](http://www.kgjks.org/repository/docs/RAPORTI_VJETOR_Pergjithshm_2010_SHQI_P_879988.pdf) (e qasur më 27 shtator 2014).

25) [www.md-ks,ballina,departamentet.-Sherbimi Korrektues I kosovës,](http://www.md-ks.ballina.departamentet.-Sherbimi_Korrektues_I_kosoves) <http://aksp.rks-gov.net/?page=2,144>